

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË



S T U D I M E **H I S T O R I K E**

1

REDAKSIA

KRYEREDAKTOR

Prof. dr. Hamit KABA

SEKRETAR SHKENCOR

Prof. asoc. dr. Sali KADRIA

BORDI I REVISTËS

Prof. dr. Afrim KRASNIQI (Shqipëri)	Prof. dr. Noel MALCOLM (Britani e Madhe)
Prof. dr. Aurel PLASARI (Shqipëri)	Prof. dr. Oliver Jens SCHMITT (Austri)
Prof. dr. Beqir META (Shqipëri)	Prof. dr. Nathalie CLAYER (Francë)
Prof. dr. Frashër DEMAJ (Kosovë)	Prof. dr. Elias G. SKOULIDAS (Greqi)
Prof. dr. Gjon BERISHA (Kosovë)	Prof. dr. Matteo MANDALÁ (Itali)
Prof. dr. Marenglen VERLI (Shqipëri)	Prof. dr. Martin BERISHAJ (Slloveni)
Prof. dr. Romeo GURAKUQI (Shqipëri)	Prof. dr. Katerina TODOROSKA (Maqedoni e Veriut)
Prof. dr. Sabit SYLA (Kosovë)	Prof. dr. Abdülhamit KIRMIZI (Turqi)
Prof. dr. Teuta SHALA-PELI (Kosovë)	Prof. dr. Fehari RAMADANI (Maqedoni e Veriut)
Prof. dr. Valentina DUKA (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Edmond MALAJ (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Sonila BOÇI (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Gjon Boriçi (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Elidor MËHILLI (SHBA)
Prof. asoc. dr. Hasan Bello (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Anton PANCHEV (Bullgari)

Korrektore gjuhësore: Mimoza KONOMI

Përpunimi teknik & Arti grafik: Mirela MIHALI

ISSN: 3005-8481 (E printuar)

ISSN: 0563-5799 (Online)

Del çdo gjashtë muaj

© Copyright:

Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Adresa e redaksisë: Rruga “Naim Frashëri”, nr.7, Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

faqe

ARTIKUJ SHKENCORË

Eduart CAKA	Vakëfi i Sinan Pashës dhe ndikimi i tij në zhvillimin urbanistik e kulturor të Elbasanit gjatë shek. XVI	5
Yll RUGOVA	Tri letra të Pikolominit gjatë fushatës ushtarake habsburgase në Kosovë (1689)	27
Edmond MALAJ	Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo-Erizzos	53
Alvin SARAÇI	Tregtarët e Voskopojës në portin e Durrësit dhe marrëdhëniet tregtare me Venecien në dy dekadat e para të shek. XVIII	83
Nikollë LOKA	Lëvizjet konkurruese nacionaliste dhe përpjekjet për hapjen e shkollave shqipe në Maqedoni	105
Romeo GURAKUQI	Roli i SHBA-së në rinjohjen e shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore	129
Klejd KËLLIÇI Ermira DANAJ	Emancipimi i gruas: Ligjërimi mbi rolin e gruas në vitet 1960-1970 në faqet e revistës “Shqiptarja e re”	161
Sabit SYLA Nuri BEXHETI	Formacionet shtetërore serbe në Kosovë më 1998-1999	191

DOKUMENTE E MATERIALE

Yll RUGOVA	Dokumente të Pikolominit për fushatën ushtarake habsburgase në Kosovë (1689)	217
------------	--	-----

TABLE OF CONTENT

	<i>page</i>
SCIENTIFIC ARTICLES	
Eduart CAKA	The vaqf of Sinan Pascha and its influence on the urbanistic and cultural development of Elbasan during the century. XVI 5
Yll RUGOVA	Three letters of Piccolomini during the habsburg military campaign in Kosovo (1689) 27
Edmond MALAJ	The political-social circumstances of the migration of Albanians to Zadar and the creation of the Borgo Erizzo colony 53
Alvin SARAÇI	The Merchants of Voskopoja (Moscopoli) in the port of Durazzo and the trade relations with Venice in the first two decades of the 18 th Century 83
Nikollë LOKA	Competing nationalist movements and efforts to open Albanian schools in Macedonia 105
Romeo GURAKUQI	The Role of the USA in the Reestablishment of the Albanian State After World War I 129
Klejd KËLLIÇI Ermira DANAJ	Women's emancipation: Discourse on the role of women in the 1960s-1970s on the pages of the magazine "New Albanian Woman" 161
Sabit SYLA Nuri BEXHETI	Serbian state formations in Kosovo in 1998-1999 191
DOCUMENTS AND MATERIALS	
Yll RUGOVA	Piccolomini's documents on the Habsburg military campaign in Kosovo (1689) 217

EDUART CAKA

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

edicaka@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/yexx2h46>

**VAKËFI I SINAN PASHËS DHE NDIKIMI I TIJ
NË ZHVILLIMIN URBANISTIK E KULTUROR TË ELBASANIT
GJATË SHEK. XVI***

Abstrakt:

Elbasani ishte njëri prej qyteteve më të rëndësishme ekonomike, politike, demografike e kulturore të Shqipërisë gjatë periudhës së sundimit osman. I pozicionuar në një hapësirë strategjike, që kishte qenë përherë aks i lidhjes, komunikimit e rivalitetit kulturor, ekonomik, ushtarak e politik ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, Elbasani pësoi një zhvillim tejet të shpejtë fill pas rindërtimit të tij prej Sulltan Mehmetit II në verën e vitit 1466. I varur fillimisht administrativisht prej Ohrit, brenda një kohe të shkurtër Elbasani u kthye në qendër sanxhaku, duke përfshirë nën juridiksionin e tij hapësira territoriale që shtriheshin nga bregdeti i Durrësit, Kavajës e Bashtovës deri në pjesët malore të Çermenikës. Të gjitha këto resurse ekonomike e demografike u pozicionuan në qendrën e sanxhakut, qytetin e Elbasanit që përjetoi një urbanizim të shpejtë. Ky artikull synon të trajtojë rolin e vakëfeve, në rastin konkret atij të Sinan Pashës, në zhvillimin e një qendre të rëndësishme të kohës siç ishte qyteti i Elbasanit.

Fjalë kyçe:

Elbasan, vakëfe, Sinan Pasha, zhvillim urban, qytete shqiptare.

Hyrje

Studimet mbi historinë e qyteteve shqiptare, së paku për periudhën e sundimit osman, mbeten ende në një gjendje sipërfaqësore. Ndonëse

* Ky studim është mundësuar me mbështetjen financiare të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Përmbytja e tij është përgjegjësi e autorit, opinionin i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AKKSHI-t.

ekziston një numër jo i vogël punimesh, kryesisht artikuj, hulumtimet e thelluara në lidhje me transformimet që pësuan qendrat urbane gjatë këtij harku kohor pesëshekullor, ato që lidhen veçanërisht me shekujt e parë të vendosjes së osmanëve në këtë hapësirë, mbeten ende të parealizuar.¹ Me këtë nënkuptojmë mungesën e studimeve të detajuara që bazohen në burimet kryesore osmane për shek. XV-XVI që janë regjistrat kadastrorë apo ato të vakëfeve,² përmes të cilave përftohen informacione parësore në lidhje me gjendjen demografike, ekonomike e infrastrukturore të hapësirave urbane për kohën në fjalë.

Një panoramë e ngjashme na del përpara edhe në rastin e njërit prej qyteteve më të rëndësishme shqiptare të periudhës osmane, Elbasanit. Në të vërtetë, veçanërisht studimet e Kiel-it³ kanë arritur të skicojnë një figurë demografike e urbanistike në lidhje me dekadat e para të qytetit pas rindërtimit të tij prej Mehmedit II në verën e vitit 1466 por, ato sërish nuk na japin mundësinë të krijojmë një ide të qartë mbi dinamikat që

¹ Artikuj të tillë, të periudhës paraosmane dhe osmane, sidomos në lidhje me objektet e kultit apo aspektet urbanistike të qyteteve shqiptare i gjejmë të botuara kryesisht në revistat *Monumentet*, *Studime historike* dhe *Buletin për shkencat shoqërore*, por edhe në disa vepra kryesore që lidhen me shek. XV sikurse është *Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike* (1968) apo seria prej tri vëllimesh me titull *Studime për epokën e Skënderbeut* (1989). Sigurisht që paraqitja e gjithë literaturës përkatëse këtu, do të dilte jashtë synimeve të këtij artikulli, prandaj do të mjaftohemi vetëm me ata artikuj që lidhen me periudhën e hershme të Elbasanit, fill pas rithemelimit të tij në vitin 1466.

² Regjistrat kadastrorë (Tahrir defterleri) dhe ato të vakëfeve janë edhe burimet më të hershme arkivore osmane, të cilat hedhin dritë veçanërisht mbi shekujt e parë të perandorisë dhe vendosjen e saj në hapësirat e reja gjeografike, por edhe ndryshimet që solli në aspektin administrativ, ekonomik, demografik e shoqëror në ato hapësira. Sot kemi mundësi të krijojmë një përfytyrim më të saktë të vendosjes së sundimit osman në hapësirën shqiptare gjatë shek. XV, zbatimit të sistemit të timarit dhe shfrytëzimit të regjistrave kadastrorë në shërbim të njohjes së historisë ekonomike, politike e demografike të saj për këtë periudhë. Për një studim të tillë, shih Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1988).

³ Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*, përktheu Klodiana Smalaj (Tiranë: AIITC, 2012); Machiel Kiel, “İlbasan”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII (İstanbul: TDV Yay., 2000), 79-81. Për disa të dhëna demografike në lidhje me popullsinë shqiptare gjatë shek. XV-XVI e në veçanti për Elbasanin, gjithashtu shih Selami Pulaha, “Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989), 45-47. Ndërsa për të ardhurat në rang sanxhaku, shih Pulaha, *Pronësia feudale*, 187.

ndikuan në zhvillimin e shpejtë të qytetit. Si ai, ashtu edhe Babinger që ka shkruar më herët mbi Elbasanin, mjaftohen duke e konsideruar këtë qendër urbane si një qytet “tipik oriental”.⁴ Sigurisht që, ata e lidhin përkufizimin e tyre me numrin e madh të objekteve të kultit, kryesisht të xhamive dhe teqeve që u ndërtuan këtu gjatë periudhës së sundimit osman, një përshkrim të detajuar të të cilave e bën Lef Nosi dhe që është cituar prej autorëve të ndryshëm të cilët kanë shkruar mbi këtë tematikë, të dhëna që do të paraqiten në mënyrë më të hollësishme më poshtë.

Shihet qartë se, ajo që del në pah te përshkrimet e mësipërme nuk lidhet me përbërjen etnike të banorëve të qytetit, për të cilët Evlija Çelebiu shprehet se janë të gjithë shqiptarë,⁵ as me aspektet kulturore, politike apo ekonomike, por me fizionominë urbane të tij. Në këtë drejtim, edhe ky artikull lidhet me faktorët politikë, ekonomikë e kulturorë që ndikuan në zhvillimet dhe transformimet urbane që pësoi Elbasani gjatë periudhës së sundimit osman, duke u përqendruar kryesisht në shekullin e tij të parë si qytet, domethënë gjysmën e dytë të shek. XV dhe gjysmën e parë të shek. XVI, kohë në të cilën mori formë edhe konfigurimi urban i këtij qyteti.

Ekziston tanimë një korpus i madh kronikash, dëshmish, artikujsh e zërash enciklopedikë në lidhje me mënyrën se si Mehmedi II e rivitalizoi një qendër të vjetër urbane si ajo e Skampi-t (Scampi), e cila nuk funksiononte më prej shekujsh.⁶ Dimë gjithashtu edhe shkaqet që i çuan

⁴ Franz Babinger, *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I (München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962), 203; Dritan Egro, *Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule*, Ph.D. Dissertation (Ankara: 2003), 172. Për një qasje kritike të studimeve të Babinger-it, veçanërisht në rastin e leximit të mbishkrimit të kalasë së Elbasanit, shih Vexhi Buharaja, “Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989), 503-526.

⁵ *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, C. VIII (İstanbul: Orhaniye Matbbası), 721. Për hapësirën shqiptare në veprën e Çelebiut, shih Robert Dankoff and Robert Elsie, *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)* (Leiden: Brill, 2000); Evlija Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh*, përkthyer nga Sali Vuçiterna (Tiranë: Besa, 2000).

⁶ Skampeis (Scampia, Skampini) përmendet në burimet antike që në shek. II p.e.s. Për më shumë të dhëna, shih Hasan Ceka, “Nga historia e lashtë e Skampinit (Elbasanit)”, *Studime historike*, nr. 1 (1975): 147-151. Ndërsa për një literaturë të zgjeruar në lidhje me rithemelimin e qytetit të Elbasanit, shih Eduart Caka, “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVI”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2016): 99-101.

osmanët të ndërtojnë një qytet në një hapësirë fushore, i cili ishte një hap me rrezikshmëri tejet të madhe por me një rëndësi strategjike. Më konkretisht, ata kishin si synim vënien nën presion të Skënderbeut, që kishte qenë edhe pengesa më e madhe e përparimit të tyre ushtarak në këto hapësira dhe në vijim t'i hidhnin sytë kah zotërimet e Venedikut në bregdet. E gjitha kjo do t'u jepte mundësinë për t'u hedhur më pas në drejtim të Italisë, hap i cili do të vinte fill pas vendosjes së plotë të sundimit në hapësirën shqiptare, gjë të cilën do ta provonin me ekspeditën e suksesshme ushtarake të Ahmet Gedik Pashës në Otranto në vitin 1480.⁷

Mirëpo, cila ishte praktika e osmanëve në lidhje me ndërtimin, rindërtimin, organizimin dhe zhvillimin urban, pra të qyteteve, pas kohës kur ata e shtrinin pushtetin e plotë në një hapësirë të caktuar gjeografike? Përgjigjja e kësaj pyetjeje do të na mundësojë të kuptojmë edhe rrethanat politike, ekonomike e kulturore që ndikuan në zhvillimin e Elbasanit, duke e kthyer atë në njërën prej qendrave më të zhvilluara urbane të Shqipërisë në një kohë të shkurtër pas themelimit të tij.⁸ Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme, le të vërejmë se si vepruan osmanët me një qytet që e kishin shtënë në dorë vetëm një dekadë para se të ndërtonin kalanë e Elbasanit, Stambollin (1453), i cili ishte edhe qyteti më i rëndësishëm i perandorisë dhe kryeqendra e Bizantit për më shumë se një mijë vjet.

Vetëm 5-6 vjet pas marrjes së Stambollit, përkatësisht më 1459, Sulltan Mehmedi II do t'i thërriste para tij të gjithë krerët e shtetit, të cilëve u kërkoi që në lagje të ndryshme të qytetit të ndërtonin objekte të ndryshme arkitekturore përmes vakëfeve që ata do të themelonin.⁹ Kjo nënkuptonte ngritjen e komplekseve të ndryshme arkitekturore, që kishin

⁷ Hedda Reindl-Kiel, "Gedik Ahmed Paşa", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XIII, TDV Yay. (İstanbul: 1996), 543-544; *Historia e Adriatikut*, nën drejtimin e Pierre Cabanes, parathënia nga Jacques le Goff, përktheu Ardian Klosi, Arben Leskaj (Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2005), 255.

⁸ Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973), 31.

⁹ Halil İnalçık, *Devlet-i 'Alîyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, C. I, İstanbul: Türkiye İş Bankası-Kültür Yayınları, 2016, 125-127; Eduart Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021, 246; Halil İnalçık, "Fatih Sultan Mehmed Tarafından İstanbul'un Yeniden İnşası", çev. Fahri Unan, *Ondokuz Mayıs Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi*, c. 3, Samsun 1988, 215-226.

në përbërjen e tyre objekte të kultit si xhamitë apo teqetë, elemente të edukimit si shkollat e bibliotekat, ndërtesa me karakter social si mensat por edhe të tjera që i shërbenin organizimit urban si hamamet, rrugët, çezmat etj. Qëllimi kryesor i ndërmarrjes së këtyre politikave me karakter social, ekonomik dhe urbanistik, fillimisht ishte rikuperimi i dëmeve që kishte pësuar qyteti gjatë periudhës së gjatë të rrethimit dhe luftimeve për marrjen e tij, por edhe të ngriheshin bazat e qendrave urbane të qëndrueshme që do të stimulonin vendosjen këtu të popullsisë dhe rigjallërimin ekonomik. Të gjitha këto në favor të shtetit, i cili siguronte së pari rendin, por edhe garantonte krijimin e një situatë të favorshme për punë e prodhim që konvertohej në të ardhura për thesarin perandorak. Vetë Mehmedi II mori përsipër ndërtimin e objekteve, të cilat financoheshin nga vakëfi i ngritur prej tij dhe, sipas autorëve të kohës, ai kishte marrë pjesë personalisht në inspektimin e punimeve që kryheshin për gjallërimin e qytetit.¹⁰

Parë në këtë këndvështrim, mund të thuhet se, osmanëve u interesonte një panoramë e stabilizuar urbane, e cila mbushte arkën shtetërore që kthehej në një garanci për fushatat ushtarake që osmanët ndërmorën veçanërisht gjatë shek. XV-XVI në kuadër të zgjerimit territorial. Pikërisht në një kontekst të tillë, veçanërisht në ato zona ku ishte stabilizuar pushteti dhe ishte vendosur rendi politik e ishte garantuar siguria ekonomike, osmanët tentuan rimëkëmbjen e qyteteve të rrënuara nga luftërat, ose ngritjen e qendrave të reja urbane, përmes komplekseve të tilla që ndërtoheshin kryesisht nga vezirë, pashallarë apo anëtarë të familjes perandorake. Edhe në rastin e ndërtimit të qytetit të Stambollit, fill pas pushtimit të tij prej osmanëve, fakti se pashallarët dhe vezirët luajtën një rol kyç në këtë drejtim, dallohet lehtësisht nga emërtimet e lagjeve, faltoreve, komplekseve të bamirësisë që kanë mbërritur deri në ditët tona.¹¹

¹⁰ İnalçık i referohet një autori të kohës sikurse ishte Kristobuli. Për më shumë, shih İnalçık, *Fatih Sultan Mehmed Tarafından İstanbul'un*, 220.

¹¹ Duket se njëri prej pashallarëve që u dallua më së shumti në këtë drejtim, ishte Mahmud Pasha. Por krahas tij, burimet përmendin edhe emra të tjerë funksionarësh të lartë sikurse ishin Gedik Ahmed Pasha, Murad Pasha apo Davud Pasha. Shih *po aty*, 220.

Politikat urbanizuese osmane në hapësirën shqiptare gjatë shek. XV

Vendosja e sundimit osman në hapësirën shqiptare përfshin një hapësirë kohore më shumë se njëshekullore, e cila ngërthen brenda vetes etapa dhe ngjarje të ndryshme, ku hegjemonia osmane është karakterizuar herë nga një vendosje e plotë e dominimit e herë tjetër nga ndërprerje tërësore. Në këtë këndvështrim, pa u ndalur në mënyrë të detajuar në këto etapa që zënë fill me ardhjen e tyre aty nga fundi i shek. XIV dhe hyrjen e disa princërve shqiptarë nën vasalitetin osman, deri në pushtimin e Durrësit që shënon edhe vendosjen përfundimtare të këtij sundimi, vlen të theksojmë se treguesi kryesor i funksionimit të qeverisjes osmane në këto hapësira lidhet me zbatimin e sistemit të timarit. Kështu, vendosja e këtij regjimi të shfrytëzimit të tokës, tregonte se aty ishte vendosur sundimi i sulltanit, që konsoliduar rendi e siguria dhe funksiononte aparati shtetëror osman.¹²

Një shtet në ekspansion kërkonte një ushtri të fortë, gjë e cila sillte me vete nevojën e një ekonomie mbështetëse në aspektin e përballimit të shpenzimeve të ekspeditave ushtarake, por edhe rend e qetësi brenda perandorisë. Për këtë arsye u fortifikuan kalatë, ku u vendosën garnizone me ushtarë si dhe u konsolidua sistemi i timarit.¹³ Në regjistrat kadastrorë për shek. XV¹⁴ të tërheq vëmendjen fakti i shumë fshatrave të shkatërruara nga luftërat apo të braktisura nga banorët, sikurse gjithashtu

¹² Për një trajtesë të detajuar të mënyrës se si vendosej sistemi i timarit në një hapësirë të caktuar, në rastin konkret atë të Shqipërisë, të mënyrës së kryerjes së regjistrimeve kadastrorë dhe ndarjes së timareve, shih *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatiti për botim në gjuhën turke Halil Inalcik, përkthyer nga Mykerem Janina; përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim nga Eduart Caka, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2017, V-XX.

¹³ Në shek. XVI timariotët e sanxhakut të Elbasanit zotëronin plot 32,9 % të të ardhurave të përgjithshme që mblihdeshin nga kjo njësi administrative. Për detajet, shih Pulaha, *Pronësia feudale*, 223.

¹⁴ Për më shumë të dhëna në lidhje me regjistrat kadastrorë osmanë për hapësirën shqiptare të shek. XV, aspektet që lidhen me vendosjen e timarit dhe zbatimin e tij, shih Eduart Caka, “Aspekte të situatës politiko-ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV bazuar në regjistrat kadastralë osmanë të kësaj periudhe”, *Gjergj-Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2019, 91-101.

vërehen edhe vendbanime që janë dhënë për t'u gjallëruar dhe rikthyer në gjendjen e mëparshme.¹⁵ Megjithatë, treguesi i vërtetë i vendosjes së sundimit konsistonte në organizimin organizativ, ku për shek. XV kemi vetëm një njësi administrative si ajo e sanxhakut të Arvanidit, ndërsa hapësirat e tjera që gjendeshin nën sundimin osman, vareshin kryesisht prej sanxhaqeve më në brendësi sikurse ishin Manastiri, Ohri, Shkupi etj. Sanxhaqet e tjera si ai i Elbasanit, Shkodrës apo Vlorës do të formoheshin vetëm gjatë shek. XVI.¹⁶

Krahas këtyre politikave që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me ekonominë dhe ushtrinë, pra lokomotivën e zgjerimit të perandorisë, osmanët zbatuan edhe parime të tjera me karakter përafrues në lidhje me hapësirat dhe grupet e reja etnike e fetare që iu bashkëngjiten shtetit. Njëra prej tyre ishte edhe ajo që njihet si politika e "istimaletit", e cila nënkuptonte ngrohjen e zemrave të bashkësive të reja, kryesisht atyre jomyslimane, që bëheshin pjesë e shoqërisë osmane. Istimaleti, një term që nënkuptonte "joshjen, fitimin e zemrës apo krijimin e simpatisë", kishte për synim qasjen me respekt e tolerancë ndaj popullatës jomyslimane duke bërë të mundur që ata të qëndronin në hapësirat e pushtuara prej osmanëve ose të vinin në këto zona prej vendeve të tjera.¹⁷ Në këtë kontekst mund të përmenden hapjet e mensave për të vobektët e udhëtarët,¹⁸ të haneve, shkollave e objekteve të tjera, të cilat duket se rezultuan praktika të suksesshme në vendosjen e sundimit osman në zona të caktuara. Kjo "politikë e butë" u zbatua kryesisht përmes institucionit të vakëfit, i cili, ashtu sikurse u përmend edhe më sipër në rastin e qytetit të Stambollit, shërbeu si një instrument kyç në shtimin e elementeve urbanizuese brenda Perandorisë Osmane.

Njëri prej shembujve më ilustrues të kësaj politike urbanizimi që osmanët përdorën për hapësirën e Shqipërisë, është ai i vakëfit të themeluar prej Iljas Bej Mirahorit, i cili pati një ndikim të drejtpërdrejtë

¹⁵ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, XXXVI.

¹⁶ *Po aty*, V-VII; Egro, *Islam in Albanian Lands*, 182.

¹⁷ Në lidhje me etimologjinë dhe kuptimin e fjalës "istimalet" si dhe përdorimin e kësaj politike në periudhën osmane, shih Mücteba İlgürel, "İstimalet", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXIII, TDV. Yay., Istanbul: 2001, 362-363.

¹⁸ I tillë është rasti i kreut të Principatës Osmane, Orhanit, i cili ua serviri me duart e tij ushqimin të vobektëve në mensën që ngriti në qytetin e Jenishehirit, fill pasi e kishte pushtuar këtë vend. Shih Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social*, 45.

në themelimin dhe zhvillimin e qytetit të Korçës.¹⁹ Kështu, objektet arkitekturore të ndërtuara prej tij, siç ishte xhamia, tyrbja, imareti, hamami dhe shkolla do të bëheshin edhe bërthama e një qendre urbane, të cilën e njohim sot si qyteti i Korçës. Vakëfi i Mirahorit jetoi deri në dekadat e fundit të shek. XIX, por ndikimi i tij vërehet ende sot në toponiminë dhe trashëgiminë kulturore e arkitekturore të qytetit të lartpërmendur.

Sigurisht që rasti i vakëfit të Iljas Beut nuk është i veçuar, por në hapësirën e Shqipërisë kemi edhe shembuj të ngjashëm. Njëri prej të cilëve është edhe ai i vakëfit të ndërtuar nga Sinan Pasha në qytetin e Elbasanit, që pati një ndikim të madh në peizazhin arkitekturor e urbanistik të kësaj qendre të rëndësishme urbane në dekadat e para të themelimit të saj.

Cili Sinan Pashë?

Sikurse e kemi përmendur edhe në punimin tonë mbi vakëfet në Shqipëri gjatë periudhës osmane, origjina e Sinan Pashës mbetet një temë e diskutueshme për studiuesit që hulumtojnë mbi figurën e tij.²⁰ Sipas Kiel-it, emri i tij i vërtetë kishte qenë Radoslav Pavlović dhe i përkiste familjes aristokrate Borovinić nga Bosnja, i cili kishte hyrë dikur në shërbimin osman duke mbajtur poste e ofiqe të larta, ndërsa më 1502 kishte ndërtuar disa objekte arkitekturore në qytetin e Elbasanit si pjesë të vakëfit të themeluar sërish prej tij.²¹ Kiel përmend gjithashtu edhe vakfijen e përgatitur me kërkesë të Sinan Pashës, e cila është botuar nga M. Tayyip Gökbilgin aty nga gjysma e shekullit të shkuar,²² si dhe informacionet që Evlija Çelebiu jep mbi objektet e ndërtuara prej pashait

¹⁹ Në lidhje me vakëfin e Mirahorit dhe ndikimin që ai pati në zhvillimin e Korçës, shih Petraq Pepo, “Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë: Berati i sulltan Bajazitit II dhe vakëfnameja e Mirahor Iljaz Beut”, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr. 3, botim i Institutit të Shkencave (1956); Eduart Caka, “Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të Korçës gjatë periudhës osmane (shek. XVI-XIX)”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2017): 84-86; Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social*, 148-166.

²⁰ Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social*, 206.

²¹ Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 138-139; Egro, *Islam in Albanian Lands*, 263.

²² M. Tayyip Gökbilgin, *XV-XVI. Asırlarda Edirne ve Paşa Livası: Vakıflar, Mülkler, Mukataalar*, İstanbul: Üçler Basımevi, 1952, 450-451.

të lartpërmendur gjatë kohës kur ai kishte vizituar qytetin e Elbasanit, pra në gjysmën e dytë të shek. XVII.²³

Vlen të theksohet fakti se, asnjë prej burimeve të mësipërme nuk e përmend në mënyrë të qartë origjinën e pashait. Madje, në parashtrimin që i bën vakëfit të Sinan Pashës, Gökbiğlin përpiket të jetë sa më korrekt në lidhje me origjinën e personalitetit të lartpërmendur, duke theksuar veçanërisht se nuk bëhej fjalë për të tjerë funksionarë të lartë të periudhës së Bajezidit II që kishin të njëjtin emër me të, porse Sinan Pasha që kishte themeluar një vakëf në Elbasan mund të evidentohet nga të tjerët kryesisht me dy poste që mbajti, atë të mirlivasë së Galiopolit dhe kapudanit, pra kreut të flotës (H. 907). I njëjti autor shton gjithashtu, se pashai i lartpërmendur, në vitin 1506 (H. 912) kishte ushtruar edhe detyrën e bejlerbeut të Hercegovinës.

Dokumenti themelues i vakëfit të Sinan Pashës është përpiluar në vitin 1502 dhe atij i janë bërë dy shtojca, i pari daton më 18 tetor 1506, ndërsa i dyti më 21 qershor 1540, të cilat Gökbiğlin i paraqet bashkë me informacionet shoqëruese përkatëse në lidhje me objektet e vakëfit të Sinan Pashës në anët e Bosnjës, si dhe ndryshimet që i janë bërë përgjatë viteve.²⁴ Megjithatë, ajo çka ka interes për ne janë ato pjesë të vakëfit të tij që gjendeshin në hapësirën e Shqipërisë, përkatësisht në Elbasan si dhe origjina e vetë Sinan Pashës, për të cilën vakfija nuk na thotë shumë.

Nisur nga fakti se, sikur e cekëm më herët, në dokumentin themelues të vakëfit të tij nuk përmendet qartësisht origjina e pashait, kështu që studiuesit i duhet një punë më e imtësishme për të evidentuar saktësisht se për cilin personalitet bëhet fjalë. Kjo, veçanërisht nëse do të kemi parasysh se në historinë osmane, përkatësisht edhe për periudhën që po shqyrtojmë, mund të evidentohen lehtësisht edhe funksionarë të tjerë të lartë që njihen me emrin Sinan Pasha.²⁵ Në këtë rast duhen parë burimet parësore, të cilat për kohën që po flasim konsistojnë kryesisht në fondin e shkresave e letërkëmbimeve që gjenden në arkivin e Topkapisë,

²³ *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 719-730.

²⁴ *Po aty*, 450. (Zeyl, 207).

²⁵ Vetëm gjatë fundit të shek. XV dhe fillimit të shek. XVI vërejmë disa funksionarë me të njëjtin emër. Njëri prej të cilëve është edhe Sinanuddin Sinan Pasha, vëllai i Rustem Pashës që shërbeu si sadrazam gjatë periudhës së sundimit të Sulltan Sulejmanit I. Për më shumë, shih: Mehmed Süreyya, *Sicil-i Osmani*, C. V, Yay. Haz. Nuri Akbayar, Eski yazıdan aktaran Seyit Ali Kahraman, İstanbul: Tarih Vakfı Yay., 1996, 1514-1516.

në regjistrat kadastrorë (Tahrir Defterleri) dhe në regjistrat për vakëfet. Këto përbëjnë edhe fondin kryesor të kancelarisë osmane sa i përket shek. XIV deri në gjysmën e parë të shek. XVI. Shqyrtimi i këtij dokumentacioni na e mundëson shqyrtimin më në detaje të kësaj hapësire kohore.

Edhe në rastin e Sinanuddin Jusuf Pashës, të cilit do t'i referohemi shkurtimisht si Sinan Pasha, po qe se dokumenti themelor i vakëfit të tij, vakëfnameja, nuk na jep një të dhënë përfundimtare në lidhje me origjinën, atëherë lipset shqyrtimi i pjesës tjetër të dokumentacionit për të parë nëse mund të gjenden informacione më të sakta. Më konkretisht, regjistrat kadastrorë të shek. XVI për sanxhakun e Elbasanit na paraqesin materiale tejet shteruese në lidhje me pronat e Sinan Pashës në këtë hapësirë, të ardhurat që ai fitonte, por edhe për vetë personin dhe familjen e tij. Anën ekonomike do ta shqyrtojmë në pjesën e vakëfit të pashait, por këtu do të ndalemi te disa aspekte që kanë të bëjnë me familjen e tij. Më saktësisht, ndonëse Kiel e ka shfletuar dhe cituar regjistrin kadastror me numër 367 për vitin 1530, ai jep të dhëna përmbledhëse në lidhje me qytetin e Elbasanit, popullsinë e tij, madje edhe për vetë Sinan Pashën, por pa u ndalur në detaje.²⁶ Ndërkohë që, në të njëjtin defter, për pashanë e lartpërmendur hasim një informacion tejet interesant. Kështu, në pjesën e nahijes së Durrësit vërehet një shënim, i cili flet për përjashtimin nga taksat e *ispenxhes* dhe të *avariz-i divanijes* të disa individëve që cilësohen si të afërm të Sinan Pashës.²⁷

Teksti në fjalë, së paku, shtrон për diskutim më të thelluar vetë debatin mbi origjinën e pashait. Sërish sipas të njëjtit shënim, ky privilegjim dhe përjashtim taksor i të afërmeve të Sinan Pashës ekzistonte që prej kohës së sundimit të Bajezidit II, aspekt i cili na bën të mendojmë se këta ishin banorë të kësaj hapësire ose, jetonin këtu prej disa dekadash. Pikërisht në këtë kohë vërejmë edhe dhurimin prej sulltanit të disa mylqeve për Sinan Pashën, të cilat, ashtu si edhe në rastin e Iljas Bej Mirahorit, do të përbënin edhe bazën e vakëfit të mëvonshëm të pashait.

Themelimi dhe aktiviteti i vakëfit të Sinan Pashës në Elbasan

Siç u përmend edhe më lart, nga pronat dhe mylqet e Sinanuddin Jusuf Pashës në Elbasan përmenden fshatrat e Bradasheshit. Këtë aspekt

²⁶ Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137-138.

²⁷ *Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi* (më tej: BOA), TT.d. 367, fl. 442.

e vërejmë qartë si në vakfijen e përpiluar prej tij ashtu edhe prej informacioneve që hasim në regjistrat kadastrorë për shek. XVI, tek të cilat gjejmë me detaje karakteristikat demografike, prodhimet dhe të ardhurat që kishte fshati në fjalë. Kështu, në vitin 1530, ky fshat kishte një numër prej 98 shtëpish me të ardhura vjetore prej 10 679 akçesh duke qenë njëra prej vendbanimeve më të mëdha të hapësirës përreth.²⁸ Ndërsa vetë myllku i pashait vinte menjëherë pas hasëve perandorake.

Si pjesë të vakëfit të Sinan Pashës, më vonë do të vërejmë edhe Ibën në zonën e Petrelës. Ky fakt evidentohet edhe nga dokumente të ndryshme të Arkivit Qendror të Shtetit ku, këto fshatra figurojnë si pjesë e vakëfit të pashait, së paku, deri në gjysmën e parë të shek. XIX. Kështu, në një dokument që i përket vitit 1836 thuhet se fshati Ibë që varej nga Petrela ishte pjesë e vakëfit të teqesë së Sinan Pashës në Elbasan.²⁹

Si dokument themeltar i institucionit të bamirësisë që pashai ngriti, vakëfnameja meriton të trajtohet në detaje. I sigluar më 18 shkurt 1502, dokumenti është plot 72 faqe në total.³⁰ Pas një hyrjeje të gjatë, ku lavdërohet dhe nxitet bamirësia, në vijim përshkruhet personi i Sinan Pashës dhe bujaria e tij. Vetë ai përmendet në vakfije, si bejlerbej i Galiopolit, ndërsa emri i të atit është shënuar si Abdulhej. Në vijim përshkruhen pasuria, objektet e ngritura në kuadër të vakëfit të tij si dhe kushtet e funksionimit të institucionit, administrimi e mirëmbajtja e tij, një strukturim i ngjashëm në të gjitha vakëfnetet. Sigurisht që në vakfije nuk bëhet fjalë vetëm për pronat dhe vakëfin që ai kishte ngritur në Elbasan, por përfshihen edhe pasuri e vepra të tjera bamirësie në pjesë të ndryshme të perandorisë, si në Stamboll, Filibe (Plovdiv) etj. Një përshkrim i detajuar i vakëfeve të tij jashtë Shqipërisë është paraqitur edhe nga Gökbilgin.³¹

Mirëpo, cilat ishin objektet që u ndërtuan në kuadër të vakëfit të Sinan Pashës në qytetin e Elbasanit? Ato ishin xhamia, teqeja, imareti, hamami dhe shkolla, të cilat përbëjnë edhe atë që quhet kompleks (Küllie) bamirësie në kontekstin klasik të funksionimit të vakëfeve gjatë

²⁸ *Po aty*, fl. 439.

²⁹ Për më shumë detaje, shih *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 129, Dosja (më tej: D.) 24, fl. 5; Pulaha, *Pronësia feudale*, 175.

³⁰ BOA, TS.MA.d./7001.

³¹ Gökbilgin, *XV-XVI. Asırlarda Edirne*, 450-452.

kësaj periudhe.³² Një numër i tillë veprash arkitekturore në një qytet që ishte themeluar vetëm tri dekada më herët, ishte pa dyshim jo vetëm një sipërmarrje tejet e konsiderueshme në dimensionin ekonomik, politik e kulturor të qytetit, por gjithashtu edhe një faktor dominues në proceset transformuese që kalonte një hapësirë periferike si Shqipëria në një kontekst tërësisht të ndryshëm politik e shoqëror si ajo e Perandorisë Osmane. Parë në këtë këndvështrim, kompleksi i Sinan Pashës duket se kishte dy dimensione: atë të zhvillimit të qytetit dhe transformimit të tij bashkë me banorët e kësaj qendre të re urbane.

Në këtë kontekst, ndoshta objekti më i rëndësishëm i vakëfit të Sinan Pashës ishte xhamia, për të cilën hasim vazhdimisht informacione.³³ Ky objekt kulti simbolizonte pushtetin qiellor në aspektin shpirtëror, autoritetin absolut të sulltanit në atë politik e sundues dhe, supremacinë kulturore në aspektin fetar, pra islamin. Të gjitha këto marrin edhe më shumë kuptim nëse do të kemi parasysh karakterin teokratik të sistemeve politike e perandorake të kohës, por edhe hegjemoninë kulturore që kishte feja në periudhën paramoderne.

Fill ngjitur me xhaminë ndodhej teqeja, e cila i përkiste krahut Xhelveti që është njëra prej nënndarjeve të rrymës sufiste, pra tarikatis Halveti.³⁴ Si Kiel ashtu edhe Ayverdi bashkohen me mendimin se, të dyja këto vepra arkitekturore qenë të pozicionuara brenda kalasë, pra në një hapësirë ku rrihte zemra e qytetit dhe numri i frekuentuesve që tejet i madh, aspekt i cili shkon në përputhje me qëllimin e ngritjes së objekteve të ngjashme, të cilat kryheshin përmes institucioneve të vakëfeve.

³² Për një përshkrim të detajuar të objekteve që ngriti Sinan Pasha, shih Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social*, 206-209. Gjithashtu shih *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), E-I-17, Abedin Çausi, “Esnafët në Elbasan”, 3-4.

³³ Informacione në lidhje me xhaminë e Sinan Pashës, por edhe për veprat e tjera të ndërtuara prej tij, vërejmë tek Evlija Çelebiu në gjysmën e dytë të shek. XVI. Për më shumë, shih *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 721. Ndërsa Kiel dhe studimet e tjera të zhvilluara në Shqipëri mbi këtë temë u referohen kryesisht informacioneve të mbledhura nga Lef Nosi, të cilat gjenden në fondin me emrin e tij në Arkivin Qendror të Shtetit. Për xhaminë e Sinan Pashës dhe objektet e tjera të vakëfit të tij në këtë fond arkivor, shih *AQSH*, F. 32, D. 37, fl. 80-87.

³⁴ Duket se teqeja i përkiste tarikatis Xhelvetije dhe kishte një vakëf më vete pasi Kiel shprehet se ajo që njëra prej teqeve më të rëndësishme të qytetit, me një numër të madh dervishësh dhe vakëf të pasur. Për më shumë, shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 138-139. Për objektet e lartpërmendura, gjithashtu shih Ekrem Ayverdi, *Avrupada Osmanlı Mimari Eserleri*, C. IV, İstanbul: İstanbul Tarih Cemiyeti, 2000, 415; Egro, *Islam in Albanian Lands*, 278, ref. 273.

Nëse xhamia ishte objekti ku drejtoheshin vetëm praktikuesit e besimit, teqetë patën një funksion tjetër. Ato shërbenin si qendra kuvendimi, bisedimesh, arti e kulture, të cilat kishin sërish për qëllim tërheqjen e njerëzve në rrugën e besimit, por në një mënyrë më elastike e një qasjeje krejtësisht të ndryshme nga dogmatizmi që impononte islami sunit. Vetë Çelebiu e përmend këtë funksion social të teqeve, kur e përshkruan Elbasanin në shek. XVII. Nga ana tjetër, udhëtari dhe kronisti osman flet për plot 46 xhami dhe një namazgjah në këtë qytet, duke e cilësuar Elbasanin si njërën prej qendrave më të zhvilluara islame të kësaj hapësire.³⁵

Krahas një objektivit më të ngushtë që kishte vakëfi i tij, pra ajo pjesë që lidhej me besimtarët, bejlerbeu i Galipolit bëri pjesë të veprimtarisë së institucionit të tij të bamirësisë edhe tërë qytetin, pa bërë dallim në fe. Kështu, në kuadër të veprave të bamirësisë të financuara prej tij, Sinanuddin Jusuf Pasha kishte ndërtuar në Elbasan edhe një imaret e hamam. Një përshkrim të detajuar të hamamit, i cili thuhet se është ndërtuar aty nga vitet 1500 dhe konsistonte si objekt me sipërfaqe të madhe, na jepet edhe nga Kiel që e ka inspektuar nga afër këtë vepër. Të dyja këto objekte tregojnë vlerën e madhe të kapitalit që kishte vakëfi i pashait në fjalë, ndërsa vetë imareti vërteton kontributin e këtij institucioni bamirësie në jetën ekonomike e shoqërore të Elbasanit duke qenë një vend ku shuante urinë popullsia e varfër. Hamami gjendej në afërsi të portës lindore të kështjellës dhe gjatë shek. XVII kishte pësuar disa zgjerime duke u kthyer në një ambient, i cili mund të frekuentohej prej një numri më të madh personash.³⁶

Si pjesë e objekteve të bamirësisë që pashai kishte ndërtuar në qytetin e Elbasanit, burimet tregojnë se ai kishte ngritur një shkollë të madhe për kohën, e cila përbëhej nga dy godina dhe një oborr. Për këtë të fundit, pashai kishte lënë vakëf të ardhurat nga dy fshatrat e përmendura, një objekt në Stamboll si dhe njëmbëdhjetë mullinj në Plovdiv të

³⁵ Egro, *Islam in Albanian Lands*, 290.

³⁶ Sipas Kiel-it, hamami ka pësuar zgjerime në shek. XVII duke u ndarë në dy pjesë kryesore, të cilave iu bashkëngjitën anash edhe disa dhoma. Objektit i ishte bërë edhe një restaurim tjetër në vitet 1970 ku çatia që mbuluar me tjegulla të reja, të ngjashme me ato origjinalet që kishte pasur hamami. Për më shumë të dhëna në lidhje me punimet e kryera mbi hamamin në fjalë, shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 160-161.

Bullgarisë.³⁷ Prej këtyre, vetëm nga përjashtimi taksor që kishin dy fshatrat e mësipërme, vakëfi i Sinan Pashës në vitet 1529-1536 përfitonte një shumë prej 10 679 akçesh.³⁸

Burimet arkivore tregojnë se vakëfi i Sinan Pashës si institucion pati vazhdimësi deri në shek. XIX, element i cili tregon për një jetëgjatësi mbi treshekullore. Shembulli i fshatit Ibë për të cilin u shkrua më lart, është edhe një tregues i qartë i këtij fakti. Ndërsa objektet e ndërtuara prej vakëfit të tij vijuan të ekzistojnë edhe në periudhën pas pavarësisë, ku një pjesë e tyre mbërritën deri në gjysmën e dytë të shek. XX.

Ndikimi i vakëfit të Sinan Pashës në jetën ekonomike e kulturore të qytetit

Si udhëtarët dhe misionarët perëndimorë ashtu edhe kronistët dhe burokratët lindorë, e përshkruajnë Elbasanin si një qytet të zhvilluar ekonomikisht, me natyrë të admirueshme dhe me një klimë të përshtatshme për të jetuar. Ky zhvillim kishte ndodhur kryesisht gjatë shek. XVI për t'ua lënë vendin dinamikave të tjera që lidheshin kryesisht me teknologjinë e prodhimit dhe që filluan aty nga dekadat e fundit të këtij njëqindvjeçari. Këtu duhet pasur parasysh pozita gjeografike e brigjeve shqiptare që ishin një urë lidhëse mes Stambollit, Lindjes e Perëndimit, vendosja e Elbasanit përgjatë Via Egnatia-s e cila kishte ushqyer për shekuj me radhë ambiciet politiko-ushtarake dhe ekonomike të perandorive, si dhe elasticiteti e mobiliteti që vërehej në hapësirat periferike krahasuar me ngathtësinë dhe përhumbjen që e karakterizonte qendrën.

Në këtë periudhë tranzicioni, pra koha nga rithemelimi i qytetit deri në funksionimin e tij si një qendër e mirëfilltë dhe e zhvilluar urbane³⁹ që

³⁷ Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı*, C. IV, 415.

³⁸ Popullsia e fshatrave që banonte nëpër hapësirat brenda vakëfit ishte falur pothuajse prej të gjitha taksave, përjashtim bënin vetëm disa taksime të veçanta siç qe ajo e xhizjes. Për më shumë të dhëna në lidhje me dispozitat ligjore dhe praktikën osmane të përjashtimit të taksave për këtë kategori të fshatrave, shih Pulaha, *Pronësia feudale*, 179.

³⁹ Aty nga fundi i shek. XVI, Elbasani numërohej si nga qytetet me zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe demografik të hapësirës shqiptare. Bashkë me qendra të tjera shumë herë më të vjetra dhe më të zhvilluara, sikurse ishte Vlora apo Berati, Elbasani mendohet se kishte një numër popullsie që i afrohej shifrës së një mijë banorëve. Shih Egro, *Islam in Albanian Lands*, 279.

nisi të zbatojë teknologji të caktuara, e cila përkon me një hark kohor prej thuajse njëqind vjetësh, duket se ka qenë edhe periudha kur vakëfet patën edhe kontributin më kryesor në vendosjen e gurëve kilometrikë që do të shërbenin si themele për zhvillimin urbanistik, demografik, kulturor dhe ekonomik të qytetit.

Në këtë këndvështrim, mund të thuhet se, përveçse të qenit një institucion bamirësie, në të vërtetë, vakëfi ngërthente brenda vetes misionë të shumëfishta. Këtu përfshihej politika, ekonomia, kultura e arti, pra të gjithë komponentët kryesorë të përditshmërisë së individit dhe shoqërisë. Kjo bëhet edhe më e dukshme në rastin e vakëfeve të tilla që kanë jetëgjatësi disashekullore. Kështu, vetëm në raport me etapat historike nëpër të cilat kaloi Perandoria Osmane, mund të thuhet se edhe një vakëf periferik si ai i Sinan Pashës në Elbasan përjetoi kulmin e vet zhvillimor, u përball me problematika gjatë periudhës së dobësimit të perandorisë dhe mori fund në kohën kur nis edhe shpërbërja e saj, nëse do të kemi parasysh shpëputjen e shteteve ballkanike dhe tronditjet që pësoi shteti osman pas Tanzimatit.

Në këtë aspekt mund të bëhet një paralelizëm ndërmjet jetëgjatësisë dhe funksionit të vakëfit të Sinan Pashës në raport me zhvillimet politike, ekonomike e kulturore që kaloi vetë qyteti i Elbasanit. Pra, si në raport makro ashtu edhe atë mikro, qoftë edhe një institucion i tillë bamirësie mund të shërbejë si një çelës për të kuptuar transformimet dhe ndërveprimin ndërmjet qendrës e periferisë, shtetit dhe shoqërisë, sunduesit dhe popullatës së thjeshtë. Kështu duhet kuptuar edhe themelimi i vakëfit, i cili vjen në një kohë me fillimet e qytetit, ku Mehmedi II e kishte populluar me familje të cilat i shpërnguli nga qendra e qytete të ndryshme të hapësirës ballkanike, duke filluar nga Sofja deri në Serez, Selanik, Janinë e Vlorë.⁴⁰ Nëse objektet e kultit i shërbenin trupës ushtarake që mbronte kalanë dhe popullsinë myslimane të qytetit, imareti dhe hamami mund të frekuentohej prej të gjithë banorëve të Elbasanit.

Zhvillimi ekonomik, urbanistik dhe demografik i qytetit sillte me vete edhe rritjen e aktivitetit të vakëfit, i cili duket se ka pasur tentativa në zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e të ardhurave. Dokumentacioni arkivor na vë në dispozicion një korpus të madh dokumentesh e

⁴⁰ Për më shumë të dhëna në lidhje me themelimin e qytetit dhe sjelljen e familjeve të krishtera prej qyteteve përreth, shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137-138.

shkresash që kanë të bëjnë me mbledhjen e të ardhurave të vakëfit apo bilancet e tij financiare. Këto raportime vijnë thuajse në periudhë periodike gjatë shek. XVI-XVII, duke na krijuar një panoramë të detajuar të këtij institucioni bamirësie.⁴¹ Por, nga ana tjetër, kanë kryer edhe shpenzime siç ishin pagesat e punëtorëve apo meremetimet e objekteve, si dhe janë përballur me abuzime, shkelje e parregullsi.⁴²

Nisur nga fakti se vakëfi ndodhej në një vend periferik si Elbasani, dhe personeli mund të manipulonte lehtësisht duke arritur të fitonte edhe njëfarë paprekshmërie prej autoriteteve vendëse, janë të shumta rastet kur administratorët apo punëtorët e vakëfit kanë abuzuar me detyrën. I tillë ishte rasti i Haxhi Mustafait, xhabi i këtij vakëfi, i cili akuzohej se kishte vrarë vëllanë e kethydait dhe gruan e tij. Personi në fjalë, gjithashtu, fajësohej prej popullatës së fshatit se kishte ushtruar dhunë mbi ta duke ua marrë me forcë vreshtat, mullinjtë e kullotat që kishin. Pas këtyre ankesave çështja është përcjellë në Stamboll ku, në shkresën përkatëse që i dërgon sanxhakbeut të Elbasanit si dhe kadilerëve të Shpatit e Elbasanit, më 28 janar 1565, sulltani i urdhëronte ata që të hetonin me përpikëri çështjen dhe të vepronin në bazë të masave që parashikonin dispozitat e sheriatit.⁴³

Ndonëse aktualisht e kemi të pamundur për të kryer një studim të thelluar⁴⁴ vetëm mbi aktivitetin e këtij vakëfi për një periudhë të caktuar kohore, nisur nga numri i madh i pronave dhe objekteve që ishin pjesë e këtij institucioni bamirësie, e kemi lehtësisht të mundur të flasim për një numër dyshifror të personelit të angazhuar në të. Pagesa që ata merrnin në këmbim të shërbimit që jepnin për vakëfin, pa dyshim që konvertohej në të mira materiale për familjet e personelit të këtij institucioni. Së dyti, nevojat ushqimore, ato tekstile apo mjetet e tjera që i nevojiteshin vakëfit

⁴¹ Taksën e xhizjes së popullatës së krishterë në fshatrat që i përkisnin vakëfit, në rastin konkret, të Bradasheshit, e mblidhte xhabiu i tij, i cili më pas i depozitonte në thesar. Për disa raste të ngjashme, shih BOA, TS. MA.e 892/12; TS. MA.e 1202/35.

⁴² Një meremetim i veprave të objekteve arkitekturore që ishin pjesë e vakëfit të Sinan Pashës është bërë në vitin 1856, gjë të cilën e mësojmë nga një shkresë që mban datën 6 tetor, shih BOA, A. DVNSMHM.d... 61/227.

⁴³ *6 Numaralı Mühimme Defteri (972/1564-1565) (Özet, Transkripsiyon ve İndeks)*, C. I, T. C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, Ankara: 1995, 366-367.

⁴⁴ Një tabelë të ngjashme jemi përpjekur ta paraqesim në rastin e vakëfit të Iljas Bej Mirahorit në Korçë. Për më shumë hollësi, shih Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social*, 160-163.

siguroheshin përmes ndërveprimit me aktorët ekonomikë dhe tregtarë të qytetit, duke bërë që ky institucion të jepte edhe një kontribut në zhvillimin e këtyre të fundit.

Veçanërisht xhamia dhe teqeja ishin ambiente me ndikim të madh në jetën politike e kulturore të qytetit, për arsye se ato frekuentoheshin në masë të madhe. Në vetvete, kjo gjë sillte edhe një rritje të peshës specifike dhe influencës që kishin në popull imamët, vaizët apo shehlerët që shërbenin këtu. Sigurisht që kjo situatë nuk ishte e vlefshme vetëm për ata klerikë të vakëfit të Sinan Pashës, por për të gjitha faltoret dhe institucionet e ngjashme. Në rastin konkret shihet se, si ndaj imamëve të xhamisë ashtu edhe ndaj shehlerëve të teqesë ka pasur vazhdimisht ankesa e përplasje, të cilat janë dërguar për shqyrtim në Stamboll. I tillë është rasti i ankesës së imam Hysen Halifes, i cili pretendonte se e kishin liruar nga detyra pa të drejtë, dhe që rikthehet në atë post me shkresë të agait të Babus'saadesë.⁴⁵ Ndërsa teqeja duket se ka pasur edhe më shumë problematika, madje në maj të vitit 1768 i është marrë Ismailit posti i shehut të teqesë.⁴⁶ Sikurse kuptohet nga dokumentet, ndërmjet sheh Ismailit dhe dervish Aliut kishte pasur një rivalitet të ashpër në lidhje me faktin se cili do të vendosej në postin drejtues të këtij institucioni. Debati kishte qenë aq i madh, sa popullata dhe kadilerët e Elbasanit, Shkodrës, Shpatit e Manastirit qenë detyruar të përcjellin në Stamboll mendimet dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me debatin.⁴⁷ Ky rast është tejet domethënës, jo vetëm për të kuptuar peshën politike që kishte një drejtues i teqesë, por edhe influencën e madhe që ai mund të ndërtonte në një hapësirë territoriale shumë më të gjerë se njësia administrative në të cilën ishte i pozicionuar.

Ndikimin që këto objekte arkitekturore patën në jetën publike dhe kulturore të qytetit, Evlija Çelebiu e përshkruan me nuanca tejet interesante. Kështu, pasi flet për interesin e njerëzve ndaj artit e kulturës, ai ndalet te xhamia e Sinan Pashës, të cilën e tregon të mbushur me shënime e vjersha të udhëtarëve e poetëve që kishin kaluar aty. Kronisti osman flet për shkrime në gjuhë të ndryshme, përfshirë këtu arabishten, persishten e greqishten në muret e xhamisë. Për më tepër, nisur nga kjo larmi e bukur, ai e pagëzon Elbasanin si vendin e poetëve (Dar-i

⁴⁵ BOA, IE.EV.. 48/5313.

⁴⁶ Po aty, C..EV.. 366/18578.

⁴⁷ Po aty, TS.MA.e 837/6.

Shuara).⁴⁸ Ky është tregues i peshës që kishin objektet e kultit në jetën dhe balancat politike, ekonomike e veçanërisht shpirtërore të qytetit. Në këtë rast, edhe të vakëfit si institucioni që i kishte ngritur të gjitha ato objekte arkitekture.

Nëse këto ishin problematika të brendshme të institucionit dhe që lidheshin kryesisht me funksionin e tij, duhet thënë se veçanërisht në shek. XVI vakëfi ka luajtur një rol domethënës në zhvillimin kulturor të qytetit përmes objekteve që u përmendën më lart. Ndonëse në shekujt e mëvonshëm, me daljen në skenë të aktorëve të rëndësishëm ekonomikë e politikë si ajanët, esnafët e tregtarët, roli i vakëfeve erdhi duke u tkurrur, këto zhvillime nuk do ta zbehnin aspak peshën e vakëfit të Sinan Pashës në qytetin e Elbasanit. Me nisjen e centralizimit të institucioneve të bamirësisë, edhe ky vakëf do të administrohej prej nëpunësve tashmë të emëruar prej shtetit, e jo nga kushtet që kishte parashikuar vakëflënësi në vakfije.⁴⁹

Përfundim

Gjatë periudhës së vendosjes së tyre në hapësirën ballkanike, por edhe në gjeografi të tjera ku u hapën, osmanët ndoqën politika të ndryshme taksore, politike e kulturore, duke përfshirë brenda praktikave të tyre qeverisëse sa elemente të mbretërive e perandorive të tjera, aq edhe një larmi kulturore që varionte në varësi të gjeografisë dhe komponentit njerëzor. Njëra prej këtyre politikave kryesore që vërehet në këtë periudhë është edhe ajo e istimaletit, e cila u zbatua gjerësisht prej osmanëve, veçanërisht në hapësirat e banuara prej të krishterëve. Pjesë e kësaj strategjie mund të konsiderohen edhe vakëfet e mëdha që pjesëtarë të dinastisë, pashallarë e vezirë ngritën në hapësira të ndryshme të perandorisë, institucione të cilat shërbyen edhe si bërthama për lindjen dhe zhvillimin e qendrave të ndryshme urbane, pra qyteteve. Nëse flasim për hapësirën shqiptare, një rast i ngjashëm është ai i Iljas Bej Mirahorit në Korçë, Sulejman Bargjinit në Tiranë, por, deri diku edhe i Sinan Pashës në Elbasan.

I themeluar në një qytet të sapongritur, ky institucion bamirësie dha një kontribut domethënës në peizazhin urbanistik dhe zhvillimin

⁴⁸ *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 721.

⁴⁹ Rasti më i hershëm që mundëm të evidentojmë në këtë drejtim, daton më 9 gusht 1804, shih BOA, C.. EV.. 343/17402.

ekonomik, kulturor e shpirtëror të qytetit. I shtrirë në një hapësirë kohore për më shumë se tre shekuj, duket se vakëfi i Sinan Pashës përjetoi një cikël zhvillimi e rënieje të ngjashëm me atë që përjetoi vetë Elbasani gjatë katër shekujve të sundimit osman.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH)

E-I-17, Abedin Çausi, “Esnafët në Elbasan”.

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondi Lef Nosi (32).

Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi (BOA)

TT. d. 367, 477.

Botime dokumentare:

6 Numaralı Mühimme Defteri (972/1564-1565) (Özet, Transkripsiyon ve İndeks), C. I, Ankara: T. C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, 1995.

Literaturë historiografike:

Ayverdi, Ekrem Hakkı. *Avrupada Osmanlı Mimari Eserleri*, C. I-IV. İstanbul: İstanbul Tarih Cemiyeti, 2000.

Babinger, Franz. *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I. München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962.

Buharaja, Vexhi. “Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit”. *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989.

Caka, Eduart. “Aspekte të situatës politiko-ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV bazuar në regjistrat kadastralë osmanë të kësaj periudhe”. *Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2019.

Caka, Eduart. “Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të Korçës gjatë periudhës osmane (shek. XVI-XIX)”. *Studime historike*, nr. 1-2 (2017).

Caka, Eduart. “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVI”. *Studime historike*, nr. 1-2 (2016).

- Caka, Eduart. *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2021.
- Ceka, Hasan. “Nga historia e lashtë e Skampinit (Elbasanit)”. *Studime historike*, nr. 1 (1975).
- Çelebi, Evlija. *Shqipëria: para tre shekujsh*. Përkthyer nga Sali Vuçiterna. Tiranë: Besa, 2000.
- Dankoff, Robert - Elsie, Robert. *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*. Leiden: Brill, 2000.
- Egro, Dritan. *Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule*. Ph.D. Dissertation, Ankara: 2003.
- Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, C. VIII, İstanbul: Orhaniye Matbbası (pa vit botimi).
- Gökbilgin, M. Tayyip. *XV-XVI. Asırlarda Edirne ve Paşa Livası: Vakıflar, Mülkler, Mukataalar*. İstanbul: Üçler Basımevi, 1952.
- Historia e Adriatikut*, nën drejtimin e Pierre Cabanes. Parathënia nga Jocques le Goff, përktheu Ardian Klosi, Arben Leskaj. Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2005.
- İlgürel, Mücteba. “İstimalet”. *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXIII, TDV. Yay. İstanbul: 2001.
- İnalcık, Halil. “Fatih Sultan Mehmed Tarafından İstanbul’un Yeniden İnşaası”, çev. Fahri Unan. *Ondokuz Mayıs Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi*, c. 3. Samsun: 1988.
- İnalcık, Halil. *Devlet-i ‘Alīyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, C. I-V. İstanbul: Türkiye İş Bankası-Kültür Yayınları, 2016.
- Kiel, Machiel, “İlbasan”. *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII. İstanbul: TDV Yay., 2000.
- Kiel, Machiel. *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*. Përktheu Klodiana Smaljaj. Tiranë: AIITC, 2012.
- Pepo, Petraq. “Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë: Berati i sulltan Bajazitit II dhe vakëfnameja e Mirahor Iljaz Beut”. Në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr. 3, Instituti i Shkencave (1956).
- Pulaha, Selami. “Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI”. *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989.
- Pulaha, Selami. *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1988.
- Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*. Përgatiti për botim në gjuhën turke Halil Inalcik, përkthyer nga Mykerem Janina; përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim nga Eduart Caka. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2017.

- Reindl-Kiel, Hedda. "Gedik Ahmed Paşa". *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XIII, TDV Yay. İstanbul: 1996.
- Süreyya, Mehmed. *Sicil-i Osmani*, C. I-V, Yay. Haz. Nuri Akbayer, Eski yazıdan aktaran Seyit Ali Kahraman. İstanbul: Tarih Vakfı Yay., 1996.
- Shkodra, Zija. *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973.

EDUART CAKA

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania
edicaka@hotmail.com

S u m m a r y

THE VAQF OF SINAN PASCHA AND ITS INFLUENCE ON THE URBANISTIC AND CULTURAL DEVELOPMENT OF ELBASAN DURING THE CENTURY. XVI

Elbasan was one of the most important economic, political, demographic and cultural cities of Albania during the period of Ottoman rule. Positioned in a strategic area, which had always been the axis of connection and communication in the fields of culture, economy but also a space of military and political rivalry between the West and the East, Elbasan underwent a very rapid development starting after its reconstruction by Sultan Mehmed II in the summer of 1466. Firstly organized as a sub administrative district depended from Ohrid, within a short time Elbasan returned to the center of the Sandjak, including in its jurisdiction territorial spaces that stretched from the coast of Durrës, Kavaja and Bashtova to the mountainous parts of Çermenika. All these economic and demographic resources were positioned in the center of the Sanjak, the city of Elbasan, which experienced rapid urbanization. This article aims to address the role of endowments, in the specific case that of Sinan Pascha, in the development of an important center of the time such as the city of Elbasan.

YLL RUGOVA

Hulumtues shkencor në projektin “Prishtina në histori”, Trembelat, Prishtinë

yll.rugova@trembelat.com

<https://doi.org/10.61773/8jhc5z66>

TRI LETRA TË PIKLOMINIT GJATË FUSHATËS USHTARAKE HABSBURGASE NË KOSOVË (1689)*

Abstrakt:

Detajet e fushatës së shkurtër të habsburgëve në vjeshtën e vitit 1689 në Kosovë, për një pjesë të madhe të historiografëve, bazohen në disa prej kronikave të hershme kryesisht të dorës së dytë që e përshkruajnë këtë ngjarje. Një burim kryesor për shumicën e tyre, dorëshkrimi i njohur si Annotationes und Reflexiones..., rishtazi është vërtetuar të jetë po ashtu i tillë, pra, burim i dorës së dytë (burim sekondar) dhe jo vepër nga një pjesëmarrës në këtë fushatë. Burimet primare, nga protagonistë që kanë qenë dëshmitarë të këtyre ngjarjeve, megjithëse një pjesë e tyre janë njohur që më parë, nuk janë përdorur sa duhet në ndriçimin e këtyre fragmenteve të historisë. Në këtë artikull do të synojmë identifikimin e disa prej këtyre burimeve të kohës që bazohen në letra, relacione e raporte. Së këndejmi, përmes tyre, dhe duke botuar disa prej tyre edhe në shqip, do të synojmë sendërtimin e një pasqyre të përditësuar të ngjarjeve historike të kësaj fushate në Kosovë. Më kryesoret prej këtyre dokumenteve janë tri letrat e vetë Pikolominit gjatë ditëve të qëndrimit të tij në Kosovë.

Fjalë kyçe:

Pikolomini, habsburgët, Kosovë, Prishtinë, Prizren, Pjetër Bogdani, Toma Raspasani, Perandoria Osmane.

Problematika e burimeve

Studimet mbi fushatën ushtarake të habsburgëve në Kosovë të vjeshtës së vitit 1689, megjithëse kanë ndriçuar konturet kryesore të saj, i

* Kërkimet për këtë punim janë pjesë e një studimi rreth historisë së Prishtinës (2023-2024) si nismë nga Trembelat dhe Varg në Prishtinë, e mbështetur me fondet e komunës së Prishtinës.

kanë lënë disa momente me rëndësi pa një përmbyllje përfundimtare. Pas mbarimit me disfatë të avancimit habsburg në Kosovë, në janar 1690, e përfundimisht në shtatorin e po atij viti, janë përpiluar disa kronika të hershme që shtjellojnë mes të tjerash këtë fushatë. Deri më tani, këto kanë përbërë korpusin kryesor të burimeve mbi këtë temë. Prej këtyre, duhet veçuar ajo më e hershmja nga italiani Simpliciano Bizozeri (1642-1704)¹ e vitit 1690 botuar në Milano, e Christoph Boethius-it (fl. 1685-1690)² botuar në Nuremberg në të njëjtin vit, dhe një tjetër nga Johann Constantin Feige (1658-1699)³ e vitit 1694 botuar në Vjenë në dy vëllime. Të tria këto janë përmbledhje me rëndësi, por që janë të cingëruara për faktin se janë përpiluar nga protagonistë që s’kishin qenë vetë dëshmitarë të ngjarjeve. Prej të triave, ajo e Feige-s është më e pasura me të dhëna. Sigurisht të mbledhura nga korrespondencat e kohës, artikujt e gazetave, dhe mbase më rrallë në ndonjë dëshmi prej pjesëmarrësve në ngjarje. Një problem tjetër i tyre ka të bëjë me faktin se, ato në shumicën e rasteve nuk u referohen burimeve përkatëse, duke e bërë të vështirë gjurmimin e autenticitetit. E tillë është kronika në dorëshkrim e Alessandro Belleard-it (fl. 1683-1697), e cila deri vonë është menduar anonime, me titullin e shkurtuar *Annotationes und Reflexiones...* nga Arkivi i Luftës (Kriegsarchiv) në Vjenë, dhe që është përdorur dendur si burim kryesor “i dorës së parë” nga historianët e mëvonshëm.⁴ Kjo kronikë, me gjithë parapëlqimin nga këta historianë,

¹ Simpliciano Bizozeri, *La sagra lega contro la potenza ottomana. Successi delle armi imperiali, polacche, venete, e moscovite*, vol. I (Milano: Regia Ducale, 1690).

² Christoph Boethius, *Ruhm-belorberter triumph-leuchtender und glantz-erhöherer Kriegs-Helm dero Röm. Käyserl. auch zu Hungarn und Böhmen Königl. Majest. und dero samtlichen hohen Bunds-Verwandten wider den blutbesprengten türckischen Tulband*, vol. IV (Nurenberg: J. C. Lochner, 1690).

³ Johann Constantin Feige, *Wunderbahrer Adlers-Schwung: Oder Fernere Geschichts-Fortsetzung Ortelii redivivi et continuati*, vol. I & II (Vieden: Voigt, 1694).

⁴ Dorëshkrimi me titull të plotë *Annotationes und Reflexiones der gloriosen kayserlichen Waffen im Jahr 1689*, në Österreichisches Staatsarchiv, Kriegsarchiv (KA), Feldakten (FA), Alte Feldakten. (AFA), 1689-13-1, ‘Annotationes No. 5’; Është burimi kryesor te: Hauptmann Gerba, “Die Kaiserlichen in Albanien 1689”, *Mitteilungen Kriegsarchiv* 2 (1888), 115-178; Мита Костић, “Спаљивање Скопља 26 и 27 окт. 1689”, *Јужна Србија* 4 (1922), 121-128 (Mita Kostiq, “Spaljivanje Skoplja 26 i 27 okt. 1689”, *Juzhna Srbija* 4 (1922), 121-128); Томо Томоски, “Еден изгубен документ за австриската војна во Македонија во 1689. година”, *Годишен зборник на Филозофскиот факултет* 15 (1963), 121-132 (Томо Tomoski, “Eден изгубен документ за австриската војна во Makedonija во 1689. godina”, *Godishen*

nuk dallon shumë për nga saktësia karshi kronikave të tjera të përpiluara në të njëjtën kohë, e cila është vërtetuar disa herë në vitet e fundit.⁵ Belear, s'ka qenë në Kosovë, as në Ballkan në atë kohë, siç shprehet edhe vetë në një letër, ku shpjegon se si kronikën e bazonte në intervista me ushtarë, dhe ndërsa po qëndronte në Vjenë, thotë se “duke u gjendur bosh dimrin e kaluar, kam mbledhur, në përputhje me talentin tim ushtarak, informacionin e historisë së mëposhtme”.⁶

E vetmja prej kronikave të hershme që bën një përjashtim të vogël është ajo e përpiluar nga ushtaraku Giovanni Paolo Zenarolla (fl. 1685-1690),⁷ i cili ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me gjeneralin kryesor të habsburgëve Margrave Ludvig von Baden (1655-1707) përgjatë periudhës në fjalë, së këndejmi kronika e tij bazohet kryesisht në

zbornik na Folozofskiom fakultet 15 (1963), 121-132); Kristo Frashëri, “Pjetër Bogdani dhe lëvizja çlirimtare shqiptare në shek. XVII”, *Studime historike*, nr.1 (1990): 159-178. Dokumenti i përkthyer në gjuhën shqipe është botuar nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1990), 256-301.

⁵ Noel Malcolm, *Kosovo – A Short History* (New York: New York University Press, 1998), 147; Noel Malcolm, *Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit: Studime mbi historinë e shqiptarëve*, përktheu Ana Haxhi (Prishtinë: Atini, 2020), 782; Nuri Bedzeti (Bexheti), *Die Teilnahme der Albaner am “Grossen Türkenkrieg” 1683-99*, disertacion për gradën Doktor i shkencave (Universiteti i Vjenës: 2005), 104-106; Nuri Bexheti, *Der “Große Türkenkrieg” und Die Albaner: Die militärische Präsenz der Balkanvölker am “Großen Türkenkrieg” (1683-1699)*, (Saarbrücken: Südwestdeutscher Verlag für Hochschulschriften, 2009), 85-99.

⁶ Joseph Chmel më 1841, në një përshkrim të botuar të dorëshkrimeve që ndodhen në *Österreichische Nationalbibliothek* të Vjenës, sjell edhe dorëshkrimin e shumëcitur të Belearit (datuar gabimisht 1682 në vend të vitit 1689). Aty ka botuar edhe një letër të këtij të fundit, pa datë, ku sqarohet se teksti bazohet në informata të mbledhura: “Onde auendo io consagrato alle glorie di V. C. e R. M. ogni mio giorno e momento, e trouandomi sfacendato nel scorso inuerno, ho raccolte, conforme al mio militar possibile talento, le notizie del seguente racconto, quali ossequiosamente paleso alla S. C. C. et R. M. V. protestando con la piu profonda sommissione, che se non sarà del di lei benigno aggradimento, donarò incontinente i miei originali alle fiamme; con che profondamente mi prostro al Trono”, shih Joseph Chmel, *Die Handschriften der K. K. Hofbibliothek in Wien im Interesse der Geschichte, besonders der österreichischen, verzeichnet und excerptirt*, vol. II (Wien: C. Gerold., 1841), 220-221.

⁷ Giovanni Paolo Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo Primo, imperatore de' Romani sempre Augusto, nell' anno 1689. fino alli 6. Marzo 1690* (Viena: Gio. Van Ghelen, 1690).

raportimet që vinin edhe nga kampi ushtarak i këtij të fundit.⁸ Prej Zenarollës kemi me shumë vlerë njërën prej letrave të Pikolominit dërguar nga Prishtina, të cilën e datojmë si të 22 tetorit 1689, por që asnjëherë nuk është përdorur nga historianët, edhe pse ka qenë botuar qysh në vitin 1690.⁹ Vetë kronika e Zenarollës, e shtypur në Vjenë më 1690, njësor si dhe të tjerat nuk u referohet burimeve të informatave, dhe kështu mbetet e vështirë për t'u verifikuar në ato pjesë ku nuk kemi të bëjmë me letra origjinale ose materiale origjinale të kohës. Edhe pse saktësia dhe pasuria në të dhëna e veçon atë prej të tjerave, ajo mbetet burim sekondar.

Si alternativë e kronikave që përmendëm, një pjesë e madhe e materialeve burimore të fushatës janë dëmtuar me kalimin e kohës.¹⁰ Më mirë të ruajtura janë indekset dhe ekstraktet e dokumenteve, të cilat sakaq, nuk mjaftojnë për një pasqyrë të plotë të fushatës.¹¹ Megjithatë, disa materiale me rëndësi kanë mbijetuar të botuara nëpër mediumet e kohës. Këto deri tashmë nuk janë qëmtuar sa duhet dhe as nuk janë përdorur nga autorët. Teksti që po sjellim këtu bazohet kryesisht në këto materiale të cilat s'janë përdorur deri më tani, ose që janë përdorur pak. Gjithashtu, teksti në vijim nuk do të përfshijë kronikat e hershme si burim.

⁸ Ky është i pari që ka botuar një letër të Pikolominit e cila kishte mbërritur në kampin e Badenit, dhe është dëshmi në këtë drejtim. Për këtë letër Zenarolla shprehej se, "... një korrier arriti në kamp, që disa ditë më parë qe dërguar te Pikolomini, dhe e solli këtë letër për Ludvig von Badenin..." (*Po aty*, 209-211). Për më shumë, të paktën në vitin 1688 dhe më 1690 janë tri letra të Zenarollës të këmbjera me Badenin që dëshmojnë për kontaktet e tij me këtë të fundit, khs. Iskra Schwarcz, Stefan Spevak & Ekaterina Večeva, *Hoffnung auf Befreiung: Dokumente aus österreichischen Archiven zur Geschichte Bulgariens (1687-1690)*, (Wien: Verlag Ostag., 2004), 100-103, 138-140, 246-247.

⁹ Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 209-211.

¹⁰ Rreth kësaj problematike shih: Tomoski, "Eden izguben dokument", 128.

¹¹ Në këtë drejtim me rëndësi janë dokumentet: *Osterreichisches Staatsarchiv* (OS), Signatur: AT-OeStA/KA ZSt HKR HR Librat (Bücher): 0378 Protokoll-Expedit mit Index, 0379 Protokoll-Registratur mit Index, 0380 Protokoll-Expedit mit Index, 0381 Index Registratur, 0382 Protokoll-Registratur, të cilat mund të qasen edhe si faksimile digjitale përmes <https://www.archivinformationssystem.at/detail.aspx?id=47162>.

Fushata e Kosovës në vjeshtën e vitit 1689

Më 24 shtator 1689, forcat imperiale nën komandën e Vjenës kishin zgjeruar territoret e tyre me marrjen e qytetit të Nishit, në Ballkanin Qendror. Letrat që ka këmbyer protagonistin kyç, Margrave Ludvig von Baden janë më kryesoret për interpretimin e synimeve perandorake në ditët para hyrjes në Kosovë. Në një letër të 5 tetorit, që i drejtohej dinastit habsburg Leopold I (1640-1705), Baden sqaron se regjimentet e tij perandorake do t'i ndante më dysh.¹² Njëra pjesë me vetë atë në krye do të nisej në drejtim të Vidinit, kurse pjesa tjetër nën komandën e Pikolominit do të ndalej në Nish, që ta përforconte dhe ta ruante atë bazë me një pjesë të njësiteve, dhe me pjesën tjetër të përparonte në drejtim të Shkupit.¹³ Sipas letrës, Pikolominit i ishte dhënë urdhër që, nëse do të ishte e mundur, të depëronte sa më thellë në drejtim të Shqipërisë “për të shkëputur Bosnjën nga tokat e tjera turke”.¹⁴ Baden ishte skeptik për sukseset e gjeneralit të tij. Për këtë thotë: “Më duhet ta pranoj që kont Pikolomini nuk është i shkathët mjaftueshëm për një operacion të tillë”.¹⁵ Por, shpresonte në konfuzionin e trupave osmane pas pësimeve të fundit, dhe në faktin se njëkohësisht vetë do të ishte në sulm në drejtim të Vidinit, çka do të shpërqendronte më tutje forcat osmane.¹⁶

Nëse kishte qenë e suksesshme fushata në drejtim të Jugut e kuptojmë nga një letër e vetë Pikolominit drejtuar drejtpërdrejt dinastit Leopold I në Vjenë, nga qyteti i Prishtinës më 21 tetor, e njohur pak deri më tani për studiuesit dhe e papërdorur në gjuhën shqipe.¹⁷ Pikolomini

¹² Letra e von Badenit për Leopoldin I, nga Nishi, 5 tetor 1689. Botuar te Philipp Röder von Diersburg, *Des Markgrafen Ludwig Wilhelm von Baden Feldzüge wider die Türken*, vol. II (Karlsruhe: Müller'schen Hofbuchandlung, 1842), 147-151.

¹³ *Po aty*, 149. Pjesë e trupave të Pikolominit kishin qenë: Këmbësori: Kroj (Croy), Aspermonti, Shtrazer (*Strasser*), Auersperg, Palaf (*Palaff*). Kalarës: Pikolomini, Hanover, Holshtajn. Dragonjtë e Stirisë, Serajit (*Seauraut*), Hanoverit. Hungarezët e Çakit (*Czakyt*), Paul Dekut, dhe rashianët (*Razen*), (*po aty*, 167-168). Siç shihet nga kjo listë, një njësit i rashianëve (serbëve) nën regjimentin hungarez ka qenë pjesë e komandës së Pikolominit edhe para hyrjes në Kosovë.

¹⁴ *Po aty*, 149.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ Letra origjinale në dialektin italian deri tashmë nuk është zbuluar, njihet vetëm botimi i saj në një përkthim në gjuhën gjermane tek *Oesterreichisch-militärische Zeitschrift*, Vjenë 2 (1808), 235-246 (më tej: *Oesterreichisch-militärische*). Në këtë vëllim janë

fillimisht kishte 5 batalione me vete në Nish, ndërsa katërqind fshatarë ishin sjellë nga rrethina për të punuar tokën.¹⁸ Datat e ngjarjeve në vijim janë të paqarta, nuk njihet as data e hyrjes në Kosovë e as në Prishtinë, prandaj ia vlen të ndalemi pak për t'u qartësuar.¹⁹ Një letër [e humbur], që Pikolomini e kishte dërguar nga Prokupja më 15 tetor, na bën të besojmë se me këtë datë ende s'kishte hyrë në Kosovë.²⁰ Ajo që mund të thuhet me njëfarë sigurie është se para kësaj date e kishte marrë dhe e kishte përforcuar qytetin e Prokupjes, të vendosur nën komandën e Aspermontit, ku kishte vendosur një batalion me urdhrin që të ndërtohej një magazinë e ushqimeve.²¹ Prej aty e ka dërguar letrën (e humbur), më 15 tetor, me njoftimin se po nisej drejt Kosovës.²² Ndalesën e parë pas

botuar dy letra të Pikolomini nga kjo fushatë. Shih te dokumentet në fund për përkthimin në gjuhën shqipe (dok. nr. 1 dhe dok. nr. 4). Këto dy letra më rishtazi i ka përdorur (në gjermanisht) Bexheti, *Der "Große Türkenkrieg"*, 87-91. Më parë janë përdorur edhe nga Kostiq, "Spaljivanje Skoplja", 121-128; Tomoski, "Eden izguben dokument", 122.

¹⁸ *Oestreichisch-militärische*, 238.

¹⁹ Megjithëse në këtë letër nuk përmenden data, ato mund të nxirren nga materiale të tjera që janë dërguar ndërkohë. Pikolomini në letër njofton se, fillimisht e kishte marrë Pirotin (të cilin e kishte gjetur të djegur) dhe Palankën, në pjesën jugore të Serbisë së sotme, afër kufirit me Bullgarinë. Nga përshkrimi i sipërpërmendur i Badenit, e dimë se ato ishin marrë para datës 3 tetor dhe se më pas Pikolomini ishte kthyer prapë në Nish. Baden thotë më 5 tetor nga Nishi, se Pikolomini "mbërriti me sukses në kamp pardje bashkë me komandantët e tij, pasi më parë kishte qenë në Pirot, pesë milje nga këtu, dhe nga kështjella afër saj, e njohur si Mustafa Pasha Palanka, një lokacion gjithashtu i vendosur mirë në dalje të një gryke të ngushtë...", Diersburg, *Des Markgrafen*, 147.

²⁰ Originali i kësaj letre nuk është zbuluar ende. Atë e përmend dhe e parafrazon në fillim të nëntorit gazeta: *Ordinari Mittwochliche Reichs-Post-Zeitungen*, Pragë, nr. 181, 12 nëntor 1689, 1-2. Raporti pa titull në këtë gazetë është i datës 6 nëntor: "Gjeneral Pikolomini, të cilit i është besuar komanda e frontit të Nishit, ka shkruar nga Prokupja më 15 të muajit të kaluar, se ai bashkë me 4 apo 5 mijë ushtarë ishte nisur në drejtim të Shqipërisë." Zenarolla, i cili ishte mjaft i mirinformuar për këtë pjesë të fushatës, ka mundësi ta ketë parë këtë letër. Megjithëse ai më datë 14 tetor thotë se Pikolomini tashmë ishte nisur nga Prokupja. Sipas tij "Pikolomini, i cili në Prokupje kishte mbledhur rezerva të mira të grurit, miellit, sanës dhe mallrave të tjera, vendosi këtu një magazinë furnizimi dhe [më pas] shkëputi nga ana e majtë ngushticën e Leskovcit, ndërsa në anën e djathtë vendosi trupat gjermane e rashiane në kështjellën e Koznikut, më datë 14 ai u nis nga Prokupja në drejtim të Shkupit...", khs. Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, f. 211-212.

²¹ *Oestreichisch-militärische*, 238.

²² *Ordinari Mittwochliche Reichs-Post-Zeitungen*, Pragë, nr. 181, 12 nëntor 1689, 1.

kësaj duhet ta ketë pasur në Leskovc, të cilin gjithashtu e kishte përforcuar (këtu paraprakisht kishte dërguar njërin prej gjeneralëve të tij, Holshtajnin).²³ Është e sigurt se ka hyrë në Prishtinë diku para datës 21 tetor, prej ku e ka dërguar edhe letrën e parë nga Kosova për Leopoldin I. Një relacion me emrin *Karta e Vjenës* që është botuar në Madrid disa muaj më vonë, e përmend datën 18 tetor si datë të hyrjes së Pikolominit në Prishtinë, që s'duket e pamundur.²⁴ Siç thotë edhe vetë Pikolomini, në fushën e madhe të Kosovës, kishte gjetur akomodim të mirë në "kryeqytetin e këtij vendi të quajtur Prishtinë".²⁵ (Edhe disa herë të tjera Prishtina njihet si kryeqytet i Kosovës në letrat dhe artikujt e kohës.) Letra vazhdon me përshkrimin se vendi ishte i gjerë dhe i hapur, por i braktisur nga banorët, të cilët ishin "boshnjakë, shqiptarë dhe turq" siç thuhet, me këtë renditje.²⁶ E njëjta pak a shumë përmendet edhe nga gjenerali tjetër Shtrazer, sipas të cilit qyteti i braktisur kishte bollëk, "kemi gjetur gjithçka që kishin lënë turqit e ikur, që banonin aty, si bagëti, drithëra, ushqime, për kafshët, së bashku me krerët e fshatrave, në mënyrë të tillë që ushtria jonë të mund të ushqehet gjatë këtij dimri."²⁷ Një inxhinier me emrin Baffet de Comos ishte angazhuar për fortifikimin e qytetit dhe vizatimin e një harte (e cila nuk është zbuluar deri tashmë).²⁸

²³ *Oestreichisch-militärische*, 238; *The London Gazette*, nr. 2508, 21-25 nëntor 1689, 1.

²⁴ Relacioni me emrin *Karta e Vjenës* (Carta de Viena), botuar në Spanjë disa javë pas ngjarjes, përveç hyrjes në qytet më 18 tetor, sjell edhe detaje të tjera mbi këtë pjesë të fushatës. Sidoqoftë, ajo qartazi është e përpiluar në Vjenë dhe nga dikush që s'ka qenë vetë prezent në ngjarje, prandaj duhet marrë me shumë rezerva. Sidoqoftë, pjesa e detajuar e ditëve të para që tregohet këtu nuk haset ndokund tjetër (përveçse në disa kronika të mëvonshme), prandaj është me vlerë në segmentin që po trajtojmë. Shih "Carta de Viena", *Nuevas ordinarias de los sucessos del Norte*, pn, 10-17 janar 1690, Madrid, 30.

²⁵ *Oestreichisch-militärische*, 238.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 228-235.

²⁸ Këtë të dhënë s'e jep Pikolomini, por ndodhet në një grumbull materialesh të cilat gjenden në *Oesterreichisches Staatsarchiv* të Vjenës, dhe që në ca fragmente të vogla e sjell Tomoski, "Eden izguben dokument", 122. Prej dokumenteve që kanë humbur nga Arkivi i Vjenës, siç njoftohemi nga Tomoski, disa janë riprodhuar më herët në këtë grumbull materialesh të titulluar *Extracte aus dem Relation des Markgrafen Louis von Baden an S. M. den Kaiser vom 26 August bis 30 Dezember 1689*, në një dorëshkrim më të madh *Geschichte des Feldzuges gegen die Türken vom Jahre 1687-1690*, Kriegsarchiv (KA), Feldakten (FA) X 3-1-6 (khs. Tomoski, "Eden izguben dokument", 128). Këtë material nuk e kemi pasur në dispozicion për këtë studim.

Siç duket, Pikolomini dhe 200 njerëzit e tij – siç i përmend në letër – ishin rehatuar të paktën ca ditë në Prishtinë.²⁹

Edhe Mahmut Pashë Begolli (fl. 1688-1698) përmendet prej Pikolominit më 21 tetor. Për të thotë se mbante kështjellën e Kaçanikut dhe se duhej larguar prej atyre anëve.³⁰ Në pjesën e fundit të letrës Pikolomini sjell edhe një informatë të re, e cila vazhdoi të përcillej më tej në raporte e korrespondenca dhe që është me interes për historinë e kësaj fushate. Aty thotë se ishte kontaktuar nga shqiptarët (*Albanesern*) dhe rashianët (*Raißen*) që donin t'u bashkoheshin trupave perandorake, për çka mendonte se duhej treguar kujdes dhe se i kishte ftuar kelmendasit (*Clementiner*) të bashkoheshin në Konfederatë (sic! – *Conferedation*). Pikolomini besonte se me këta të fundit do të takohej së shpejti.³¹ Pra, të paktën nga kjo, mund të supozohet se kontaktet e para më të drejtpërdrejta me shqiptarët ishin bërë përpara datës 21 tetor.³² Pikolomini paraprakisht kishte nisur disa njësite në drejtime të ndryshme për të eksploruar vendin.

Sipas një raporti anonim nga kampi ushtarak i Pikolominit në Kaçanik, Shtrazer ishte mbërthyer në Kaçanik, Holshtajn në Novobërdë, e Maursberg në Mitrovicë e Zveçan.³³ Ndërkohë që një njësit këmbësorie i husarëve rashianë kishte marshuar në drejtim të Pejës për ta ndjekur Mahmut Pashë Begollin, “dhe për t’ia marrë bishtin e kalit”.³⁴ (Përzënia apo kapja e Mahmut Pashë Begollit duhet të ketë qenë veprim strategjik për të depërtuar në drejtim të Shkupit përmes Kaçanikut.) Po atë ditë (21 tetor), ky njësit ishte kthyer në Prishtinë (ndoshta, pasi ishte dërguar letra

²⁹ *Oestreichisch-militärische*, 238.

³⁰ *Po aty*, 239.

³¹ *Po aty*.

³² Më 10 tetor, A. Molin raportonte se habsburgët po bënëin përpjekje për negociata me malësorët shqiptarë përmes patrikut serb Arsenit III si ndërmjetës (Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 212-214). Por patriku në atë kohë s’ka qenë në Pejë, siç dëshmohej nga një letër tjetër (*po aty*, 215-216).

³³ Raport anonim prej kampit të Pikolominit i datës 27 tetor në Kaçanik, botuar i plotë: “Auß dem Kayserlichen Feld-Lager mitten im Paß gegen Scopia, genandt Kazaneck”, *Die Europäische*, nr. 97, 25 nëntor 1689, pn. Për përkthimin në gjuhën shqipe të këtij raporti, shih në fund dokumentet (dok. nr. 3).

³⁴ *Po aty*, pn. Bishti i kalit, i njohur në shqip si *tujë*, ishte simbol i rëndësishëm i gradave të pashallarëve osmanë. Mahmut Begollit këtë tujë (bisht-kali) ia kishte dhuruar vetë Veziri, siç thotë edhe Pikolomini në letër, shih: *po aty*, pn. Nuk mund të kuptojmë për cilin vezir e ka pasur fjalën.

e parë e Pikolominit) dhe përveç tujës, në plaçkat e përfituara ndodheshin edhe katër flamuj të kapur diku afër Pejës prej trupave të shpartalluara të këtij pashai.³⁵ Në raportin anonim, Peja përmendet me emërtimin *Pöza*, dhe thuhet se aty përveç husarëve rashianë (*Räßen Hussaren*) qarkullonte edhe një delegacion tjetër që ishte nisur për të negociuar me kelmendasit, shqiptarët dhe “popujt e tjerë”.³⁶ Delegacioni i kthyer kishte njoftuar Pikolominit për rrugën e bërë nëpër bjeshkët e larta të këtij vendi, ku “dy popujt e Kelmendit dhe të Resaiava-s* (sic!) ishin paraqitur me dëshirën që të bënin marrëveshje” me autoritetet habsburgase.³⁷

Në një letër të dytë të Pikolominit drejtuar Badenit³⁸ që është pa datë dhe vend, por që duhet të jetë e një dite më vonë, më 22 tetor,³⁹ thuhet se takimi tashmë ishte mbajtur. Në fillim të kësaj letre Pikolomini thotë: “[s]hqiptarët e Kelmendit kanë dërguar përfaqësuesit e tyre tek unë, me propozimin që të jenë nën devotshmërinë e Perandorit, me të cilët tashmë jam në marrëveshje (traktat)”.⁴⁰ Këtu kelmendasit këtë herë përmenden si “shqiptarë të Kelmendit” (*gli Albanesi di Clementa*).⁴¹

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

* Këtu mund të jetë fjala për rashianë (serbë) ose për popullin e Rozhajës.

³⁷ Po aty.

³⁸ E botuar së pari në dialektin italian në vitin 1690 te Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 209-211. E njëjta është botuar në vitin 1700 nga Rycout në gjuhën angleze, khs. Paul Rycout, *Being a full Relation Of the Last Troubles in Hungary, with the Sieges of Vienna, and Buda, and all the several Battles both by Sea and Land, between the Christians, and the Turks, until the End of the Year 1698, and 1699* (London: Robert Clarendon dhe Abel Roper, 1700), 351. Për përkthimin e këtij dokumenti në gjuhën shqipe (shih dokumentet në fund) ka ndihmuar prof. dr. Majlinda Bregasi dhe F. Serée, shih rubrikën e dokumenteve (dok. nr. 2).

³⁹ Ndoshta nga fshati Rabovc (Robovze), afër Lipjanit, ku thuhet se ishte vendosur përkohësisht Pikolomini pas Prishtinës, shih “Auß dem Kayserlichen”, pn.

⁴⁰ Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 209.

⁴¹ Prej tri letrave të Pikolominit, dy janë në dialektin italian që nuk është për t’u çuditur, duke qenë se vetë vinte prej rajonit të Toskanës në Italinë e sotme. Edhe një letër tjetër e tij, botuar nga Zamputi, e pranverës së të njëjtit vit është shkruar në dialektin italian, khs. Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 164-165. Për jetën e Pikolominit dihet çuditërisht pak, duke mos qenë të sigurt madje as për emrin e plotë. Ka mundësi që emrin e vërtetë ta ketë pasur Johann Norbert Graf Piccolomini dhe jo Aeneas Sylvius Piccolomini, siç përmendet në disa raporte të tjera (përfshi biografinë e hershme nga Belleard që jepet edhe nga Gerba). Në letrat që njihen prej tij, nënshkrimi është vetëm “Piccolomini”. Nuk mund të konfirmohet as viti 1651 si vit i lindjes. Disa prej biografive të tij gabojnë edhe vendin e datën e vdekjes, dhe për këtë

Letra vazhdon më tutje se edhe shqiptarët myslimanë (*l'Albania Turca*) kanë vepruar njësoj, të cilët kishin ofruar të dorëzonin të gjitha kështjellat e tyre.⁴² Pastaj thotë se kishte ftuar edhe komunitetet e tjera të krishtera të ngjashme të bashkoheshin në marrëveshjen e tij,⁴³ pa sqaruar konkretisht për kë e kishte fjalën. I njëjti moment konfirmohet edhe nga raporti anonim i datës 27 tetor ku thuhet, se në mëngjes “më 22 të po këtij muaji, për hir të këtij negocimi është dërguar tek këta persona [kelmendasit] një kolonel lejtënant Pikolominian me disa të tjerë në shoqërim”.⁴⁴ Ky takim mund të jetë mbajtur në Pejë, siç e përmendte më vonë vetë sekretari i Pikolominit.⁴⁵ *Karta e Vjenës*, mbi këtë rast thotë se “[a]rnautët, popull i

dëshmitë janë të dendura, khs. Carl A. Schweigerd, *Oesterreichs Helden und Heerführer von Maximilian I. bis auf die neueste Zeit*, vol. II (Grima: Verlags-Comptoir 1853), 351-353; Hauptmann Gerba, “Die Kaiserlichen in Albanien 1689”, *Mitteilungen*, vol. II (1888), 149-151; Reinhard Rudolf Heinisch, “Piccolomini, Johann Norbert Graf”, në *Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas*, vol. III (Mynih, 1979), 455-456.

<https://www.biolex.ios-regensburg.de/BioLexViewview.php?ID=1535> (shikuar më 15.01.2024).

⁴² Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 209. Raporti anonim i 27 tetorit shpjegon edhe gjeografikisht prej nga vijnë këta shqiptarë myslimanë, “mes vendit në fjalë [Pejë] dhe Shkupit shumë turq janë regjistruar nën mbrojtjen Perandorake të Cezarit romak, me besimin se nuk do të përjashtohen nga shtëpitë dhe pallatet e tyre”, shih, “Auß dem Kayserlichen”, pn. Ndërkohë edhe kronisti osman, Silahdar Agha, konfirmonte të paktën 3 000 trupa shqiptare nga Karadaku që ishin bashkuar me habsburgët; shih: Nazire Karaçay Türkal, “Silahdar Findiklili Mehmed Ağa Zeyl-İ Fezleke: (1065-22 Ca.1106 / 1654-7 Şubat 1695)”, disertacion për gradën Doktor i shkencave (i pabotuar), (Marmara Üniversitesi Stamboll: 2012), 1283.

⁴³ Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 209.

⁴⁴ Përkthimi i këtij paragrafi në raportin e 27 tetorit e lë pak të paqartë nëse edhe vetë Pikolomini kishte qenë pjesëmarrës në takim. “[D]annenherr den 22. dito der Piccolominische Obrist Lieutenant mit einiger Mannschafft dieses Negoty halber an ermeldte Leuthe abgeschicket worden”, shih: “Auß dem Kayserlichen”, pn. Për formulimin e plotë shih dok. nr. 3 në fund.

⁴⁵ Një relacion i panjohur deri më tani i sekretarit të Pikolominit: Giovanni Francesco Pompeati, *Relazione di quanto nel Paese di Cossova e passato sotto il comando del Sig. Colonello Barone Strasser, con alcuni Squadroni di Cavalleria, e 200 Fanti, contro incirca 40000 Turchi, Tartari, & Arnauti dell'Albania, seguito à di 1 Genaro, 1690* (pa vend, pa botues, 1690). Një ksombël me katër faqe të panumërtuara ndodhet në *Bayerische Staatsbibliothek* (BSB), me nënshkrimin: Res. 4, Eur. 384/46. Ky relacion për një ngjarje të pak ditëve më vonë thotë: “...në mes të dhjetorit edhe kelmendasit erdhën në Prishtinë për të përtërirë marrëveshjen e tyre, të cilën e kishin lidhur në Pejë pak kohë më parë” (për fragmentin e plotë shqip shih dokumentet në fund, dok. nr. 6). Zenarolla, ndoshta duke ndjekur të njëjtat burime, në kronikën e tij

krishterë, në qytetin madhështor dhe të bukur të Prishtinës, kryeqytetin e provincës së Kosovës, vendlindjen e Perandorit Justinian, kanë dërguar përfaqësuesit e tyre në një takim të shkurtër; këta vinin jo vetëm nga i gjithë vendi, por edhe nga provinca e Klinës (sic!), për t'u betuar në prani të gjeneralit për devotshmërinë e tyre ndaj Zotit Perandor”.⁴⁶ Ky variant sugjeron se takimi ishte mbajtur në Prishtinë dhe jo në Pejë.⁴⁷ Ka mundësi që kontaktet e para të jenë bërë në Pejë, kurse vetë traktati është përmbyllur në Prishtinë me Pikolominin prezent. Sidoqoftë, edhe *Karta e Vjenës* thotë se marrëveshja është arritur më 22 tetor.⁴⁸ Kjo mund të ketë qenë data kur është konkluduar marrëveshja e parë e Pikolominit me shqiptarët dhe banorët e tjerë të vendit.

Letra e Pikolominit më pas vazhdon me njoftimin se kishte shpërndarë flamuj perandorakë që ishin porositur në Vjenë një vit më parë, të cilët qenë vendosur në të gjitha kështjellat që ishin pjesë e marrëveshjes, sepse, shpresonte dhe punonte që tokat prej Shkodrës deri në Novipazar të futeshin nën devocionin perandorak.⁴⁹ Letrën e përmbyll me planet për të marrë Kaçanikun dhe më pas Shkupin, pasi tashmë Novobërdën e kishte nën kontroll.⁵⁰

Për disa ditë nuk kemi prej Pikolominit letra të tjera. Kjo deri më datë 31 tetor, kur nga kampi ushtarak i Kaçanikut i ishte drejtuar Leopoldit I përsëri, këtë herë me një raport më të gjatë dhe të detajuar të

thotë se më datë 22 tetor Pikolomini kishte dërguar përfaqësuesin e tij për t'i përmbyllur negociatat (khs. Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 211-222). Një version edhe më i gjatë i të njëjtit relacion është botuar në atë kohë edhe nga një periodik i Holandës, khs. Francisco Pompeati, “Verhael, van het geen in het Lant van Cossoua onder het Commando van den Heer Collonel Baron Strasser met eenige Esquadrans Cavallery ende 200 Voetknechten tegen omtrent 40000 Turken, Tartaren en Arnauten voorgevallen is op den eersten January, 1690.”, *Hollandse Mercurius... In het Jaer 1690* (Harlem: 1691), 290-294.

⁴⁶ “Carta de Viena”, 30.

⁴⁷ Pa qenë i sigurt, i mendimit se takimi është mbajtur në Prishtinë është edhe: Bexheti, *Der “Große Türkenkrieg”*, 89.

⁴⁸ “Carta de Viena”, 30.

⁴⁹ Zenarolla, *Trionfi di Leopoldo*, 210.

⁵⁰ *Po aty*, 210. Janë këto informata që na ndihmojnë rreth datimit të letrës së dytë të Pikolominit. Novobërda duhet të jetë marrë më 22 tetor, sepse në letrën e parë të 21 tetorit që e dërgon te Leopold I, kjo kështjellë nuk përmendet se ishte shtënë në dorë, kurse tek e dyta, po. Kurse raporti anonim i 27 tetorit thotë më specifikisht se më 22 ishte marrë Novobërda, khs. “Auß dem Kayserlichen”, pn.

ditëve të fundit.⁵¹ Në këtë letër të tij, Pikolomini sjell informata të reja rreth marrëveshjes me shqiptarët: “I kam bërë të qarta kërkesat e mia; ato konsistojnë në dhënien e betimit të besnikërisë ndaj Madhërisë Suaj, në zbatimin e urdhrave më të larta dhe nga ato që vijnë prej gjeneralëve tanë e eprorëve të tjerë [dhe] me një garanci në përmbushjen e saktë të asaj që është rënë dakord”.⁵² Marrëveshja ishte e shkurtër dhe e thjeshtë, me lojalitet dhe respektim të hierarkisë, ku gjeneralët perandorakë ishin në krye. Siç thotë vetë Pikolomini, s’kishte hapësirë për më shumë kërkesa se kaq, duke qenë se vëmendjen e kishte drejt depërtimit sa më thellë në viset e Shkodrës.⁵³ Pikolomini nuk flet për kërkesat e kelmendasve dhe të popujve të tjerë, por ato përmenden në raportin anonim të 27 tetorit: kelmendasit kishin kërkuar që të mos detyroheshin të paguanin taksa, siç nuk kishin paguar deri atëherë, kurse popujt e tjerë (*Turcken*) të mos largoheshin nga shtëpitë dhe kasollet e tyre.⁵⁴ Ndërkohë, menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes, habsburgët në Prishtinë ishin sulmuar nga pashai i Pejës: “Kur Mahmut Pasha mësoi se shqiptarët dhe popujt e tjerë po bënë negociata me mua, dhe se unë isha duke e ndjekur me një njësit për të parandaluar avancimin e tij, u nis drejt qytetit të Prishtinës, që i takon Serbisë; por kur unë u nisa me një trok në drejtim të tij, ai u tremb dhe iku, nuk e di se ku.”⁵⁵ As në këtë raport Pikolomini nuk jep data, por, duke marrë në konsideratë letrën e mëparshme, kjo ngjarje duhet të ketë qenë e datës 22-23 tetor. Pas këtij sukse, Pikolomini ishte nisur në drejtim të Kaçanikut, më 23 tetor.⁵⁶ Letra e Pikolominit shpjegon si është marrë Kaçaniku me lehtësi, prej ku qenë nisur përmes maleve në drejtim të Shkupit – të cilat duke i kaluar kishin hequr të “zitë e ullirit” – dhe pas tetë orësh rrugë kishin arritur në një fushë të gjerë pranë këtij qyteti.⁵⁷ Më gjerësisht tregon se si më 26 tetor e kishte djegur qytetin e madh të Shkupit, i cili ishte djegur edhe më datë 27.⁵⁸ Që qyteti ishte djegur në këtë datë konfirmohet edhe nga raporti anonim, si dhe nga letra e

⁵¹ Botuar në gjuhën gjermane që duhet të ketë qenë edhe gjuha origjinale e përpilimit, *Oestreichisch-militärische*, 239-246. Disa fragmente të kësaj letre janë përkthyer në gjuhën serbe dhe janë botuar nga Kostiq, “Spaljivanje Skoplja”, 123-126.

⁵² *Oestreichisch-militärische*, 240.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ “Auß dem Kayserlichen”, pn.

⁵⁵ *Oestreichisch-militärische*, 240-241.

⁵⁶ “Auß dem Kayserlichen”, pn.

⁵⁷ *Oestreichisch-militärische*, 241.

⁵⁸ *Po aty*, 244.

Shtrazerit e datës 18 nëntor.⁵⁹ Këtu është rasti të shihen zbukurimet që kronistët u bënë të dhënave. Belearn, i cili kurrësi s'kishte qenë në Shkup në këtë fushatë, sjell një rrëfim alternativ duke thënë "e kishte djegur po atë ditë, pra më 27. Të tjerë kanë raportuar se kjo djegie kishte ndodhur edhe më 26. Por unë jam i vetmi që shkruan prej atyre që di për këtë gjë".⁶⁰

Pikolomini arsyet e djegies, jo pa pendesë, i ndërlidh me madhësinë e qytetit dhe mungesën e trupave të nevojshme për ta mbajtur atë.⁶¹ Sipas Pikolominit ndërtesat e qytetit të Shkupit, mermeri, dekoret, mund të krahasoheshin me madhësitë e Romës. Sipas tij, qyteti ishte i madh sa Praga.⁶² Kështu në fund të letërës, si *post scriptum*, gjejmë një informatë me rëndësi, të panjohur deri më tani, në lidhje me identitetin e negociatorëve shqiptarë të këtyre traktateve. Po e sjellim të plotë fragmentin, ngaqë jo gjithçka kuptohet qartë prej saj dhe kërkon elaborim: "Shkupi kishte 60.000 banorë, së bashku me 40.000 refugjatë që janë vendosur atje dhe 400 familje hebreje, të cilët u larguan nga qyteti dyzet e tetë orë para mbërritjes sime aty. Dy priftërinj që kanë studiuar në Loreto (Romë) thonë se disa ditë më parë ishin në Sofje, ku aktualisht po qëndronte një francez i respektuar nga Sulltani; i mora me vete këta klerikë dhe njëzet familje të krishtera; në kohën e duhur do t'i liroj me lëmoshë nga paratë e Madhërisë Suaj, sepse nuk jam në gjendje të shpërndaj gjë prej lëmoshës time."⁶³ Nuk është shumë e qartë cilët janë këta dy priftërinj që kanë studiuar në Loreto, dhe nëse kishin ardhur prej Shkupit. As nëse ata janë pjesë e të ikurve nga Shkupi, apo ishin bashkuar me Pikolominin më parë, ndoshta gjatë negociatave nga Prishtina. Sidoqoftë, edhe Pjetër Bogdani, edhe Toma Raspasani kishin qenë nxënës në Loreto, prandaj s'është krejt e pamundur të bëhet fjalë për këta të dy, çka do të ishte konfirmimi më i hershëm i kontaktit të Bogdanit me Pikolominin.

⁵⁹ "Auß dem Kayserlichen", pn; Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 228-235. Djegia e Shkupit përmendet edhe në një burim osman, por pa datë, Ahdülkadir Özcan, *Defterdar Sari Mehmed Paşa Zübde-i Vekayât tahlil ve metin (1066-1116 / 1656-1704)*, (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basimevi, 1995), 338.

⁶⁰ Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 256-301.

⁶¹ *Oesterreichisch-militärische*, 244.

⁶² *Po aty*, 242-243.

⁶³ *Po aty*, 245.

Këtu mbarojnë letrat e Pikolominit. Një letër që e dërgon Baden te Leopold I, më 7 nëntor, përveç lëvdatave për sukseset e fundit të gjeneralit të tij në Jug, nuk sjell asnjë njoftim të ri nga vetë Pikolomini.⁶⁴ Më 10 nëntor te Baden kishte mbërritur një letër nga kampi i Pikolominit, por jo nga dora e tij, siç e shpjegon vetë, me raporte të datës 29 tetor pas pushtimit të Shkupit.⁶⁵ Për rrugëtimin e Pikolominit në ditët në vijim, njoftohemi nga raportet dhe relacionet e botuara në gazetat e kohës. Siç mësojmë nga një raport i kampit habsburg të Prizrenit, më datë 1 nëntor, pasi e kishin riparuar kështjellën e Kaçanikut në disa pika, ishin ndalur në Lipjan, prej ku, Shtrazer me tri batalionet të tij dhe me tetë topa kishte vazhduar për në Zveçan dhe në Banjskë, kurse paraprakisht Holshtajn me husarët e Hanoverit dhe me regjimentin e kontit Çaki ishin nisur drejt Novobërdës.⁶⁶ Vetë Pikolomini me regjimentin e tij, dragonjtë e Stirisë dhe me dy topa, ishte nisur në drejtim të Prizrenit kah Llapushniku (*Capuschnik*).⁶⁷ Gjenerali në këtë fshat kishte qëndruar edhe më datë 3 tetor, për shkak të etheve që e kishin kapluar dhe një gunge që i ishte shfaqur nën sqetull (simptomë e zakonshme e murtajes bubonike). Lodhja e sëmundjes nuk e kishte ndalur Pikolominin ta vazhdonte udhën e tij, më datë 4 tetor ishte ndalur në Banjë (*Pannige*) afër Malishevës.⁶⁸ Më 5 tetor është ndalur në Mamushë (*Mamuscha*), tri orë larg Prizrenit, ku ishte pritur nga shqiptarët (*Albanesere*). Dhe më në fund, më datë 6 kishte mbërritur në Prizren, ku është pritur prej kryeipeshkvit të vendit dhe prej krerëve të Kelmendit, që e kishin përshëndetur me një flamur me një kryq.⁶⁹ Ky fragment, që është kopjuar me devijime nga kronistët, ka

⁶⁴ Letra e von Badenit për Leopoldin I, nga kampi ushtarak në Fetislam, 7 nëntor 1689. Botuar në Diersburg, *Des Markgrafen*, 171-176.

⁶⁵ Letra e von Badenit për Leopoldin I, nga kampi ushtarak i Çrncit, 10 nëntor 1680 (botuar *po aty*, 177-180). Është e mundur se këtu bëhet fjalë për raportin anonim të 27 tetorit (shih: "Auß dem Kayserlichen", pn).

⁶⁶ Edhe këtu njohim vetëm variantin e botuar të këtij raporti në shtypin e kohës, *Die Europäische Relation*, nr. 97, 10 dhjetor 1689, 787-791. Sipas faksimiles së mikrofilmuar nga Staats-und Universitätsbibliothek Bremen. Për tekstin e përkthyer në gjuhën shqipe, shih dokumentet në fund (dok. nr. 5).

⁶⁷ *Po aty*, 788. Në kaligrafinë e kohës C dhe L ngatërroheshin lehtësisht. Duket se kjo është arsyeja pse shtypshkruesit Llapushnikun në vazhdimësi e transliterojnë si Capuschnik. Gabime të ngjashme ka edhe me qytetet e tjera, Shkupi shënohet si Sconia, për shkak të ngjashmërisë mes n dhe p në kaligrafinë gjermane.

⁶⁸ *Po aty*, 789. Banja shpesh në raportet e kohës shkruhet si Panna, ose ngjashëm.

⁶⁹ *Po aty*.

qenë subjekt i shumë debateve. Në mënyrë *gati* identike është përsëritur e ripërsëritur, me versione e interpretime të llojllojshme. Por në formën të cilën po i referohemi ne, dhe që është më e hershmja e njohur nga ky moment (10 dhjetor 1689), fjalia në gjermanisht është kështu: “...woselbsteu der Hr General von dem Erz-Bichoffe selbigen Landes und den Patriarchen von Climent empfangen wurde, so eine Fahne mit den Zeichen des Creuzes vorher tragen liessen.”⁷⁰ Pra, po flitet për një kryeipeshkëv të vendit bashkë me krerët (*den Patriarchen*) e Kelmendit.⁷¹ Sidoqoftë, ky formulim i pazakontë duket se ka qenë burimi kryesor i konfuzionit në lidhje me këtë çështje. Në pjesën tjetër të tekstit burimi i kampit të Pikolominit nuk përmend më patriarkët e Kelmendit. Kronikat e mëvonshme (si edhe disa medie) këtë “*den Patriarchen von Climent*” e kanë përkthyer si patriarku i Kelmendit, ndërsa në fakt kemi të bëjmë me shumësin e rasës dhanore, *den Patriarchen*, që do të thotë *patriarkët*, apo patricës, e jo *patriarku*. Kuptimi duhet të jetë ai sekular i “patricëve” në vend të atij fetar të “patriarkut”. Me siguri referencë për krerët e Kelmendit, siç janë quajtur në atë kohë udhëheqësit e fiseve. Një letër në shqip e nënshkruar si “Krenat e Gashit”, e dërguar në Romë nga Pulti në fund të majit të atij viti (1689),⁷² duket se është shkruar pikërisht

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ Nga njohësit e gjuhës gjermane dhe specialistët që kemi konsultuar është vënë re se bëhet fjalë për shumësin, pra patrikët e Kelmendit. Falënderoj Andreas Reich-in për ndihmën në një përkthim paraprak të këtij fragmenti dhe prof. dr. Blera Ismajlin për komentet e ndihmën shtesë në transliterim dhe përkthim, *Die Europäische Relation*, nr. 97, 10 dhjetor 1689, 789.

⁷² Megjithëse në qarqet shkencore deri më tani është besuar se kjo letër në shqip ishte nga dora e Gjergj Toliqit, shih Peter Bartl dhe Martin Camaj, “Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689”, *Zeitschrift für Balkanologie*, 5 (1967) 1, 23-33; Bardhyl Demiraj, “Grimca biografike për autorët tanë të vjetër (IV) – Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689)”, *Hylli i Dritës*, 2 (2016), 41-54. Dëshmi të reja e përjashtojnë një mundësi të tillë, duke qenë se ai disa muaj para letrës ishte vrarë në Novi Pazar, për çka njoftohemi nga vetë Bogdani në një letër që ia dërgon Vatikanit, khs. Odette Marquet, *Letra dhe dokumente: nga Arkivi i Kongregatës de Propaganda Fide si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit* (Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997), 503. Ndërkohë, me kërkesë të Bogdanit aty ishte vendosur Tomë Raspasani, që mund të ketë ndihmuar në përpilimin e letrës (khs. Marquet, *Letra dhe dokumente*, 505). Kjo informatë e re mund të ndriçojë edhe të dhëna për identitetin e Raspasanit. Për një biografi më të hershme të Raspasanit, shih: Ражко Веселиновић, “Томас Распасановић (Raspasani) и његов рад за аустро-турског рата крајем XVII века: Расправа из културне и војно-политичке историје”, *Зборник Матице српске: Серија друштвених наука*, 12 (1956), 39-64 [Rajko Veselinović, “Toma

nga Tomë Raspasani (1648-1718) që duhet të ketë qenë prezent edhe në këtë pritje të Prizrenit.⁷³ Edhe pse s'i njohim dinamikat e përkthimit mes shqiptarëve, serbëve dhe habsburgëve në këtë kohë, ka shumë mundësi që gjuha e përdorur prej tyre të ketë qenë italishtja. Nuk e dimë gjuhën e raportit origjinal të kampit ushtarak të Prizrenit, sepse vetëm përkthimi në gjuhën gjermane njihet deri sot,⁷⁴ por mund të imagjinohet se ndonjë formë e “Capi di Clementi” ndoshta ka qenë në formulimin fillestar, që më pas në gjermanisht ka përfunduar si “den Patriarchen von Climent”. Në Francë “Gazette”, e datës 31 dhjetor 1689, bazuar në të njëjtin relacion nga Prizreni shkruante në parafrazim se Pikolomini kishte mbërritur “më datë 6 të muajit të kaluar: dhe është pritur nga Arqipeshkvi, klerikët dhe të parët e vendit.”⁷⁵ Kjo gazetë nuk e përmend fjalën “patriark”. Gazeta “Extra Ordinari” nga Praga, më 14 dhjetor, në një formulim të tyrin e kishin përdorur në shumës “allwo Er auch den 6ten ejusdem von des Orths Erz-Bisschoffen, und der Clementirten Patriarchen.”⁷⁶ Ndërkohë “The London Gazette”, e datës 23-26 dhjetor 1689, duke parafrazuar raportin në anglisht e sjell në njëjës, “the Archbishop of that City, with the Patriarch of the Clementins”.⁷⁷ Sidoqoftë, kjo instancë është hera e vetme e kësaj fushate që fjala

Raspasanoviq (Raspasani) i njegov rad za austro-turskog rata krajem XVIII veka: Rasprava iz kulturne i vojno-političke istorije”, *Zbornik Matice srpske: Serija drushtvenih nauka*, 12 (1956), 39-64]. Për një biografi më të re me saktësime, shih Skënder Asani, Albert Ramaj & Natasha Didenko, *Familjet katolike shqiptare në Shkup (dokumente, fotografi dhe dëshmi)*, (Shkup: Acta Non Verba, 2018), 60-74. Për ditët e fundit të Raspasanit në Hungari, shih Eleonóra Géra, “The Secret Life of the Albanian Priest Toma Raspasani in Buda”, në *These were hard times for Skanderbeg, but he had an ally, the Hungarian Hunyadi: Episodes in Albanian-Hungarian Historical Contacts*, Krisztián Csaplár-Degovics (ed.) Hungarian Academy of Sciences Research Centre for the Humanities (Budapest, 2019), 93-106.

⁷³ Frederico Veterani, *Memorie del Maresciallo Conte Deferico Veterani dall'anno 1683 sino all'anno 1694, concernenti l'operazioni militari da lui fatte in Ungaria, e provincie adiacenti* (Wien, Leipzig: Giov. Federigo Jahn, 1771), 50; Veselinoviq, “Toma Raspasanoviq”, 48.

⁷⁴ Shih referencën 68, khs. *Die Europäische Relation*, nr. 97, 10 dhjetor 1689, 787-791.

⁷⁵ *Gazette*, nr. 54, 31 dhjetor 1689, 628, lajmi nga Vjena i datës 11 dhjetor. Jo e pazakontë për raportimet e kohës nga mosnjohja e rajonit, në këtë lajm në vend të Prizrenit vazhdimisht thuhet Prishtina: “Il y arriva le 6 du mois dernier: & fut receu par l'Archivesque, le Clerge & les principaux de pais. [...] Le 7 & le 8, la maladie du Comte Picolomini augmenta de telle sorte qu'il mourut le 9 a Pristina...”.

⁷⁶ *Extra Ordinari Mittwochliche Reichs-Post-Zeitungen*, pn, 14 dhjetor 1689, pn.

⁷⁷ *The London Gazette*, nr. 2517, 23-26 dhjetor 1689, 1.

“Patriarchen” dhe “Climent” përmenden bashkërisht. Siç do të shohim në vijim, më vonë bëhet fjalë vetëm për kryepeshkvin dhe patriarkun e Shqipërisë ose të vendit.

Një grumbull me 5 000 shqiptarë, të krishterë dhe myslimanë, kishin qenë pjesë e pritjes, të cilët të ndarë në dy kolona kishin gjuajtur me pushkë tri herë në shenjë respekti.⁷⁸ Kronistët e mëvonshëm raportojnë numra të tjerë, deri në 20 000, gjë që nuk haset në letërkëmbimet e kohës (as në raportimet e medieeve).⁷⁹ Më pas, këta shqiptarë u vendosën në kampet pranë atyre të “ushtrisë gjermane”.⁸⁰ Më datë 7 nëntor, Pikolomini i shtrirë në shtrat, ishte takuar me kryepeshkopin dhe me oficerë të tjerë për të ripranuar devotshmërinë e tyre.⁸¹ Të njëjtën ditë, i pafuqishëm për të vazhduar më tej, Pikolomini i dorëzon komandën dukës së Holshtajnit, me udhëzimin që të nisej sa më parë për në Prishtinë.⁸² Holshtajni nuk ka qenë prezent në Prizren në ato momente, pasi ishte i angazhuar në mbrojtjen e Shtipit pas një sulmi osman.⁸³ Më 8 nëntor trupat shqiptare, sipas traktatit të ri, janë regjistruar si regjimente nën komandën perandorake.⁸⁴ Ndërkaq, më 9 nëntor, rreth orës 7 të mëngjesit, Pikolomini kishte dhënë frymën e fundit, nën shoqërinë e kryepeshkopit.⁸⁵ Një ditë më vonë, një korrier i shpejtë njoftonte Shtrazerin në Prishtinë për vdekjen e gjeneralit.⁸⁶ Po atë ditë, më 10 dhjetor, Pikolomini përmes një ceremonie të udhëhequr nga kryepeshkopi, që varrosur në xhaminë “më të përmendur” të Prizrenit.⁸⁷

⁷⁸ *Die Europäische Relation*, nr. 97, 10 dhjetor 1689, 789.

⁷⁹ Shih p.sh. kronikën e Belleardit, Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 256-301.

⁸⁰ *Die Europäische Relation*, nr. 97, 10 dhjetor 1689, 789.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *Po aty*, 789-790.

⁸³ Pompeati, *Relazione di quante*, pn; *Gazette*, nr. 54, 31 dhjetor 1689, 627. Një fragment i shkurtër nga Shtipi prej kampit të Holshtajnit i datës 11 nëntor është ruajtur në një relacion më të madh me titull *Relation Dessen Was von Tag zu Tag', unter dem Commando Ih. Excell. Hr. General Piccolomini stehenden Kayserl. Armee passiret: Auch des Siegs, Der bey damaligem Treffen mit dem Erbfeind, unter Anführung Ihr. Hochfürstl. Durchl. zu Holstein, bey Stippo erhalten worden* (pa autor, pa vend shtypi), BSB, Signatur: 999/4 Hist.pol.541/19.

⁸⁴ *Po aty*, 790.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 228-235.

⁸⁷ Këtë informatë shkurtimisht e përcjell *Montägiger Ordinari-Friedens- und Kriegs Currier*, nr. 9, 19 dhjetor 1689, sipas një lajmi nga Vjena, i datës 11 dhjetor. Feige në

Këtu mbyllet fushata e Pikolominit në Kosovë. Në pjesën në vijim, roli kryesor i organizimit të fushatës habsburgase në këto anë i takon gjeneralit Holshtajn.⁸⁸

Identiteti i “kryepeshkopit” ka qenë subjekt i shumë spekulimeve të mëvonshme. Se për kë konkretisht bëhej fjalë nuk saktësohet në asnjërën prej kronikave të hershme dhe as nëpër letrat e relacionet nga kampet e Vjenës (që kemi përmendur këtu). Atë e sqaron një letër që është dërguar për në Romë disa javë pas ngjarjes, më 6 dhjetor nga Gjon Bogdani, nipi i Pjetër Bogdanit. Letra është dërguar nga Prishtina. Aty mes tjerash duke folur gjerësisht për Bogdanin thotë, “me ardhjen nga këto anë të ushtrisë fitimtare të Cezarit tonë [Leopoldit I], i shkoi personalisht në takim për të ulur krenarinë e trupës që të mos shtyheshin në dëme dhe keqbërje ndaj katolikëve, dhe lumturisht ia doli plotësisht. Pastaj, si u kthye në Prizren, atdheun e vet, me fort të shkëlqyeshmin gjeneral Pikolominin për të marrë pak frymë, ky kalorës trim ra në shtrat prej murtajës, pranë të cilit qëndroi [deri] në nevojën e fundit të shpirtit të tij”.⁸⁹ E njëjta letër sqaron se më pas vetë Bogdani ishte sëmurë dhe për arsye shëndetësore që vendosur në një spital me mjekë gjermanë në Prishtinë, ku edhe vdiq në mëngjesin e 6 dhjetorit,⁹⁰ po atë ditë kur është dërguar edhe letra e Gjonit. Për vdekjen e “kryepeshkopit të shqiptarëve” (pa përmendur emrin e tij) ishte raportuar edhe nga relacionet dhe mediet e kohës.⁹¹ Por,

kronikën e tij, e përcjell këtë informatë në mënyrë identike, por ai thotë se Pikolomini ishte varrosur në *kishën* e këtij qyteti, khs. Feige, *Wunderbahrer Adlers-Schwung*, 517. Ndërkohë, historiani gjerman Gerba, në shek. XIX, flet edhe për një njoftim nga konsulli gjerman në vitin 1888 në Prizren, Richard Hickel, i cili besonte se Pikolomini duhet të jetë varrosur në kishën e Shën Premtës, khs. Gerba, “Die Kaiserlichen”, 151. Sot kjo kishë është ndër katër objektet në Kosovë nën mbrojtjen e UNESCO-s.

⁸⁸ Pompeati, *Relazione di quante*, pn; *The London Gazette*, nr. 2520, 2-6 janar 1689 (sic!), 1; khs. *Gazette*, nr. 54, 31 dhjetor 1689, 628-630; edhe *Gazette*, nr. 6, 11 shkurt 1690, 62-63.

⁸⁹ Marquet, *Letra dhe dokumente*, 509-511 (Letra e përkthyer në gjuhën shqipe nga Stefan Paloka).

⁹⁰ *Po aty*, 511.

⁹¹ Shih p.sh. një lajm të gazetës *Bologna*, në muajin vijues, që u referohet raporteve nga Prishtina të datës 18 dhjetor: “E morto l'Arcivescovo d'Albania con dispiacere uniuue sale delli noltti Generali Cesarei per hauer contribuito tatto il suo potere, e

siç u tha, në asnjërën prej tyre (përveç letrës së Gjon Bogdanit) nuk përmendet emri i këtij kryepeshkopi. Sakaq, testamenti i Bogdanit, i përpiluar e nënshkruar në Prishtinë më 1 dhjetor 1689, i botuar si transliterim për herë të parë më 1997, nuk lë hapësirë për dyshim se kemi të bëjmë me Bogdanin në këtë rast.⁹² Në këtë testament përmendet prezent krahas tij edhe një peshkop i Pultit në Shqipëri, “Petrus Bogdanus Archiepiscopus Scuporum, et Administrator totius Serviae, et Episcopus Puletensis in Albania praesentibus”⁹³ që mund të ketë qenë Tomë Rapsani. Por këtë nuk mund ta konfirmojmë, sepse ai s’kishte qenë në mesin e të nënshkruarve të testamentit në fund.⁹⁴ Ka mundësi që edhe këtë titull e mbante vetë Bogdani, krahas kryepeshkopit të Shkupit, e administratorit të Serbisë. Ngjarjet e këtij muaji në Prishtinë më së miri i shpjegon sekretari i Pikolominit, i cili në kohën e shkrimit të relacionit ishte në shërbim të Holshtajnit.⁹⁵ Ai shpjegon se pas vdekjes së kryepeshkopit të Shqipërisë (*Morse frà tanto l’Arcivescovo di Albania*) kishte pllakosur një pikëllim në mesin e popullatës lokale dhe të krerëve imperialë, përfshi Holshtajnin, porse negociatat me shqiptarët s’ishin ndalur. Në “mesin e atij muaji” kishin ardhur kelmendasit që të përforconin “marrëveshjen e parë të bërë në Pejë”, dhe pas tyre kishin ardhur edhe Gashët (*Li Gassi*) që të siguronin prezencën në Gjakovë.⁹⁶ Më vonë, siç thotë Pompeati, pas shumë ftesave e lajkave, pasi kishte vëzhguar nga larg deri atëherë ngjarjet në Kosovë, ishte paraqitur edhe patriarku i Pejës, Arseni III.⁹⁷ Me këtë të fundit, sekretari i Pikolominit ishte takuar personalisht, me udhëzimin që bashkë me të, të niseshin në

applicatione in vantaggio degl' interessi di Cesare in quelle parti”, *Bologna*, pn, 24 janar 1690, faqja e fundit (pn); apo, *Gazette*, nr. 6, 11 shkurt 1690, 62.

⁹² Ky testament mëtohet të ketë qenë fshehur nga jezuitët çekë për një kohë, me qëllim përfitimi, khs. Јован Радонић, *Римска курија у јужнословенске земље*, 424-425 (Beograd: SANU, 1950) (Jovan Radonić, *Rimska kurija u juzhnoslovenske zemlje* (Beograd: SANU, 1950)). Testamenti origjinal i botuar nga Marquet, *Letra dhe dokumente*, 519-521.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ Anipse, as prifti që i kishte aplikuar sakramentet nuk është nënshkruar si dëshmitar. Radonić, zakonisht i mirinformuar, bazuar në dokumentet arkivore të Propaganda Fide-s besonte se krahas Bogdanit kishte qenë një Pjetër tjetër me mbiemrin Karagich, i cili siç duket në një moment e ka mbajtur pozitën e peshkopit të Pultit, po kjo duhet të ketë qenë disa vjet më vonë, më 1698, khs. Radonić, *Rimska kurija*, 424-425.

⁹⁵ Pompeati, *Relazione di quante*, pn.

⁹⁶ *Po aty*.

⁹⁷ *Po aty*.

Hercegovinë për të bërë për vete edhe këta popuj.⁹⁸ Nuk mund të konfirmohet nëse vizita e Arsenit III në Prishtinë është bërë rreth datës 31 dhjetor, siç raportojnë mediet e kohës.⁹⁹ Këto gazeta, për ndonjë arsye, gjithashtu raportojnë se patriarku i Pejës kishte ardhur për të marrë pasaportë që të shkonte në Vjenë.¹⁰⁰ Këtë informatë kurrsesi nuk e kishte sjellë Pompeati që kishte qenë vetë prezent aty. Deri më tani, ky relacion i Pompeatit i datës 1 janar është i vetmi nga një protagonist i cili ka qenë vetë në Prishtinë dhe që përshkruan diçka më në detaje nga gjysma e dytë e muajit dhjetor në këtë qytet.

Përfundime

Letrat dhe relacionet që janë përdorur në këtë artikull, kryesisht të botuara nëpër mediet e kohës, u takojnë protagonistëve të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në ngjarjet që përshkruhen. Gjithashtu, ato vinin gjatë kohës kur ngjarjet ishin ende duke u zhvilluar, ose pak ditë a javë më pas (periudha tetor 1689, deri në janar të vitit 1690). Përmes tyre, dhe duke anashkaluar kronikat e hershme, kemi konstruktuar një kronologji të përditësuar të ngjarjeve të fushatës habsburgase në Kosovë të vjeshtës së vitit 1689. Të dhënat e paraqitura në disa raste janë krejt të panjohura dhe të papërdorura për këtë segment historie. Ndërkohë, këto materiale dëshmojnë se kronikat e hershme, që janë përpiluar nga mesi i vitit 1690 e tutje nga njerëz që s'kanë qenë pjesëmarrës në këto ndodhi, në shumicën e tyre bazohen te letrat dhe relacionet e hershme, si këto që kemi përdorur këtu. Përveç tri letrave të Pikolominit gjatë fushatës, që kanë mbijetuar vetëm në versionet e shtypura, artikulli ka shfrytëzuar edhe raportimet dhe relacionet e botuara nëpër gazetatat e kohës. Një

⁹⁸ *Po aty.*

⁹⁹ Shih p.sh. një gazetë e Madridit: "Por otras cartas de Pristina, de 30. del pasado, y primero del presente, avisan, que efte propio dia havia llegado à aquella Cividad el Patriarca de Albania (sic), y de todas las pequeñas Provincias cercanas...", *Nuevas ordinarias de los sucesos del Norte [Noticias Ordinaires]*, pn, 22 shkurt 1690, 69; *Bologna*, 31 janar 1690, faqja e fundit; *Gazette*, nr. 6, 11 shkurt 1690, 61. Mbi këtë çështje ekziston edhe një letër e datës 15 janar 1690 nga Vjena, që mbahet në arkivat venecianë (e që ngjason më shumë me raportimet e gazetave të mësipërme) ku tregohet se korrieri kishte sjellë nga Prishtina letra të datës 1 janar dhe njofton për ardhjen e patriarkut; Zamputi, Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, 311-312. Mbi datën e ardhjes së Arsenit III në Prishtinë shih edhe argumentimin e Malcolm-it, *Kosovo*, 156.

¹⁰⁰ *Nuevas ordinarias*, 69; *Bologna*, 31 janar 1690, faqja e fundit.

qëmtim i tyre i vazhdueshëm mund të sjellë edhe të tjera të dhëna me rëndësi rreth kësaj fushate. Materialet që kemi përdorur prej protagonistëve janë vetëm disa prej atyre që kanë mbijetuar dhe që janë gjetur mbi këtë fushatë. Të tjera (si letra e Pikolominit nga Prokupja) mund të dalin në sipërfaqe në të ardhmen, duke ndihmuar më tej në ndriçimin e këtij fragmenti të historisë në Kosovë.

Bibliografi:

Burime arkivore:

Osterreichisches Staatsarchiv (OS), Signatur: AT-OeStA/KA ZSt HKR HR Librat (Bücher): 0378 Protokoll-Expedit mit Index, 0379 Protokoll-Registratur mit Index, 0380 Protokoll-Expedit mit Index, 0381 Index Registratur, 0382 Protokoll-Registratur

Relacione dhe botime dokumentare:

Diersburg, Philipp Röder von. *Des Markgrafen Ludwig Wilhelm von Baden Feldzüge wider die Türken*, vol. II. Karlsruhe: Müller'schen Hofbuchandlung, 1842.

Marquet, Odette. *Letra dhe dokumente: nga Arkivi i Kongregatës de Propaganda Fide si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*. Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997.

Oestreichisch-militärische Zeitschrift, Vjenë 2 (1808): 235-246.

Pompeati, Francisco. "Verhael, van het geen in het Lant van Cossoua onder het Commando van den Heer Collonel Baron Strasser met eenige Esquadrans Cavallery ende 200 Voetknechten tegen omtrent 40000 Turken, Tartaren en Arnauten voorgevallen is op den eersten January, 1690." *Hollandse Mercurius... In het Jaer 1690*. Harlem: 1691, 290-294.

Pompeati, Giovanni Francesco. *Relazione di quanto nel Paese di Cossova e passato sotto il comando del Sig. Colonello Barone Strasser, con alcuni Squadroni di Cavalleria, e 200 Fanti, contro incirca 40000 Turchi, Tartari, & Arnauti dell'Albania, seguito à di 1 Genaro, 1690* (pa vend, pa botues, 1690).

Zamputi, Injac & Selami Pulaha. *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699). Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1990.

Botime historiografike:

- Asani, Skënder & Albert Ramaj, Natasha Didenko. *Familjet katolike shqiptare në Shkup (dokumente, fotografi dhe dëshmi)*. Shkup: Acta Non Verba, 2018.
- Bartl, Peter & Martin Camaj. "Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689". *Zeitschrift für Balkanologie*, 5 (1967) 1: 23-33.
- Bexheti, Nuri. *Der "Große Türkenkrieg" und Die Albaner: Die militärische Präsenz der Balkanvölker am "Großen Türkenkrieg" (1683-1699)*. Saarbrücken: Südwestdeutscher Verlag für Hochschulschriften, 2009.
- Bexheti, Nuri. *Die Teilnahme der Albaner am "Grossen Turkenkrieg" 1683-99*, disertacion për gradën Doktor i shkencave. Universiteti i Vjenës: 2005.
- Bizozeri, Simpliciano. *La sagra lega contro la potenza ottomana. Successi delle armi imperiali, polacche, venete, e moscovite*, vol. I. Milano: Regia Ducale, 1690.
- Boethius, Christoph. *Ruhm-belorberter triumph-leuchtender und glantz-erhöherer Kriegs-Helm dero Röm. Käyserl. auch zu Hungarn und Böhmen Königl. Majest. und dero samtlichen hohen Bunds-Verwandten wider den blutbesprengten türckischen Tulband*, vol. IV. Nuremberg: J. C. Lochner, 1690.
- Chmel, Joseph. *Die Handschriften der K. K. Hofbibliothek in Wien im Interesse der Geschichte, besonders der österreichischen, verzeichnet und excerpirt*, vol. II. Wien: C. Gerold., 1841.
- Demiraj, Bardhyl. "Grimca biografike për autorët tanë të vjetër (IV) – Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689)". *Hylli i Dritës*, 2 (2016): 41-54.
- Feige, Johann Constantin. *Wunderbahrer Adlers-Schwung: Oder Fernere Geschichts-Fortsetzung Orteli's redivivi et continuati*, vol. II. Vieden: Voigt, 1694.
- Frashëri, Kristo. "Pjetër Bogdani dhe lëvizja çlirimtare shqiptare në shek. XVII". *Studime historike* 1 (1990): 159-178.
- Géra, Eleonóra. "The Secret Life of the Albanian Priest Toma Raspassani in Buda". *These were hard times for Skanderbeg, but he had an ally, the Hungarian Hunyadi: Episodes in Albanian-Hungarian Historical Contacts*, Krisztián Csaplár-Degovics (ed.) Hungarian Academy of Sciences Research Centre for the Humanities. Budapest: 2019: 93-106.
- Gerba, Hauptmann. "Die Kaiserlichen in Albanien 1689". *Mitteilungen Kriegsarchiv* 2 (1888): 115-178.
- Kostiç, Mita. "Spaljivanje Skoplja 26 i 27 okt. 1689". *Juzhna Srbija* 4 (1922): 121-128. [Мита Костић, "Спаљивање Скопља 26 и 27 окт. 1689", *Јужна Србија* 4 (1922): 121-128.]

- Malcolm, Noel. *Kosovo – A Short History*. New York: New York University Press, 1998.
- Malcolm, Noel. *Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit: Studime mbi historinë e shqiptarëve*. Përktheu Ana Haxhi. Prishtinë: Atini, 2020.
- Özcan, Ahdülkadir. *Defterdar Sari Mehmed Paşa Zübde-i Vekayât tahlil ve metin (1066-1116 / 1656-1704)*. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basimevi, 1995.
- Radoniq, Jovan. *Rimska kurija u juzhnoslovenske zemlje*. Beograd: SANU, 1950. [Јован Радонић, *Римска курија у јужнословенске земље* (Beograd: SANU, 1950)]
- Rycaut, Paul. *Being a full Relation Of the Last Troubles in Hungary, with the Sieges of Vienna, and Buda, and all the several Battles both by Sea and Land, between the Christians, and the Turks, until the End of the Year 1698, and 1699*. London: Robert Clarell & Abel Roper, 1700.
- Schwarcz, Iskra & Stefan Spevak, & Ekaterina Večeva. *Hoffnung auf Befreiung: Dokumente aus österreichischen Archiven zur Geschichte Bulgariens (1687-1690)*. Wien: Verlag Ostag., 2004.
- Schweigerd, Carl A. *Oesterreichs Helden und Heerführer von Maximilian I. bis auf die neueste Zeit*, vol. II. Grima: Verlags-Comptoir 1853.
- Tomoski, Tomo. “Eden izguben dokument za avstriskata vojna vo Makedonija vo 1689. godina”. *Godishen zbornik na Folozofskiom fakultet* 15 (1963): 121-132. [Томо Томоски, “Еден изгубен документ за австриската војна во Македонија во 1689. година”. *Годишен зборник на Филозофскиот факултет* 15 (1963): 121-132.]
- Türkal, Nazire Karaçay. “Silahdar Findiklili Mehmed Ağa Zeyl-İ Fezleke: (1065-22 Ca.1106 / 1654-7 Şubat 1695)”. Disertacion për gradën Doktor i shkencave (i pabotuar). Marmara Üniversitesi Stamboll: 2012.
- Veselinoviq, Rajko. “Toma Raspasanoviq (Raspassani) i njegov rad za austro-turskog rata krajem XVIII veka: Rasprava iz kulturne i vojno-političke istorije”. *Zbornik Matice srpske: Serija drushtvenih nauka*, 12 (1956): 39-64. [Ражко Веселиновић, “Тома Распасановић (Raspassani) и његов рад за аустро-турског рата крајем XVII века: Расправа из културне и војно-политичке историје”. *Зборник Матице српске: Серија друштвених наука*, 12 (1956): 39-64].
- Zenarolla, Giovanni Paolo. *Trionfi di Leopoldo Primo, imperatore de' Romani sempre Augusto, nell' anno 1689. fino alli 6. Marzo 1690*. Viena: Gio. Van Ghelen, 1690.

Gazeta:

Bologna, Bolonjë, 1690.

Die Europäische Relation, Hamburg, 1689.

Extra Ordinari Sambstägliche Wienerische und andere Post-Zeitungen
[*Ordinari Mittwochliche Reichs-Post-Zeitungen*], Prager, 1689.

Gazette, Paris, 1689, 1690.

Montägiger Ordinari-Friedens- und Kriegs Currier, Nuremberg, 1689.

Nuevas ordinarias de los sucessos del Norte [*Noticias Ordinaires*], Madrid, 1690.

Ordinari Mittwochliche Reichs-Post-Zeitungen, Prager, 1689.

The London Gazette, 1689.

YLL RUGOVA

Scientific researcher in the project "Prishtina in history", Trembelat, Prishtina
yll.rugova@trembelat.com

S u m m a r y

THREE LETTERS OF PICCOLOMINI DURING THE HABSBURG MILITARY CAMPAIGN IN KOSOVO (1689)

The unfolding of the short Habsbourg campaign in Kosovo in the fall of 1689, for most historians, was observed through the lenses of some early mostly second-hand chronicles that describe this event. A main source for most of them, the manuscript known as *Annotationes und Reflexiones...*, has recently been proven to be a secondary source, and not the work of a participant in this campaign. Primary sources, from protagonists who witnessed these events, though in some cases were known before, have not been used enough in works related to these fragments of history. This article aims to identify some of these primary sources of time that are mainly letters, relations, and reports. Through them, and by publishing some of them in Albanian, it will seek to create an updated overview of the historical events of this campaign in Kosovo. The main set of these documents are the three letters written by Piccolomini himself during the days of his stay in Kosovo. Others are letters and reports coming from the war camps in Kosovo. Most letters and reports utilized in this article, mainly published in the media of the time, belong to the protagonists who directly participated in the events described. Also, they come from the time

when the events were still unfolding, or a few days or weeks later (the period October 1689 to January 1690). The data presented in some cases is completely unknown for this segment of history. Additionally, to an extent the article confirms that the early chronicles, mainly compiled from the middle of 1690 and after, themselves are based on early letters and relations, such as the ones we have used here. A continued exploration of similar accounts, kept in archives, or published in periodicals of the time may bring other important data about this campaign. The materials used here are only some of those that survived and were found during this campaign, others (such as Piccolomini's letter from Prokuplja from 15th of October), may surface in the future, and will further help to clarify the details of this campaign.

EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

edmond.malaj@asa.edu.al

<https://doi.org/10.61773/5fgrc144>

**RRETHANAT POLITIKO-SHOQËRORE TË SHPËRNGULJES
SË SHQIPTARËVE NË ZARË DHE KRIJIMI I KOLONISË SË
BORGO ERIZZO-S****Abstrakt:**

Në këtë artikull do të përqendrohemi kryesisht në historinë e krijimit të kolonisë shqiptare të Borgo Ericos (Borgo Erizzo) në Zarë, të cilën e kemi shtjelluar në dy tema bosht. Pavarësisht se në literaturën e huaj, sidomos në atë në gjuhën kroate, por edhe në gjuhët italiane e gjermane, tashmë ka të dhëna për komunitetin e arbëreshëve të Zarës, në literaturën historike është shkruar pothuajse shumë pak për ta dhe ky artikull synon ta mbulojë këtë boshllëk.

Fillimisht, trajtohen rrethanat politiko-shoqërore por edhe ekonomike që ekzistonin në Shqipëri gjatë periudhës së shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë të Kroacisë. Në qendër të vëmendjes do të jenë pikërisht krahinat nga e kishin origjinën arbëreshët e Zarës, pra famullitë e Shestanit dhe të Briskut dhe famullitë e dioqezës së Shkodrës. Tematika e dytë ka të bëjë me ikjen e atyre grupeve të shqiptarëve, të cilët më vonë krijuan kolonitë e arbëreshëve të Zarës.

Në artikull pasqyrohen valët e ndryshme të këtyre refugjatëve, fatet e tyre të mëtejshme dhe mundësisht të dhëna mbi familjet dhe zakonet e tyre. Argjipeshkëvi i Zarës në atë kohë ishte Vinçens Zmajeviq i cili pati një meritë të madhe në vendosjen e shqiptarëve në Zarë, por në lidhje me ndikimin dhe aktivitetin që zhvilloi Zmajeviq në procesin e kësaj shpërnguljeje, në pritjen dhe në sistemimin e këtyre shqiptarëve në Kroaci, do të flitet në një artikull tjetër që është tashmë në proces përgatitjeje. Artikulli bazohet qoftë në literaturë historike, qoftë në dokumente arkivore të gjetura në Arkivin Shtetëror të Zadarit dhe citimi i këtyre dokumenteve është bërë sipas rregullores zyrtare që ka ky arkiv.

Fjalë kyçe:

Arbanasi, Borgo Erizzo, Zarë, Zemoniko (Zemonico), Nikolo Erizzo, Shkodër, Krajë, Shestan, Brisku, Perandoria Osmane, Albania Veneta, Vinçens Zmajeviq.

Rrethanat politiko-shoqërore, por edhe ekonomike

Gjendja e shqiptarëve në fund të shek. XVII dhe në fillim të shek. XVIII ishte shumë e vështirë. Brenda Perandorisë Osmane ata jetonin në dy pashallëqe të mëdha. Kjo periudhë është shumë komplekse, e ngatërruar dhe e mbushur me ngjarje të shumta qoftë në rrafshin gjeopolitik, qoftë në atë historik të popujve të Gadishullit Ballkanik. Burimet dokumentare zbërthejnë sfondin e një drame të dhimbshme, e cila vazhdonte të luhej edhe në territoret shqiptare, që ishte pikëtakimi i interesave të fuqive të kohës, Perandorisë Osmane në njërën anë, dhe në anën tjetër të fuqive perëndimore, si: Austro-Hungaria, Selia e Shenjtë, Venediku të mbështetura edhe nga Rusia. Janë të njohura ngjarjet e viteve '80 dhe '90 të shek. XVII gjatë të cilave Perandoria Osmane, duke filluar nga viti 1683 e deri në vitin 1699 mori goditje sidomos nga forcat austriake edhe nga forcat venedikase,¹ më tej disfatat dhe sëmundjet vdekjeprurëse të kohës, të cilat ndikuan në mënyrë të ndjeshme në strukturën etnike të disa viseve shqiptare,² nga ku ndodhën shpërngulje masive për në territore më të sigurta.

Nga dokumentet e kohës si dhe nga dokumentet e mëvonshme, theksohet se respekti për fenë dhe shtypja ekonomike janë shkaqet kryesore, të cilat shkaktuan mërgatën e shqiptarëve. Tani, për sa u përket famullive të dioqezës së Shkodrës gjendja ishte akoma edhe më e rëndë. Për shembull, nëse do t'i referohemi relacionit të Zmajeviqit famullia e Briskut dhe e Shestanit po kalonin në fillim të shek. XVIII një gjendje të rëndë ekonomike. Sipas Zmajeviqit, 11 fshatrat e kësaj famullie ishin të zhytura në varfëri abosulte, por njëkohësisht trazoheshin edhe nga turqit.³ Zmajeviq vëren në këto krahina fenomenin e apostazisë dhe të laramanizmit. Për shkak të gjendjes shumë të keqe ekonomike dhe si

¹ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë 1990), 4.

² Në lidhje me sëmundjen e murtajës, sidomos në Ballkanin Perëndimor por edhe më tej, shih: Slaven Bertoš, "La peste in Istria nel medioevo e nel Eta Moderna (Il contesto Europeo delle epidemie)", në *Atti*, Vol. XXXVII (2007): 121-159.

³ Peter Bartl / Injac Zamputti, *Vincenzo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë / Relazione dello stato d'Albania e Serbia (1702-1703)*, Albert Ramaj (ed.) (Prishtinë/St. Gallen: Faik Konica/ Albanisches Institut, 2022), 41. (Më tej cituar: Zmajevich, *Relacion*, f.).

rrjedhje e pagesave të taksës së haraçit tri fshatra të kësaj famullie, Teliqi, Livari dhe Brisku rrezikoheshin të ktheheshin në fenë islame. Përveç gjendjes së mjeruar të banorëve, Zmajeviq konstaton edhe një gjendje të rënduar të kishave, të cilat kishin nevojë për riparime dhe për plotësim pajisjesh.

Gjatë kësaj periudhe pati persekutime edhe punë angarie të ushtruara ndaj popullsisë *raja*, të cilat arritën kulmin në fund të shek. XVIII.⁴ Edhe pse dioqeza e Shkodrës kishte një pasuri natyrore të madhe me një liqen, ndër më të mëdhenjtë në Europë që kishte për çdo muaj peshkun e vet,⁵ me lumenj e ujëra të bollshme dhe me fusha të shumta, gjendja ekonomike sidomos e popullsisë katolike ishte shumë e mjerë. Për sa i përket qytetit të Shkodrës, Zmajeviq jep të dhëna rreth madhësisë së këtij qyteti, dikur në lashtësi shumë më i madh porse tanimë i tkurrur, i përbërë vetëm nga Kështjella mbi një mal të paarrtshëm dhe nga një varosh poshtë saj i përbërë nga 500 shtëpi.⁶ Zmajeviq shkruante se besimtarët e krishterë vuanin shumë pasi Shkodra tashmë ishte selia e pashait më të lartë turk, i cili ishte kryetar i gjithë Shqipërisë.⁷ Në relacion theksohet edhe gjendja e rënduar ekonomike e kishave, ngaqë ato ishin zhveshur krejtësisht nga pasuritë e patundshme që kishin pasur para pushtimit osman dhe një fenomen tjetër që relatori vë re është edhe grabitja e vazhdueshme e të ardhurave që u bëhet këtyre kishave dhe klerikëve nga jo-të krishterët.

Dioqeza e Shkodrës në atë kohë nuk kishte as katedrale, as banesë për ipeshkvin dhe madje as titullar, sepse titullari i fundit imzot Negri qe varur nga turqit më 2 shkurt 1698.⁸ Edhe nëpër famullitë e Shkodrës, për sa i përket shërbimit kishtar, Zmajeviq vëren të meta të shumta, si rrjedhim i mosfunksionimit si duhet, dhe ashtu si në famullitë e Krajës dhe të Shestanit, relatori vëren raste të apostazisë, të kriptokrishterimit

⁴ Tulio Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara*. Cenni Storici. Raccolti dai documenti dell' I. R. Archivio Luogotenenziale (Dubrovnik: Tiskarnica Joza Flori, 1883), 11.

⁵ Zmajevich, *Relacion*, 43.

⁶ *Po aty*.

⁷ Një ndër pashallarët e Shkodrës që ka pasur shumë influencë dhe është quajtur edhe "Pasha i Shqipërisë" ka qenë edhe Sulejman Pasha, i cili ishte pinjoll i familjes së Bushatllinjve. Ky pasha pësoi një humbje të rëndë nga kryengritësit malësorë të krahinave të Kuçit dhe të Palabardhit (Bjellopavliqit). *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, vëll. IV (1675-1699), nr. 47.

⁸ Zmajevich, *Relacion*, 43.

apo të konkubinatit. Kjo ishte pak a shumë gjendja qoftë brenda dioqezës së Shkodrës në përgjithësi, qoftë nëpër disa fshatra të Krajës, pra në famullitë e Shestanit dhe të Briskut, nga ku u larguan më vonë një numër i konsiderueshëm shqiptarësh në drejtim të Kroacisë, në teritore që në atë kohë ishin ende nën zotërimin e Republikës së Venedikut.

Një shkak tjetër është edhe lufta turko-persiane e viteve 1722-1736 (e njohur ndryshe edhe me emrin *lufta osmano-safavide* e viteve 1722-1736), për të cilën Turqia kërkonte shumë ushtarë për nevojat e veta.⁹ Kjo luftë përpiu shumë njerëz, të cilët merreshin me dhunë për shërbimin ushtarak, jo vetëm nëpër trojet shqiptare por edhe nëpër treva të tjera të Ballkanit. Kështu, në vitin 1725, pashai i Shkodrës, Arslani mori urdhrin nga Porta e Lartë që të mblidhte ushtrinë e të nisej për në Persi. Po që se ndonjë pasha nuk i bindej këtij urdhri, atij do t'i pritej koka.¹⁰ Ishin pikërisht këto probleme dhe kjo frikë që i bëri shqiptarët katolikë të Krajës por edhe të Kosovës të largoheshin nga vendlindja e tyre dhe të vendoseshin në vende të huaja. Dokumentet e Kotorrit të vitit 1726 shënojnë për këtë kohë shpërnguljen më të madhe të shqiptarëve katolikë të Kosovës për në Mbretërinë e Hungarisë. Numri i tyre shkonte deri në 1 800 familje.¹¹

Përveç kësaj, po në atë kohë kishte shpërthyer murtaja në shumë vende të Ballkanit. Këto shkaqe nxitën shqiptarët e Veriut t'i lëshonin trojet e tyre të pushtuara nga turqit. Kjo situatë e vështirë bëri që shumë familje shqiptare të shpërnguleshin drejt Zarës (Zadari i sotëm në Kroaci) në vitet 1726-1733. Gjatë kësaj kohe, argjipeshkvi i Zarës ishte imzot Vinçens Zmajeviq i sipërpërmendur, i cili u kishte shërbyer shqiptarëve si argjipeshkëv i Tivarit gjatë periudhës 1701-1713, dhe që i njihte shumë mirë problematikat e tyre.

Disa të dhëna rreth shpërnguljes së shqiptarëve në Istria

Para së gjithash, duhet të thuhet se Republika e Venedikut i kushtonte shumë rëndësi çështjes që të dukej si forcë çliruese për popullsitë e krishtera që gjendeshin nën sundimin turk dhe kjo del në pah edhe nga fakti se ajo pranonte në teritorët e saj herë pas here elementë që

⁹ Evaristo Coli, *Kallmeti. Fakte dhe gojëdhëna* (Tiranë: Botime Albania, 2014), 141.

¹⁰ Nikë Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare (Nga shek. XI deri më sot)* (Tiranë: Qendra Botuese Shqata e Jezuitëve, 2016), 147.

¹¹ *Po aty*.

emigronin ose arratiseshin nga territore të cilat ishin nën sundimin osman. Së dyti, për shek. XVIII duhet të përmendet këtu edhe marrëdhënia miqësore ndërmjet Republikës së Venedikut me nënshtetasit e Perandorisë Osmane që ishin nga Bosnja e Hercegovina, e sidomos nga Shqipëria. Shqiptarët për Republikën e Venedikut ishin me rëndësi të veçantë, ngaqë ishin të besimit katolik.¹²

Ardhja e shqiptarëve në bregdetin verilindor të Adriatikut fillon edhe më përpara shek. XVIII. Këtu mund të përmendim rastin e kapitenit shqiptar Nikolò Çeklina (Nicolò Cechlina), i cili planifikoi që të drejtonte për në Istria rreth 50 familje shqiptare dhe të tjera (termi për këtë komunitet duhet të ketë qenë *albanezë*^{*}), për të cilët kishte gjetur edhe një lokalitet rreth 12 km në afërsi të Fontane-s.¹³ Për këtë komunitet, i cili, me sa dukej, përbëhej kryesisht nga shqiptarë, kapiten Cechlina kërkoi nga Antonio Zen qeveritari venedikas i “Dalmacisë dhe i Albanisë” gjatë periudhës 1655-1656, të drejta dhe liri të ngjashme që gëzonin edhe banorët e Zhupës¹⁴ ndërmjet Kotorrit dhe Budvës, të cilët vetëqeveriseshin dhe vetorganizoheshin nga e drejta e tyre zakonore.¹⁵ Ai kërkoi për komunitetin liri për besimin dhe mënyrën e jetesës në ritin e tyre greko-ortodoks dhe të kishin mundësi që të merrnin një ose më shumë priftërinj të ritit të tyre,¹⁶ ndihmë materiale për ndërtimin e një kisha, a vendi të shenjtë dhe për ndërtimin e shtëpive; si dhe ndihmë në vegla

¹² Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 11.

^{*} Termi administrativ “Albania Veneta” para pushtimit turk përfshinte territoret nga Perasti e Kotorri e shkonte deri në Durrës.

¹³ *Hrvatski Državni Arhiv u Zadru*, Fondi nr. 1 (më tej: HR-DAZD-1). Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122; shih edhe: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 12; Ludwig Thallóczy, “Die albanische Diaspora”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [und andere], Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte (München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916), 323.

¹⁴ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122: “*Che possino goder l'istesso Privilegio, che godono li paesani della provintia di Zuppa*”.

¹⁵ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122: “*Che sia dati il solito agiunto, che sol essere dato á quali novi habitanti che vengono dalli lontan paesi alla devot.^{ne} di Sua Ser.^{ta}*”.

¹⁶ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122: “*Che possino liberamente vivere nel loro rito, essendo della lege greca. .. Che possino condur uno o più Sacerdoti del suo rito alli quali sia dal Pub. provisto di un loco sacro*”.

bujqësore me qëllim që të fillonin të kishin fryte e të ardhura nga puna e tyre.¹⁷ Disa kërkesa të tjera me rëndësi për këtë komunitet ishin që të mos komandoeshin nga të huajt, përveçse nga i sipërpërmenduri Nikolo, të mos çoheshin nëpër galera lufte dhe të rrinin të gjithë të bashkuar.¹⁸

Në lidhje me këtë komunitet, Talloci është i mendimit se mund të kenë qenë dalmatinë serbë, ngaqë ishin të fesë ortodokse dhe kanë jetuar edhe më vonë në një fshat të quajtur Peroi (shq. *përroi*, *përrua*), në afërsi të Polas së Istrias.¹⁹ Po në gadishullin e Polas, në qytetin e Parenzos (sot Poreč) që vendosur edhe një komunitet shqiptar, i cili e ruajti gjuhën shqipe deri në fillim të shek. XIX. Për këtë komunitet na flet edhe një dokument i datës 27 tetor 1674, i cili përmend toka të vëna në dispozicion të këtij komuniteti por nuk jep as emra, as detaje të tjera.²⁰

Shpërngulja e shqiptarëve në Zarë

Në gjysmën e parë të shek. XVIII disa qindra familje nga zona mbi Liqenin e Shkodrës emigruan në tri valë të njëpasnjëshme në pjesën lindore të gadishullit të Zarës. Ky emigracion filloi në gjysmën e parë të shek. XVIII dhe u përmbyll në gjysmën e dytë të po të njëjtit shekull.²¹

¹⁷ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122: “*Che li sia dato agiuto così di legname come di feram, to di poter fabricar le loro habitationi....Che incominciarano haver il frutto delle loro intrade*”.

¹⁸ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II, Karta 122: “*Che non possino esser agravati di armar Galere. Che non possino esser comandanti, se non da quelli Rapresentanti, et sopra intendenti Publichi, et dall’ istesso Cap.º Nicolò sud.o, et da persone private, et inparticular, che possino star uniti in do loco da loro riconosciuto et non sbandati*”.

¹⁹ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 323. Këta të ashtuquajtur shqiptarë (Albaner), të cilët sipas Tallocit janë bokezë malezeze të kishës ortodokse, u vendosën në ato krahina gjatë periudhës 1645-1647 dhe i përkisnin kolonisë morlake-malazeze, shih: po aty, 324; shih edhe te Bernardo Schiavuzzi, “Cenni Storici sulla Etnografia dell’Istria”, në *Atti e memorie della Società istriana di archeologia e storia patria*, Vol. XX (1-2) 21 (1904), 79, 87-88.

²⁰ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 37: Pietro Civran (1673-1775). Vol. II, Karta 813: “*Circa le famiglie approdate dall Albania per trasferisrri alla Cultura dei tTerreni de Particolari in Parenzo, sarà proprio l’informazione del modo che han tenuto inlevarsi dilà dà chi persuase alla partenza, e le cause per arrivarcelo, ben convenendo in silimile materia, caminare con li riguardi e risserve dovute. Per non prestare à Turchi pretesti d’indolenze di servirsi i loro sudditi . Venezia 27. Ott. 1674*”.

²¹ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 323.

Në vitin 1700, Porta e Lartë kishte angazhuar pashanë e Pejës Hodaverdi Muhamedbegolli që bashkë me ushtrinë të depërtonte nëpërmjet Ulqinit dhe Tivarit me qëllim që të nënshtrohte Malësinë e Madhe dhe me këtë rast ata sulmuan edhe malësorët e Kelmendit, të cilët bënë një rezistencë të madhe.²² Megjithatë, sundimi osman ia doli që të dëbonte nga zona rreth 274 familje të cilat u vendosën në Peshter e në Rugovë.²³ Rreth gjendjes së tyre në Peshter, shkruan disa vjet më vonë edhe argjipeshkvi asokohe i Tivarit, Vinçens Zmajeviq, dhe më 2 shkurt 1705 ai i lutet Kongregacionit për ndihmë financiare për misionet e atyshme.²⁴ Rreth komunitetit të Peshterit Zmajeviq është interesuar edhe më pas, si për shembull në vitin 1707, në kohën kur ky komunitet ishte zmadhuar tashmë dhe kishte arritur në 251 shtëpi me rreth 1 987 persona.²⁵ Një pjesë e komunitetit të kelmendasve në Rugovë e në Peshter, me sa duket, u kthye sërish në Kelmend po atë vit.²⁶

Ndërkohë përpjekjet për kryengritje nuk pushojnë së reshturi edhe më tej në Malësinë e Madhe. Gjatë vitit 1707 proveditori i Dalmacisë, Giustino da Riva lidhi miqësi të madhe qoftë me bokezët, qoftë me malësorët shqiptarë e malazezë dhe kur ky proveditor bënte përsëritjet e tij në Kotorr aty mblidheshin edhe këta malësorë dhe ofroheshin si aleatë në luftë kundër turkut.²⁷ Me atë rast, proveditori Giustino da Riva u fali individëve me influencë dhurata²⁸ dhe parë e disa

²² Errok Zefiq, *Shqiptarët kelmendas në Hrtkovc e Nikinc (1730-1997)* (Zagreb: Zajednica Albanaci u Republici Hrbatskoj, 1998), 10.

²³ *Po aty*, 10.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 230: Gisutino da Riva. Libro di Dispacii. vol. II (1706-1707), Karta 158: *“Mi sono poi stati portati li divoti Sentimenti de Cristiani d' Albania dimoranti intorno la Boiana quali con l'occasione che si era sparsa qualche voce di prossima rottura di guerra, hanno potuto significarmi il loro desiderio e la brama di porsi in libertà sotto la Publica protezione e suggerirne anco il modo. Sebbene è totalmente inopportuno, fuor di tempo e di misura il disegno, ad ogni modo perchè ancor questo è un testimonio del costante buon genio, che nutrisce la Nazione alla Religione ed al Dominio, e perchè serva di lume non ometto di umilmente rassegnarne la notizia in tale proposito rilevata.”*; Thallöczy, “Die albanische Diaspora”, 324.

²⁸ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 230: Gisutino da Riva. Libro di Dispacii. vol. II (1706-1707), Karta 215.: *mi do l'onore di rassegnarne la notizia. Non può non influire vantaggio specialm.te in caso di rottura a Publici interessi la contumacia di*

krerëve të cilëve u ishin shkatërruar a marrë shtëpitë, u dha terren të mjaftueshëm për të jetuar në territoret e Republikës. Ai, gjithashtu, u premtoi se në të ardhmen ata do të gëzonin edhe më tej avantazhe dhe mbrojtje publike, ashtu siç kishin bërë edhe më parë gjatë luftërave kundër turqve.²⁹

Shqiptarët e krahinave të Bunës i kishin shprehur Da Rivës edhe dëshirën për t'u vendosur në territoret e Republikës së Venedikut, ngaqë kishin dëgjuar se ndërmjet Venedikut dhe Perandorisë Osmane do të zhvillohej një luftë.³⁰ Nuk vonon shumë dhe që në vitin 1707 ndërmjet malësorëve të Malësisë së Madhe në veri të Shkodrës, në veçanti mes kelmendasve dhe organeve turke krijohen përplasje, pasi Porta e Lartë nuk mund t'i toleronte më sulmet e malësorëve kundër fshatarëve që merreshin me bujqësi në zonat e ulëta. Turqit u munduan që t'ua kufizonin pavarësinë malësorëve me dhunë. Kështu pashai i Shkodrës filloi t'i trajtonte malësorët, sidomos kelmendasit, në mënyrë të papranueshme duke i dëbuar ata nga kullotat e tyre e duke u munduar që t'i vendoste tjetërkund me banim,³¹ ashtu siç kishte bërë edhe më përpara. Kryengritja që shpërtheu pati edhe përplasje të përgjakshme.³² Pikërisht ky ishte edhe shkaku i drejtpërdrejtë i kryengritjeve të malësorëve, të cilët ditën që dalëngadalë t'i iknin sferës së pushtetit të pashallarëve osmanë, por njëkohësisht kjo po u shkaktonte dëm edhe latifondistëve muhamedanë.³³ Duhet të themi se në jetën e malësorëve të fiseve veriore të Malësisë së Madhe, këto përleshje dhe kryengritje ishin diçka e zakonë, në mos e përditshme dhe bëheshin pikërisht për bukën e gojës.³⁴

queste numerose Popolazioni inclinatissime al nome Veneto per genio e per religione; ed al mio arrivo alle Bocche nou resterò di cautamente e con tutto il riguardo blandire quei Capi, e con qualche regalo tenerli ben disposti ed affetti. Spalato 20 Settembre 1707”.

²⁹ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 18.

³⁰ *Po aty*, 17.

³¹ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 325.

³² HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 230: Gisutino da Riva. Libro di Dispacii. vol. II (1706-1707), Karta 215: *Venendomi in questo punto partecipato con l'annesse lettere l'insorto movimento dei Clementi Popoli Montani dell' Albania, contro le violenze de Turchi e le facioni seguite tra di loro”.*

³³ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 325.

³⁴ *Po aty*.

Tani, kolonitë shqiptare në Dalmaci nuk e kanë origjinën nga Kelmendi apo nga fiset e tjera të zonës së Shkodrës, por cila është lidhja me valët emigruese në Borgo Erizzo. Pushteti turk në Shkodër, ngaqë nuk mundi t'u bënte gjë malësorëve që jetonin në veri të Shkodrës dhe e pa veten si të pafuqishëm ndaj tyre, i shfryu nervat dhe hakmarrjen e vet mbi popullsinë e krishterë nëpër krahinat fushore të atyshme, duke mos i lënë ata as të ushtronin besimin e tyre fetar, e madje as të punonin tokat e tyre.³⁵ Si rrjedhojë, fshatarët bujq të krahinave të Nënshkodrës të cilët jetonin në luginat e Preshjas dhe të Shën Jakut (Shjakut) (jo shumë larg Mirditës), që ishin një fis dhe kishin edhe kushërinë me malësorët veriorë, u mbledhën në vitin 1723 dhe u ankuan. Gjatë kësaj kohe, Vinçens Zmajeviq ishte argjipeshkëv i Zarës. Ai i dëgjoi ankesat e tyre dhe e mbështeti me zell të madh shpërnguljen e tyre në drejtim të Dalmacisë. Ndër këto familje kishte edhe disa që i përkisnin rritit ortodoks.

Të gjitha këto ngjarje ndodhën pas Paqes së Karlovicit (Karlovac, 26 janar 1699) dhe pas Paqes së Pasarovicit (Pozharevac, 21 korrik 1718) ndërmjet Perandorit habsburgas Karl IV dhe Venedikut nga njëra anë, dhe Sulltan Ahmetit III nga ana tjetër. Në kohën kur, me dekretet e Paqes së Karlovicit dhe Paqes së Pasarovicit nuk lejohej pranimi i refugjatëve, Republika e Venedikut megjithatë pranoi çdokënd që kishte dëshirë të vendosej atje, për arsye se lokalitetet e zonës kufitare me Perandorinë Osmane kishin pësuar një rënie të madhe ekonomike, qoftë nga luftërat, qoftë nga fshatrat grabitëse të hordhive turke, duke çuar edhe në zbrazjen e popullsisë.³⁶

Krijimi i kolonisë së Borgo Erizzo-s, vala e parë (1726)

Gjatë periudhës 1723-1726 në Dalmaci qeveriste konti Nicolò Erizzo (II),³⁷ i cili sapo u njoftua nga argjipeshkvi Zmajeviq për ardhjen e

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty, 326.

³⁷ Nicolò Erizzo (II), i njohur me emrin Antonio, ishte venedikas. Ai lindi në Venecia më 19 janar 1687. Meqenëse shtëpia e tij nuk kishte pasuri të mëdha, hoqi dorë nga martesja dhe nga karriera diplomatike për t'iu përkushtuar shërbimit shtetëror në aparatin ushtarak, duke ndjekur shembullin e xhaxhait të tij Nicolò (II), i njohur si Bartolomeo. Në shkurt të vitit 1723, ai u zgjodh administrator i përgjithshëm në Dalmaci dhe Albani (*provveditore generale in Dalmazia ed Albania*). Ai nuk e përfundoi mandatin e tij dhe më 16 mars 1730 mori rolin e mbikëqyrësit të përgjithshëm të Detit (*provveditore generale da Mar*). Vdiq në Venecia më 7 mars

shqiptarëve të krishterë u mundua që t'u vinte në dispozicion atyre troje të përshtatshme ku mund të vendoseshin. Me historitë e shqiptarëve ai duhet të jetë njohur edhe më përpara nga një xhaxha i tij i quajtur gjithashtu Nicolò Erizzo (Bartolomeo). Ky ishte zgjedhur si proveditor i jashtëzakonshëm në Kotorr dhe më 2 shtator 1690 u shqua në betejën për marrjen e Vlorës, në të cilën u mund pashai i Shkodrës.³⁸

Në atë kohë në Zarë kishte nevojë të madhe, qoftë për krahë pune, qoftë për njerëz që dinin të përdornin armët, sepse kjo provincë kishte pësuar dëme të mëdha nga luftërat e fundit që ishin bërë kundër turqve dhe tokat kishin mbetur të shkreta.³⁹ Kjo vendosje e popullsisë, pra duke marrë punëtorë që paguheshin në ato zona ku ishte nevoja, përbënte edhe sekretin e politikës kolonizuese të Republikës së Venedikut.⁴⁰ Administratori Erizzo i pranoi me qejf tetëmbëdhjetë familjet shqiptare (rreth 147 veta) dhe i caktoi detyrë famullitarit nga Zara Giovanni Grisigono-s që një pjesë të truallit të tij ta vinte në dispozicion për këto familje. Priftit Giovanni Grisigono, Republika e Raguzës më 26 gusht 1726 i premtoi zyrtarisht si kompensim një truall tjetër nga territoret publike, por që nuk ia dha kurrë as atij e as pasardhësve të tij më vonë.⁴¹

Ky truall i vënë në dispozicion përbëhej nga 160 arësh (160 *campo* sipas masës padoveze ishte i barabartë me 1016 *quadratklafter*^{*}).⁴² Përveç *Campos (Arës)* ekzistonte edhe një njësi tjetër më e vogël që quhej *tavola* dhe që në Venedik ishte e barabartë me 4,3 m², të cilën do ta përmendim gjithashtu më poshtë. Këtu pra u vendosën familjet shqiptare dhe katundi u quajt Borgo Erizzo, por njëherësh edhe "*Borgo degli*

1768. Për të dhëna më të zgjeruara, të dhëna biografike shih: Renata Targhetta, "ERIZZO, Nicolò", në *Dizionario Biografico degli Italiani*, Volume 43 (1993), tek: https://www.treccani.it/enciclopedia/nicolo-erizzo_res-bd184c89-87ec-11dc-8e9d-0016357eee51_%28Dizionario-Biografico%29/ (shikuar më 24.11.2023).

³⁸ Po aty.

³⁹ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 23.

⁴⁰ Thallöczy, "Die albanische Diaspora", 326.

⁴¹ Ky kompensim nuk iu kthye familjes as në vitin 1778 kur dy nipat e priftit në fjalë, Pietro e Giovanni Grisonigo-Franceso të cilët tashmë ishin të varfër, iu lutën Senatit venedikas ta përfitonin, edhe pse familja Grisonigo i kishte shërbyer Republikës me devotshmëri me qindra vjet. Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 24.

^{*} 1 Quadratklafter vjenez = 3,5979 m², pra mbi tre metër katror e gjysmë.

⁴² Thallöczy, "Die albanische Diaspora", 326. Sipas dokumentit që flet për dorëzimin e këtij territori sipërfaqja shkonte deri në 169 ar padovane. Një ar padovan (*campo padovano*) ishte i barabartë me 1016 klafter katror vjenez. Shih: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 24.

Albanesi”.⁴³ Përpara këtyre ngjarjeve, “Borgo Erizzo” nuk ka ekzistuar si fshat dhe u themelua si i tillë vetëm me ardhjen e shqiptarëve.⁴⁴ Në lidhje me këtë ngjarje kemi edhe dy dokumente të datës 15 gusht 1726 që flasin për ardhjen e shqiptarëve dhe për shkaqet e ikjes së tyre nga Shqipëria turke. Në dokumentin e parë si shkaqe të ikjes së tyre dhe të vendosjes në territoret venedikase përmendet: *së pari*, zelli që këta shqiptarë kishin për religjionin katolik dhe, *së dyti*, shpëtimi nga tirania e ushtruar nga osmanët, duke i bërë ata që të linin pas të gjitha pronat e gjithçka që kishin (*coll abbandono totale di quanto possedevano*).⁴⁵

Qeveria e provincës u ndërtoi menjëherë këtyre refugjatëve shtëpi të reja që përbëheshin nga një ndërtesë kryesore banimi, të cilat ishin të pajisura edhe me stallë e me plevicë, dhe përveç kësaj i çliroi ata për 12 vjet edhe nga taksat,⁴⁶ me përjashtim të taksës së të dhjetës.⁴⁷ Qysh prej datës 17 gusht 1726, këtij komuniteti iu lejua që të zgjidhnin vetë një kapedan të tyrin (*knes*), i cili kishte si detyrë të përfaqësonte interesat e këtij komuniteti tek administratori i Zarës dhe kishte të drejtën edhe të zgjidhte një kryetar komuniteti që funksiononte, me sa duket, si gjyqtar (*giudici*).⁴⁸ Më poshtë po japim emrat e këtyre familjeve, si dhe sipërfaqen e tokës që përfituan:

⁴³ Peter Bartl, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*, Herausgegeben und bearbeitet von Peter Bartl. I, Wiesbaden: Harrovitz, 1975, 18.

⁴⁴ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 23.

⁴⁵ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 93: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 158: “...l’infrascritte famiglie dell’ Albania Ottomana, hanno risolto di sottrarsi dalla tirania de’ barbari e ricoversi nello stato felicissimo di Sua Ser.tà in queste Provincie coll abbandono totale di quanto possedevano rispettivamente in quelle parti. ...Zara 15 Agosto 1726”.

⁴⁶ Bartl, *Quellen und Materialien*, 18.

⁴⁷ Thallóczy, “Die albanische Diaspora”, 326.

⁴⁸ HR-DAZD-1. Nr. 93: Proveditori Generali: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 159: “...Essendo pertanto in ordine all’ indulto concesso stato proposto per Capitanio del nuovo Borgo Luca di Andrea, ò sia Andrich; ci hanno supplicato, che volessimo avvalorarne la sua elezione, coll’ Autorità e col Nostro assenso. Colla potestà dunque del Generalato Nostro, confermiamo in Capitanio del nuovo Borgo il sudetto Luca Andrich ben persuasi, che saprà distinguere la sua puntualità, e la sua ubbidienza nell’occasione del Pubblico Servizio, e la sua attenzione nell’ovviare qualunque sconcerto, che fra i suoi Borghesani potessero insorgere all’ avvenire”.

Emrat e familjeve dhe të kryefamiljarëve ⁴⁹	Arat (campi)	Çerekë (quarti)	Tavole	Numri i personave
1.Luca d'Andrea Gesgenovich	26	-	144	9
2.Nicolò di Luca Marghiecievich	33	-	172	12
3.Nicolò d'Andrea Gesgenovich	35	3	1	11
4.Giovanni d'Andrea Gesgenovich	23	3	6	8
5. Pere de Marco	29	3	13	10
6. Prem Vucca Marghiecievich	23	2	147	8
7. Paolo Gliech Marghiecievich	17	5	7	6
8. Nicolò d'Andrea Marghiecievich	20	3	66	7
9. Nicolò di Luca Marghiecievich	41	3	8	13
10. Giech Prend Marghiecievich	17	3	23	10
11. Giech Pepa Marghiecievich	20	3	-	7
12. Marco Disciato Marghiecievich	17	3	5	6
13. Premz Prema Marghiecievich	14	3	24	5
14. Petar Vucca Marghiecievich	17	3	2	6
15. Nico Matessich	3	-	42	1
16. Luca Prend	20	3	3	6
17. Stanica Gielenovich ⁵⁰	11	3	102	-
18. Visco Gielenovich	28	2	72	-
19. Lech Pero Marghiecievich	11	3	80	
20. Luca Lucich	3	1	-	-
Gjithsej	441	2	203	121

Katër familjet e fundit duhet të kenë mbërritur pak më vonë dhe nuk u vendosën në territorin që i kishte përkitur priftit Grisigono. Ndër këta, dy persona, Nico Matessich dhe Luka Lucich rezultojnë se kanë qenë beqarë në kohën kur mbërritën, sepse nuk jepet numri i pjesëtarëve të familjeve të tyre.⁵¹ Emrat e mësipërm janë të vendosur ashtu siç janë regjistruar në kadastër, pra në këtë formë nuk janë vendosur nga vetë ata, por prej nëpunësit që merrej me atë punë, dhe sipas T. Erber-it shqiptarët e ardhur në atë kohë nuk mbanin mbiemra familjarë, por përdornin vetëm

⁴⁹ HR-DAZD-1. Nr. 93: Proveditori Generali: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 158.

⁵⁰ Në kadastrën e vitit 1756 shfaqen tri familje me mbiemrin Gielenovich dhe numri i personave për të tria këto familje ishte 15 veta. HR-DAZD-1. Nr. 93: Proveditori Generali: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 157-158; shih edhe: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 27.

⁵¹ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 93: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 158.

emrin e tyre të pagëzimit dhe emrin e babait.⁵² Një zakon i tillë përdoret edhe sot e kësaj dite në Malësi të Madhe dhe në krahina të tjera.

Duke pasur parasysh natyrën e tyre burrërore, Nicolo Erizzo u krijoi shqiptarëve edhe disa kushte juridike specifike që ishin të ndryshme nga fshatrat e tjera të krahinës së Zarës. Ndër këto kushte ishte, siç e përmendëm edhe më sipër, edhe mundësia e zgjedhjes së një kapedani brenda komunitetit, por që ai duhej të konfirmohej edhe nga proveditori venedikas.⁵³ Sipas një dokumenti të datës 25 gusht 1726,⁵⁴ detyrat e këtij kapedani ishin:

1. Ai duhej t'u bindej përfaqësuesve të pushtetit venedikas që kishin epërsi mbi të për të gjitha nevojat që kërkonte shërbimi publik;

2. Kapedani duhej të ruante qetësinë publike brenda komunitetit të tij;

3. Ai duhej të përfaqësonte në masën dhe në mënyrën e duhur në komunitetin e shqiptarëve interesat dhe se cilat ishin arsyet e komunës ku bënte pjesë kolonia shqiptare, duke iu shmangur çdo akti armiqësie;

4. Nga pjesëtarët e komunitetit të tij duhej të zgjidhte gjykatësit e tij, të cilët duhej të ishin nën komandën e tij, por kjo zgjedhje duhej të konfirmohej nga proveditori i Përgjithshëm.

5. Në rastet e shkeljeve me karakter civil, qoftë ndërmjet vetë shqiptarëve, qoftë midis shqiptarëve dhe të tjerëve që nuk i përkisnin komunitetit, shqiptarët duhej të pranonin për *gjykatës pretor* kontin venedikas.

6. Në ato raste ku bëhej fjalë për shkelje në lidhje me tokat që u ishin dhënë shqiptarëve nga shteti venedikas, zgjidhja e problemeve i takonte vetëm proveditorit të Përgjithshëm venedikas.

Dokumenti i cituar më sipër, i cili krahason të tjerave përmban edhe rregullat e sipërshtuara, ishte si një formë kushtetute për komunitetin shqiptar. Të drejtën për të zgjedhur kapedanin e tyre, shqiptarët e shfrytëzuan pothuajse menjëherë. Dy ditë më vonë, nga një dokument i datës 17 gusht mësojmë edhe emrin e kapedanit të parë, i cili ishte Luka, i biri i Ndreut (Luca di Andrea, apo Andrich).⁵⁵ Megjithatë, detyra e

⁵² Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 27.

⁵³ *Po aty*, 29.

⁵⁴ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 93: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I, Karta 157-158; shih edhe: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 108-110.

⁵⁵ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 93: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Karta 159: Elezione del Capo del Borgo degli Albanesi. "*Noi Stabilite già da Noi con positiva*

kapedanit nuk qe e përhershme sepse u hoq pas 33 vjetësh, më 1759 dhe kolonët shqiptarë që nga ky vit u vunë nën supremitetin e “kolonelit” kontadës së Zarës (*colonello del contado di Zara*),⁵⁶ por kishin të drejtë që të zgjidhnin përsëri një kapedan (*capitano*) dhe një gjykatës, porse këto zgjedhje duhej që të aprovoreshin nga proveditori i Përgjithshëm.⁵⁷

Krijimi i kolonisë së Zemonikos gjatë dyndjes së dytë në vitin 1727

Përveç kolonisë së lartpërmendur pati edhe një koloni tjetër shqiptarësh e përbërë nga 7 familje (71 persona) që erdhi në Zarë në vitin 1727 dhe u vendos në Zemoniko⁵⁸ në krahinën e Kotarit,⁵⁹ rreth 12 km larg nga Zara, të cilët u trajtuan me të njëjtat kushte sikurse komuniteti i Borgo Erizzo-s,⁶⁰ një vit më vonë, më 1728. Transferimi i tyre në Zemoniko ndodhi pikërisht për faktin se proveditori i Përgjithshëm, Gian Pietro Vendramin (1726-1739), së bashku me alfierin e tij Carlo Molari, donin t’u siguronin këtyre shqiptarëve sipërfaqe tokësore që ishte e papërdorur.⁶¹ Dokumenti i datës 28 maj 1728 jep në mënyrë të detajuar sipërfaqet e tokës që iu caktuan shqiptarëve në atë lokalitet. Në këtë

terminazione le regole con le quali averano da dirigersi le famiglie Albanesi, che hanno abitato il Borgo di questa Città, le abbiamo trà le altre concessa la facoltà di ellegersi uno del loro corpo, il quale come Capo abbia da soprastare agl' altri, non meno per il privato loro interesse, che per eseguire gli ordini, che venissero d'esserle rilasciati per il Pubblico importante servitio à conditione di dover presentare la persona su cui venisse di cadere la nomina per l' approvazione di questa Suprema Carica. Essendo pertanto in ordine all' indulto concessole stato proposto per Capitanio del nuovo Borgo Luca di Andrea, ò sia Andrich; ci hanno supplicato, che volessimo avvalorarne la sua elezione, coll' Autorità e col Nostro assenso. Colla potestà dunque del Generalato Nostro, confermiamo in Capitanio del nuovo Borgo il sudetto Luca Andrich ben persuasi, che saprà distinguere la sua puntualità, e la sua ubbidienza nell'occasione del Pubblico Servitio, e la sua attenzione nell'oviare qualunque sconcerto, che fra i suoi Borghesani potessero insorgere all' avvenire. Per tale dunque da tutti gli altri Albanesi a lui soggetti sarà riconosciuto, e nell'occasioni di Pubblico servizio esattamente ubidito. In quorum. Zara 17. Agosto 1726”.

⁵⁶ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 327.

⁵⁷ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 16-17; shih edhe: Bartl, *Quellen und Materialien*, 18.

⁵⁸ Bartl, *Quellen und Materialien*, 30-31.

⁵⁹ *Po aty*, 18.

⁶⁰ Thallòczy, “Die albanische Diaspora”, 327.

⁶¹ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 98: Pietro Vendramin, Vol. II (1726-1729), Karta 370-371.

dokument ky territor përmendet edhe me emrin *Gajo di Zemonico* dhe përveç territorit që iu caktua shqiptarëve Zemoniko kishte edhe një pyll, shfrytëzimi i të cilit iu lejua edhe kolonisë së Borgo Erizzo-s për nxjerrjen e drurit. Kjo zonë kishte edhe kullota, ku mund të kullosnin bagëtitë të dyja kolonitë.⁶²

⁶² HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 97: Pietro Vendramin, Vol. I (1726-1729), Karta 114-115: Noi. *Ad esempio di molte altre si sono rassegnate alla divozione del Principe le seguenti sette famiglie pervenute dall'Albania. Essendo però onesto di renderle accomodate di terre, dalle quali ritrar possano il loro mantenimento, e benedire la loro lodevole vocazione, è concorsa questa Carica di stabilirle provisionalmente coll' assegno di tre campi per testa, et un sito per costruirvi il loro domicilio nella Villa di Zemonico. Spedito dunque l'Ingegnere Camozzini nella Villa stessa le rese egli accomodate come spicca dal disegno formato sopra beni abbandonati, et inculti. Supplicandoci esse famiglie però di rilasciarle il Decreto dell' Investita a fondamento del loro possesso, siamo concorsi di renderle consolate. In nome pertanto della Ser.ma Signoria di Venetia, e coll' autorità impartita in più Ducali dell' Ecc. Senato alla Carica concedemo provisionalmente, e con titolo di semplice locazione nella Villa sudetta di Zemonico a Giovanni de Giovo d' anime dieci in famiglia, Gieci d'Andrea d' anime sette, Pietro de Marco d'anime cinque, Giovanni di Vucchia d'anime cinque, Giovanni de Nica d'anime diecisette, Giovanni de Prenci d' anime tredici, e Nicolò de Giovi d'anime quattordici, che in tutti sommano settanta un anima il sito con murache, che giace a Borra delli quartieri di Cavalleria, confina da Ostro la casa del Signor Tenente Argnach, a Borra la fontana e la strada, a Maistro altre murache e terre che furono assegnate alle famiglie Albanesi venute prima. Più campi due cento tredici; cioè sopra la strada del Pozzo di Smerdel campi venti, quarti due, tavole 84, confina a Borra terra incolta, a Maistro terre assegnate alli popoli Albanesi venuti prima, a Sirocco vigne, a Garbin terre dei sudditi vecchij di Zemonico mediante strada e fosso. Più campi cinquanta tre, quarti uno a Tramontana delli pradi pubblici continua a Ponente pradi del Tenente Argnach e Frati di San Zuane, a Tramontana strada, a Borra terre de' sudditi vecchij, a Levante incolto pubblico, a Ostro e Garbin pradi pubblici mediante strada. Più campi quattordici sotto la strada che va a Ambar, cioè a Levante delli pradi pubblici confina a Borra strada, agli altri venti incolto pubblico. Più campi ottanta nove, quarti due, a Sirocco e Maistro dell'acqua Pecina, confina a Borra terre assegnate alli popoli Albanesi venuti prima, a Maistro incolto pubblico, a Ostro bosco o Gajo assegnato per pascolo de manzi alli popoli Albanesi et a Sirocco terra incolta, più verso il confine d'Ambar sotto la strada campi trenta cinque e mezzo, cofina a Borra strada, a Maistro li primi Albanesi e sudditi vecchij, agli altri venti terre dei medesimi sudditi vecchij di Zemonico, che in tutti sommano campi due cento tredici come sopra, e questi spatij divisi proportionalmente a cadauna di esse famiglie, giusto il disegno, che si è rilasciato in quest' Archivio di Zara a Publica e privata cognitione. Avveranno il debito di coltivarle è corrisponderle la giusta X de frutti, che producono esse terre, in ricognitione del diretto Alto Dominio di Sua Serenità. In quorum. Zara li 12 Maggio 1728".* Shih edhe: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 113-114.

Zemoniko dikur ishte një kështjellë e rëndësishme dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XVII kishte qenë nën sundimin e osmanëve. Gjatë shek. XVII venedikasit ishin përpjekur disa herë për ta pushtuar këtë kështjellë si për shembull më 24 nëntor 1627, ku venedikasit vranë aty 6 ushtarë turq “sipas dokumentit, me anë të tradhtisë” dhe grabitën edhe kafshë.⁶³ Venediku ia doli ta pushtonte atë 20 vjet më vonë. Pisani, proveditori i kalorësisë ua mori kështjellën turqve në vitin 1647, i plaçkiti ndërtesat dhe shtëpitë që ishin brenda saj dhe rrënoi muret, dhe që nga ajo kohë venedikasit në atë vend mbanin një kazermë kalorësie. Dokumenti osman që është një letër e përkthyer e Halil Beut, beut të fundit të Zemonikos drejtuar doxhës së Venedikut, në lidhje me pushtimin e kësaj kështjelle na jep të dhëna për sa i përket kësaj ngjarjeje si më poshtë:

“Shkruesi (që në këtë rast është Halili, Beu i Zemonikos) tregon që, Administratori venecian në Zara rrethoi Zemonikon dhe e mori në dorëzim pas katër-pesë ditësh, duke premtuar, nëpërmjet dy kapitenëve të Zarës, shpëtim për qytetin dhe leje për beun për të shkuar tek Pashai. Në vend që të ruante fjalën e dhënë, ai e shkeli paktin duke rrëmbyer gra e fëmijë dhe duke i burgosur ushtarët në galerë. Shkruesi kërkoi që të flasë me Dogjin me qëllim që të merrte drejtësi, por kjo nuk iu lejua; ai u çua rob në Breshia. Pas dorëzimit të qytetit pesëdhjetë a gjashtëdhjetë nga njerëzit e tij u zunë rob, kështu që ndoshta dy a tre prej tyre u caktuan në shërbim të tij; rreth njëzet a tridhjetë u hipën në galerë, e cila i çoi ata në Venecia. Shkruesi shpreson për mëshirë dhe drejtësi dhe i lutet Dogjit që të lejohet të dërgojë në shtëpinë e tij një plak, Hoxhë Dervishin, i cili është me të. Ai, gjithashtu, deklaroi se është trajtuar me respekt qoftë nga kastelani qoftë nga kapiteni në Breshia, qoftë nga kapiteni i galerës, qoftë edhe nga ai që e shoqëron atë aty ku ndodhet aktualisht. (ab)”⁶⁴

⁶³ I “*Documenti turchi*” dell’ *Archivio di Stato di Venezia*, Inventario della miscellanea a cura di Maria ia Pedani Fabris con l’edizione dei registi di Alessio Bombaci, Ministero per i Beni Culturali e Ambientali, Ufficio Centrale per i Beni Archivistici, 1994, Busta 12, 367.

⁶⁴ *Po aty*, ASV, Busta 14, 1522. Senza data [circa 1647]. Istanza dell’ex bey di Zemonico Halil, prigioniero a Brescia, al doge. Ottomano; trad. n. 1523. “*Lo scrivente racconta come il provveditore veneto a Zara abbia assediato Zemonico e abbia ottenuto dopo quattro-cinque giorni la resa promettendo, tramite due capitani zaratini, salvezza per la città e, per lui, il permesso di raggiungere Il pascia. Invece di*

Halili, ish-beu i Zemonikos nuk u lirua kurrë më, por qëndroi në burgun e Breshias deri në fund të nëntorit të vitit 1653, kur u mbyt me shtrëngim për fyti nga gardianët e burgut.⁶⁵ Pra, një lokalitet që u ishte marrë turqve iu vu në dispozicion shqiptarëve që i kishin ikur pushtimit turk. Territori i Zemonikos përbëhej nga fusha pjellore dhe shtëpitë që u ndërtuan, qoftë në Zemonik qoftë në Borgo Erizzo, qenë të mëdha, me hapësira të bollshme e me kopshte dhe banorët e të dyja kolonive të shqiptarëve shumë shpejt arritën një shkallë mirëqenie të kënaqshme.⁶⁶ Ata kishin si detyrim t'i paguanin shtetit një të dhjetën e prodhimit të tyre ashtu sikurse komuniteti i Borgo Erizzo-s dhe vareshin gjithashtu nga kapedani i atij komuniteti, gjë e cila mësohet shumë vonë, nga një dokument i datës 30 maj 1792.⁶⁷ Ashtu si anëtarët e Borgo Erizzo-s edhe banorët e Zemonikos kishin të drejtë që të prisnin dru në të njëjtin pyll dhe të kullotnin bagëtitë në të njëjtin vend si komuniteti tjetër.⁶⁸ Emrat e kryefamiljarëve të këtyre familjeve së bashku me numrin e personave po i japim si më poshtë, duke u bazuar në dokumentin e datës 12 maj 1728:⁶⁹

mantenere la parola data, violò i patti predando donne e fanciulli e imprigionando i soldati nelle galee. Lo scrivente chiese di parlare con il doge per ottenere giustizia, ma ciò non gli venne concesso; fu invece portato prigioniero a Brescia. Dopo la resa della città cinquanta-sessanta dei suoi uomini furono catturati, per cui è forse possibile che due-tre di essi siano assegnati al suo servizio; sulla galea che lo portò a Venezia ne furono imbarcati addirittura venti-trenta. Lo scrivente auspica clemenza e giustizia e prega il doge che gli venga concesso di inviare alla sua casa un vecchio, l'hoca Dervis, che si trova con lui. Dichiarò inoltre di essere stato trattato con riguardo sia dal castellano e dal capitano a Brescia, sia dal capitano della galea, sia da quello che lo accompagnò dove attualmente si trova. (ab)".

⁶⁵ ASV, Inquisitori di Stato, bb. 18, 229, 230, 930, po aty, 415.

⁶⁶ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 29.

⁶⁷ HR-DAZD-1. Provveditori Generali. Nr. 212: Angelo Diedo (1790-1792), Vol. IV, Karta 174.

⁶⁸ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 31.

⁶⁹ HR-DAZD-1. Provveditori Generali. Nr. 97: Pietro Vendramin 1726-1729. Vol. I, Karta 151: "Famiglie Albanesi stabilite a Zemonico e terre loro assegnate. "In nome pertanto della Ser.ma Signoria di Venetia, e coll' autorità impartita in più Ducali dell' Ecc. Senato alla Carica concedemo provisionalmente, e con titolo di semplice locazione nella Villa sudetta di Zemonico a Giovanni de Giovo d' anime dieci in famiglia, Gieci d'Andrea d' anime sette, Pietro de Marco d'anime cinque, Giovanni di Vucchia d'anime cinque, Giovanni de Nica d'anime diecisette, Giovanni de Prenci d' anime tredici, e Nicolò de Giovi d'anime quattordici, che in tutti sommano settanta un anima il sito con murache, che giace a Borra delli quartieri di Cavalleria, confina da

1. Giovanni di Giovo me 10 persona;
 2. Gieci di Andrea me 7 persona;
 3. Pietor di Marco me 5 persona;
 4. Giovanni di Vuchia me 5 persona;
 5. Giovanni di Nica me 17 persona;
 6. Giovanni di Prenci me 13 persona;
 7. Nicolo Giovi me 14 persona.
- Gjithsej 71 veta.

Me ndërtimin e shtëpive të tyre u mor një inxhinier me emrin Camozzini, i cili më pas vazhdoi edhe me skicimin e tokave të dhëna shqiptarëve.

Familjet që erdhën në Zarë ishin në përgjithësi nga krahinat e Shkodrës, sidomos nga krahina e Krajës, prej së cilës spikasin kryesisht banorët e fshatrave Shestan, Brisk, Livar etj., të cilat edhe pse ishin krejt afër qytetit të Shkodrës i përkisnin Kryedioqezës së Tivarit. Për sa u përket familjeve të ikura në vitin 1726, për grupin e parë prej 56 vetash jep të dhëna vikari i përgjithshëm i Argjipeshkvisë së Tivarit (më vonë argjipeshkëv i Tivarit) Marko Deluchi, i cili për këta refugjatë thotë se, “nuk kanë asgjë për të mbajtur me vete” dhe se “kanë ikur natën tinëz në mënyrë që turqit të mos i vrisnin dhe se është duke u përgatitur edhe grupi i dytë prej 28 familjesh katolike, mirëpo tash për tash i pengon dimri i egër dhe errësira e natës”.⁷⁰

Vala e tretë, e viteve 1733-1735

Në vitin 1733 pati edhe një valë tjetër të madhe refugjatësh shqiptarë që erdhën në Zarë dhe iu shtuan komunitetit shqiptar të atyshëm.⁷¹ Në këtë valë të tretë që ndodhi gjatë kohës kur proveditor i Përgjithshëm ishte Zorzi Grimani duhet të kenë qenë rreth 156 persona (sipas T. Erber-it 150 persona⁷²). Kjo valë përbëhej prej 28 familjesh me

Ostro la casa del Signor Tenente Argnach, a Borra la fontana e la strada, a Maistro altre murache e terre che furono assegnate alle famiglie Albanesi venute prima”. Shih edhe: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 113-114.

⁷⁰ Të dhënat janë marrë nga letra që vikari i përgjithshëm Marko Deluchi-Llukisha i dërgon argjipeshkvit të Tivarit më datë 23 mars 1726. Ukgjini, *Kisha Katolike*, 146.

⁷¹ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 22-24.

⁷² *Po aty*.

rreth 150 pjesëtarë,⁷³ apo nga 156 persona gjithsej.⁷⁴ Gjatë kësaj kohe kishte shpërthyer në Grykat e Kotorrit (*Boche di Cattaro*) epidemia, që me sa duket ishte murtajë, e cila fillimisht ishte përhapur në zonën e Pastroviqëve (Pastrovicchi), zona jugore e Kotorrit. Shkaku (ose iu la faji) kishte qenë një anije që vinte nga Durrësi, e ngarkuar me pelerina me kapuç (schiavina), tehe parmendash (*coltri*) dhe thasë me lesh, e cila kishte hyrë fshehtas dhe i kishte sjellë këto mallra në shtëpinë e njëfarë Nikolo Kasanegra, njeri i fuqishëm i zonës, me kredi e me autoritet në ato anë ("*Nicolò Casanegra, uomo ben opulento e perciò di partito, di credito e di autorità fra quella popolazione*").⁷⁵

Edhe pse u morën masa, murtaja u përhap deri në territoret e Raguzës.⁷⁶ Përhapjen e murtajës në Kotorr ia bënë të ditur Grimanit në vitin 1733 Emo, proveditori i jashtëzakonshëm venedikas i Kotorrit.⁷⁷ Një shkak tjetër i ikjes së shqiptarëve ka qenë edhe keqtrajtimi i tmerrshëm i Omer Pashës së Tivarit,⁷⁸ i cili gjatë qeverisjes së tij bëri që të largoheshin shumë të krishterë nga territoret e tyre. Shqiptarët, duke përfituar nga situata e rrëmujshe, kishin gjetur mundësinë të iknin në drejtim të Castel Nuovo-s (sot Herceg Novi).

Përveç sa përmendëm më sipër, shkaqe të tjera ishin edhe keqtrajtimet e qeveritarëve osmanë të Shkodrës Ahmet Pasha dhe pasuesit të tij Kurt Pasha, i cili bënte fajtor Venedikun dhe i kërkonte kompensime në parë për shkakun e këtyre ikjeve që kishin çuar në zbrazjen e disa krahinave. Në vitin 1733, Grimanit kishte dërguar në Shkodër një njeri të tijin të besueshëm, një oficer (*sargente-maggiore*) të quajtur Bucchia që duhej të mblidhte të dhëna, të cilat ia dërgoi pastaj Grimanit, në dhjetor të vitit 1733. Ushtaraku Bucchia në Shkodër kishte mundur të bënte për vete njëfarë Sulejman Aga, njeri i fuqishëm e i vlerësuar i cili e kishte pasur armik personal Ahmet Pashën, dhe ia bëri të ditur barbaritë që ai kishte ushtruar ndaj këtyre shqiptarëve që më pas

⁷³ Thallòczy, "Die albanische Diaspora", 327.

⁷⁴ Të dhënat janë marrë nga letra që vikari i përgjithshëm Marko Deluchi-Llukisha i ka dërguar argjipeshkvit të Tivarit më datë 23 mars 1726. Shih: Ukgjini, *Kisha Katolike*, 146.

⁷⁵ Guido Candiani, "Sanità e controllo mercantile alle Bocche di Cattaro: il lazzeretto di Castelnuovo 1700-1797", në *Mediterranea - ricerche storiche*, Anno XVII (Aprile 2020), Nr. 48, 56.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 37.

⁷⁸ Po aty.

ikën.⁷⁹ Talloci na përmend këto familje: Vlagdan, Preuto Stani, Kneunichi, Nichin, Luco, Prendi, Tamartinovich, Muzia, Popovich, Marusich, Pavlov, Vucin, Nica-Dobrez, Gioca-Giuchin, Gioca Gionon, Lecca, Sperz, Marcov Toma, Covaz, Tanovich, Dioba, Giuri, Pertu.⁸⁰ Regjistri i proveditorit venedikas Zorzi Grimani që gjendet në arkivin e Zadarit⁸¹ na jep një listë të plotë të tyre, qoftë të këtyre familjeve, qoftë të tokave që përfituan. Më poshtë po japim emrat e këtyre kryefamiljarëve me familjet e tyre dhe me sipërfaqet e tokave që përfituan:

Familjet	Individët	Arat (campi)	Çerekët (quarti)	Tavola
1. Kapedan Nicolo Vlagdan	9	25	2	115
2. Prento Stani	6	15	3	125
3. Prento Kneunichi	6	17	2	156
4. Pema Nichin	6	17	3	177
5. Stiepe Luco	8	24	-	58
6. Paolo Prendi	5	14	2	107
7. Vuca Tamartinovich	10	28	3	120
8. Mar Muzia	10	28	2	180
9. Nicolò Andre	8	23	1	18
10. Frane Popovich	6	18	2	-
11. Paolo Marussich	10	30	2	-
12. Nicolo Paulov	8	22	-	-
13. Jovan Vucin	13	38	2	-
14. Marco Nicodobrez	6	18	1	140
15. Giocca Giuchin	9	27	2	103
16. Giocca Gionon	6	16	2	26
17. Marco Giocca	4	12	-	116
18. Lecca Marco	8	24	1	-
19. Gen Sperz	3	19	-	160
20. Rado Ruco	5	13	-	-
21. Prendo Marcov	6	15	3	10
22. Andrea Toma	5	15	-	-
23. Crasto Covaz	6	19	-	170
24. Vucsa Taucovich	6	17	3	69
25. Pietro Tioba	7	20	3	107
26. Stiepo Giuri	7	20	3	140

⁷⁹ Po aty, 38.

⁸⁰ Lista është nxjerrë nga: Thallöczy, "Die albanische Diaspora", 328.

⁸¹ HR-DAZD-1. Proveditori Generali. Nr. 106: Zorzi Grimani (1732-1735), Vol. I, Karta 264; shih edhe listën tek: Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 42.

27. Marco Pertu	6	16	-	95
28. Nicola Rose	6	18	-	-
Për trashëgiminë e kishës		12	2	148

Një ndër familjet shqiptare që shkuan në Zarë ishte edhe një familje kallmetore, e cila mbërriti rreth vitit 1733. Kjo familje mbante mbiemrin Muriçi kur shkoi, por që më vonë e ndryshoi në Kalmeta për të ruajtur identitetin se nga kishin ardhur. Sot, numri i pasardhësve të kësaj familjeje është rritur shumë dhe të gjitha mbajnë mbiemrin Kalmeta.⁸² Në vitin 1733 pati edhe një ndryshim në të drejtat e shqiptarëve. Gjatë këtij viti vdes Giovanni Cristofoli që ishte guvernator i dy komuniteteve të shqiptarëve dhe në vend të tij emërohet ushtaraku Marko Draganiq (Draganić), i cili duhej që të asistonte në të gjitha problemet e këtyre komuniteteve. Nën urdhrat e tij ishte edhe kryeplaku i Borgo Erizzo-s.⁸³

Pas kësaj vale pati edhe rreth 49 shqiptarë të tjerë të cilët, duke kaluar nëpër Castel Nuovo erdhën dhe u vendosën në vitin 1735 në të dyja kolonitë shqiptare të Borgo Erizzo-s dhe të Zemonikos. Ata u pritën miqësisht, qoftë nga qeveritari Grimani, qoftë nga argjipeshkvi Zmajeviq.⁸⁴ Duhet të sqarohet këtu se transferimi dhe vendosja e këtyre personave nga një komunitet tek tjetri ishte e ndaluar rreptësisht, edhe pse të dyja komunitetet ishin shqiptare dhe vinin afërsisht nga krahinat e Shkodrës.⁸⁵ Megjithëse lëvizja nga një komunitet në tjetrin nuk lejohej, pati disa familje që u transferuan nga Borgo Erizzo dhe u vendosën në Zemoniko. Mbiemrat⁸⁶ e këtyre familjeve janë:

1. Prendi (3 familje);
2. Periq (Perić) (4 familje);
3. Merushiq (Merušić) (1 familje);
4. Shestani (Šestan) (3 familje);

⁸² Sipas E. Coli-it, "Ato janë të integruara më së miri në jetën e shtetit kroat dhe kanë arritur edhe poste të larta siç është rasti i ish-ministrit të Transporteve të Kroacisë – Božidar Kalmeta, i shpallur "Qytetar Nderi" i komunës Kallmet. Edhe shumë familje të tjera u shpërngulën nga Kallmeti dhe fshatrat e tjera të kësaj komune gjatë shek. XVII. Vlen të përmendim këtu themelimin e një fshati në Tiranë me emrin Kallmet, por që sot janë të besimit mysliman apo shumë familje në Shkodër që mbajnë mbiemrin Rraboshta". Coli, *Kallmeti. Fakte dhe gojëdhëna*, 142.

⁸³ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 36-37.

⁸⁴ Thallòczy, "Die albanische Diaspora", 327.

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo*, 34.

5. Pinçiq (Pinčić) (4 familje);
6. Petani (2 familje);
7. Qurkoviq (Čurković) (4 familje);
8. Gjergia (4 familje);
9. Paleka (10 familje);
10. Shkopelja (Škopelja) (2 familje);
11. Katariq (Katarić) (4 familje);
12. Bergela (Brgela), një familje e cila më vonë u shua.

Pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve donin që t'i aktivizonin ushtarakisht, por ata nuk ishin të interesuar për shërbime ushtarake.⁸⁷ Në vitin 1756 kemi të dhëna të tjera në lidhje me emrat e shqiptarëve të vendosur në Zarë dhe në librin themeltar të regjistrimit të këtij viti përmenden mbiemrat e mëposhtëm (me germa kursive janë të shënuar ata mbiemra që në fillim të shek. XX ekzistonin ende): *Bergela*, Bitri, *Chiurcovich*, *Calmetich*, Covacich, Covacevich, Duca i përmendur edhe si *Cioba*, *Duca*, *Giuca*, *Jovi*, *Gelencovich*, *Kraste*, Marsija, *Marsani*, Nica, Nicagi, *Petani*, *Pincich*, *Pezzi*, *Scopelja*, Sestani, Smirn, Jochich, *Vuca* (*Vukich*), *Vladagni*, *Zancovich*.⁸⁸ Siç u pa edhe më sipër, emrat e këtyre shqiptarëve janë shkruar në versionet italisht apo sllavisht ngaqë, sipas Tallocit, shqiptarët gjatë kësaj periudhe ashtu si edhe familjet çobane romune nuk kishin emra familjarë.⁸⁹

Për sa i përket itinerarit, ai pothuaj ishte i njëjtë për të gjitha grupet që përmendëm më sipër. Përpara se të mbërrinin në Kroacinë e sotme dhe të vendoseshin në Zarë, këta shqiptarë qëndruan për një kohë të shkurtër nëpër disa lokalitete të ndryshme, si Kaštel Lastva e Kaštel Novi, pra në Petrovac dhe në Herceg Novin e sotëm, dhe vazhdonin më tej deri në Zarë me anije. Disa qëndruan në Bashka Voda (Baška Vod) dhe në Čovi (Čiovo), jo shumë larg Splitit.

Pas këtyre tri valëve kryesore pati edhe disa valë të tjera, më të vogla emigracioni, gjë që shihet edhe nga shpërndarja e mbiemrave. Autoritetet u munduan që kolonët të integroheshin në mënyra të ndryshme. Shpërnguljet, siç e përmendëm edhe më sipër, u miratuan dhe u mbështetën nga administrata e Republikës së Venedikut me synimin për

⁸⁷ Thallóczy, "Die albanische Diaspora", 327.

⁸⁸ Lista është nxjerrë nga: po aty, 328-329.

⁸⁹ Po aty, 329.

të ringjallur pjesët e shkretuara të Dalmacisë, veçanërisht pjesën e brendshme të qytetit të Zarës.



Fig. 2: Kisha e Arbanasit me shtëpinë e famullitarit
(Foto. E. Malaj, dhjetor 2023)

Për sa i përket numrit të saktë të këtyre refugjatëve, edhe pse ka lista të ndryshme nuk mund të përcaktohet një shifër e përgjithshme e përpiktë, pasi të dhënat janë të pasakta. Dy komunitetet shqiptare, pra Borgo Erizzo dhe Zemoniko, edhe pse jo shumë larg njëra-tjetrës patën histori të ndryshme. Sipas Tallocit, Zemoniko me kalimin e

kohës do të përzihej me elementin kroat dhe dalëngadalë e humbi identitetin e vet shqiptar dhe gjuhën shqipe, dhe sot aty askush nuk flet më shqip.⁹⁰ Megjithatë, nëse do t'i hidhnim një sy faqes zyrtare të kësaj komune, konstatojmë se aty banojnë 20 shqiptarë, të cilët përbëjnë 1% të popullsisë së komunës.⁹¹ Përveç këtyre komuniteteve ka pasur edhe një komunitet tjetër, më të vogël në Ploče (Ploče), i cili ashtu si ai i Zemonikos u kroatizua krejtësisht në mesin e shek. XIX dhe ka ruajtur vetëm ndonjë gjurmë në patronimi apo në mikrotoponimi.⁹²

Borgo Erizzo e ruajti karakterin e vet shqiptar dhe sot e kësaj dite aty ende flitet shqip. Një ndër arsytet e ruajtjes së identitetit ishte edhe lejimi i martesave që nga kushërinia e tretë, të cilën e lejoi argjipeshkvi Zmajeviq. Ky ligj kishtar i lejonte shqiptarët që të martoheshin ndërmjet tyre, edhe pse kishin lidhje farefisnore. Disa vjet pas ardhjes së tyre filloi të ndërtohej për ta edhe një kishë dhe më vonë afër saj u ndërtua edhe shtëpia e famullitarit. Edhe kisha në gjuhën shqipe duhet të ketë luajtur një rol vendimtar në ruajtjen e gjuhës dhe të identitetit. Komuniteti i

⁹⁰ Po aty, 327.

⁹¹ *Općina Zemunik*: Demografski podaci. URL: <https://www.zemunik.hr/op%C4%87ina-zemunik/demografski-podaci> (shikuar më 24.11.2023).

⁹² August Kovačec, "Arbanasi-Albanisch", në *Lexikon der Sprachen des europäischen Ostens*. Herausgegeben, v. M. Okuka (Klagenfurt: Wieser, 2002), 67.

Borgo Erizzo-s nga 56 shqiptarë të sapoardhur që kishte në vitin 1726 u rrit nga viti në vit dhe për kohë të ndryshme mund të jepen shifra⁹³ të ndryshme:

Viti 1756 – 409 persona;

Viti 1853 – 900 persona;

Viti 1880 – 2000 persona;

Viti 1900 – 2600 persona.

Sipas të dhënave të listës lokale dalmatine, që është bërë nga austro-hungarezët në vitin 1908, Borgo Erizzo përbëhej nga 384 shtëpi. Nga këto, për sa i përket identitetit fetar, 2 573 frymë ishin katolikë romanë, 13 frymë ishin grekë-ortodoksë dhe 2 të besimeve të tjera, kurse për sa i përket identitetit etnik 2 415 janë të regjistruar si kroatë, 117 si italianë, 13 si gjermanë dhe nacionalitete të tjera 23 persona.⁹⁴ Te kroatët janë të përfshirë edhe shqiptarët e Borgo Erizzo-s, sepse nga ana juridike dhe politike ata njihen si kroatë dhe statistika e mësipërme nuk është e ndërtuar mbi bazën e gjuhës amtare. Pra mund të themi, se pjesa më e madhe e atyre që në statistikë jepen si kroatë kishin si gjuhë amtare të tyre shqipen.⁹⁵ Disa vjet më pas në Borgo Erizzo jetonin rreth 3 194 banorë, por siç e pamë edhe nga shifrat e mësipërme jo të gjithë ishin shqiptarë.

Përmbledhje

Në artikullin e mësipërm u trajtuan çështje të historisë së krijimit të kolonisë shqiptare të Borgo Ericos (Borgo Erizzo) në Zarë (Zadar, Kroaci). Pavarësisht se në literaturën e huaj, sidomos në atë në gjuhën kroate, por edhe në gjuhën italiane e gjermane, tashmë ka të dhëna për komunitetin e arbëreshëve të Zarës, në literaturën historike është shkruar pothuajse shumë pak për ta dhe ky artikull synon ta mbulojë këtë boshllëk. Në pjesën e parë paraqitëm të dhëna mbi rrethanat politiko-shoqërore që ekzistonin në Shqipëri gjatë fundit të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII, periudhë kohore që përkon me kohën e ikjes së shqiptarëve nga disa krahina të caktuara që ishin fshatra me popullsi katolike në Krajë (kryesisht në Shestan) dhe vendosjen e tyre

⁹³ Shifrat e mësipërme janë marrë nga: Thallóczy, “Die albanische Diaspora”, 328.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Po aty.

përfundimisht në Zarë të Kroacisë, duke kaluar fillimisht nëpër Kotorr dhe stacione të tjera të *Albania Veneta* (sot në Mal të Zi).

Krahinave nga e kishin origjinën arbëreshët e Zarës, pra famullitë e Shestanit dhe të Briskut dhe famullitë e dioqezës së Shkodrës, u kushtuam në pjesën e parë një vëmendje të veçantë duke dhënë shkaqet që i bënë shqiptarët e atyre zonave të braktisnin trojet e tyre të origjinës.

Në pjesën e dytë të artikullit u morëm me valët e ikjeve të atyre grupeve të shqiptarëve, të cilët më vonë krijuan kolonitë e arbëreshëve të Zarës dhe dhamë disa të dhëna edhe mbi fatet e tyre të mëtejshme dhe familjet e tyre. Në lidhje me ndikimin dhe aktivitetin e madh që pati argjipeshkvi i Zarës në atë kohë Vinçens Zmajeviq në procesin e kësaj shpërnguljeje, në pritjen dhe në sistemimin e këtyre shqiptarëve në Zarë, do të flitet në një artikull tjetër që është tashmë në proces përgatitjeje, sepse kontributi i këtij argjipeshkvi në krijimin e kolonisë së arbëreshëve është i rëndësishëm së veçantë dhe kërkon një vëmendje të veçantë.





Fig. 3: Kisha e Arbanasit. Në pikturën murale paraqitet ardhja e shqiptarëve dhe pritja që Zmajeviq u bëri atyre në Zarë (Foto: E. Malaj, dhjetor 2023)

Bibliografi:

Arkiva:

Hrvatski Državni Arhiv u Zadru (HR-DAZD)

HR-DAZD, Fondi 1 (HR-DAZD-1)

Proveditori Generali. Nr. 20: Giovanni Antonio Zen (1655-1656). Vol. II

Proveditori Generali. Nr. 93: Nicolo Erizzo II (1723-1726), Vol. I

Proveditori Generali. Nr. 97: Pietro Vendramin, Vol. I (1726-1729)

Proveditori Generali. Nr. 98: Pietro Vendramin, Vol. II (1726-1729)

Proveditori Generali. Nr 106: Zorzi Grimani (1732-1735), Vol. I

Proveditori Generali. Nr. 212: Angelo Diedo (1790-1792), Vol. IV

Botime dokumentare:

Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, vëll. IV (1675-1699). Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: 1990.

I "Documenti turchi" dell' Archivio di Stato di Venezia. Inventario della miscellanea a cura di Maria ia Pedani Fabris con l'edizione dei registi di Alessio Bombaci. Ministero per i Beni Culturali e Ambientali, Ufficio Centrale per i Beni Archivistici, 1994.

Literaturë historiografike:

Bartl, Peter / Injac Zamputti. *Vincenzo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë / Relazione dello stato d'Albania e Serbia (1702-1703)*, Albert Ramaj (ed.). Prishtinë/St. Gallen: Faik Konica/ Albanisches Institut, 2022.

Bartl, Peter. *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*. Herausgegeben und bearbeitet von Peter Bartl. I. Wiesbaden: Harrovitz, 1975.

Bertoš, Slaven. "La peste in Istria nel medioevo e nel Eta Moderna (Il contesto Europeo delle epidemie)". *Atti*, Vol. XXXVII (2007).

Candiani, Guido. "Sanità e controllo mercantile alle Bocche di Cattaro: il lazzeretto di Castelnuovo 1700-1797". Në *Mediterranea - ricerche storiche*. Anno XVII (Aprile 2020), Nr. 48.

Coli, Evaristo. *Kallmeti. Fakte dhe gojëdhëna*. Tiranë: Botime Albania, 2014.

Erber, Tulio. *La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara*. Cenni Storici. Raccolti dai documenti dell' I. R. Archivio Luogotenenziale. Dubrovnik: Tiskarница Joza Flori, 1883.

Kovačec, August. "Arbanasi-Albanisch". Në *Lexikon der Sprachen des europäischen Ostens*. Herausgegeben, v. M. Okuka, Klagenfurt: Wieser, 2002.

Schiavuzzi, Bernardo. "Cenni Storici sulla Etnografia dell'Istria", në *Atti e memorie della Società istriana di archeologia e storia patria*. Vol. XX (1-2) 21 (1904).

- Thallóczy, Ludwig. “Die albanische Diaspora”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [und andere], Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916.
- Ukgjini, Nikë. *Kisha Katolike në trevat shqiptare (Nga shek. XI deri më sot)*. Tiranë: Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, 2016.
- Zefiq, Frrok. *Shqiptarët kelmendas në Hrtkovc e Nikinc (1730-1997)*. Zagreb: Zajednica Albanaci u Republici Hrbatskoj, 1998.

Botime elektronike, Website:

- Targhetta, Renata. “ERIZZO, Nicolò”. Në *Dizionario Biografico degli Italiani*, Volume 43 (1993), tek:
https://www.treccani.it/enciclopedia/nicolo-erizzo_res-bd184c89-87ec-11dc-8e9d-0016357eee51_%28Dizionario-Biografico%29/
(shikuar më 24.11.2023).
- Općina Zemunik*: Demografski podaci. URL:
<https://www.zemunik.hr/op%C4%87ina-zemunik/demografski-podaci> (shikuar më 24.11.2023).

EDMOND MALAJ

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edmond.malaj@asa.edu.al

S u m m a r y

THE POLITICAL-SOCIAL CIRCUMSTANCES OF THE MIGRATION OF ALBANIANS
TO ZADAR AND THE CREATION OF THE BORGO ERIZZO COLONY

In this Article we have dialed with the history of the creation of the Albanian colony of Borgo Erizzo in Zadar, Croatia). Despite the fact that in foreign literature, especially in the Croatian language, but also in the Italian and German languages, there are already data about the Arbanasi-Community of Zara, almost very little has been written about it in the Albanian historical literature, and this article aims to cover this void. In the first part, we provided data on the social political circumstances that existed in Albania during the late 17th and early 18th centuries, a period that coincides with the time when Albanians fled from certain provinces that were villages with a Catholic population (mainly in Shestan) and their eventual settlement in Zadar, Croatia. This Albanians first passed through Kotor and other stations of Albania Veneta (in today Montenegro). In the first part, we paid special attention to the

provinces from which the Albanians (Arbanasi) of Zadar originated. That is, the parishes of Shestan and Brisk and the parishes of the Diocese of Shkodra. We gave the reasons that made the Albanians of those areas leave their lands of origin.

The second part of the article dealt with the waves of escape of those groups, who later created the Arbëreshëvi colonies of Zara, and gave some data on their further fates and their families. Regarding the great influence and activity that the Archbishop of Zara had at that time, Vinçens Zmajevic, in the process of this migration, in the reception and in the settlement of these Albanians in Zara, it will be discussed in another article that is already in the process of preparation, because the contribution of this archbishop in the creation of the Arbëresh colony is of special importance and requires special attention.

ALVIN SARAÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

saracialvin@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/krb81r74>

**TREGTARËT E VOSKOPOJËS NË PORTIN E DURRËSIT
DHE MARRËDHËNIET TREGTARE ME VENECIEN
NË DY DEKADAT E PARA TË SHEK. XVIII****Abstrakt:**

Marrëdhëniet tregtare të Voskopojës me Venecien nëpërmjet portit të Durrësit gjatë tri dekadave të fundit të shek. XVII dhe përgjatë shek. XVIII përkrijnë me periudhën e urbanizimit të qytetit. Tregtarët voskopojarë patën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregtisë nëpërmjet lidhjeve të ngushta me konsujt venecianë të Durrësit, Giorgio Cumano dhe nipin e tij Giorgio Emmanuele Cumano, të cilët kishin qenë më parë korrespondentët e tyre në Venecia. Konsullatat e tjera të huaja u përpoqën të zgjeronin tregtinë e tyre nëpërmjet disa tregtarëve nga Janina dhe Siatista, që kishin krijuar kompani të përbashkëta me tregtarët e Voskopojës. Megjithatë, Venecia pati vëllimin më të madh të tregtisë në Durrës dhe jo vetëm i përfshiu ata në këto shkëmbime, por i angazhoi edhe në marrëdhëniet me autoritetet lokale dhe në letërkëmbimin me bailiun. Edhe gjatë luftës turko-veneciane të Moresë, venecianët e vazhduan tregtinë duke u mbështetur te dy tregtarë, njëri prej të cilëve voskopojar, të cilët hapën seli të tjera konsullore. Në këtë periudhë, Voskopoja pati një zhvillim ekonomik, social dhe kulturor. Pas Traktatit të Pasarovicit (1718) nisi rënia e tregtisë së Durrësit me Venecien dhe u krijuan premiset që tregtarët e Voskopojës të largoheshin drejt Europës Qendrore.

Fjalë kyçe:

Tregti, Voskopojë, Venecia, porti i Durrësit, dekadat e para të shek. XVIII.

Voskopoja ishte një qendër tregtare në brendësi të Shqipërisë. Rritja e saj ekonomike nis në vitin 1650 në pragun e hapjes së konsullatës

veneciane të Durrësit më 1671.¹ Letërkëmbimi i konsullatës veneciane të Durrësit, që është botuar pjesërisht si përmbledhje me dokumente, hedh dritë pikërisht mbi marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë e Venecies dhe rolin parësor që patën tregtarët e Voskopojës.² Duke pasur parasysh se misioni i konsullatave të huaja shërbente për zgjerimin e tregtisë dhe mbrojtjen e interesave të shtetasve të huaj në Shqipëri, kjo ndikoi në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me Venecien në tri dekadat e fundit të shek. XVII dhe përgjatë shek. XVIII. Megjithatë, artikulli do të trajtojë vetëm harkun kohor që përfshin dy dekadat e para të Shtatëqindës, që i paraprijnë periudhës kur Voskopoja arriti kulmin e lulëzimit të saj në vitet 1720-1770.³

Voskopoja kishte një përbërje heterogjene ku mbizotëronte kryesisht elementi shqiptar dhe arumun, si dhe kultura greko-ortodokse. Familjet kryesore voskopojare ishin me origjinë shqiptare, por ekzistonte edhe komponenti arumun.⁴ Vllehtë u zhvendosën nga Meçova ose malet e Pindit dhe Tesalia e krijuan dy lagje në qytet.⁵ Zona e Pindit mund të lokalizohet ndërmjet Kosturit e Prespës dhe përfshin edhe Janinën, ku kalon mali i Gramozit që ndan Shqipërinë me Greqinë Juglindore.⁶ Periudha në të cilën ndodhi ky emigrim barinjsh vlleh i përket shek. XIV,

¹ Max Demeter Peyfuss, *Shtypshkronja e Voskopojës, 1731-1769: shtypja e librave dhe adhurimi i shenjtore në Patrikanën e Ohrit*, përktheu Gjergj Misha (Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2002), 28r.

² *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: ASV), Cinque Savi alla Mercanzia (më tej: CSM), busta (më tej b.) 661 1700-1711 dhe b. 662 (1711-1738); Zija Shkodra, “Hyrje”, në *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letra të konsujve venedikas të Durrësit* (1696-1707), përktheu dhe përgatiti për botim Zija Shkodra (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1975), 8; Valeriu Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie et le commerce venitien aux XVIIe et XVIIIe siècles”, në *Mélanges de l’École roumaine en France* (Paris: Gamber éditeur, 1931), 30. Zija Shkodra ka përkthyer dhe botuar dokumentet e viteve 1696-1707, ndërsa historiani arumun Valeriu Papahagi ka botuar pjesërisht dokumentet që flasin për tregtinë e Voskopojës me Venecien në vitet 1696-1761.

³ Aurel Plasari, *Fenomeni Voskopojë* (Tiranë: Phoenix, 2000), 11-12.

⁴ Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669-1779)* (Tiranë: Toena, 2010), 65, 70-71, 84-87.

⁵ *Po aty*, 66.

⁶ Nicolae Iorga, *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*, përktheu Viron Koka (Tiranë: Saraçi, 2004), 7-8.

kur Voskopoja ishte pikërisht pjesë e zotërimit të Petro Muzakës.⁷ E gjithë zona e Ohrit, Kosturit, Manastirit (Bitolës), Korçës, Voskopojës, Zagorisë, Janinës e deri në Siatistën e Kozanit në Tesali ishte e karakterizuar edhe nga elementi arumun.⁸ Ajo që i bashkonte banorët vllah të këtyre zonave ishte tradita e blegtorisë.

Megjithëse Voskopoja përmendet që në shek. XIV, ajo u zhvillua si qendër e Shqipërisë Juglindore në shek. XVI. Siç dëshmohet në regjistrat osmanë, Voskopoja ishte pjesë e kazave të Bilishtit në shek. XVI dhe të Korçës në gjysmën e dytë të tij. Ajo që të bie në sy në regjistrin e vitit 1568-1569 krahasuar me regjistrin e mesit të shek. XVI (që duhet të jetë i vitit 1551-1555), ishte se pavarësisht një rënijeje të lehtë demografike nga 342 në 330 shtëpi, ka një dyfishim të taksave, çka dëshmon gjithashtu për rritjen e të ardhurave.⁹

Nga fundi i shek. XVII dhe përgjatë shek. XVIII, Voskopoja u transformua nga një zonë rurale në një qendër urbane.¹⁰ Zona përreth Oparit ndikoi gjithashtu në rritjen e popullsisë së qytetit dhe kontribuoi për ngritjen e ndërtesave.¹¹ Voskopoja kishte lidhje të drejtpërdrejta me Korçën e me qendra të tjera, si: Drenova, Shpaska, Nikolica, Boboshtica, Vithkuqi, Maliqi, Grabova e Llenga.

Zhvillimi i saj mori hov me krijimin e shtresës tregtare dhe 14 esnafeve, ndër të cilat ai i leshit ishte më i rëndësishmi.¹² Ndër të përmenden edhe esnafi i rrobaqepësve (1714-1749) dhe i bakejve (1750-1791).¹³ Një rol të rëndësishëm pati gjithashtu esnafi i lëkurëpunuesve, i

⁷ Pëllumb Xhufi, "Ngritja dhe rënia e një qyteti", në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, konferencë ndërkombëtare (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2018), 68.

⁸ Nicolae Iorga, *Histoire des roumains de la Peninsule balcanique (Albanie, Macédoine, Épire, Thessalie, etc.)*, (Bucarest: Société des Macédo-Roumains de Bucarest "Cultura Neamului Românesc, 1919), III. Është bashkëngjitur edhe harta e zonave me popullsi arumune.

⁹ Ferit Duka, "Zona Korçë-Voskopojë në fillimet e erës osmane", në *Qytetërimi i Voskopojës*, 338-340.

¹⁰ Georgios Giacomis, "Jehona e urbanizimit të Voskopojës në dekorimet e mureve të kishave në rrethin e saj", në *Qytetërimi i Voskopojës*, 116.

¹¹ Xhufi, "Ngritja dhe rënia e një qyteti", 71.

¹² Plasari, *Fenomeni Voskopojë*, 41; po aty, 77-78.

¹³ Konstantinos Giacomis dhe Juna Miluka, "Qasje fillestare mbi operacionet kredidhënëse dhe menaxhimin e riskut prej esnafit të rrobaqepësve të Voskopojës (1716-1727)", në *Paraja dhe bankingu në Shqipëri nga antikiteti deri në ditët tona*,

bakërxhinjve dhe i këpucarëve.¹⁴ Esnafet ishin të organizuara mbi bazën e solidaritetit ekonomik e social. Anëtarët më të rinj të këtyre esnafëve shkonin në Korçë, ku voskopojarët kishin dyqane dhe përgatitëshin profesionalisht. Përveç artizanatit dhe ushtrimit të tregtisë, tregtarët dhe esnafet kontribuonin për ndërtimin e rrugëve, urave, kishave, shkollave, objekteve urbane, botimin e librave dhe vepra bamirësie.¹⁵

Tregu shqiptar u fuqizua nga produktet e ekonomisë agrare dhe zhvillimi i artizanatit, gjë që ndikoi fuqimisht në shkëmbimet tregtare ndërqytetare edhe me jashtë.¹⁶ Produktet kryesore të tregtisë sipas rëndësisë ishin: leshi, dylli, lëkurët, cergat ose shtrojat prej leshi të trashë, duhani, pambuku, vaji etj. Kjo vërehet pikërisht në radhën e ngarkesave të anijeve ku ngarkohet në fillim leshi dhe pastaj mallrat e tjera.¹⁷ Leshi (*lana d'Albania*) dhe lëkurët ishin produkte shqiptare, ashtu si dhe dylli që asokohe arrinte nga të gjitha zonat e Shqipërisë, por edhe nga principatat rumune dhe Bosnja.¹⁸ Voskopoja ishte një ndër zonat ku nxirrej leshi dhe grumbullohej leshi i Gramozit, Pindit dhe Tomorrit, por meqenëse tregtarët frekuentonin hapësirën e hinterlandit ballkanik ata e sillnin leshin edhe nga Tesalia, Maqedonia, Serbia, Bullgaria dhe principatat rumune.¹⁹ Nisur nga relacionet e konsujve venecianë në gjysmën e dytë të shek. XVIII, historiani Stavri Naçi përmend Elbasanin, Tiranën, Krujën, Kavajën, Ndroqin etj., si zonat nga arrinte saftjani ose lëkura e dhisë (*cordovane*)*, lëkura e deles (*montonine*), lëkura e qengjit (*agnelline*) dhe Dibrën për lëkurët e verdha (*damaschine*).²⁰

Punimet e konferencës së parë të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 14-15 qershor 2017 (Tiranë: Banka e Shqipërisë, 2018), 107.

¹⁴ Stilian Adhami, *Voskopoja në shekullin e lulëzimit të saj* (Tiranë: 8 Nëntori, 1989), 32, 29.

¹⁵ *Po aty*, 33; Eduart Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2001), 405.

¹⁶ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, 9-10.

¹⁷ *Po aty*, dok. nr. 40, 8 qershor 1702, 91.

¹⁸ Papahagi, "Les Roumains de l'Albanie", 50.

¹⁹ Adhami, *Voskopoja*, 38; Xhufi, *Shekulli i Voskopojes*, 316.

* Saftjani (*cordovane*) ishte lëkurë e regjur dhe gjysmë e punuar nga lëkurëpunuesit dhe e lyer me ngjyrë të kuqe ose të verdhë me shqemë (sumak) ose lende lisi e tanin. Ishte më e fortë se lëkura e deles dhe përdorej për rripa, këpucë, takëmet e kuajve, çanta, lidhjen e librave etj.

Në tri dekadat e fundit të shek. XVII, porti i Durrësit u kthye në një pikë kalimi të tregtisë ndërkombëtare të mallrave të eksportit dhe destinacion i produkteve industriale nga jashtë si rrjedhim i zhvillimit të marrëdhënieve tregtare kryesisht me Venecien, e cila e hapi selinë e saj pas Raguzës edhe me vende të tjera të huaja, si Franca dhe Holanda, që ngritën konsullatat e tyre në Durrës. E gjithë kjo periudhë deri në luftën e Moresë (1714-1718) u karakterizua nga konkurrenca tregtare ndërmjet Venecies dhe vendeve të tjera, që u shfaq në drejtimin e mallrave në rrugët tregtare Durrës -Venecia dhe Durrës-Raguzë-Ankonë.²¹

Tregtia nga Voskopoja kryhej nëpërmjet karvanëve që bënë pjesë ndër 10 karvanët që përshkonin Shqipërinë. Rrugët kryesore lidheshin me Korçën e Ohrin dhe Beratin, ku ato ndaheshin në Jug drejt Vlorës dhe drejt qendrës nëpërmjet luginës së Devollit e Osumit për në Durrës.²²

Gjithashtu për lidhjet ndërmjet portit të Durrësit me zonat e brendshme kishte rëndësi edhe rruga Via Egnatia përgjatë së cilës ishin vendosur një sërë qendrash tregtare si Elbasani, Struga, Kosturi etj., të cilat tregtarët voskopojarë duke qenë se ishin tregtarë lëvizës, i frekuentonin për sigurimin e mallrave.²³ Megjithatë, për transportin e tyre, ata përdornin edhe portin e Vlorës dhe të Sajadhës (Saiada) sot përtej kufirit grek dhe rrallëherë Shirgjin e Shkodrës. Roli i tyre ishte pozitiv për shkëmbimet ndërqytetare brenda vendit, sepse ata ishin të pranishëm në Kavajë, Berat, Elbasan, Tiranë etj.²⁴

Po ashtu, tregtarët voskopojarë frekuentonin edhe qendra të tjera tregtare dhe panaire në Maqedoni e Tesali: Kosturin, Strugën, Manastirin

²⁰ Stavri Naçi, “Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shekullit XVIII”, në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr. 3 (Tiranë: Mihal Duri, 1961), 39.

²¹ Ulpian Hoti, “An overview of trade aspects between Albania and Western Countries”, *European Academic Research*, vol. III, Issue 2 (maj 2015), 2596.

²² Adhami, *Voskopoja*, 35.

²³ Ilia V. Ballauri, *Paralele: Venetiku dhe Voskopoja: studim mbi lidhjet, përqasjet, dhe përngjasjet mes Venetikut dhe Voskopojës së shek. 17-të dhe të 18-të* (Korçë: Libraria Kotti, 2013), 56; Valeriu Papahagi, *Aromâni Moscopoleni, și comerțul Venețian în secolele al XVII-lea și al XVIII-lea*, me parathënie nga Nicolae Jorga (București: Editura societății de cultură macedo-română, 1935), dok. nr. XVII, 19 qershor 1697, 157. Ekziston edhe versioni në gjuhën frënge i hyrjes së përmbledhjes me dokumente dhe jo i plotë i Valeriu Papahagi-t.

²⁴ Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie”, 50.

(Bitola), si dhe Larisën, Moskolorin e Asalonën.²⁵ Një ndër to ishte Selaniku, ku përveç tregtisë, ata kishin poste edhe në dogana dhe konsullata të huaja. Kështu, voskopojari Konstandin Paiko ishte dragoman nderi i konsullatës franceze të Selanikut dhe tagrambledhës i taksës së duhanit.²⁶ Në vitin 1701, ai tregtonte në portin e Durrësit 988 veshje të bardha (*saloniche*)²⁷ dhe 30 pako me dyllë dhe kishte kaq ndikim në Stamboll sa që kishte mundur të nxirrte një berat për Dhimitër Triandafilin nga Siatista, me të cilin i njihej posti i sekretarit (*scrivano*) të portit të Durrësit.²⁸

Marrëdhëniet ndërmjet Voskopojës dhe Venecies shkojnë pas në kohë. Ato nisin me vendosjen e grekëve, arbërve dhe arumunëve në Venecia. Në vitin 1498 u ngrit shkolla e Shën Nikollës së grekëve pranë kishës së San Biaggio-s në Venecia sipas sistemit venecian të bashkësive ose vëllazërive (*confraternitates*), dhe në vitin 1511 disa stratiotë arbër dhe grekë iu dërguan një petition autoriteteve veneciane lidhur me ngritjen e një kishë ortodokse, e cila u ndërtua më vonë në zonën e njohur si San Giorgio dei Greci, rreth së cilës mblidhej kjo bashkësi.²⁹ Pranë saj u ngrit il *Collegio Flangini*, ku shkolloheshin pjesëtarët e kësaj bashkësie. Në shek. XVII, u vendosën këtu disa familje tregtarësh nga Janina, Pogoni dhe Voskopoja.

Në fillim të shek. XVIII, tregtarët e Voskopojës që kishin shkëmbime tregtare me Venecien ishin: Dhimitri, vëllai i Besos, Adam Papa, Mihail Gjergj Sideri, Athanas dhe Simo Jorgji, Adam Dhimitri, Jani i Gjergj Papës, Kosta dhe Jorgji Theodhori, Anton dhe Adam Gira (Hira), Nikolla Stavri e Soto Patra.³⁰ Mes tregtarëve të Voskopojës u

²⁵ Victor Bérard, *La Turquie et l'Hellénisme Contemporain* (Paris: F. Alcan, 1893), 40; Adhami, *Voskopoja*, 38.

²⁶ Nikos G. Svoronos, *Le commerce de Salonique au XVIII siècle* (Paris: Presses Universitaires de France, 1956), 200-202.

²⁷ *Salonichio* – ishin veshje të bardha që visheshin nga shtresat e ulëta sociale dhe e kishin marrë emrin nga qyteti i Selanikut, ku ishin prodhuar për herë të parë.

²⁸ ASV, CSM, 1. S., b. 661, 18 prill 1701 dhe 11 shtator 1705; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 24, 18 prill 1701, 71, dok. nr. 73, 11 shtator 1705, 142-143.

²⁹ Giorgios Placatos, ‘Diasporas, Space and Imperial Subjecthood in Early Modern Venice: A Comparative Perspective’, në *Diasporas: circulations, migrations, histoire, scène urbaine*, 28, 2016, 45. <https://doi.org/10.4000/diasporas.540>.

³⁰ ASV, CSM, 1. S., b. 661, 29 qershor 1706; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 119, 29 qershor 1706.

përfshinë edhe tregtarë të disa fshatrave si Shipska ose Grabova e Sipërme e Gramshit.³¹ Mes tyre shfaqen në vitin 1705 si tregtarë dylli dhe leshti me Venecien Kostandin dhe Jovan Saguna.³² Sipas Papahagi-t, ata e kishin origjinën nga Grabova e Sipërme dhe duhej të kishin lidhje farefisnore asokohe me peshkopin e Voskopojës, Andrea Saguna.³³

Tregtarët e Voskopojës kishin mbështetjen e dy konsujve të Venecies në Durrës, Giorgio Cumano-s (1700-1702) dhe nipit të tij Giorgio Emmanuele Cumano-s (1702-1705) nga Kreta, sepse ata kishin qenë më parë korrespondentë të tregtarëve voskopojarë në Venecia. Pikërisht me rastin e zgjedhjes së të parit më 1 shtator 1700, ata i dërguan një petition Pesë të Urtëve për tregtinë ku shprehnin pëlqimin e tyre për zgjedhjen e tij në postin e konsullit venecian, ndikimin e tij për uljen e taksës së navllimit (qiramarrjes së anijeve) dhe vendosjen e tarifës për dyllin prej 60 asprash çdo 140 okë për taksën doganore veneciane të *cottimos*.³⁴

Nga fundi i Gjashtëqindës, Giorgio Cumano-s i drejtohen disa letra nga tregtarët e Voskopojës. Këto letra janë mbledhur nga Nicolae Iorga dhe Valeriu Papahagi*, që kanë hulumtuar arkivat e Venecies dhe janë marrë kryesisht me fondin dokumente greke (*carte greche*) dhe konsujt venecianë të Durrësit e letërkëmbimin e tregtarëve të Voskopojës, Janinës dhe Pogonit në gjuhën greke. Kështu, ky letërkëmbim tregtar përmban rreth 314 letra, 93 prej të cilave u përkasin tregtarëve shqiptarë dhe vllëh që tregtonin nëpërmjet portit të Durrësit. Nga ato që u përkasin tregtarëve të Voskopojës Iorga ka dhënë një përmbledhje të 10 prej tyre,

³¹ Peyfuss, *Shtypshkronja e Voskopojës*, 27.

³² *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 60, viti 1705, 119.

³³ Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie”, 49.

³⁴ ASV, CSM, 2° Serie (më tej: S.), b. 28, 1 shtator 1700; Cristian Luca, “The Dynamics of the Commercial Activity in the Ottoman Port of Durazzo during the Consulate of Zorzi (Giorgio) Cumano (1699 -1702)”, në *Small is Beautiful?, Interlopers and Smaller Trading Nations, Proceedings of the XVth World Economic History Congress in Utrecht (Netherlands) 2009*, ed. Markus A. Denzel dhe Philipp Robinson Rössner (Stuttgart: Franz Steiner, 2011), 179. Kjo taksë doganore veneciane ishte 2% për të gjitha mallrat.

* Historiani rumun Nicolae Iorga, themeluesi i Institutit rumun në Venecia në vitin 1929, e nxiti Valeriu Papahagi-n me anë të një burse për të studiuar dokumentet veneciane që hedhin dritë mbi marrëdhëniet tregtare të Voskopojës me Venecien, i cili, falë origjinës së tij nga Avdhela, një fshat arumun në malet e Pindit, konsiderohet si një nga njohësit më të mirë të historisë arumune.

ndërsa Papahagi ka transkriptuar 23 letra që i përkasnin shek. XVII dhe 3 letra të shek. XVIII, dy prej të cilave janë përkthyer në gjuhën shqipe nga Ilia Ballauri.³⁵

Në njërën nga letrat që mban datën 15 tetor 1696 dhe i përket Nikollë (Kolë) Theodorit, ai i rekomandonte korrespondentit Kumano nipin e tij Theodorin që do të kthehej në qytetin lagunar.³⁶ Ky dokument sipas Adhamit, që është shkruar në Voskopojë, është më i vjetri.³⁷ Disa tregtarë voskopojarë si nipi tjetër i tij Mihail Jorgji Sideri dhe Dhimitër Bendo kishin marrëdhënie tregtare me principatat e Vallakisë dhe të Moldavisë, nga ku arrinte kryesisht dylli që tregtohej në Venecia.³⁸ Por, sasia më e madhe e dyllit prej 3 000 okësh (3 810 kg)^{*} i erdhi asokohe korrespondentit Kumano nga tregtari Aleks Jorgji. Pikërisht ky tregtar i dërgoi një letër tjetër Giorgio Cumano-s, ku i shkruante më 19 qershor 1697 se kishte shkuar në Berat dhe Elbasan me të atin për të siguruar lesh, të cilin do ta dërgonte me anijen e ardhur nga Venecia nëpërmjet Ankonës dhe më pas do të drejtohej për në Strugë për të blerë dyllë.³⁹ Më vonë, më 27 qershor, tregtari voskopojar i shkruan një letër tjetër nga porti i Durrësit ku flitet për Dhimitrin, njërin nga vëllezërit Bendo, i cili kishte raporte të mira me disa karamyslimë të Vlorës, të cilët ishin nisur me të deri në Moskolouri për të tregtuar bagëti.⁴⁰ Disa nga tregtarët voskopojarë më të pasur, si Dhimitër Bendo dhe Teodor Nikolla, kishin

³⁵ ASV, Documenti Greci, 314 carte; Iorga, *Histoire des roumains*, 38-39; Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie”, 30. Ekziston gjithashtu edhe përkthimi i tyre në gjuhën italiane në fondin arkivor venecian Bailo a Costantinopoli. Konstantina Karakosta, “The Greek merchants of Moschopoli”, *European Scientific Journal, ESI*, vëll. 18, nr. 10 (mars 2024): 115-138. <https://doi.org/10.19044/esj.2022.v18n10p115>, 118; Apostolos E. Vacalopoulos, *History of Macedonia*, përktheu Peter Megann (Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1973), 296, <https://www.macedonia.krkoraina.com/en/av/index.html> (shikuar më 8 shkurt 2024); Adhami, *Voskopoja*, 39; Ballauri, *Paralele: Venetiku dhe Voskopoja*, 56-58, letrat e 19 dhe 27 qershorit 1697 të tregtarit voskopojar Aleks Jorgji.

³⁶ Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie”, dok. nr. IV, 15 tetor 1696, 93.

³⁷ Adhami, *Voskopoja*, 40-41.

³⁸ Luca, “The dynamics of commercial”, 179.

^{*} Raporti duhet të jetë 1 okë baras me 1,25 kg dhe 1,50 kg. Për periudhën për të cilën flasim merret e para.

³⁹ Ballauri, *Paralele: Venetiku dhe Voskopoja*, 55-56.

⁴⁰ *Po aty*, 57-58.

marrë me koncesion taksën e gjedhit në Vlorë për furnizimin e ushtrisë turke dhe, sipas Jorgës, i dërgonin bagëtitë nga Voskopoja në Beograd.⁴¹

Por, me zgjedhjen e Giorgio Cumano-s në postin e konsullit venecian të Durrësit në fillim të shek. XVIII, sipas ligjit venecian, ai nuk mund ta ushtronte tregtinë, prandaj tregtarët e Voskopojës kishin si korrespondentë të tyre në Venecia vëllanë e tij Giovanni Cumano dhe nipin Giorgio Emmanuele Cumano.⁴²

Emrat e tregtarëve voskopojarë shfaqen mes dokumenteve konsullore në policë-ngarkesat e anijeve, ku shënohet sasia dhe pesha e mallit që ata tregtonin në Venecia. Kështu, në policën e ngarkesës të një anijeje raguzane të 3 nëntorit 1700, tregtari Jani Jorgji, Nikollë Vreto dhe Kristo Dhimitri dërgonin në Venecia përkatësisht 10 dengje dhe nga 4 dengje me saftjan (lëkurë dhie – *cordovane*), ndërsa Simo Jorgji, Llazar Theodhori dhe Jani Hira përkatësisht nga 18 pako, 10 pako dhe 4 pako me dyllë për kompaninë familjare korrespondente Kotoni nga Arta, ndërsa Jorgji Theodori 6 dengje me lesh për korrespondentin nga ishujt jonikë Mikel Peruli.⁴³ Në ndryshim nga shumica e tregtarëve porositës në Venecia që ishin nga Janina dhe Arta, tregtarët voskopojarë ishin lëvizës dhe u përkisnin kryesisht kompanive tregtare familjare, prandaj i dërgonin mallrat vetë në Venecia si për shembull Jani Papa, djali i Jorgjit, i cili tregtonte 4 dengje me lëkurë qengji (*agnelline*), Jani Dhimitri 10 dengje me lesh dhe Teodor Jorgji Siguri 6 pako me dyllë.⁴⁴ Megjithatë, në vitin në vijim, Jani Papa vendoset përkohësisht në Venecia si korrespondent i Andrea Papës.⁴⁵

Leshi ishte një produkt i ndaluar nga Stambolli, sepse përdorej për nevojat e tregut të brendshëm. Nga mesi i shek. XVII u liberalizua tregtia e leshit dhe ky ishte një faktor që u dha hov shkëmbimeve tregtare të leshit të Voskopojës nga fundi i Gjashtëqindës dhe në dekadat e para të shek. XVIII në përputhje me kërkesat e tregut të jashtëm.⁴⁶

⁴¹ Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 182; Iorga, *Histoire des roumains*, 38.

⁴² *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 7, 3 nëntor 1700, 40 dhe dok. nr. 21, 27 shkurt 1701, 66. Tregtari voskopojar dërgues Kristo dhe Nikolla Dhimitri kishin si korrespondent Giovanni Cumanon, ndërsa Anton Pjetër Samarxhiu Giorgio Emmanuele Cumanon.

⁴³ *Po aty*, dok. nr. 7, 3 nëntor 1700, 39-40.

⁴⁴ *Po aty*, dok. nr. 8, i padaturar, 37-41.

⁴⁵ *Po aty*, dok. nr. 42, 11 korrik 1702, 95.

⁴⁶ Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 316-318.

Në ngarkesat e anijeve dalmato-perastine të Durrësit në gjysmën e parë të vitit mbizotërojnë dylli dhe lëkurët,⁴⁷ ndërsa në gjysmën e dytë është leshi që përbën produktin kryesor.⁴⁸ Kjo lidhet sigurisht edhe me periudhën e qethjes së leshit të ri në pranverë dhe në vjeshtë, si dhe me kohën që u duhej tregtarëve për ta mbledhur dhe për ta dërguar në Durrës.

Për herë të parë pesha e leshit dhe e dyllit shprehet në okë në vitin 1703, ndërkohë që njësia matëse veneciane e peshës për ngarkesat ishte libra.⁴⁹ Në një policë-ngarkesë thuhet se Kosta Theodori ngarkoi 10 dengje me lëkurë dhie, 2 dengje me lëkurë dashi dhe 4 dengje e gjysmë me saftjan (lëkurë dhie), Adam Papa 9 dengje me lëkurë dhie, 3 dengje me lëkurë të verdha (damaskine) dhe 6 pako me dyllë ose 370 okë e gjysmë.⁵⁰

Nganjëherë letërkëmbimi është i mangët, sepse mungojnë policë-ngarkesat dhe flitet vetëm për disa faktorë që ndikuan negativisht mbi tregtinë. Kështu, tregtarët voskopojarë u përfshinë në vitin 1702 në një ngjarje që u krijua për shkak të konkurrencës së anijeve për transportin e mallrave. Ata u bindën nga konsullatat franko-holandeze të Durrësit që t'i dërgonin mallrat në Venecia me anë të anijes ulqinake me kapiten Mehmet Bekrian.⁵¹ Kjo u bë shkak që kapiteni perastin Marco Stukanovich ta rrëmbente gjatë natës anijen me mallra që gjendej e ankoruar në portin e Durrësit. Por në vitin 1705, anija e gjetur u rikthye në port dhe konsullit venecian iu dërgua shuma prej 4 319 dukatesh për zhdëmtimin e tregtarëve, që u shpërnda nga Dhimitër Triandafili, dragoman i konsullatës veneciane.⁵²

⁴⁷ Po aty, dok. nr. 24, 18 prill 1701, 68-72.

⁴⁸ Po aty, dok. nr. 30, 30 tetor 1701, 76-77.

⁴⁹ Angelo Martini, *Manuale di metrologia ossia misure, pesi e monete in uso attualmente presso tutti i popoli* (Torino: Loescher, 1883), 202, 818-819. Në Durrës 1 okë ishte baras me 1,600 kg, por ishte në përdorim edhe oka e Stambollit e barasvlershme me 1,280 kg, ndërsa në Venecia një libër e madhe ishte e barabartë me 0,4769 kg, ndërsa një libër e vogël me 0,300 kg.

http://www.braidense.it/dire/martini/modweb/index_6.htm. (shikuar më 8 shkurt 2024).

⁵⁰ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 29, 18 korrik 1703, 103.

⁵¹ Po aty, dok. nr. 36, 23 mars 1702, 85.

⁵² ASV, CSM, 1 S., b. 661, 27 nëntor 1705; po aty, dok. nr. 86, 27 nëntor 1705, 167. Ka një ndryshim ndërmjet shifrës prej 4 319 dukatesh për të cilën shkruan Pietro Roza dhe të 4 419 dukateve në deklaratën e Dhimitër Triandafil.

Një pjesë e ngarkesës së dy anijeve të mbytura, njëra nga moti i keq dhe tjetra nga një brazdë e krijuar nga një gjyle topi, që transportonin një sasi të konsiderueshme leshi dhe një numër të vogël pakosh me dyllë dhe lëkurë më 11 nëntor 1702, u përkiste tregtarëve të Voskopojës.⁵³ Kështu voskopojarët, ashtu si tregtarët e tjerë që kishin humbur mallrat, iu drejtuan konsullit venecian të Durrësit që së bashku me një përfaqësi të tyre të niseshin për të takuar bailiun në Stamboll dhe nëpërmjet konsullit ua drejtuan lutjet dhe dokumentet për zhdëmtimin e tyre edhe autoriteteve veneciane të Pesë të Urtëve për tregtinë.⁵⁴

Në njërën prej anijeve të quajtur “Santa Croce” shfaqen emrat e Dhimitër Bendos dhe vëllait të tij, për të cilin është folur më parë, të cilët u mbytën, sipas një dokumenti, nga një e çarë e shkaktuar nga sulmi i një anijeje pirate nga Tripoli. Por, në të vërtetë, anija duhej të ishte turke dhe në qendër të kësaj ngjarjeje ishte një nga arkondët e Voskopojës Dhimitër Bendo, i cili më parë gjatë luftës së Moresë kishte furnizuar venedikasin.⁵⁵

Me ardhjen e konsullit të ri venecian, Pietro Orsini Rosa, më 15 korrik 1705 në Durrës, ky raport mirëbesimi me tregtarët voskopojarë vazhdoi. Për t’i bërë ballë konkurrencës së selive të tjera konsullore, kryesisht asaj holandeze që kontrollonte edhe magazinat e portit dhe për ta drejtuar tregtinë drejt Venecies, ai u përqendrua gjithashtu në negociatat me komunitetet tregtare. E tillë ishte orvatja e tij me tregtarët e Elbasanit dhe të Voskopojës, që t’i sistemonin mallrat në magazinat e konsullatës veneciane dhe me ndërmjetësinë e konsullit t’ua dërgonin korrespondentëve në Venecia.⁵⁶ Tregtarët e Voskopojës i dërguan një letër konsullit venecian Pietro Orsini Rosa në vitin 1706 që të takohet me përfaqësuesit (prokuratorët) e tyre Adam dhe Andon Hira (Gira), sepse ashtu si tregtarët e Elbasanit donin t’i ruanin mallrat në magazinat e konsullatës së Durrësit.⁵⁷

⁵³ *Po aty*, dok. nr. 10, 11 dhe dok. nr. 24, 68-72.

⁵⁴ ASV, CSM, I. S, b. 661, 1 dhjetor 1700.

⁵⁵ Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 173-176, 178-181.

⁵⁶ ASV, Bailo a Costantinopoli (më tej: BC), Lettere di Ascanio Giustinian (1703-1709), 29 qershor 1706; Papahagi, *Aromâni Moscopoleni*, dok. nr. 171, 29 qershor 1706, 121; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, 119, 29 qershor 1706, 112.

⁵⁷ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, dok. nr. 119, 29 qershor 1706; Karakosta, “The Greek merchants of Moscopoli”, 120-121.

Përveç tregtisë, ata përmbushnin misionet e konsullit venecian duke i mbajtur kontaktet me bailiun.⁵⁸ Kështu, për zgjidhjen e kontradiktave për emërimin e sekretarit të portit të Durrësit, ai e dërgoi letërkëmbimin për ambasadorin venecian në Stamboll, Ascanio Giustinian më 1706 me anë të tregtarit voskopojar Jani Kosta Zhupani (Ziupan).⁵⁹

Sipas policë-ngarkesave në periudhën 1705-1706 ka një shtim të numrit të dengjeve. Në vitin 1705, sasia e leshit të dërguar ishte përkatësisht 855 dengje dhe 642 dengje në vitin 1706. Në periudhën 1707-1715, industria tekstile e Venetos furnizohej me leshin e hapësirës shqiptare për shkak të krizës nga konkurrenca gjermane.⁶⁰ Sigurisht, kjo duhet ta ketë nxitur tregtinë e leshit nga Voskopoja me Venecien.

U krijuan gjithashtu kompani të përbashkëta ndërmjet tregtarëve të Siatistës e të Voskopojës për tregtinë e leshit dhe të dyllit, siç ishte rasti i tregtarëve Niko Stathi, Niko Duka e Jorgji Hira dhe kompania voskopojare për tregtinë e leshit Dhimitri & Jorgji.⁶¹ Rufeti (esnafi) i leshit ishte më i rëndësishmi i Voskopojës, që falë raporteve me Venecien u quajt edhe “*compagnia*”.⁶² Kjo për faktin se, meqenëse ishte produkti kryesor vendës, tregtimi i tij në Venecia zhvilloi ekonominë e Voskopojës.

Konsullata veneciane e Durrësit mbështetej pikërisht te komunitetet e tregtarëve, ku voskopojarët kishin peshën e tyre jo vetëm për mbarëvajtjen e marrëdhënieve tregtare, por edhe për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e çështjeve me autoritetet lokale.⁶³ Në vitin 1712, dy tregtarë voskopojarë të quajtur Dhimitër Bizuka dhe Jani Papa u dërguan nga konsulli Roza për të përcjellë pashanë e Vlorës, i cili do të takonte sundimtarin e Shkodrës pas kontradiktave që kishin lindur ndërmjet

⁵⁸ Karakosta, “The Greek merchants of Moscopoli”, 52.

⁵⁹ Papahagi, *Aromâni Moscopoleni*, dok. nr. XXXVI, 25 prill 1706, 98.

⁶⁰ Walter Panciera, “Il lanificio: mercanti e produzione. Dalla crisi finanziaria al libero mercato”, *Storia economica e sociale di Bergamo (Il tempo della Serenissima, Settecento, età del cambiamento)*, ed. Marco Cattini dhe Marzio Achille Romani, vëll. IV (Bergamo: Istituto di studi e ricerche fondazione per la storia economica e sociale di Bergamo, 2006), 75.

⁶¹ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII*, shih policë-ngarkesat e viteve nga data 25 shtator 1705 dhe të vitit 1706.

⁶² Xhufi, “Ngritja dhe rënia e një qyteti”, 78-79.

⁶³ Umberto Signori, *Venezia e Smirne tra Sei e Settecento. Istituzioni, commerci e comunita' mercantili* (tezë diplome e Universitetit Ca'Foscari të Venecies), 2013/2014, 168.

anijeve ulqinake dhe atyre perastine në portin e Vlorës. Ali Pashai, sundimtari i Vlorës, ishte ngarkuar nga Porta që të kryente hetimet e nevojshme lidhur me çështjen dhe së bashku me kapixhiun dhe sundimtarin e Shkodrës shkuan për katër ditë në Ulqin për të takuar autoritetet lokale. Pas takimit, ndërkohë që po përgatitej dekreti në Stamboll, voskopopjarët do të niseshin më pas për të informuar bailiun.⁶⁴ Por kishte gjasa që dekreti të lëshohej në favor të ulqinakëve, dhe atëherë ndërhyrja e bailiut në Stamboll do të ishte e kotë. Në letrën që i shkruanin konsullit venecian të Durrësit, dy tregtarët i shpjegonin se falë ndërhyrjes së tyre kishin arritur ta bindnin pashanë, sipas dëshirës së konsullit Roza, që të ishte i paanshëm dhe të zbatonte drejtësinë.⁶⁵

Tregtarët e Voskopojës mund të ndikonin në sistemin e taksave doganore veneciane. Kështu, në vitin 1704, ata bashkë me tregtarët e Elbasanit i bënë një kërkesë konsullit venecian të Durrësit që taksa doganore për dyllin dhe lëkurët të ishte 1/4 realë për koli.⁶⁶

Voskopopjarët i dërgonin mallrat në Durrës së bashku me tregtarët e Elbasanit, Kosturit, Malovishtes (Manastirit) dhe Siatistës, qytet në zonën e Kozanit në Tesali (Greqi). Ndër ta ishte edhe tregtari nga Siatista Joan Neranzi, i cili kishte qenë më parë sekretar i portit të Durrësit dhe kishte raporte të mira me konsullatën veneciane.

Në fakt, më 22 tetor 1705, u ngrit një kompani tregtare në ortaki ndërmjet Nicola Pulimeno-s, konsullit holandez të Durrësit dhe Joan Neranzit. Qëllimi i saj ishte t'i tërhiqte tregtarët në tregtinë franko-holandeze. Ata mundën të bënin pjesë të saj dy tregtarët e Voskopojës, Jani Papa dhe Dhimitër Bizuka.⁶⁷ Kjo e rriti konkurrencën ndërmjet konsullatave të huaja në Durrës dhe ndikoi negativisht mbi tregtinë veneciane, sepse edhe tregtarë të tjerë si Sinan Muço Kasaçi nga Kavaja e braktisën tregtinë me Venecien, duke i shkaktuar humbje tregtarit porositës Gjergj Stamatelo në Venecia, i cili e kishte parapaguar navllimin (qiranë e anijes). Në fakt, edhe konsullatat e tjera e pranonin si

⁶⁴ ASV, CSM, 1. S. b. 661, 24 prill 1711; Papahagi, "Les Roumains de l'Albanie", 54; Ballauri, *Paralele: Venetiku dhe Voskopoja*, 48-51.

⁶⁵ ASV, CSM, 1. S. b. 661, 9 prill 1711; *po aty*, 183-184, 186.

⁶⁶ *Po aty*, CSM, 1. S. b. 28, 27 shtator 1704.

⁶⁷ *Po aty*, BC, filza (më tej: f.) 130, Lettere ad Alvise Mocenigo, 1709-1714, 1708; *po aty*, CSM, 1. S. b. 661, 26 shkurt 1709, 16 gusht 1712; Adhami, *Voskopoja*, 41.

praktikë prokurimin e mallrave të porositura për korrespondentët e vet.⁶⁸ Megjithëse ngarkesat me mallra ishin porositur nga korrespondentët venecianë, nganjëherë ato ndryshonin drejtim dhe ndiqnin destinacione të tjera (kryesisht drejt Raguzës ose Ankonës). Prandaj, konsulli venecian i Durrësit u detyrua t'i bindte tregtarët që të mos i ngarkonin ato mbi anije të tjera. Sigurisht, ata duhej t'u përmbaheshin kontratave të qiramarrjes së anijeve dalmato-perastine, të cilat ishin destinuar për portin e Durrësit, përndryshe tregtia do të kishte çrregullime. Megjithatë, në vitet në vijim kjo kompani i bënte konkurrencë Venecies, sepse pas vdekjes së Pulimeno-s në vitin 1710 vazhdonte të përfshinte tregtarë të tjerë nga zona të tjera të Shqipërisë si, shkodranin Mehmet Priska dhe elbasanasit Haxhi Ider dhe Ibrahim Biçaku.⁶⁹ Megjithatë, në shkurt të vitit 1709, Venecia arriti t'i rikthente dy tregtarët voskopojarë Dhimitër Bizuka dhe Jani Papa në anën e saj. Sigurisht, ndikimi venecian u ndie në këtë kompani kryesisht në ortakërinë me Joan Neranzin, sepse një pjesë e tregtisë u drejtua në Venecia. Edhe pas vdekjes së dy tregtarëve voskopojarë, meqenëse ishin kompani familjare, ata u zëvendësuan nga vëllezërit e tyre Kosta Bizuka dhe Nikollë Papa.⁷⁰ Madje, ata patën edhe një çështje tregtare me Joan Neranzin, i cili kishte qenë ortak i vëllezërve të tyre që kishin vdekur në vitin 1710.⁷¹ Ata pohonin se kishin ngarkuar dy vjet më pas 9 fuçi me vaj nga Vlora me vlerë 709 zekinë në anijen e kapitenit Nicolo' Diclich, me të cilin kishin nënshkruar një kontratë se ai do t'u jepte një paradhënie prej 100 dukatesh dhe pjesën e mbetur t'ua paguante në Venecia, dhe kjo nuk kishte të bënte me kompaninë e mësipërme. Më pas, Jani Papa i kishte lëshuar kontabilistit të tij Nicolo' Reghini një kambial (*lettera di cambio*)* për pjesën e mbetur. Por emri i Nikollës, vëllait të tij, nuk rezultonte as në policën e ngarkesës ku ishte shkruar vetëm emri i Kostandin Bizukës dhe as në kambial, gjë të cilën ai

⁶⁸ ASV, CSM, 1. S. b. 661, 26 mars 1706, *Dokumente mbi Shqipërinë në shek. XVIII ...*, 26 mars 1706, dok.102, 184-185.

⁶⁹ Rossana D'Alborton Vitale, "La scala di Durazzo negli anni del console Rosa (1705-1733)", në *Studi veneziani*, vol. XXXIV (Pisa, Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 1997), 228.

⁷⁰ Papahagi, *Aromâni Moscopoleni*, 188-189.

⁷¹ ASV, CSM, 1. S. b. 662, 13 shkurt 1713.

* Kambiali ishte një dokument financiar dhe tregtar për një shumë hua ose mallra të blera me kredi. Përdoret përgjithësisht nga tregtari për të garantuar pagesën e mallrave të shitura. Nëpërmjet tij, ai mund t'i japë financim tregtarit që e ka blerë mallin dhe shërben si garanci se ai do t'i arkëtojë paratë në afatin e caktuar.

e justifikonte me faktin se Joani kishte hyrë në borxhe në Venecia. Shitblerja e mallrave me kredi ishte një praktikë e zakonshme për tregtarët voskopojarë, sepse kështu vepronin tregtarët venecianë.⁷² Meqenëse ortakia ishte lidhur me një kompani familjare, ai vazhdoi rrugën e të vëllait. Në fakt, i shërbeu dëshmia e tregtarit Bizuka.

Ndërkohë, Gjergj Stamateli e kishte paraqitur çështjen para Pesë të Urtëve në Venecia ku kërkonte shpjegime nëse Jani Papa kishte qenë kreditor me interes për kambialin e tregtarit venecian Nicolo' Reghini-t, për pagesën e shumës prej 602 zekinësh. Për këtë, kishte marrë dokumente origjinale nga konsullata veneciane e Durrësit, ndërsa Neranzi i kishte kërkuar konsullit venecian provat e dëshmitarëve.⁷³ Ata ishin tregtarët Thanas Kosturi nga Kosturi dhe Jorgji Peio nga Siatista që kishin qenë të pranishëm gjatë marrëveshjes, të cilët dëshmuuan në favor të tij se edhe ai ishte një nga ortakët e kompanisë.⁷⁴ Në lidhje me këtë çështje, konsulli Rosa ishte informuar se në marrëveshje kishte marrë pjesë si përkthyes edhe Joan Neranzi.⁷⁵

Në periudhën 1714-1718, tregtia u ndal për shkak të luftës së Moresë, prandaj mungon edhe letërkëmbimi i konsullit venecian me autoritetet veneciane për tregtinë.⁷⁶ Megjithatë, në vitin 1715, Venecia e vazhdoi tregtinë me Durrësin me mbështetjen e tregtarit nga Siatista Joan Neranzi, i cili, së bashku me tregtarin voskopojar Gjergj Vreto siguruan në Stamboll pranë ambasadës angleze, holandeze dhe gjenoveze letrat kredenciale *lettres patentes* si dokumente që lejonin hapjen e selive konsullore angleze dhe gjenoveze në Durrës dhe morën drejtimin e tyre. Kjo nuk u mirëprit nga konsulli francez i Durrësit, Joseph Isnard, i cili i shkruante Pontchartraini-t se ata kishin përkrahjen e ambasadorëve të këtyre vendeve në Stamboll.⁷⁷

Gjatë kësaj lufte venecianët humbën Morenë, por i forcuan pozitat e tyre në Adriatik, sepse arritën të ngrinin rrethimin osman të Korfuzit me

⁷² Adhami, *Voskopoja*, 42.

⁷³ ASV, CSM, 1° S, b. 661, 28 gusht 1712; Papahagi, *Aromâni Moscopoleni*, 192-193.

⁷⁴ ASV, CSM, 1° S, b. 661, 16 gusht 1712; *po aty*, 188-189.

⁷⁵ *Po aty*, CSM, 1. S. b. 662, 13 shkurt 1713.

⁷⁶ Papahagi, *Les aroumains de l'Albanie*, 54.

⁷⁷ *Po aty*, dok. nr. XLIX, 9 shtator 1715, 194.

ndihmën e një flote aleate dhe të merrnin kështjellën e Butrintit (1718-1797), Prevezën, Vonicën dhe ishullin jonik të Shën Maurës.⁷⁸

Me Traktatin e Pasarovicit (Pozharevacit) të 27 korrikut 1718, u vendos paqja ndërmjet Venecies dhe Perandorisë Osmane. Më 1719, në vigjilje të hapjes së tregtisë, konsulli Pietro Rosa i shkruante Carlo Ruzzini-t, përfaqësues i Venecies në marrëveshjen e paqes dhe më pas ambasador i saj në Stamboll, se kishte zgjedhur si dragoman dhe zëvendës të tij voskopojarin Gjergj Vreto, i cili do të kthehej në Durrës nga Voskopoja për t'i dërguar letrën e konsullit venecian në mënyrë që të siguronte beratin që e konfirmonte në këtë post me shpenzimet e veta «*degnare farli ottenere il baratto di dragomano*».⁷⁹ Kapitujt e traktatit i erdhën konsullit nga ambasadori venecian në Stamboll nëpërmjet tregtarit voskopojar.⁸⁰

Tregtarët e Voskopojës ishin angazhuar me dërgimin e postës së konsullit venecian të Durrësit në ambasadën veneciane në Stamboll sepse ishin në ortaki me sipërmarrës atje, ku shkonin për tregti siç ishte edhe rasti i tregtarit Mihail Jorgji, i cili priste në Voskopojë tregtarin Mustafa Agë Alirusin.⁸¹

Në maj të vitit 1720, dy tregtarët voskopojarë Gjergj Vreto dhe Dhimitër Bizuka tregtonin me Venecien, pavarësisht se ishin strehuar nga Luigi Matteo në ambasadën franceze në Durrës, i cili i kishte bindur që të navllonin një anije raguzane. Për këtë, konsulli Roza informonte se kjo ishte në dëm të transportit të mallrave me anije tregtare perastine.⁸² Në këtë rast, duke mos pasur policën e ngarkesës, meqë malli kishte kaluar me anë të konsullatës franceze, nuk mund të arrijmë në ndonjë përfundim për sa i përket vëllimit të tregtisë.

Pas Traktatit të Pasarovicit (Pozharevacit) të 21 korrikut 1718 u nënshkrua edhe Traktati i Lundrimit dhe i Tregtisë i 28 korrikut 1718, i cili përmbante edhe pika që përcaktonin sistemin e taksave doganore prej 3% për tregtinë ndërmjet Austrisë me Perandorinë Osmane, duke i hapur rrugën tregtisë dypalëshe. Në ndryshim nga Venecia, që nënshkroi me

⁷⁸ Kenneth Setton, *Venice, Austria and the Turks in the Seventeenth Century* (Philadelphia: American philosophical society, 1991), 442-445.

⁷⁹ Papahagi, *Aromâni Moscopoleni*, dok. nr. LI, 21 tetor 1719, 195-196; Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 183-184.

⁸⁰ ASV, CSM, I. S. b. 662, 13 shkurt 1720.

⁸¹ Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 231.

⁸² ASV, CSM, I. S. b. 662, 26 maj 1720.

këtë traktat humbjen e Moresë, që i kaloi Perandorisë Osmane, Austria arriti jo vetëm të fitojë territore por edhe privilegje tregtare.⁸³ Që në vitin 1717, Austria kishte ngritur Kompaninë Orientale të privilegjuar për tregtinë për marrëdhëniet tregtare me Ballkanin dhe kishte nxjerrë dekretin për lirinë e lundrimit në Adriatik, ndërkohë që portet e lira të Triestes dhe Fiumes që në vitin 1719 konkurronin me portet veneciane në Adriatik për sa u përket tarifave doganore.⁸⁴ Pikërisht më 1720, u hap konsullata austriake në Durrës dhe në disa dokumente veneciane shfaqet emri i konsullit austriak Francesco Passarovich.⁸⁵

Megjithatë, pas Pasarovicit rruga tregtare Voskopojë-Durrës-Venecia e humbi rëndësinë e saj në favor të aksit tokësor Selanik-Shkup-Beograd, sepse austriakët e zhvendosën kufirin turk përtej Hungarisë deri në Transilvani.⁸⁶ Kjo e liberalizoi më tej tregtinë e leshit dhe të lëkurëve, duke nxjerrë në pah qendra të tjera tregtare më pranë kufirit austriak e duke mënjeluar industrinë e leshit të Venecies dhe të qyteteve të Voskopojës e Siatistës që ishin të lidhura me të. Nevoja për lesh për uniformat habsburgase nxiti Selanikun si pikë grumbullimi e leshit maqedonas dhe shqiptar për një tregti të drejtpërdrejtë me Austrinë, duke e zëvendësuar Voskopojën që në dy dekadat e para të shek. XVIII.⁸⁷

Kjo situatë e favorshme u dha mundësi në vitin 1720 tregtarëve voskopojarë, ashtu si dhe tregtarëve të tjerë nga Shqipëria e Jugut, Tesalia dhe Maqedonia që të largoheshin drejt Europës Qendrore falë kërkesës për lesh si produkt dhe të vendoseshin në Hungari, Austri, Transilvani, Bosnjë, Serbi, Sllovaki, Poloni e Rusi.⁸⁸ Fakti që ata u kthyen në sedentarë në disa vende, dëshmon se iu krijua hapësirë që ta ushtronin tregtinë në kuadër të marrëdhënieve tregtare ndërmjet Austrisë

⁸³ Setton, *Venice, Austria and the Turks*, 150-151.

⁸⁴ Hrvoje Petrić, "The Navigation and Trade Agreement of 1718 and Othoman orthodox merchants in Croatia and the military border", *The Peace of Passarowitz*, ed. Charles W. Ingrao, Nikola Samardžić, Jovan Pešalj, West Lafayette, Indiana, Purdue University Press, 2011, 179-181.

⁸⁵ ASV, CSM, 1. S. b. 662.

⁸⁶ Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 322-325.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ Xhufi, "Ngritja dhe rënia e një qyteti", 78; Vacalopoulos, *History of Macedonia*, 296-297; Traian Stanojevich, "The Conquering Balkan Orthodox Merchants", në *The Journal of Economic History*, vol. XX, nr. 2 (Cambridge: Cambridge University Press, 1960) 277; Anton Spiesz, "Die Orthodoxen Handelsleute aus dem Balkan in der Slowakei", *Balkan Studies*, vol. 9, nr. 2 (1968), 384.

dhe Perandorisë Osmane. Në fillim të vitit 1721, lëvizja e tregtarëve nga Durrësi drejt destinacioneve të tjera mund të çonte drejt mbylljes së konsullatave: «*Quando poi li Mercanti seguirano à sfugire questa di lei Scala come la maggior parte già à ' fatto, Noi altri Consogli pure saremo astretti dalla necessità rittirarsi...*». Pati edhe faktorë të tjerë që e reduktuan tregtinë e Durrësit. Mallrat kishin ndryshuar drejtim në dyvjeçarin 1720-1721 dhe niseshin nga porti i Sajadhës. Produkti kryesor dylli, që më parë vinte nga Vallakia, Shkupi dhe Bosnja, kalonte tashmë në Split dhe në Dubrovnik.⁸⁹ Gjithashtu, nuk lejohej tregtia nga Durrësi e disa produkteve si vaji, kështu që ai tregtohej nga Vlora. Sipas raporteve konsullore, kjo ndikoi në tregtinë e Durrësit me Venecien e cila gjatë periudhës korrik-tetor 1726 u reduktua sa $\frac{1}{4}$ e vëllimit të tregtisë së mëparshme.⁹⁰

Si përfundim, zhvillimi i Voskopojës si qendër tregtare që parapriu hapjen e konsullatës veneciane dhe konsullatave të tjera të huaja nga viti 1671 e tutje, qëllimi kryesor i të cilave në atë periudhë ishte zgjerimi i marrëdhënieve tregtare me këto vende, duhet të ketë ndikuar në urbanizimin e qytetit në fundin e shek. XVII dhe përgjatë shek. XVIII. Tregtia e Voskopojës me Venecien nëpërmjet portit të Durrësit u rrit në dy dekadat e para të shek. XVIII dhe nuk u ndërpre as gjatë luftës veneto-turke të Moresë (1714-1718) për faktin se me anë të dy tregtarëve, njëri prej të cilëve voskopojar, u hapën seli të tjera konsullore në mënyrë që të vazhdonte tregtia me Venecien. Marrëdhëniet tregtare me Venecien kontribuan për zhvillimin kulturor, social e arkitektonik të qytetit. Shumat e parave të fituara falë tregtisë nga tregtarët e Voskopojës në Venecia dhe artizanët, u investuan për ngritjen e një shkolle më 1710, megjithëse prania e një shkolle vërehet që nga fundi i shek. XVII.⁹¹ Një ndër arsytet ishte edhe mësimi i llogaritjes dhe italishtes, që do të lehtësonte shkëmbimet mes dy brigjeve. Në të njëjtin vit u ngrit dhe Biblioteka me libra të shtypur në Venecia e më pas edhe me libra të shtypur në Voskopojë pas hapjes së Shtypshkronjës së Voskopojës në

⁸⁹ ASV, CSM, 1. S, b. 662, 18 mars 1721. Peticion i katër konsullatave dërguar doganierit të Durrësit.

⁹⁰ Vacalopoulos, *History of Macedonia*, 297; Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, 327.

⁹¹ Adhami, *Voskopoja*, 59.

vitin 1731.⁹² Zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor i Voskopojës si një ndër qendrat e rëndësishme të Shqipërisë nisi nga fundi i shek. XVII, vazhdoi përgjatë dy dekadave të shek. XVIII dhe arriti kulmin e lulëzimit të saj në periudhën 1720-1770.⁹³

Bibliografi:

Arkiva:

Archivio dello Stato di Venezia (ASV)

- CSM 1. S, b. 661, Lettere dei Consoli di Durazzo 1700-1711
- CSM 1. S, b. 662, Lettere dei Consoli di Durazzo 1712-1738
- CSM, 2. S, b. 28, Consoli di Durazzo (1700-1712)
- BC, Lettere di Ascanio Giustinian (1703-1709)

Botime dokumentare:

Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707). Përkthyer dhe përgatitur për botim nga Zija Shkodra. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1975.

Literaturë historiografike:

Adhami, Stilian. *Voskopoja në shekullin e lulëzimit të saj*. Tiranë: 8 Nëntori, 1989.

Ballauri, Ilia V. *Paralele: Venetiku dhe Voskopoja: studim mbi lidhjet, përjasjet, dhe përngjasjet mes Venetikut dhe Voskopojës së shek. 17-të dhe të 18-të*. Korçë: Libraria Kotti, 2013.

Bérard, Victor. *La Turquie et L' Hellénisme Contemporain*. Paris: F. Alcan, 1893.

Caka, Eduart. *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2001.

Carageani, Gheorghe. “Venezia e gli Aromeni (i Macedoromeni)”, në *Dall'Adriatico al Mar Nero: veneziani e romeni, tracciati di storie comuni* ed. Grigore Arbore Popescu, 128-140. Roma: CNR, 2003.

⁹² Nertila Ljarja Haxhia, “Voskopoja, one of the most important hearths of Balkan illuminist ideas”, *Journal of education and social research*, Roma: MCSER Publishing, vol. IV, nr. 3 (maj 2024), 232.

⁹³ *Po aty*, 229.

- Duka, Ferit. “Zona Korçë-Voskopojë në fillimet e erës osmane”, *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan, konferencë ndërkombëtare*. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2018.
- Falo, Dhori. *Tragjedia e një qyteti: (Voskopoja)*. Korçë: Libraria Kotti, 2015.
- Giakoumis, Konstantinos & Juna Miluka, “Qasje fillestare mbi operacionet kredidhënëse dhe menaxhimin e riskut prej esnafit të rrobaqepësve të Voskopojës (1716-1727)”. Në *Paraja dhe bankingu në Shqipëri nga antikiteti deri në ditët tona, Punimet e konferencës së parë të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 14-15 qershor 2017*. Tiranë, Banka e Shqipërisë, 2018: 101-113.
- Giorgios, Placatos, “Diasporas, Space and Imperial Subjecthood in Early Modern Venice: A Comparative Perspective”: 37-54. *Diasporas: circulations, migrations, histoire*, scène urbaine, 28, 2016. <https://doi.org/10.4000/diasporas.540>.
- Hoti, Ulpian. “An overview of trade aspects between Albania and Western Countries”. In *European Academic Research*, vol. III, Issue 2 (maj 2015): 2590-2599.
- Iorga, Nicolae. *Histoire des roumains de la Peninsule balcanique (Albanie, Macédoine, Épire, Thessalie, etc.)*. Bucarest: Société des Macédo-Roumains de Bucarest “Cultura Neamului Românesc, 1919.
- Iorga, Nicolae. *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*. Përktheu nga frëngjishtja Viron Koka. Tiranë: Saraçi, 2004.
- Karakosta, Konstantina. “The Greek merchants of Moschopoli”, *European Scientific Journal, ESI*, vëll. 18, nr. 10 (mars 2024): 115-138. <https://doi.org/10.19044/esj.2022.v18n10p115>.
- Ljarja, Nertila Haxhia. “Voskopoja, one of the most important hearths of Balkan illuminist ideas”. In *Journal of education and social research*, Roma: MCSER Publishing, vol. IV, nr. 3 (maj 2024): 229-232.
- Luca, Cristian. “The Dynamics of the Commercial Activity in the Ottoman Port of Durazzo during the Consulate of Zorzi (Giorgio) Cumano (1699 -1702)”. In *Small is Beautiful? Interlopers and Smaller Trading Nations, Proceedings of the XVth World Economic History Congress in Utrecht (Netherlands), 2009*, edited by Markus A. Denzel dhe Philipp Robinson Rössner, Stuttgart: Franz Steiner, 2011: 177-200.
- Naçi, Stavri. “Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shekullit XVIII”. Në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr. 3. Tiranë: 1961: 3-64.

- Panciera, Walter. "Il lanificio: mercanti e produzione. Dalla crisi finanziaria al libero mercato", 75-103. In *Storia economica e sociale di Bergamo. (Il tempo della Serenissima, Settecento, età del cambiamento)*, edited by Marco Cattini dhe Marzio Achille Romani. Bergamo: Istituto di studi e ricerche fondazione per la storia economica e sociale di Bergamo, 2006, vëll. 4.
- Papahagi, Valeriu. "Les Roumains de l'Albanie et le commerce venitien aux XVIIe et XVIIIe siècles". *Mélanges de l'École roumain en France*. Paris, 1931: 29-124.
- Papahagi, Valeriu. *Aromăni Moscopoleni Și Comerțul Venețian in sec. al XVII-lea si al XVIII-lea*. București: 1935.
- Peyfuss, Max Demeter. *Shtypshkronja e Voskopojës, 1731-1769: shtypja e librave dhe adhurimi i shenjtore në Patrikanën e Ohrit*. Përkthyer nga Gjergj Misha. Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2002.
- Petrić, Hrvoje. "The Navigation and Trade Agreement of 1718 and Othoman orthodox merchants in Croatia and the military border". *The Peace of Passarowitz*, ed. Charles W. Ingrao, Nikola Samardžić, Jovan Pešalj. West Lafayette, Indiana, Purdue University Press, 2011.
- Plasari, Aurel. *Fenomeni Voskopojë*. Tiranë: Phoenix, 2000.
- Setton, Kenneth. *Venice, Austria and the Turks in the Seventeenth Century*. Philadelphia: American Philosophical Society, 1991.
- Spiesz, Anton. "Die Orthodoxen Handelsleute aus dem Balkan in der Slowakei". In *Balkan Studies*, vol. 9, nr. 2 (1968): 384-428.
- Stoianovich, Traian. "The Conquering Balkans Orthodox Merchant". In *The Journal of Economic History*, vol. XX, nr. 2. Cambridge, Cambridge University Press, 1960: 234-313.
- Svoronos, Jorgos Nicos. *Le commerce de Salonique au XVIII siècle*. Paris: Presses Universitaire de France, 1956.
- Vitale, Rossana D'Alborton. "La scala di Durazzo negli anni del console Rosa (1705-1733)". Në *Studi veneziani*, vol. XXXIV. Pisa, Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 1997: 225-245.
- Xhufi, Pëllumb. "Ngritja dhe rënia e një qyteti". Në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, konferencë ndërkombëtare. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike, 2018: 67-84.
- Xhufi, Pëllumb. *Shekulli i Voskopojës (1669-1779)*. Tiranë: Toena, 2010.

Botime elektronike, Website:

Martini, Angelo. *Manuale di metrologia ossia misure, pesi e monete in uso attualmente presso tutti i popoli*. Torino: Loescher, 1883.

http://www.braidense.it/dire/martini/modweb/index_6.htm.

Vacalopoulos, Georgos. *History of Macedonia*, përkthyer nga Peter Megann. Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1973.

<https://www.macedonia.kroraia.com/en/av/index.html> (shikuar më 8 shkurt 2024).

ALVIN SARAÇI

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania

saracialvin@hotmail.com

S u m m a r y

THE MERCHANTS OF VOSKOPOJA (MOSCOPOLI) IN THE PORT OF DURAZZO AND
THE TRADE RELATIONS WITH VENICE IN THE FIRST TWO DECADES OF THE 18TH
CENTURY

The article is based on the correspondance of the consul of Venice in Durazzo with the *Cinque Savi alla Mercanzia*, which are published as collection of documents by Zija Shkodra and Valeriu Papahagi. It focuses on the important role of the merchants of Voskopoja in the trade relations with Venice by means of the port of Durazzo by the end of XVII Century and in the first two decades of the XVIII Century, the close relations with the consuls of Venice in Durazzo, Giorgio Cumano and his nephew Giorgio Emmanuele Cumano, which were their former brokers and Pietro Orsini Rosa, the other consulates, the causes for the decline of the Venetian trade of Durazzo and the reasons why the merchants of Voskopoja began to move to the Austrian Empire after the Treaty of Passarowitz.

NIKOLLË LOKA

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

nikolloka@yahoo.com

<https://doi.org/10.61773/g25aqj38>

**LËVIZJET KONKURRUESE NACIONALISTE
DHE PËRPJEKJET PËR HAPJEN E SHKOLLAVE SHQIPE
NË MAQEDONI***

Abstrakt:

Maqedonia e shek. XIX ishte një mozaik popujsh, ku shumicën e popullsisë e përbënin bullgaro-maqedonasit dhe shqiptarët, por kishte edhe pakica të tjera etnike: serbë, turq, grekë etj. Në periudhën e zhvillimit të nacionalizmave dhe të formimit të identiteteve kombëtare lindën lëvizje konkurruese nacionaliste, të cilat synonin të legjitimonin si të tyre territore sa më të gjera të Maqedonisë. Duke qenë se identitetet fetare ishin të konsoliduara prej kohësh, në skenë kishin dalë rivalitetet fetare midis ortodoksëve: Patrikanës së Stambollit si mbrojtëse e greqizmit, Ekzarkatit bullgar dhe kishës serbe. Identitetet dhe besnikëria e popullsisë ortodokse në Maqedoni ishin të papërcaktuara dhe maqedonasit vendës të besimit ortodoks mund të konsideroheshin grekë, nëse ndiqnin një kishë greke, por bullgarë ose serbë nëse flisnin një gjuhë sllave. Për kishat ortodokse nuk kishte rëndësi gjuha të cilën e flisnin besimtarët, por varësia kishtarë. Nëse një sllav i Maqedonisë (që fliste gjuhë sllave) ishte i lidhur me Patrikanën, automatikisht trajtohej si grek. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me shqiptarët ortodoksë. Në lojë ishte dhe shteti osman, i cili kreu reforma të rëndësishme arsimore gjatë periudhës së Tanzimatit. Pavarësisht nga pozita e disfavorshme e shqiptarëve si etni pa shtet të vetin, ata hapën shkolla shqipe në territoret shqiptare

* Maqedonia është një rajon historik dhe gjeografik në Europën Juglindore. Në këtë artikull, emri Maqedoni i referohet vilajetit të Manastirit, që ishte një prej njësive administrative të Perandorisë Osmane. Kufijtë e këtij rajoni kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Vilajeti i Manastirit u krijua në vitin 1874, u shpërbë më 1877 dhe u rikrijua në vitin 1879. Territori i vilajetit të Manastirit u pushtua nga ushtritë e Aleancës Ballkanike gjatë Luftës së Parë Ballkanike në vitin 1912 dhe u nda kryesisht midis Mbretërisë së Greqisë dhe Mbretërisë së Serbisë.

në Maqedoni aty ku mundën dhe e kthyen Manastirin në qendër të lëvizjes kombëtare për shkollën shqipe.

Fjalë kyçe:

Milet, Patrikanë, Ekzarkat, arsim fetar, arsim laik, shkollat greke, shkollat bullgare, shkollat serbe, arsimi në gjuhën shqipe.

Nga Ballkani i përbashkët osman te vetidentifikimi etnonacionalist

Megjithëse termi *milet* jep idenë e “kombit” në gjuhën turke, ai ngjante pak me konceptin e kombit në Europën Perëndimore. Miletet osmane i identifikuan njerëzit vetëm në bazë të fesë dhe duke eliminuar të gjitha konsideratat e përkatësisë etnike, identifikimit si pjesë e një mileti i mungonte plotësisht kuptimi territorial, i lidhur me konceptin europeanoperëndimor të kombit.¹ Shoqëria osmane u organizua në traditën *zimmi* (dhimmah)² dhe nuk kishte asnjë koncept të shtetësisë, derisa ligji për shtetësinë osmane u miratua në vitet 1860.³

Kisha ishte mjeti i parë politik i entiteteve që u bënë shtete kombëtare në Ballkan.⁴ Grekët dhe sllavët, falë përdorimit të gjuhës greke e sllave në ceremonitë fetare dhe në të gjitha entitetet ortodokse, kishin arritur të mbronin pjesët bazë të kulturës së tyre me mjetin më të rëndësishëm, gjuhën. Sistemi mori pak kohë për t’u zhvilluar dhe milete

¹ Dennis P. Hupchick, *The Balkans: From Constantinople to Communism* (New York: Palgrave Macmillan 2002), 134.

² Dhimmi i referohet një subjekti jomysliman të Perandorisë Osmane, që rrjedh nga konceptet ligjore islame të anëtarësimit në shoqëri, “dhimmive” jomyslimanë u është ofruar mbrojtje nga shteti, janë përjashtuar nga shërbimi ushtarak në këmbim të taksave specifike. Statusi i dhimmiut u hoq ligjërisht më 1839 me Hatt-i Sherif të Gülhanes dhe u zyrtarizua me Ligjin osman të Kombësisë së vitit 1869, si pjesë e reformave më të gjera të Tanzimatit. H. Patrick Glenn, *Legal Traditions of the World* (Oxford University Press: 2007), 218-219.

³ Fatih Ozturk, “The Ottoman Millet System”, 7, <https://dergipark.org.tr/en/download/article-file/12937> (shikuar më 18.06.2014).

⁴ Kemal H. Karpat, “The Balkan National States and Nationalism”: Image and reality, *Islamic Studies*, vol. 36, no. 2/3, Special Issue: Islam in the Balkans (Summer/Autumn 1997), 343, published by: Islamic Research Institute, International Islamic University, Islamabad Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/23076200>. (shikuar më 18.06.2014).

të tjera u krijuan më vonë, veçanërisht në shek. XIX dhe derisa mileti pas Revolucionit Xhonturk u bë sinonim i kombësisë.⁵

Mileti i parë që u institucionalizua ishte ai ortodoks.⁶ Bota ballkanike në këtë kohë ishte një botë ortodokse jokombëtare.⁷ Deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII, territoret ballkanike ishin nën autoritetin e tri kishave të njohura autoqefale nga autoritetet osmane. Juridiksioni i Patrikanës së Stambollit fillimisht ishte i kufizuar në zona të përcaktuara mirë të Ballkanit dhe Anadollit. Shumë pjesë të Ballkanit në Bosnjën e sotme, Serbi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë e Veriut dhe Shqipërinë e Jugut ishin nën juridiksionin e Patrikanës serbe të Pejës ose Kryepeshkopatës autoqefale bullgare të Ohrit.⁸ Ndërsa patriarkët e Pejës ishin serbë,⁹ shumë kryepeshkopë të Ohrit ishin bullgarë, vllëh ose shqipfolës, shpesh nga Himara ose Voskopoja.

Shfuqizimi i kishave autoqefale serbe dhe bullgare e forcoi procesin e greqizimit të popullsisë së etnive të ndryshme.¹⁰ Nëpërmjet milletit ortodoks, gjuha greke u bë gjuha e Ballkanit osman jomysliman

⁵ Milena B. Methodieva, *Between Empire and Nation Muslim Reform in the Balkans* (Stanford California: Stanford University Press, 2021), 13.

⁶ Mehmeti II emëroi Gennadios II Scholarios si patriark më 1454 dhe e caktoi atë si udhëheqës shpirtëror, si dhe etnark ose, në turqisht, milletbashi të të gjithë të krishterëve ortodoksë në perandori, pavarësisht nga origjina etnike; jo vetëm grekët, por edhe bullgarë, serbë, shqiptarë, vllëh, moldavë, kroatë, sirianë, arabë ortodoksë, gjeorgjianë dhe lazë. Barbara Jelavich, *History of the Balkans, Eighteenth and Nineteenth Centuries*, vol. I (Cambridge University Press: 1983), 52.

⁷ Leften Stavros Stavrianos, "Antecedents to the Balkan Revolutions of the Nineteenth Century", *Journal of Modern History*, vol. 29, no. 4 (Dec., 1957), 345.

⁸ Kryepeshkopata e Ohrit u krijua në vitin 1018 me uljen e Patrikanës Autoqefale Bullgare në rangun e Kryepeshkopatës. John Shea, *Macedonia and Greece: the struggle to define a new Balkan nation* (Jefferson, North Carolina and London: McFarland, 1997), 172-173.

⁹ Në kuvendin që u mbajt më 16 prill 1346 në Shkup morën pjesë kryepeshkopi serb Joanikije II, kryepeshkopi Nikolla I i Ohrit, patriarku Simeon i Bullgarisë dhe shumë hierarkë dhe dinjitarë të tjerë të kishës. Kuvendi shpalli ngritjen e Kryepeshkopatës Autoqefale Serbe në rangun e Patrikanës. Aleksandar Fotić, "Serbian Orthodox Church", në *Encyclopedia of the Ottoman Empire* (New York: Infobase Publishing, 2008), 519-520.

¹⁰ Albert Doja, "Ecclesiastical Pressures and Language Politics: The Boundary Work of Albanian Language in the 17th-18th Centuries, Ecclesiastical Pressures and Language Politics", në *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 50 (4) (2022), 759. (10.1017/nps.2021.55); (halshs-03648536).

dhe kultura fetare greke u nxit pothuajse në çdo qendër kishtare ortodokse nën kontrollin e Patrikanës së Stambollit.¹¹

Fanariotët kishin një interes të madh për ta ruajtur shoqërinë osmane siç ishte. Ata kontrolluan miletin ortodoks, dominuan çështjet ekonomike dhe të jashtme të perandorisë dhe monopolizuan sundimin në të dyja principatat rumune. Të gjitha postet e rëndësishme administrative të miletit ishin në duart e tyre.¹² Kur fanariotët tradicionalë e përforcuan ndjenjën ekzistuese të epërsisë kulturore greke ndaj anëtarëve jogrekë, kryesisht sllavë të miletit ortodoks, pati një reagim të thellë etnik antigrek, i cili u shndërrua në armiqësi të plotë ndaj tyre¹³ dhe atëherë shqiptarët, vllehtë dhe bullgarët u vendosën në rrugën e njohjes dhe vetëpërkufizimit si kategori kolektive për shkak të veçorive të tyre gjuhësore.¹⁴

Shpërbërja në sistemin e miletit filloi me Tanzimatin në mesin e shek. XIX, si një çështje prioritare, kur ata që sunduan shtetin osman hynë në një përpjekje për të krijuar një komb të ri osman, i cili u bë një nga elementet bazë që përcaktoi sistemin arsimor osman në shek. XIX.¹⁵ Me njohjen që iu bë Ekzarkatit dhe miletit bullgar nga Sulltani në vitin 1870, ortodoksët e Ballkanit u përçanë në “patriarkistë” dhe në “ekzarkistë”. Po atë vit, autoritetet osmane do të njihnin miletin vllëh (arumun).¹⁶ Megjithatë, pavarësisht nga shtimi i mileteve, siç ka vërejtur Maria Todorova, para së gjithash, “Perandoria Osmane ishte një shtet islamik me hierarki të rreptë fetare, ku jomyslimanët zinin vendet e pasme”.¹⁷

Në përgjithësi, jo vetëm grekët, por edhe nacionalizmat e tjerë ballkanikë mund të shihen si një problem madhor për teorinë nacionaliste

¹¹ Hupchick, *The Balkans from Constantinople*, 206.

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*.

¹⁴ Paschalis M. Kitromilides, “‘Imagined Communities’ and the Origins of the National Question in the Balkans”, *European History Quarterly*, 19 (1989), 152.

¹⁵ Tuğrul Özcan, “Abdulhamid Doneminde Gayrimuslim okullarının idari isleyisine dair birdeğerlendirme”, në *Uluslararası multidisipliner çalışmaları sempozyumu* (Roma, Italya: 18-21 Mayıs 2017), 122-123.

¹⁶ Nathalie Clayer, *Në origjinë të nacionalizmit shqiptar, lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë* (Tiranë: Përpjekja, 2012), 46.

¹⁷ Artan Puto, *The idea of Nation during the Albanian National Movement (1878-1912)*, Thesis (Florence: European University Institute, Department of History and Civilization, 2012), 34.

duke pasur parasysh prapambetjen e Ballkanit.¹⁸ Shtetet ballkanike hartuan projektet e tyre nacionaliste dhe bënë përpjekje për të plotësuar imperativin nationalist – një shtet, një kulturë.¹⁹ Kur çështja maqedonase u ngrit, pas vitit 1870, ideja se nacionalitetet e ndryshme që jetonin në këtë territor dalloheshin nga gjuha ishte njëri nga faktorët për përplasjet mes Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Portës së Lartë.²⁰ Nuk është për t'u habitur që konflikti greko-bullgar doli se ishte më i dobishëm për bullgarët. Ai arriti kulmin pas fermanit perandorak të shkurtit 1870, kur u shpall themelimi i Ekzarkatit autonom bullgar, të ndarë nga Patrikana greke. Kisha e pavarur bullgare çoi në krijimin e strukturave politike të veçanta, organeve këshillimore dhe ekzekutive brenda elitës bullgare.²¹ Nacionalizmi bullgar e konsideronte si rivalin e tij kryesor nacionalizmin grek dhe Patrikanën në Kostandinopojë, prandaj autonomia e kishës bullgare u konsiderua si hapi i parë drejt shtetësisë bullgare.²²

Deri në vitet 1870, me ardhjen e agjitacionit nationalist bullgar, grek dhe serb, banorët e Maqedonisë mbanin identitetin fetar si të krishterë, ndërsa etniciteti specifik i përcaktuar gjuhësisht do të thoshte pak për ta; mjaftonte që shumica flisnin sllavisht dhe ishin ortodoksë, gjë që i dallonte nga fqinjët myslimanë.²³ Ata iu nënshtruan planeve imperialiste të institucioneve fetare dhe arsimore greke, bullgare dhe serbe në Maqedoni, të cilat u përpoqën të rrënjosnin mbi ta një kombësi greke, bullgare dhe serbe në mes të kaosit të një mjedisi të përkeqësuar ekonomik, social e politik brenda shtetit osman.²⁴ Në fakt, në këtë periudhë, maqedonasit sllavë kishin një ndjenjë të vaktë të përkatësisë. Në shkrimet e tij nga viti 1906-1907, Cvijić pohoi se “sllavët maqedonas” ishin një masë “amorfë” dhe “e luhatshme”, pa vetëdije

¹⁸ Ernest Gellner, *Nationalism* (London: Weidenfeld & Nicolson, 1997), 41.

¹⁹ *Po aty*, 54.

²⁰ Eric J. Hobsbawm, *Nations and Nationalism since 1870, Programme, myth, reality*, Second Edition (Cambridge University Press: 1990), 108.

²¹ Misha Glenny, *The Balkans: Nationalism, War and the Great Powers 1804-1999* (London: Penguin Putnam Inc., 2000), 115.

²² Alexis Heraclides, *The Macedonian Question and the Macedonians: A history* (Routledge: 2021), 6.

²³ Hupchick, *The Balkans from Constantinople*, 297.

²⁴ Nick Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity, 1870-1912*, Thesis (Victoria University: 2005), 106.

kombëtare. Sipas tij “ata ishin të predispozuar të bëheshin serbë ose bullgarë në varësi të shtetit që i aneksonte”.²⁵

Debati midis shteteve ballkanike rreth etnisë së subjekteve maqedonase nuk pati asnjë pasojë për osmanët, të cilët dëshmuuan se ishin të aftë të vendosnin një komunitet kundër tjetrit, që ua bënte më të lehtë zgjatjen e pranisë së tyre në rajon.²⁶

Etnonacionalistët ballkanas në betejën për Maqedoninë

Pak specialistë të Ballkanit do ta kundërshtojnin pretendimin se në shek. XIX identiteti mbizotërues i sllavishtfolësve në tri vilajetet e Maqedonisë osmane ishte ndjenja e të qenit të krishterë ortodoks. Sllavofolësit, nga vitet 1860, fituan një identitet etnik ose kombëtar (përveç identitetit të tyre fetar ose të ndryshëm nga ai), i cili mund të ndahet në katër kategori: shumica që pretendonte se ishin bullgarë ose bullgarë maqedonas (kryesisht ekzarkë); një grup më i vogël në Jug që pretendonte se ishin ose ishin bërë grekë (të njohur si grekomanë); një grup edhe më i vogël, kryesisht në Veriperëndim, pretendonin se ishin serbë; pjesëtarët e grupit të katërt, numri i të cilëve nuk dihet, këmbëngulnin se nuk ishin as bullgarë, serbë apo grekë, por “maqedonas” ose “maqedonas të krishterë ortodoksë”.²⁷

Në tërësinë e tij, elementi ortodoks i Ballkanit Jugperëndimor përmblihte shqiptarë, grekë, arumunë, sllavë dhe ciganë. Në vitet 1766-1767, kur u mbyllën Patrikana e Pejës dhe Argjipeshkvia e Ohrit, të gjithë u lidhën shpirtërisht me Patrikanën e Stambollit dhe hierarkinë e saj. Por, duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XIX, krijimi i shteteve të para ballkanike (Serbi, Greqi, Principata rumune) dhe rritja e “nacionalizmave ortodoksë” çuan në krijimin e rrjeteve rivale që mbështeteshin në hierarki të dallueshme nga njëra-tjetra dhe te përdorimi i gjuhëve liturgjike (dhe të shkollimit) të ndryshme.²⁸

Për të penguar shpëputjen e popujve ballkanikë nga shteti osman, në periudhën pas kryengritjeve të grekëve, bullgarëve, serbëve dhe vllahve, atyre iu njohën disa veçori kulturore, njëra prej të cilave ishte edhe shkollimi në gjuhën amtare. Në realitet, popujt jomyslimanë edhe

²⁵ Aleksandar Amfiteatrov, *Strana razdora* (St. Petersburg: I.V. Rayskoy, 1903), 13.

²⁶ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 43-44.

²⁷ Heraclides, *The Macedonian Question*, 64.

²⁸ Clayer, *Në origjinë të nacionalizmit*, 46.

më përpara e kishin shkollimin në gjuhët e tyre, por në këtë periudhë ata filluan ta shfrytëzonin këtë të drejtë për formësim kulturor dhe identitar. Parë në këtë këndvështrim, shqiptarët kishin mbetur prapa, në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit.²⁹ Aq më keq për shqiptarët, sepse në tokat e tyre po hapeshin shkollat e huaja: greke, serbe dhe bullgare, pasi dekreti perandorak osman i quajtur *Hatti-Humaiun* i lejonte ato.

Ndikimi kulturor i kishës dhe respektimi i një riti të caktuar ishin thelbësorë për përcaktimin e identitetit kombëtar.³⁰ Në rajone me popullsi të përzier, mbi të gjitha në Maqedoni, çdo aspekt shpirtëror i konfliktit u mbyt nga nevoja për të pohuar pretendime territoriale.³¹ E perceptuar politikisht si nënkuptim i kombësisë, përkatësia kishtare nënkuptonte gabimisht një lidhje me shtetin përkatës kombëtar. Lufta për një kishë autonome bullgare është një nga temat e pakta që duket se bashkon historianët ballkanikë, pavarësisht nga kombësia. Ata pajtohen se nuk kishte të bënte me fenë, por ishte një konflikt thjesht politik.³² Për shembull, kur bullgarët dhe serbët themeluan kishat e tyre (si dhe kishën rumune, që e synonin vllëhtë), u njohën miletet e reja dhe papritmas u shfaqën “kombësi” të reja në Maqedoni.³³

Në gjysmën e dytë të shek. XIX, tri shtetet konkurruese i pretenduan maqedonasit në baza etnike, duke ngatërruar qëllimisht përkatësinë kishtare me përkatësinë etnogjuhësore. Të tria shtetet ballkanike kishin kisha të njohura ortodokse “kombëtare” dhe si rrjedhim mund të vepronin lirshëm në Maqedoninë osmane: të krijonin famulli dhe shkolla që shërbenin si instrumente të nxitjeve dhe propagandës së tyre nacionaliste.³⁴ Grekët ishin të vetëdijshëm se shumica e sllavëve maqedonas do t'i bashkoheshin një kishë ortodokse sllave, gjuha letrare-liturgjike e së cilës i ngjante shumë gjuhës së tyre amtare. Serbët, të preokupuar me Bosnjë-Hercegovinën në vitet 1870, fillimisht e injoruan kërcënimin e mundshëm të Ekzarkatit bullgar për zgjerimin e ardhshëm të Serbisë. Bullgarët pro-Ekzarkatit e përshkuan Maqedoninë, duke bërë

²⁹ İsmail Yücedağ & Nurgün Koç, “Kërkesat e shqiptarëve për shkollimin në gjuhën amtare”, në *Dituria islame* 354 (maj 2020), 35.

³⁰ Glenny, *The Balkans*, 114.

³¹ *Po aty*, 116.

³² *Po aty*, 114.

³³ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 92.

³⁴ Andrew Rossos, *Macedonia and Macedonians* (California, Standfort: Hoover Institution Press, 2008), 73.

proselitizëm midis sllavëve. Grekët pro Patrikanës, të cilët nuk donin ta humbnin monopolin e miletit, u kundërpërgjigjën me përpjekje të ngjashme. Fushata e nxehtë fetaro-kombëtare shpejt degjeneroi në terrorizëm dhe gjakderdhje. Bandat e organizuara të ekzarkëve dhe patriarkëve i frikësuan fshatarët sllavë dhe shpesh u përplasën midis tyre.³⁵

Kisha bullgare u bë instrumenti kryesor për promovimin e pretendimeve kombëtare bullgare në Maqedoni në gjysmën e dytë të shek. XIX. Për ta kundërshtuar këtë, peshkopët grekë të zonës morën qëndrime gjithnjë e më militante nacionaliste, deri në atë pikë sa që betejat kombëtare në Maqedoni u zhvilluan kryesisht për kontrollin e kishave dhe juridiksioneve kishtarë. Tablosë komplekse do t'i shtoheshin së shpejti prelatët shqiptarë, pasi edhe ata u angazhuan në drejtimin e lëvizjes nacionaliste shqiptare.³⁶

Rivaliteti i madh midis Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë filloi me përplasjet fetare midis patriarkut grek të Stambollit dhe Ekzarkatit bullgar gjatë viteve 1894-1896. Nëpërmjet shkollave në Maqedoni, ata mund të përdornin në mënyrë strategjike numrin dhe vendndodhjen e tyre si dëshmi që përputhet me aspiratat e tyre territoriale.³⁷ Ekzarkët vepruan me energji në ndërtimin e rrjetit të tyre shkollor, falë financimit rus e bullgar dhe për faktin se shërbimet e priftërinjve në shkolla u dhanë falas, ndërsa për nxënësit e shkollave të mesme, kryesisht ata nga fshati, u dhanë bursa.³⁸ Deri në vitin 1876, në Maqedoni kishte 350 shkolla bullgare dhe deri para Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913 arritën në 1 141 shkolla me 1 884 mësues dhe 65 474 nxënës.³⁹

Deri në dekadën e fundit të shek. XIX, mjeti kryesor për zgjerimin e ndikimit grek ishte edukimi në shkollat greqishtfolëse dhe propaganda e ndikimi i Patrikanës përmes klerikëve që përpiqeshin të frenonin ndikimin bullgar. Në Athinë, Shoqëria për përhapjen e shkrim-leximit grek, e ndihmuar dhe financuar nga Ministria e Jashtme greke, ishte

³⁵ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 340-341.

³⁶ Kitromilides, "Imagined Communities", 182.

³⁷ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 374.

³⁸ Michael Palaret, *Macedonia: A Voyage through History*, vol. 2 (From the Fifteenth Century to the Present), (Cambridge Scholars Publishing: 2015), 123.

³⁹ Victor Roudometof, *Collective Memory, National Identity, and Ethnic Conflict, Greece, Bulgaria, and the Macedonian Question* (Praeger Publishers: 2002), 92-93.

angazhuar në përpjekjet për të helenizuar banorët sllavishtfolës.⁴⁰ Në vitin 1886, organet dhe institucionet e propagandës greke mbanin dhe kontrollonin 836 shkolla në Maqedoni. Institucionet përfshinin tri kolegje për arsimtarë, dy shkolla të mesme, një gjimnaz (shkollë të mesme) për djem dhe vajza në Manastir dhe disa seminare teologjike. Ata regjistruan 45 000 nxënës.⁴¹ Në vitin 1894, në Maqedoni kishte rreth 907 shkolla greke me 1245 mësues dhe 53 633 nxënës.⁴²

Gjatë shek. XIX, një lëvizje relativisht e vogël arsimore serbe u zhvillua në rivalitet me bullgarët. Përhapja e shkollave serbe filloi kur Beogradi krijoi Këshillin Arsimor (Prosvetni odbor) për të ngritur shkolla në “Serbinë e Vjetër” dhe në Maqedoni dhe për t’u pajisur me mësues e libra shkollorë serbë. Kriza Lindore e viteve 1870 e ndërpreu punën e Këshillit, i cili rifilloi me vendosmëri më të madhe pas Kongresit të Berlinit dhe Konventës së fshehtë serbo-austriake të vitit 1881.⁴³ Deri në luftën ruso-turke të vitit 1876, në “Serbinë e Vjetër” u hapën 98 shkolla serbe por, me shpërthimin e luftës, 33 mësues u detyruan të iknin në Serbi nga frika për jetën e tyre dhe vetëm 17 vazhduan punën. Meqë edhe bordi për shkollat dhe mësuesit pushoi së ekzistuari, rindërtimi i punës arsimore serbe në Perandorinë Osmane nuk u rivendos në fund të luftës dhe as disa vjet më vonë. Si rrjedhojë, në vitin 1882, në territorin e “Serbisë së Vjetër” funksionuan gjithsej 22 shkolla serbe.⁴⁴ Për ta riorganizuar punën, në vitin 1887, Ministria e Arsimit e Serbisë kishte hapur një departament të posaçëm për shkollat dhe kishat jashtë vendit. Duke punuar në bashkëpunim me konsujt serbë në Maqedoni,

⁴⁰ Heraclides, *The Macedonian Question*, 9.

⁴¹ Rossos, *Macedonia and Macedonians*, 75.

⁴² Roudometof, *Collective Memory*, 92-93.

⁴³ Rossos, *Macedonia and Macedonians*, 75.

⁴⁴ Урош Шешум, “Српске школе и учитељи у Старој Србији и Македонији у Великој источној кризи”, Историјски Архив Шумадије, Крагујевац, *Јован Ристић државник и дипломата - Берлински Конгрес*, Зборник Радова са научног Скупа, Одржаног 28. новембра 2018. године у Крагујевцу Уредник Предраг Илић, архивски саветник (Крагујевац: 2020) (Uroš Šešum, “Srpske škole i učitelji u Staroj Srbiji i Makedoniji u Velikoj istočnoj krizi”, Istorijски Arhiv Šumadije, Kragujevac, *Jovan Ristić državnik i diplomata – Berlinski Kongres*, Zbornik Radova sa naučnog Skupa, Održanog 28. novembra 2018. godine u Kragujevcu, Urednik Predrag Ilić, arhivski savetnik (Kragujevac: 2020), 199.

Departamenti i Propagandës në Ministrinë e Arsimit u përpoq të hapte shkolla serbe për djem dhe vajza në Maqedoni, kudo që ishte e mundur.⁴⁵

Meqenëse serbët mbetën pas grekëve dhe bullgarëve në propagandë, ata krijuan një qasje të re – bashkëpunimin me patriotët maqedonas. Në vitin 1888, Stojan Novakoviç, i dërguari serb në Stamboll, shkoi tek anëtarët e Komitetit Sekret Maqedonas në Sofje me një propozim për bashkëpunim. Në Beograd, të dyja palët ranë dakord për një program, ku kërkonin rivendosjen e Kryepeshkopatës së Ohrit nën Patrikanën e Kostandinopojës dhe kështu të fitonin të drejtën për të organizuar bashkësitë kishtarë-shkollore maqedonase, si dhe të drejtën për hapjen e shkollave në gjuhën maqedonase,⁴⁶ duke i nxitur maqedonasit për dallimet që kishin me bullgarët.

Gara nxori edhe palë të tjera, të cilat ose nuk funksionuan në shkallën e “treshes së madhe”, ose u ballafaquan me pakicat specifike. Rumania kultivoi arsimin në gjuhën rumune për popullin vllëh në jug dhe në përfundim të Maqedonisë.⁴⁷ Edhe me njohjen e milletit (kombësisë) vllëh në Turqi më 1905, njohje e marrë si rezultat i lobimit politik rumun në Stamboll, u krijua vetëm një kishë rumune e vllëhve (jashtë juridiksionit të Patrikanës), por duke qenë se nuk kishte peshkopë vllëh, ajo nuk u shugurua kurrë. Qeveria rumune nuk kishte shfaqur ndonjë ambicie serioze në Maqedoni,⁴⁸ si rezultat i presionit grek, pasi forca e irredentizmit grek në zonat e kontestuara të Maqedonisë varej kryesisht nga “besnikëria e vllëhëve”.⁴⁹ Sipas historianit rumun, Arginteanu, “në vitin 1899 në Maqedoni kishte gjithsej 34 shkolla rumune”. Stavrianos pohon se “në vitin 1912 kishte 30 shkolla të vllëhëve me rreth 2000 nxënës”.⁵⁰

Ajo që e bëri lëvizjen nacionaliste arsimore komplekse ishte fakti se identitetet dhe besnikëria e popullsisë ortodokse në Maqedoni ishin të papërcaktuara. Për shembull, maqedonasit vendës të besimit ortodoks mund të konsideroheshin grekë nëse ndiqnin një kishë greke (nuk kishte rëndësi gjuha që flisnin), por bullgarë ose serbë nëse flisnin një gjuhë sllave (në këtë rast kishte rëndësi gjuha që flisnin). Disa flisnin më shumë

⁴⁵ Roudometof, *Collective Memory*, 43.

⁴⁶ Rossos, *Macedonia and Macedonians*, 124.

⁴⁷ Stavrianos, “Antecedents to the Balkan”, 521.

⁴⁸ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 314-315.

⁴⁹ Heraclides, *The Macedonian Question*, 9.

⁵⁰ Anastasovski, *Contestation over Macedonian Identity*, 387.

se një gjuhë dhe shpesh u treguan të gatshëm të manipulonin rrethanat në favor të tyre, duke ndryshuar kisha ose shkolla, nëse ofrohej një marrëveshje më e mirë. Kështu konkurrenca u intensifikua, pasi palët rivale u përpoqën të konsolidonin dhe të legjitimonin praninë e tyre, duke ndërtuar kisha dhe shkolla. Edhe pse është e diskutueshme se sa tërheqje masive patën realisht lëvizjet kombëtare konkurruese, përpjekjet e tyre pedagogjike nxorën gjenerata të reja maqedonasish të arsimuar.

Shqiptarët dhe rivalitetet arsimore ballkanike në Maqedoni

Në epokën e pas-Tanzimatit, vendet ballkanike u mbledhën rreth strukturave të një boshti etnik. Kjo ishte një aleancë midis trojeve dhe njerëzve të ndryshëm, bazuar në gjuhën, alfabetin, arsimin dhe ndërgjegjen e tyre kombëtare. Duke marrë parasysh strukturën e boshtit etnik të formuar në rajon, krahasuar me fqinjët e tyre, shqiptarët mbetën prapa në aspektin e gjuhës, alfabetit, arsimit dhe ndërgjegjes kombëtare, pasi ishin vonuar në themelimin e shtetit të tyre kombëtar.⁵¹

Në përpjekjet e para dhe të brishta për formimin e ndërgjegjes kombëtare, gjendja e shqiptarëve brenda sistemit të milletit vë në dukje raportin paradoksal midis fesë e nacionalizmit, sepse, në thelb, për shqiptarët “qëndrueshmëria e traditave të tyre ishte prioritet dhe ndarja fetare nuk u perceptua si problem”. Aktivizimi i nacionalizmit bullgar, pas atij të grekëve dhe serbëve, nxiti zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila nuk u mor parasysh nga projektet e Bullgarisë së Madhe, Greqisë së Madhe apo të Serbisë së Madhe.

Shqiptarët, nga ana e tyre, nuk ishin plotësisht të imunizuar ndaj zhvillimit formues etnonacional. Shumë shqiptarë, ndër ta edhe të Maqedonisë kishin ikur në emigracion, ku u përfshinë në komunitete, anëtarët e të cilave përfundimisht përvetësuan konceptet kombëtare perëndimore dhe zhvilluan një identitet etnokombëtar shqiptar. Në Maqedoni përveç popullatës së besimit mysliman, apo siç i quanin të huajt muhamedanët, jetonin edhe një pjesë e popullatës shqiptare e besimit ortodoks, që përfshinte një rajon të bukur të madh, Rekën e Epërme. Brenda 10-15 vjetësh, gjegjësisht prej vitit 1831-1845 në Rekën e Epërme do të ndërtoheshin 7 kisha dhe, sipas dëshmive, në të gjitha

⁵¹ Seçkin Arpalier & Ireida Hamzaj, “Analysing from a systematic perspective the Albanian nationalism in the Ottoman Empire”, *Acta Humana*, 1 (2020), 10.

kishat liturgjia deri në vitin 1840 zhvillohej në gjuhën shqipe.⁵² Ortodoksë shqiptarë kishte edhe në Ohër, Gostivar, Tetovë, që i takonin sanxhakut të Dibrës, si dhe në Manastir e në Shkup. Krahas tyre jetonte edhe një komunitet i vogël i shqiptarëve katolikë.

Zhvillimet arsimore në trevat shqiptare u ndikuan nga vendimet e Lidhjes së Prizrenit. Idetë dhe platforma arsimore e Lidhjes u bënë pjesë përbërëse e shumë veprave, artikujve dhe fjalimeve të ideologëve të shquar të Rilindjes Kombëtare. Shqiptarët u përplasën me bullgarët, grekët dhe serbët, duke luftuar për të hapur shkolla shqipe, edhe pse veprimtaria e tyre arsimore konsiderohej e paligjshme. Me lejen e sulltanit, Ekzarkati bullgar hapi shumë shkolla edhe në vendbanimet shqiptare, pa marrë parasysh kombësinë e popullatës si: në Shkup, Kumanovë, Velesh, Manastir, Dibër, Kërçovë, Gostivar, Rekë e Epërme. Po të njëjtën politikë asimiluese ndoqi edhe Serbia, e cila hapi 49 shkolla, së pari në Ohër, Velesh, Dibër, Gostivar, Tetovë, Kërçovë dhe, më vonë, në disa fshatra shqiptare si: në Premkë, Shutovë, Zajaz, duke dërguar mësues të cilët dinin ta flisnin mirë gjuhën shqipe.⁵³

Pas kushtetutës së vitit 1846, dhe si rrjedhojë e dekretit sulltanor, u lejua hapja e shkollave laike shtetërore, çka i hapi dyert fillimit të lëvizjeve për arsim e kulturë. Por, duke qenë se “për pjesën myslimane lejohej vetëm përdorimi i alfabetit arab, intelektualët shqiptarë myslimanë të kohës u munduan që edhe përmes këtij alfabeti të përhapnin mësimin e gjuhës shqipe, si mjeti i përparimit dhe i ngritjes kulturore”.⁵⁴

“Sulltani e mohoi kombësinë shqiptare dhe me këmbëngulje e në çdo mënyrë u përpoq të fuste përçarje fetare e krahinore te shqiptarët. Duke u mbështetur në ideologjinë fetare islame, ai nuk e çante kokën për shkollat në gjuhën amtare shqipe, por vazhdoi që të hapte edhe më tej shkolla turko-arabe”.⁵⁵ Në fakt, Abdül Hamid-i II ndoqi një politikë arsimore dhe kulturore që synonte dobësimin e ndjenjave të nacionalizmit, veçanërisht në mesin e elementëve myslimanë me origjinë

⁵² Avzi Mustafa, “Përpyjekjet e shqiptarëve në Maqedoni për arsim kombëtar në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX”, <https://merbraha.com/perpjekjet-e-shqiptareve-ne-maqedoni-per-arsim-kombetar-ne-fund-te-shekullit-xix-dhe-ne-fillim-te-shekullit-xx/> (shikuar më 23.09.2020).

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

të ndryshme etnike. Qëllimi kryesor i kësaj politike, e cila u përgatit në përputhje me politikën e islamizmit, ishte futja e vlerave islame dhe besnikëria ndaj Kalifit, i cili ishte faktori më i rëndësishëm, që mund ta mbante gjallë perandorinë. Po kështu, turqishtja, gjuha e administratës dhe e arsimit shtetëror ishte e një rëndësie kritike për unitetin dhe integritetin e myslimanëve, të cilët konsideroheshin elementë thelbësorë të perandorisë.⁵⁶ Administrata osmane tregoi interes të veçantë për mësimin e turqishtes nga shqiptarët në shkollat shtetërore, të cilat u shtuan veçanërisht në zonat e banuara prej tyre. Nga ana tjetër, u morën të gjitha llojet e masave për të penguar arsimin në gjuhën shqipe në shkolla. Në zhvillimin e këtij qëndrimi ka luajtur rol fakti se brezat e rinj, që do të rriteshin me arsimin shqip, do të shkëputeshin nga ideali osman. Për më tepër, presionet për ndalimin e botimeve në gjuhën shqipe kishin për qëllim parandalimin e përhapjes së ideve nacionaliste dhe separatiste ndër shqiptarë kundër sundimit osman.⁵⁷

Të njëjtin qëndrim mbante edhe shteti grek përmes Patrikanës ortodokse. Forcimi i lidhjeve midis “identitetit ortodoks” dhe “identitetit grek” në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, nën autoritetin shpirtëror të Patrikanës së Stambollit, do t’i shtynte disa veprimtarë të shqiptarizmit të ndërtonin një “ortodoksi shqiptare” në të njëjtën mënyrë siç ishte krijuar “ortodoksia bullgare” me formimin e Ekzarkatit. Nuk bëhet fjalë për të denoncuar ndarjet fetare, as fetë si të tilla, por për të luftuar kundër përdorimit politik që i bënte fesë Patrikana. Krahas përpjekjeve të tyre për të konceptuar një komb shumëbesimësh, veprimtarët ortodoksë, kundërshtarë të helenizmit, përpiqeshin të provonin se helenizmi ishte i papajtueshëm me shqiptarizmin.⁵⁸ Në këto përpjekje ishte arritur edhe njëfarë bashkëpunimi shqiptar me vllëhtë përreth Manastirit dhe Korçës, që çoi në grindje me shqiptarët e helenizuar atje.⁵⁹

Për zhvillimin e arsimit dhe të shkollës shqipe në Maqedoni, ndihmesë të madhe kanë dhënë klerikët shqiptarë të besimit katolik. Në vitin 1656, kryepeshkopi i kishës katolike, Andrea Bogdani, i cili kishte

⁵⁶ Mustafa Gençoğlu, “Osmanlı Devleti’nini Şkodra Vilayeti’ndeki Eğitim Politikası (1876-1908)”, *Yeni Türkiye* 69 (2015): 4922.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Clayer, *Në origjinë të nacionalizmit*, 445-446.

⁵⁹ Hugh Poulton, *Who are the Macedonians?*, Second Edition (Bloomington and Indianapolis: Indiana University Press, 2000), 65.

kryer kolegjin ilirik në Loreto, zhvilloi veprimtari të madhe në lëmin e arsimit dhe të gjuhës.⁶⁰ Në vijim të punës për mësimin e shqipes, në fillim të shek. XIX, Matei Krasniqi hapi në Shkup një shkollë, ku së pari u shpjegonte nxënësve në gjuhën shqipe e pastaj në gjuhën latine. Arsytimi i këtij mësuesi të fesë ishte se nxënësit që ndiqnin shkollën, nuk e kuptonin gjuhën latine dhe se fillimisht u duhej shpjeguar në gjuhën amtare e pastaj edhe në atë gjuhë. Në këtë shkollë, në vitin 1835, si mësues murgu uniat erdhi Pavle Horvat. Në vitin 1840 u hapën shkolla fetare edhe në Rekën e Epërme, ku mësohej edhe shqip. Qendra kryesore fetare dhe arsimore e rajonit ishte manastiri i Shën Johan Bigorit afër Dibrës, ku ishte hapur një shkollë kishtare në gjuhën amtare për nxënësit shqiptarë.⁶¹

Në Rekën e Epërme me ndërtimin e kishave me vetë kontributin e fshatarëve e sidomos të qehajait Gjorgji Kokale, shqiptar nga Reka e Vogël, u krijua mundësia që të hapen pranë disa prej atyre kishave edhe shkolla të tipit “qelie” aty rreth viteve 1835-1840. Në vitin 1840, në Duf të Rekës së Epërme u hap një shkollë kishtare në gjuhën shqipe. Mësuesit e parë të saj kanë qenë: Kosta Llazareviq që punoi 15 vjet, deri më 1855. Shkolla punoi pa ndërprerje deri në vitin 1875, pastaj mbyllet për shkak të luftës ruso-turke dhe hapet në vitin 1879 me mësuesin vendës Ilija Trifunoviq. Në këtë shkollë mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, megjithëse tekstet mësimore kanë qenë të shtypura në serbisht. Ilija Trifunoviq punoi 4 vjet në atë shkollë deri në vitin 1889. Në vitet 1890-1893 ka punuar një mësues tjetër dufas, Ksenofon Stefanoviq.⁶²

Me zbatimin gradual të reformave në Perandorinë Osmane, shkollat ishin shndërruar në laike. Në shkollën e Dufit në këtë kohë dha mësim Nikolla Kastratoviq nga Berana e Malit të Zi. Në vitin 1899, në Duf hapet edhe një shkollë tjetër, pra kemi dy shkolla me nga 40 nxënës secila, për dy lagje, Jerçevish dhe Brazdavec.⁶³ Shkolla shqipe ka pasur edhe në

⁶⁰ Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e ish- Jugosllavisë së sotme* (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, 1970), 59.

⁶¹ Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit, shkollës dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni* (Tetovë: BKSH, 1997), 61; Mustafa, “Përpyjekjet e shqiptarëve në Maqedoni për arsim”.

⁶² Abazi, *Zhvillimi i arsimit*, 62-63.

⁶³ *Po aty*, 64-65.

Vërben e Krakonicë të Rekës së Epërme, ku ka dhënë mësim Kristo Gjinovski.⁶⁴

Hapja e shkollës së parë laike shqipe të Korçës përfaqësonte një hap themelor në zhvillimin e arsimit shqip. Rëndësia e saj qëndronte në faktin se ishte institucioni i parë brenda Perandorisë Osmane, ku mësohej lirisht gjuha shqipe së bashku me lëndë të tjera si: aritmetika, historia dhe gjeografia.⁶⁵ Pavarësisht nga pengesat që u krijuan, shqiptarët ishin të vendosur për të ecur përpara. Dy javë më vonë u çel shkolla shqipe në Pogradec, pastaj me radhë në Ohër, Rekë etj. Më 1895 në Ohër, një shkollë shqipe u hap nga Hamdi Bej Ohri. Pas një kohe të shkurtër, këtë pishtar të arsimit shqip osmanët e burgosën në burgun e Manastirit. Por ai nuk qëndroi rehat as në burg, pasi të burgosurve shqiptarë ua mësonte shkrim-leximin shqip. Pas daljes nga burgu, ai bashkë me të shoqen Zejnepe Qokun, më 1899, hapën në shtëpinë e tyre, në Ohër, shkollën për djem dhe për vajza. Në vitin 1903, autoritetet osmane e burgosën përsëri dhe, me akuzën se “merret me punë të ndyta”, e dërguan për vuajtjen e dënimit në Diarbakir të Anadollit. Një shkollë shqipe u hap nga Said Najdeni (Hoxhë Voka) në vitin 1888 në Dibër. Kur e diktuan organet e pushtetit, e mbyllën shkollën, por ajo u rihap më 1893, pastaj u mbyll përsëri, por u hap në vitin 1900. Kjo shkollë punonte me abetare të shkruara në gegërisht nga vetë mësuesi. Me sa duket, shkolla e Vërbenit nuk vazhdoi gjatë. Shkolla ishte mbyllur, pasi në vitin 1899, emigrantë rekas që punonin në Rumani e kishin bindur priftin Olimbia Savo që të hapte një shkollë në kishën e Vërbenit, ku do të mësoheshin shkronjat shqipe.⁶⁶

Shtetet që ishin të interesuara që të pengojë shkollimi shqip gjetën gjuhën e bashkëpunimit në mes tyre. Qeveria xhonturke iu kundërvu politikës austro-hungareze në Ballkan dhe zbatoi politikën e afrimit dhe të bashkëpunimit⁶⁷ me Serbinë e Bullgarinë, sidomos me të parën, duke i

⁶⁴ *Po aty*, 63.

⁶⁵ Denisa Kostovicova, *Kosovo: The Politics of identity and space* (London & New York: Routledge, 2005), 33.

⁶⁶ Qerim Lita, “Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shkombëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX”, në, *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës* (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi (Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014), 294.

⁶⁷ *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914*, књига III, Свеска 5/1 (1/14 Април - 31 Август / 13 Септембар 1909) Приредио Михаило Војводић, САНУ, Одељење историјских наука (Београд: 2014), док. 232 (496).

bërë asaj koncesione të ndryshme. Porta e Lartë i toleroi veprimtaritë nacionaliste të serbëve në territorin e vet. Sipas njoftimeve të konsullit austro-hungarez në Manastir “serbët po zhvillonin prej kohësh një veprimtari aktive dhe të suksesshme në Manastir”.⁶⁸ Një raport tjetër nga konsulli serb në Manastir vinte në dukje se “përfaqësuesi i xhonturqve ishte i kënaqur me sjelljen e serbëve dhe të klubeve të tyre në vilajetin e Manastirit”.⁶⁹

Për të siguruar objektivat e saj, Lëvizja Kombëtare Shqiptare kombinoi veprimtarinë legale me atë ilegale. Një brez i tërë me ndikim të madh: intelektualë, publicistë, mësues e punonjës të shtetit, në nëntor të vitit 1905 themeluan Komitetin sekret “Për lirinë e Shqipërisë”,⁷⁰ i cili u ndikua nga veprimtaria e komiteteve të tilla që krijuan grekët dhe bullgarët në të njëjtin territor.⁷¹ Themelimi i Komitetit shënoi fillimin e një organizimi më të gjerë kombëtar. Komiteti hartoi një program të strukturuar mirë: sipas statutit, qëllimi i organizatës ishte “ringjallja e shtetit shqiptar, vëllazërimi, dashuria, bashkimi dhe hapja e një rruge

Послаништво Краљевине Србије Бугарској - Софија, Министру иностраних дела Краљевине Србије др Миловану Ђ. Миловановићу - Београд (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, knjiga III, Sveska 5/1 1/14 April - 31 Avgust / 13 Septembar 1909 Priredio Mihailo Vojvodić, SANU, Odeljenje istorijskih nauka (Beograd: 2014), dok. 232 (496). Poslaništvo Kraljevine Srbije Bugarskoj - Sofija, Ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Serbisë, Dr. Millovan Đ. Milovanović - Beograd.

⁶⁸ Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A.PA.A.) në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH), Vj. 20-13-1306. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfaj dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Aehrenthal, Manastir, 1 shkurt 1910.

⁶⁹ *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914*, књига IV, Свеска 1/1 (1/14 јануар-30. април / 13 мај 1910. Године), Приредили Љиљана Алексић-Пејковић, Климент Џамбазовски, САНУ, Одељење историјских наука (Београд: 2012), док. 106 (337). Конзулат одељењу Министарства иностраних дела Краљевине Србије - Београд. Конзулат Краљевине Србије-Приштини (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, knjiga IV, Sveska 1/1 1/14 januar - 30. april / 13 maj 1910. godine, Priredili Ljiljana Aleksić-Pejković, Kliment Džambazovski, SANU, Odeljenje istorijskih nauka (Beograd: 2012), dok. 106 (337). Konsullata e Mbretërisë Serbe për Departamentin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Serbisë në Beograd, Prishtinë.

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Po aty.

qytetërimi nëpërmjet librit dhe edukimit”.⁷² Edhe pse zakonisht injorohet nga pretendentët kryesorë, ata përfundimisht u bashkuan me anarkinë endemike të Maqedonisë, duke kundërshtuar militantisht si autoritetet lokale osmane, ashtu edhe bandat e armatosura të protagonistëve nacionalistë.⁷³ Në lidhje me veprimtarinë arsimore ilegale, Senkeviç shkruante se “shqiptarët nuk do të kenë rrethana të tjera përpos organizimin e fshehtë të elitës politike të kohës, për të luftuar politikat e qeverisë së re të xhonturqve”.⁷⁴

Veprimtaria kryesore arsimore u zhvillua në Manastir, i cili ishte qendër për shpërndarjen e librave shqip nga misionarët protestantë⁷⁵ dhe si i tillë, në vitin 1885, u bë qyteti ku u hap shkolla e parë private në gjuhën shqipe.⁷⁶ Roli qendror i Manastirit në zhvillimet arsimore dhe pozicioni i tij në një trevë ku përplaseshin synimet shoviniste të fqinjëve, bëri që aty të mbahet Kongresi për unifikimin e alfabetit dhe të kthehet në qendër të lëvizjes arsimore kombëtare të shqiptarëve. Përhapja e shkollës shqipe në territorin e Maqedonisë mori hov të madh pas Kongresit të gjuhës shqipe në Manastir më 1908, ku dita-ditës interesi për shkollimin shqip po shtoej. Kështu, disa klube filluan të hapnin shkolla në gjuhën amtare si: në Dibër, Rekë, Shkup, Manastir, Kërçovë, Tetovë, Gostivar, Kumanovë e gjetiu. Vlen të përmendim se veprimtarë për shkolla shqipe, të shquar në këto qytete ishin: në Kërçovë: Jusuf Turabi – Kërçova, Rexhep Fasku – Greshnica, Ali Drogomishti; në Strugë shquhen Dervish Hima e Ibrahim Temo; në Dibër: Kadri Fishta e Said Najdeni; në Gostivar: hoxha Afiz Lila; në Patishka Rekë: hoxha i fshatit; në Shkup: Rrok Berisha, Bedri Pejani; në Rekë: prifti Todor e Josif Bageri; në

⁷² Esmeralda Hoti Dani, *Le istituzioni educative in Albania dal 1878 al 1913*, Dissertazione (Università degli Studi di Macerata, Dipartimento di Scienze dell'educazione e della formazione dei beni culturali e del turismo, 2014), 105.

⁷³ Hupchick, *The Balkans from Constantinople*, 306.

⁷⁴ I. G. Senkevič, “Osvoboditelno revolucija 1908 goda i albansko nacionalni diviženie”, në *Sovetskoe*, no.1 (Moskva: 1958), 159.

⁷⁵ Xhevat Lloshi, David Hosaflook, “Te fillimet e shkollimit shqip për shqiptarët në Maqedoni dhe në Kosovë”, konferencë shkencore me temë: *75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore*, 20 nëntor 2016, 5. https://www.academia.edu/36855310/Te_fillimet_e_shkollimit_shqip_p%C3%ABr_shqiptar%C3%ABt_n%C3%AB_Maqedoni_dhe_n%C3%AB_Kosov%C3%AB (shikuar më 20.05. 2024).

⁷⁶ Sevçani Ibrahim, “Arsimi shqip në rajonin e Pelagonisë”, *Zëri i Pelagonisë*, nr. 3-4 (Shkup: 2010), 79; Abazi, *Zhvillimi i arsimit*, 124.

Kumanovë: Jashar Erbara e Anastas Albanski e shumë të tjerë.⁷⁷ Edhe përkundër pengesave të mëdha që hasi Josif Bageri për shkollën shqipe të Nistrovës nga kisha serbe me despot Varnavën në krye, si dhe nga bashkëpunëtorët e regjimit xhonturk, ai përsëri u mundua që ajo shkollë të funksiononte.⁷⁸

Kundër arsimit shqip u angazhua me të gjitha forcat Patrikana e Stambollit. Ajo i kundërvihet gjuhës dhe arsimit shqip për ortodoksët, sepse kjo do të thoshte humbje e ndikimit të saj, që do të çonte deri në krijimin e kishës shqiptare të pavarur. Patrikana punoi me këmbëngulje për hapjen e shkollave greke deri në fshatrat më të largëta, duke ia kaluar edhe shtetit grek.⁷⁹

Një nga lëshimet e Portës së Lartë ishte dhënia e lejes për botimin e një organi periodik. Këtë leje nuk ua dha shqiptarëve myslimanë, të cilët i konsideronte turq, por shqiptarëve ortodoksë, me qëllim që te këta të fundit të mos ndikonte propaganda greke. Leja u lëshua në emrin e Petro Pogës (nga Erindi i Gjirokastrës), njërit prej anëtarëve të kryesisë së Shoqërisë së shqiptarëve të Stambollit.⁸⁰ Në një raport të vitit 1909 për të krishterët shqiptarë, u sugjerua që t'u hapej rruga për kryerjen e ritualeve në gjuhën e tyre, në përputhje me lirinë e sekteve të parashikuara nga Kanun-i Esasi. Kështu, të krishterët shqiptarë mund të shpëtonin nga indoktrinimi grek. Kjo do të krijonte një “disfatë të përjetshme” në ambiciet e Greqisë për Shqipërinë e Jugut.

Në trevat shqiptare të Maqedonisë dhe në qendrat kryesore: Manastir, Shkup, Ohër, Dibër, Tetovë etj., u zhvilluan disa nga veprimtaritë më të rëndësishme në favor të përhapjes së arsimit shqip. Rilindësit shqiptarë preferuan t'i zhvillonin betejat kryesore për arsimin shqip në zonat kufitare me popujt e tjerë, për të pohuar edhe vendosmërinë e tyre për t'i mbrojtur ato territore.

⁷⁷ Mustafa, “Përpyjekjet e shqiptarëve në Maqedoni për arsim”.

⁷⁸ Rezehana Hysa, “Veprimtaria kulturore-arsimore e Shoqërisë “Dëshira” të Sofjes dhe influenca e Josif Bajger-it në përhapjen e arsimit dhe shkollave shqipe në Rekë të Epërme”, *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës*, (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi (Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014), 323.

⁷⁹ Clayer, *Në origjinë të nacionalizmit*, 130.

⁸⁰ Viola Dolani, Belinda Mero, “Hulumtim mbi kontributin e atdhetarëve të Rilindjes në shkollën shqipe”, në *130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe – vatër e arsimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare*, konferencë shkencore mbarë-shqiptare, Korçë, 6 mars 2017 (përmbledhje materiale), (Vlorë: Triptik, 2017), 225.

Shkrimi shqip u përhap me shpejtësi në Dibër, në Strugë e në Ohër, ku përveç klubeve vendëse ndihmoi edhe ai i Manastirit.⁸¹ Kontributi i madh i Anastasit i referohet përfshirjes së nxënësve në klasat e mbrëmjes, të cilat sipas J. Erebarës numëronin 130 nxënës shqiptarë.⁸² Josif Bajgeri kishte kaluar nëpër të gjitha fshatrat e Rekës së Epërme, duke propaganduar për mësimin e gjuhës shqipe dhe kishte çelur shkollën në vendlindje, Nistrovë.⁸³

Sukseset e arritura nga zhvillimi i arsimit kombëtar në Shqipëri i shqetësoi së tepërmi turqit e rinj, të cilët përdorën kundër arsimit shqip çdo mjet, që nga shfrytëzimi i ndjenjave fetare dhe intrigat e deri te dhuna e drejtpërdrejtë që u ushtrua në të gjitha qendrat e arsimit shqip. Në maj të vitit 1909 u arrestuan 17 veta nga Struga, Pogradeci dhe Ohri, të akuzuar si agjentë të Sulltan Hamid-it. Midis të arrestuarve nga Ohri ishin: Hamdi Bej Ohri, Xheladin Beu, kryetar i klubit dhe Mehmet Beu. Në vitin 1910 masat xhonturke u ashpërsuan; në Shkup u arrestua kryetari i klubit të atjeshëm Beqir Efendiu dhe mësuesi i gjuhës shqipe Bedri Pejani; në Manastir u arrestuan Fehim Zavalani dhe vëllezërit Kristo e Dhimitër Qirjazi etj.⁸⁴

Vetëm pas kryengritjes së madhe shqiptare të vitit 1912, u arrit marrëveshja midis shqiptarëve dhe qeverisë xhonturke, ku u lejua shkollimi shqip. Me këtë rast u rihapën për pak kohë shkollat shqipe në Maqedoni, të cilat u mbyllën sapo shpërthyen Luftërat Ballkanike.

⁸¹ HHStA PA XXXVIII. Kt. 404 f. 132r-133v, Prochaska - Ahrenthalit, Raporti Nr. 63, Prizren 7 shtator 1909, citim sipas: *Politik und Gesellschaft im Vilayet Kosovo und im serbisch Beherrschten 1870-1914, Berichte der österreichischen Konsuln aus dem zentralen Ballkan (1870-1914)* Verlag der österreichischen akademie der Wissenschaften (Wein: 2020), 46.

⁸² Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996), 56; Avzi Mustafa, "Anastas Albanski (Arnaudov) mësuesi nga Reka e Epërme", në *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës*, (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi (Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014), 72; Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit*, 193.

⁸³ Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar*, 56.

⁸⁴ *Po aty*, 293.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Haus und Hof Staats Archiv Wien, Politisches Archiv, Albanien (HHtA, PA, Alb). Koleksioni i dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (HHStA.PA.A)

Botime dokumentare:

Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914, књига IV, Свеска 1/1 1/14 јануар- 30. април / 13 мај 1910. Године. Приредили Љиљана Алексић-Пејковић, Климент Џамбазовски, САНУ, Одељење историјских наука. Београд: 2012. (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, knjiga IV, Sveska 1/1 1/14 januar- 30. april / 13 maj 1910. Godine. Priredili Ljiljana Aleksić-Pejković, Kliment Džambazovski, SANU, Odeljenje istorijskih nauka. Beograd: 2012).

Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914, књига III Свеска 5/1 1/14 Април - 31 Август / 13 Септембар 1909 Приредио Михаило Војводић, САНУ, Одељење историјских наука, Београд: 2014 (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, knjiga III Sveska 5/1 1/14 April - 31 Avgust / 13 Septembar 1909. Priredio Mihailo Vojvodić, SANU, Odeljenje istorijskih nauka. Beograd: 2014).

Politik und Gesellschaft im Vilayet Kosovo und im serbisch Beherrschten 1870-1914, Berchte der östrreichischen Konsuln aus dem zentralen Ballkan (1870-1914). Verlag der österreichischen akademie der Wissenschaften. Wein: 2020.

Literaturë historiografike:

Abazi, Nexhat. *Zhvillimi i arsimit, shkollës dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni*. Tetovë: BKSJ, 1997.

Amfiteatrov, Aleksandar. *Strana razdora*. St. Petersburg: I.V. Rayskoy, 1903.

Anastasovski, Nick. *Contestation over Macedonian Identity, 1870-1912*. Thesis. Victoria University: 2005.

Arpalier, Seçkin & Ireida Hamzaj. "Analysing from a systematic perspective the Albanian nationalism in the Ottoman Empire". Në *Acta Humana*, 1 (2020): 97-110.

Clayer, Nathalie. *Në origjinë të nacionalizmit shqiptar, lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*. Tiranë: Përpjekja, 2012.

- Dakin, Douglas. *The Greek Struggle in Macedonia, 1897-1913*. Thessaloniki: Museum of the Macedonian Struggle, 1993.
- Doja, Albert. "Ecclesiastical Pressures and Language Politics: The Boundary Work of Albanian Language in the 17th-18th Centuries, Ecclesiastical Pressures and Language Politics". Në *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 50 (4) (2022), 759. (10.1017/nps.2021.55). (halshs-03648536).
- Dolani, Viola & Belinda Mero. "Hulumtim mbi kontributin e atdhetarëve të Rilindjes në shkollën shqipe". Në *130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe – vatër e arsimimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare*, Konferencë shkencore mbarëshqiptare, Korçë, 6 mars 2017 (përmbledhje materialesh). Vlorë: Triptik, 2017.
- Fotić, Aleksandar. "Serbian Orthodox Church". Në *Encyclopedia of the Ottoman Empire*. New York: Infobase Publishing, 2008: 519-520.
- Gellner, Ernest. *Nationalism*. London: Weidenfeld & Nicolson, 1997.
- Gençoğlu, Mustafa. "Osmanlı Devleti'nin Şkodra Vilayeti'ndeki Eğitim Politikası (1876-1908)". *Yeni Türkiye* 69, 2015: 4922.
- Glenn, H. Patrick. *Legal Traditions of the World*. Oxford University Press: 2007.
- Glenny, Misha. *The Balkans: Nationalism, War and the Great Powers 1804-1999*. London: Penguin Putnam Inc., 2000.
- Heraclides, Alexis. *The Macedonian Question and the Macedonians: A history*. Routledge: 2021.
- Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike, 2003.
- Hobsbawm, Eric J. *Nations and Nationalism since 1870, Programme, myth, reality*, Second Edition. Cambridge University Press: 1990.
- Hoti Dani, Esmeralda. *Le istituzioni educative in Albania dal 1878 al 1913*. Dissertazione. Università degli Studi di Macerata, Dipartimento di Scienze dell'educazione e della formazione dei beni culturali e del turismo, 2014.
- Hupchick, Dennis P. *The Balkans: From Constantinople to Communism*. New York: Palgrave Macmillan 2002.
- Hysa, Rezehana. "Veprimtaria kulturore-arsimore e Shoqërisë "Dëshira" të Sofjes dhe influenca e Josiv Bajzerit në përhapjen e arsimit dhe shkollave shqipe në Rekë të Epërme". Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës*, (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi. Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014: 313-330.
- Jelavich, Barbara. *History of the Balkans, Eighteenth and Nineteenth Centuries*, vol. I. Cambridge University Press: 1983.

- Kitromilides, Paschalis M. "‘Imagined Communities’ and the Origins of the National Question in the Balkans". *European History Quarterly*, 19 (1989): 149-192.
- Kostovicova, Denisa. *Kosovo: The Politics of identity and space*. London & New York: Routledge, 2005.
- Lita, Qerim. "Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shkombëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX". Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës*, (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi. Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014: 292-300.
- Marinov, Tchavdar. "Famous Macedonia, the Land of Alexander: Macedonian Identity at the Crossroads of Greek, Bulgarian and Serbian Nationalism". Në *Entangled Histories of the Balkans*, Volume One: National Ideologies and Language Policies. Edited by Roumen Daskalov and Tchavdar Marinov. Brill: 2013.
- Methodieva, Milena B. *Between Empire and Nation Muslim Reform in the Balkans*. Stanford California: Stanford University Press, 2021.
- Mustafa, Avzi. "Anastas Albanski (Arnaudov) mësuari nga Reka e Epërme". Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës*, (red.) Ali Pajaziti, Nasir Selimi, Rasim Zuferi. Gostivar-Shkup: Universiteti i Europës Juglindore, 2014.
- Myzyri, Hysni. *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996.
- Özcan, Tuğrul. "Abdulhamid Doneminde Gayrimuslim okullarının idari isleyisine dair birdegerlendirme". Në *Uluslararası multidisipliner çalışmaları sempozyumu*. Roma, Italya: 18-21 Mayıs 2017.
- Palairot, Michael. *Macedonia: A Voyage through History*, vol. 2 (From the Fifteenth Century to the Present). Cambridge Scholars Publishing: 2015.
- Poulton, Hugh. *Who are the Macedonians?*, Second Edition. Bloomington and Indianapolis: Indiana University Press, 2000.
- Puto, Artan. *The idea of Nation during the Albanian National Movement (1878-1912)*. Thesis. Florence: European University Institute, Department of History and Civilization, 2012.
- Rexhepagiq, Jashar. *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e ish-Jugosllavisë së sotme*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, 1970.
- Rossos, Andrew. *Macedonia and Macedonians*. California, Standfort: Hoover Institution Press, 2008.
- Roudometof, Victor. *Collective Memory, National Identity, and Ethnic Conflict, Greece, Bulgaria, and the Macedonian Question*. Praeger Publishers: 2002.

- Senkevič, I. G. "Osvoboditelno revolucija 1908 goda i albansko nacionalni diviženie". Në *Sovetskoe*, no.1. Moskva: 1958.
- Sevgani, Ibrahim. "Arsimi shqip në rajonin e Pelagonisë". Në *Zëri i Pelagonisë*, nr. 3-4, Shkup: 2010:78-87.
- Shea, John. *Macedonia and Greece: the struggle to define a new Balkan nation*. Jefferson, North Carolina and London: McFarland, 1997.
- Stavrianos, Leften Stavros. "Antecedents to the Balkan Revolutions of the Nineteenth Century", *Journal of Modern History*, vol. 29, no. 4 (Dec., 1957).
- Yücedağ, İsmail & Nurgün Koç. "Kërkesat e shqiptarëve për shkollimin në gjuhën amtare". Në *Dituria islame* 354 (maj 2020): 35-38.
- Урош Шешум, "Српске школе и учитељи у Старој Србији и Македонији у Великој источној кризи", Историјски Архив Шумадије, Крагујевац, Јован Ристић државник и дипломата -Берлински Конгрес, Зборник Радова са научног Скупа, Одржаног 28. новембра 2018. године у Крагујевцу Уредник Предраг Илић, архивски саветник Крагујевац, 2020 - (Uroš Šešum, "Srpske škole i učitelji u Staroj Srbiji i Makedoniji u Velikoj istočnoj krizi", Istorijски Arhiv Šumadije, Kragujevac, Jovan Ristić državnik i diplomata -Berlinski Kongres, Zbornik Radova sa naučnog Skupa, Održanog 28. novembra 2018. godine u Kragujevcu, Urednik Predrag Ilić, arhivski savetnik Kragujevac: 2020.

Botime elektronike, Website:

- Karpat, Kemal H. "The Balkan National States and Nationalism": Image and reality. *Islamic Studies*, vol. 36, no. 2/3, Special Issue: Islam in the Balkans (Summer/Autumn 1997), 343, published by: Islamic Research Institute, International Islamic University, Islamabad Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/23076200> (shikuar më 18.06.2014).
- Lloshi, Xhevat & David Hosaflook, "Te fillimet e shkollimit shqip për shqiptarët në Maqedoni dhe në Kosovë". Konferencë shkencore me temë: 75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, 20 nëntor 2016, 5. https://www.academia.edu/36855310/Te_fillimet_e_shkollimit_shqip_p%C3%ABr_shqiptar%C3%ABt_n%C3%AB_Maqedoni_dhe_n%C3%AB_Kosov%C3%AB (shikuar më 20.05. 2024).
- Mustafa, Avzi. "Përpyekjet e shqiptarëve në Maqedoni për arsim kombëtar në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX",

<https://merbraha.com/perpjekjet-e-shqiptareve-ne-maqedoni-per-arsim-kombetar-ne-fund-te-shekullit-xix-dhe-ne-fillim-te-shekullit-xx/> (shikuar më 23.09.2020).

Ozturk, Fatih. "The Ottoman Millet System", 7,

<https://dergipark.org.tr/en/download/article-file/12937> (shikuar më 18.06.2014).

NIKOLLË LOKA

University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

nikolloka@yahoo.com

S u m m a r y

COMPETING NATIONALIST MOVEMENTS AND EFFORTS TO OPEN ALBANIAN SCHOOLS IN MACEDONIA

Since the society continued to be divided based on the system of millets, competing nationalist movements developed within each millet, which for Macedonia belongs within the Muslim millet between the Albanians and the Ottoman state, as well as within the orthodox system of millets from Greeks, Bulgarians, Serbs, but also Albanians and Vlachs. The division of the orthodox millet into smaller millets caused the competing nationalist movement for the school to develop on Macedonian Christians, who had low national consciousness and still considered religion as the first source of self-identification. At first glance, with a religious and educational character, these movements aimed at clear political goals, to possess as much territory as possible, the population of which would be declared in favor of one or the other orthodox millet. In this clash scene was involved and the Albanian nationalist movement.

The decision to make the Monastery the national center of the movement for Albanian education should be seen in the context of the clash of Albanian nationalism with other nationalisms and efforts to assert the claims of Albanians on their ethnic lands in Macedonia. Albanian teachers were working to increase the national consciousness of the compatriots of those countries, who were threatened three times: by the Bulgarians, the Serbs and the Greeks. The nationalist movements and clash between Balkan nationalisms in the field of education was fierce in Macedonia and preceded other forms of conflict that culminated in the Balkan Wars of 1913.

ROMEO GURAKUQI

Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

romeo_gurakuqi@hotmail.com; romeo.gurakuqi@asa.edu.al

<https://doi.org/10.61773/bdv28z09>

**ROLI I SHBA-SË NË RINJOHJEN E SHTETIT SHQIPTAR PAS
LUFTËS SË PARË BOTËRORE****Abstrakt:**

Artikulli trajton historinë e qëndrimit të diplomacisë së SHBA-së, në periudhën e fundit të Luftës së Parë Botërore dhe në katër vjetët që pasuan Shqipërinë, çështjen kombëtare shqiptare, statusin shtetëror, kufijtë dhe çështjet që lidhen me shtetformimin e brendshëm, si kusht paraprak për të hyrë në marrëdhënie ndërshtetërore. Kjo periudhë kohore e viteve 1918 (dhjetor) – 1922 (korrik), që përkon me ripërcaktimin e statusit shtetëror, kufijve (9 nëntor 1921) dhe përmbylljes së njohjeve ndërkombëtare më 28 korrik 1922, përkufizohet si koha e pavarësisë dhe e shtetformimit të dytë të Shqipërisë në epokën moderne. Autori ndjek historinë e ndryshimit të qëndrimit amerikan ndaj të drejtave të popullit shqiptar nën veprimin e disa faktorëve, nivelin e implementimit të parimeve racionaliste dhe realiste të Diplomacisë së re të promovuar nga Presidenti Wilson në mjedisin ende intrigues të Konferencës së lartpërmendur, lobimin e faktorëve të jashtëm proshqiptarë, të mërgatës elitare shqiptare në SHBA dhe në Europë, ndërhyrjet e Selisë së Shenjtë në mbrojtje të të drejtave të popullit shqiptar etj. Ndajja e kursit të vjetër diplomatik, ndjekur nga Franca, Italia mbështetur indirekt nga indiferentizmi fillestar i Britanisë së Madhe, ndodhi falë qëndrimeve të prera dhe parimore të diplomacisë amerikane. Pikërisht këtë ndërhyrje, bazuar në dokumentacionin arkivor ka ndjekur autori. Pjesa e fundit e artikullit u kushtohet njohjes zyrtare dhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe SHBA-së.

Fjalë kyçe:

Statusi shtetëror, Shqipëria subjekt i së drejtës ndërkombëtare, Shqipëria pas Luftës së Parë Botërore, Konferenca e Paqes e Parisit, Lidhja e Kombeve dhe Shqipëria, Diplomacia e re e Presidentit Wilson, njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar.

Hyrje

Fundi i Luftës së Parë Botërore (LPB) dhe katër vitet pasuese shënojnë fillimin e procesit të rithemelimit të shtetit shqiptar në aspektin institucional brenda dhe në nivel ndërkombëtar. Kjo periudhë karakterizohet nga rinjohja e statusit shtetëror, përcaktimi i kufijve nga fuqitë fituese, anëtarësimi në Lidhjen e Kombeve dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtete të tjera. Përpjekjet e para për pavarësi dhe shtetformim, nga viti 1912 deri në vitin 1914 me Qeverinë e Vlorës dhe Principatën e Wilhelm von Wied-it, u rrënuan nga trazirat sociale, politike dhe fetare, gjegjësisht nga Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, Lëvizja vorio-epirote, përpjekjet uzurpatore të Essad Pashë Toptanit, si dhe nga pushtimet greke, italiane dhe serbo-malaziasë. Në periudhën e kontrollit austro-hungarez (1916-1918), shqiptarët përjetuan një periudhë relative qetësie dhe zhvillimi në fushën administrative, sociale, arsimore dhe kulturore. Hyrja e trupave austro-hungareze u mirëprit për shkak të ndihmës së tyre në heqjen e trupave serbe dhe malazeze nga territori nacional. Austro-Hungaria ofroi një autonomi të kufizuar, duke mbështetur shkollat shqipe dhe kulturën lokale. Pas përfundimit të luftës dhe shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze, shqiptarët u gjendën në një situatë të vështirë gjatë bisedimeve të paqes në Paris, duke u ndarë midis orientimeve proitaliane dhe proanglo-amerikane. Mungesa e konsensusit dëmtoi përpjekjet për rindërtimin e shtetit dhe krijoi hapësirë për ndërhyrjen e fqinjëve. Çështja shqiptare në harkun kohor 1919-1921 u trajtua në Konferencën e Paqes në Paris, në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve, fillimisht si pjesë e problemeve më të mëdha të diplomacisë ndërkombëtare, duke lënë shqiptarët në një pozicion të vështirë dhe pa zgjidhje të qëndrueshme për një periudhë të gjatë e më vonë, pas ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të qeverisë së SHBA-së, si një problem i veçantë i njohjes së shtetësisë, ndërtimit shtetëror dhe kufijve të njohur ndërkombëtarisht.

Pyetja jonë kërkimore është, cili ka qenë roli i SHBA-së në ndihmë të kësaj Shqipërie kaq të cenuar?

Që në fillim duhet të kujtojmë se, para hyrjes së SHBA-së në Luftën e Parë Botërore nuk mund të flitet për ndonjë politikë amerikane

ndaj Shqipërisë. Principata e Shqipërisë, e krijuar zyrtarisht më 1913 dhe e zhvilluar institucionalisht në vitin 1914, nuk ishte njohur asnjëherë nga SHBA-ja. Vetëm pas hyrjes së Amerikës në Luftën Botërore filloi të marrë formë një qëndrim amerikan ndaj problemit shqiptar. Kur në janar të vitit 1919 u përgatit raporti përfundimtar i Komisionit të Hetimit (një organizatë e krijuar nga Presidenti Wilson, pas shpalljes së luftës amerikane, për të studiuar dhe për të përgatitur, mbi parime shkencore, planet për një zgjidhje të qëndrueshme paqeje) ndodhën disa ndryshime pozicionesh në lidhje me Shqipërinë. Planet fillestare të ekspertëve amerikanë për zgjidhjen e problemit shqiptar ishin të ngjashme me zgjidhjen e përshkruar në Traktatin e Fshehtë të Londrës (1915).¹ Raporti që u përgatit për Shqipërinë sugjeronte që, ndërsa një Shqipëri autonome duhej të vazhdonte të ekzistonte, pjesë të Veriut të Shqipërisë duhej t'i jepeshin Jugosllavisë dhe në Shqipërinë Jugore, Gjirokastra dhe Korça duhej të aneksoheshin nga Greqia. Ndryshimi i raportit të Komisionit Amerikan të Hetimit me dispozitat e Traktatit të Londrës (1915) ishte vetëm në një klauzolë, sipas së cilës, Shqipëria e Veriut duhej t'i jepej Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (MSKS) si mandat nën Lidhjen e Kombeve, e cila mund të mbronte të drejtat e shqiptarëve. Ndërsa, në lidhje me krahinat jugore të Shqipërisë, ato do t'u jepeshin grekëve me sovranitet të plotë, me arsyetimin e pasaktë të prirjeve të forta prohelene të Shqipërisë së Jugut, sipas ekspertëve amerikanë. Për sa i përket shtetit të vogël të pavarur shqiptar, për shkak të papjekurisë politike të këtij vendi, ekspertët amerikanë e panë të nevojshme të jepnin një mandat nën mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve.²

Deri në përfundim të LPB-së, njohuritë e Presidentit Wilson në lidhje me çështjen shqiptare ishin të kufizuara. Qeveria e SHBA-së nuk kishte qenë firmëtare e Traktatit të Fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915 dhe Komisioni Amerikan i Bisedimeve të Paqes në Konferencën e Paqes, ruajti lirinë e veprimit në Çështjen e Adriatikut, duke u kujdesur më shumë në zbatimin e 14 Pikave të Presidentit Wilson për traktatin e paqes me Austrinë dhe Hungarinë.³ Ajo që përbën bazat e këtyre tezave të

¹ Robert Larry Woodall, *The Albanian Problem During the Peacemaking, 1919-1920* (Memphis State University: University Microfilms International, 1978), 48.

² David H. Miller, *My Diary at the Conference of Peace*, vol. IV (New York: 1928), 209-281.

³ Margaret MacMillan, *Paris 1919 - Six Months that Changed the World* (New York: Random House 2002), 495-496.

shpallura nga Presidenti Wilson ishte ndërtimi i një rendi të ri botëror bazuar mbi diplomacinë e hapur, lirinë e deteve, lirinë dhe mosdiskrimimin në tregti, kufizimin e garës së armatimit, vetëvendosjen dhe parimin e drejtësisë për të gjithë popujt dhe nacionalitetet. Diplomacia e vjetër, sipas Presidentit Wilson, ishte e bazuar mbi parimet e balancës së fuqisë, tashmë përgjithmonë e diskredituar. Diplomacia e vjetër zbatohet nëpërmjet diplomacisë egoiste dhe të fshehtë, e cila e kishte sjellë të gjithë Europën në luftë.⁴ Të bie në sy në këtë memorandum të Presidentit Wilson, se çështja shqiptare nuk kishte asnjë referim pozitiv, madje i vetmi referim që kishte të bënte me Shqipërinë ishte ai mbi premtimin për një dalje të lirë dhe të sigurt në det për Serbinë. Informacioni i parë që ai mori në lidhje me Shqipërinë ishte memorandum i datës 2 janar 1918, përgatitur nga Mezes, Miller dhe Lippman,⁵ në të cilin rekomandohej ndarja e Shqipërisë, pasi ky vend përfaqësonte një terren të intrigave të Fuqive të Mëdha. Nga ndarja e Shqipërisë, sipas memorandumit në fjalë, duhej të përfitonte Mali i Zi për rajonin e Shkodrës, Serbia të gjithë pjesën qendrore me Durrësin dhe Greqia do të përfitonte pjesë jugore të Shqipërisë me Vlorën në qendër.

Për shkak të këtij raporti të parë jo të thelluar dhe të pandjeshëm ndaj vendit ilirik, pozicioni fillestar i SHBA-së në Konferencën e Paqes në Paris ka qenë jo i favorshëm në lidhje me Shqipërinë. Bazuar mbi këtë konstrukt të parë dijeshe dhe pozicionimi diplomatik, më 14 prill 1919, Presidenti Wilson do t'i dorëzonte Kryeministrit italian Orlando një memorandum rreth çështjes së kërkesave italiane në Adriatik. Rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kësaj mosnjohjeje është edhe referenca e përdorur në memorandumin e mësipërm ndaj problemit shqiptar. Ka vetëm një ide të ndryshuar nga plani i parë, që lidhet me dhënien e portit të Vlorës Italisë, por e mjaftë për ta rilidhur tanimë të gjithë çështjen shqiptare tërësisht me problemin e Adriatikut. Në memorandumin amerikan fjalja është formuluar kështu:

⁴ Ruth Henig, "New Diplomacy and Old: a Reassessment of British Conceptions of a League of Nations, 1918-1920", në *The Paris Peace Conference, 1919 – Peace without Victory?*, edited by Michael Dockrill and John Fisher, Palgrave in association with the Public Record Office (New York: 2001), 159.

⁵ Lawrence E. Gelfand, *The Inquiry, American preparations for peace 1917-1919* (New Heaven: Yale University Press, 1963), 109, 145, 220-221.

“Unë besoj se do të jetë një marrëveshje e përgjithshme që Ishulli Lissa duhet t’i lëshohet Italisë dhe se ajo duhet të mbajë edhe portin e Vlorës”.⁶

Pas memorandumit të Presidentit Wilson drejtuar Orlando-s, pozitat e Italisë në veri të Adriatikut u vështirësuan dhe në këto rrethana në mbrëmjen e datës 19 prill 1919, delegacioni italian vendosi të kërkonte zbatimin e Traktatit të Fshtë të Londrës.⁷ Një kërkesë e tillë do të thoshte një rikthim i pretendimeve të vjetra të Italisë ndaj “Shqipërisë së Vogël Qendrore” dhe integriteti mbi Vlorën, duke e “qethur” shtetin nga prezenca e shqiptarëve të krishterë. Pra, në kushtet e mosplotësimit të kërkesave italiane për Fiumen, Italia kërkonte të gjitha të drejtat që Antanta i kishte garantuar Italisë, gjë që për Shqipërinë nënkuptonte sovranitet italian mbi Vlorën si dhe protektoratin mbi shtetin qendror mysliman shqiptar: Shqipëria dilte kështu e përgjysmuar edhe më tej.

Nuk vonoi shumë dhe kundërpërgjigjja amerikane erdhi: më 23 prill 1919 kemi Manifeston e famshme të Presidentit Wilson në lidhje me rivendikimet e Italisë.⁸ Në këtë shpallje të mirënjohur, referenca e përgjithshme ndaj zotërimit italian të Vlorës nuk është e cilësuar, por është një referencë e nënkuptuar që linte në fuqi pak a shumë deklaratimet e 10 ditëve më parë. Pas komunikimit të këtij memorandum, delegatët italianë, të zemëruar deklaruan se do të largoheshin nga konferenca, ndërsa delegacioni shqiptar protestoi për faktin se, në vend që të merreshin në konsideratë pretendimet e delegacionit shqiptar, mendohej t’i jepej një pjesë e territorit shqiptar për të kënaqur pretendimet e pangopura të shteteve kufitare, për të rregulluar një konflikt në të cilin Shqipëria nuk kishte të bënte.⁹ Mosdakordësia e gjithanshme detyroi diplomacinë amerikane të paraqiste një ofertë të re. Më 8 maj 1919, shefi

⁶ René Albrecht-Carrié, *Italy at the Paris Peace Conference*, Published for the Carnegie Endowment for International Peace in the Series The Paris Peace Conference-History and Documents, Columbia University Press (New York: Morningside Heights, 1938), Doc. 36, 445-447. Memorandumi i Wilson-it për Orlando-n lidhur me çështjen e pretendimeve italiane në Adriatik, 14 prill 1919. Memorandumi është i përbërë nga këto pjesë: Hyrja, Shtetet e pavarura, Gadishulli Istriani, Portet e Shtetit të Ri.

⁷ Pietro Pastorelli, *L’Albania nella politica estera italiana 1914-1920* (Napoli: Editore Jovene, 1970), 102.

⁸ Albrecht-Carrié, *Italy at the Paris Peace Conference*, 498-500. Document 42 Wilson Manifesto, April 23.

⁹ Amedeo Giannini, *L’Albania dall’indipendenza all’unione con l’Italia (1913-1939)* (Varese: Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, 1940), 74-76.

i Sektorit të Gjeografisë Kufitare i delegacionit amerikan, profesor Johnson-i, u paraqiti komisionerëve një memorandum të ri me një formulë të re për zgjidhjen e Çështjes së Adriatikut. Formula e sugjeruar për zgjidhjen e kësaj çështjeje, bazuar tanimë në rekomandimet e Presidentit Wilson, për Shqipërinë përmbante sa më poshtë vijon: *Pika 9.* Italia merrte Vlorën dhe një hinterland të mjaftueshëm rreth këtij qyteti për mbrojtje; *Pika 10.* Italia të merrte mandatin mbi këto territore për të cilat do të arrihej marrëveshja, dhe të sigurohej marrja e masave të drejta ekonomike, që ishin të justifikueshme në kuadrin e situatës së saj të veçantë; *Pika 11.* I gjithë bregdeti Adriatik, nga ish-kufiri italo-austriak deri në kufijtë veriorë të Shqipërisë, të asnjansohej nën Lidhjen e Kombeve. Ky parashikim duhej të shoqërohej prej garancive të kalimit të lirë për anijet tregtare jugosllave përmes Adriatikut të Jugut dhe Kanalit të Otrantos, madje edhe në kohë lufte.¹⁰ Memorandumi i ri shërbeu si bazë për një plan të ri të rakorduar edhe me fuqitë e tjera.

Më 14 maj 1919 u paraqit Plani Miller-Di Cellere, në të cilin për Shqipërinë parashikohej që “*Vlora vendosej nën sovranitetin e Italisë, dhe në qoftë se një mandat do të vendosej për Shqipërinë, Italia duhej ta kishte këtë mandat*”.¹¹ Italia, dy ditë më vonë, dha përgjigje pozitive për sa i përket këtij plani, në lidhje me parashikimet e tij mbi Shqipërinë.¹²

Pas ballafaqimit të radhës mes Presidentit Wilson me Kryeministrin italian Orlando më datë 26 maj, me propozimin e Kryeministrit francez Clemenceau (Klemanso), u arrit të përpunohej nga ekspertët italianë dhe francezë kompromisi Tardieu-Crespi, i cili për Shqipërinë parashikonte pikën 4: Italisë t’i njihej mandati mbi Shqipërinë, me kufij veriorë ata të vitit 1913, ndërsa ata jugorë do të përcaktoheshin prej konferencës. Në këtë kompromis, parashikohej gjithashtu ndërtimi i një hekurudhe me 40% kapitale italiane, 40% kapitale jugosllave dhe 20% kapitale të vendeve të tjera.¹³ Të nesërmen e përpilimit të planit në fjalë, ai iu paraqit Këshillit të të Katërtëve. Presidenti Wilson kërkoi që çështja e Shqipërisë të mbahej pezull deri në përgatitjen e një raporti prej një komisioni të veçantë. Kjo ndërhyrje e Presidentit Wilson, tashmë krejt e ndryshme në

¹⁰ Albrecht-Carrié, *Italy at the Paris Peace Conference*, 510-514. Document 45, Johnson’s Memorandum May 8, 1919.

¹¹ *Po aty*, 153-183.

¹² David Hunter Miller, *My Diary at the Conference of Paris, with Documents*, 20 vol. (New York: Appeal Printing Co., 1928), vol. I, pp. 314-315 dhe vol. X, doc. no. 967.

¹³ Albrecht-Carrié, *Italy at the Paris Peace Conference*, 186-188.

raport me Memorandumin e datës 14 prill 1919, vinte si rezultat i informacioneve më të plota që ai kishte marrë mbi faktin që shqiptarët po protestonin kundër idesë për t'u vënë përfundimisht nën mandatin e Italisë. Wilson shtoi gjithashtu se shqiptarët i tmerronte ideja që mund të vendoseshin nën Italinë, dhe se, ai mendonte se atyre [shqiptarëve] u duhej dhënë liria. Përgjigjja e Lloyd George-it (Lloid Xhorxh) ishte e shkurtër:

“Unë në të vërtetë nuk e di se çfarë do të bëjnë ata më pas me këtë pavarësi, përveç se t'i presin fytyrë njëri-tjetrit. Shqipëria do të jetë pikërisht si Malësitë e Skocisë në shekullin XV”.

Kurse përgjigjja e Presidentit Wilson ishte e menjëhershme: “*Mos fol keq për malet e Skocisë*”! “*Është vendi i origjinës së familjes sime*”.¹⁴ Dhe ky ishte fundi i trajtimit të problemit në Këshillin e të Katërtëve, për pjesën që i përkiste këtij këshilli.

Muaj të tërë kaluan pa ndonjë zhvillim të veçantë mbi Shqipërinë, derisa më 29 gusht 1919 u propozua një skemë e re prej vendeve të Antantës, që iu përcoll me një notë përfaqësuesit amerikan M. Polk: Italisë t'i jepej mandati mbi Shqipërinë brenda kufijve të vitit 1913; Italisë t'i jepej sovraniteti mbi Vlorën me një hinterland rreth saj, ngushtësisht i nevojshëm në pikëpamje ekonomike dhe të sigurimit. Për kufirin e Shqipërisë me Greqinë, Italia pranonte vijën e kufirit të vitit 1913, me adoptimin e propozuar nga delegacioni amerikan në Konferencën e Paqes, sipas të cilit Korça i lihej Shqipërisë dhe Gjirokastra i jepej Greqisë.¹⁵ Ky propozim është mbajtur në këtë formë

¹⁴ Margaret MacMillan, *Peacemakers, The Paris Conference of 1919 and its attempt to end war* (London: John Murray-2002), 372-373; po ashtu në: *Papers relating to the Foreign Relations of United States, The Paris Peace Conference, 1919*, vol. V, Joseph V. Fullet (editor), (United States Department of State Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office, 1946), 483. Notes of a Meeting held at President Wilson's House in the Place des Etats-Unis, Paris, on Tuesday, May 6, 1919, at 11. a.m.,.

¹⁵ *British Documents on Foreign Affairs* (më tej: *BDFA*), Reports and papers from the Foreign Office Confidential Print, General Editors Kenneth Bourke and D. Cameron Watt, Part II, Series I, The Paris Peace Conference of 1919, editor M. Dockrill, vol. 10 (University Publication of America: 1991), 333- 336. Sir E. Crowe to Earl Curzon, Paris, October 13, 1919, doc. 180; Inclosure in doc 180, doc.181, Memorandum respecting Negotiations between the Allied Governments in regard to the Adriatic Question and the future of Fiume: Annex 1 Projet de Note pour M. Polk, le 29 aout 1919.

në draftin e përgatitur për t'ia dërguar Presidentit amerikan Wilson, të nënshkruar më 5 shtator 1919 nga Clemenceau dhe Lloyd George, por në variantin zyrtar, të dorëzuar më 10 shtator 1919, nuk përmenden më as kufijtë e vitit 1913 dhe as çështja e zgjidhjes së problemit të Korçës dhe Gjirokastrës, sipas propozimit amerikan.¹⁶ Më 2 tetor 1919, përfaqësuesi amerikan komunikoi përmbajtjen e telegramit të Presidentit Wilson të datës 22 shtator 1919. Në këtë telegram, Presidenti Wilson nuk e pranonte zgjidhjen e çështjes së Fiumes në favor të Italisë, ndërsa në lidhje me çështjen shqiptare, theksonte se “*mandati mbi Shqipërinë ishte një çmim i madh për t'u paguar për pranimin nga ana e Italisë*”.¹⁷ “Egoizmi nacional” i diplomatëve italianë ishte tashmë i padurueshëm dhe i jepte përherë lëkundje disproporcionale dhe të paarsyeshme diplomacisë së këtij vendi, duke sjellë vështirësi në komunikimin mes Fuqive dhe rëndesë negative ndaj interesave kombëtarë shqiptarë. Prandaj, më 27 tetor 1919, Frank Polk (që në atë kohë shërbente si kryetar i delegacionit amerikan në Konferencën e Paqes, pas largimit të Lansing-ut), i dorëzoi ministrit të Jashtëm italian, Tittoni një notë, në të cilën jepej një përgjigje e detajuar nga Sekretari i Jashtëm Robert Lansing, mbi çështjen shqiptare. Pozicioni i SHBA-së ishte si më poshtë: 1- shteti i pavarur i Shqipërisë duhej të vendosej nën mandatin italian, në kushte të atilla, që të parandalohesh shfrytëzimi ekonomik dhe ushtarak i vendit, ose kolonizimi i tij; 2 - qyteti i Vlorës, me një hinderland të kufizuar, i mjaftueshëm vetëm për të përballuar nevojat e veta thelbësore ekonomike dhe ngushtësisht i nevojshëm për sigurinë, duhej t'i kalonte Italisë në sovranitet të plotë dhe se territori rreth e qark Vlorës duhej të asnjansohej; 3 - jugosllavët duhej të kishin të drejtën të ndërtonin dhe operonin hekurudhën në veri të gjerësisë gjeografike 41° 15', dhe se ata duhej të kishin gjithashtu të drejtën të përmirësonin lundrimin në lumin e Bunës. Më 18 nëntor 1919, delegacioni amerikan paraqiti një komentari të detajuar mbi qëndrimin italian dhe një memorandum të ndërtuar me një precizion të madh që, në fakt, përbën edhe deklaratën finale të pozicionit

¹⁶ *B DFA*, Part II, Series I, The Paris Peace Conference of 1919, Volume 10, 336-337, 338-339. Annex 2 *Projet de Cable au president Wilson par MM. Clemenceau et Lloyd George*, Le 5 septembre, 1919, Anex 5, The Clemenceau-Lloyd George Proposal as submitted to the President on September, 10, 1919.

¹⁷ *Po aty*, 340-341. Annex 7 Substance of telegram from President Wilson to Mr. Polk dated September 22.

të qeverisë amerikane në lidhje me Çështjen e Adriatikut.¹⁸ Ky është komentari i fundit që i jepej Italisë për shpjegim dhe kompromis nga ana e SHBA-së, përpara se rrethanat të ndryshonin thelbësisht, problematika shqiptare të sqarohej dhe qeveria amerikane të ndryshonte tërësisht qëndrim në favor të Shqipërisë.

Falë një numri ndërhyrjesh të rëndësishme me ekspertizë të thelluar nga ekipi i ekspertëve, njohuritë e Presidentit Wilson në lidhje me çështjen shqiptare do të vinin duke u plotësuar me kalimin e muajve, e për rrjedhojë, qëndrimi fillestar amerikan ndaj kësaj çështjeje do të pësonte ndryshime rrënjësore me kalimin e muajve dhe viteve. Në sajë të këtij qëndrimi të ri të qeverisë amerikane mund të themi se u arrit, më së shumti, shpëtimi i Shqipërisë së Parë Shtetërore, d.m.th. i kufijve të vitit 1913, ndryshimi i vizionit fillestar dhe kundërshtimi i fuqishëm i marrëveshjes së 14 janarit 1920, mes Kryeministrave Lloyd George, Clemenceau dhe Nitti. (Kjo marrëveshje parashikonte që Italia duhej të merrte të gjithë Istrian dhe Fiumen (Rijekën), Jugosllavia në këmbim duhej të merrte Shqipërinë Veriore, ndërsa pjesa tjetër e vendit duhej të ndahej në bazë të marrëveshjes Tittoni-Venizelos). Më 13 janar 1920 u arrit një marrëveshje mes kryeministrave britanikë, francezë dhe italianë, gjegjësisht: David Lloyd George (Britani), Georges Clemenceau (Francë) dhe Francesco Nitti (Francesko Niti) (Itali), në cilësinë e delegatëve të Konferencës së Paqes, por në mungesë të përfaqësuesit të SHBA-së, Frank L. Polk. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin Kryeministri grek Venizelos dhe ministri i Jashtëm i Mbretërisë SKS, Trumbiq.¹⁹

¹⁸ Po aty, 354-355. Inclosure in doc 194 Anex II American Commission to Negotiate peace, memorandum, Paris, November 18, 1919. “Shqipëria duhej të vendosej nën një mandat italian, kushtet e të cilit duhej të ishin të tilla që të parandalonin shfrytëzimin italian të vendit, ashtu sikurse edhe militarizimin italian dhe kolonizimin. Territori jashtë Vlorës duhej të demilitarizohej plotësisht dhe jugosllavët duhej të kishin të drejtën të ndërtonin dhe shfrytëzonin hekurudhën përgjatë Shqipërisë Veriore, në veri të paralelit 41 gradë e 15’ ose përndryshe të gëzonin privilegje të plota të transportit ndërkombëtar përmes Shqipërisë Veriore, ashtu sikur ishte njohur në konventat e reja në mes Aleatëve dhe Fuqive të Asociuara. E drejta për të kontrolluar lundrimin në lumin Buna i jepej Lidhjes së Kombeve, me fuqi që të delegonte punën edhe të Italisë ose Jugosllavisë, nën kufizime të përshtatshme. Qyteti i Vlorës, së bashku me një hinterland të vogël, të mjaftueshëm vetëm për nevojat ekonomike të qytetit dhe sigurisë së tij, duhej t’i jepej në sovranitet të plotë Italisë.”

¹⁹ *The Adriatic Question*, Presented by Mr. Hitchcock (Washington: Government Printing Office, 1920), 11.

Pjesëmarrësit ranë dakord që, si vijë kufitare për Shqipërinë e Jugut të pranohej vija e përcaktuar nga marrëveshja Tittoni-Venizelos. Për sa i përket Shqipërisë Veriore, u pranua që Mbretëria SKS do të aneksonte Shkodrën dhe të caktohej si kufi lumi Drin, me dalje në detin Adriatik, në portin e Shëngjinit. Fjala e fundit i mbetej në këtë rast Presidentit Wilson.²⁰

Më 20 janar Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Lansing, pasi u informua për këto zhvillime të papritura në Paris, ngriti kundërshtime ndaj një zgjidhjeje për të cilën SHBA-ja nuk ishte konsultuar. Ai shtroi pyetjen nëse synimi i Francës dhe i Britanisë së Madhe ishte të rregullonin vetë problemet europiane dhe thjesht t'i komunikonin vetëm rezultatet SHBA-së?²¹ Rreth datës 22 janar 1920, lord Derby, ambasadori britanik në Paris, i dorëzoi ambasadorit të SHBA-së, Wallace, përgjigjen e qeverisë franceze dhe asaj britanike për Sekretarin e Shtetit Robert Lansing. Në notën e tyre, Clemenceau dhe Lloyd George shkruanin se zgjidhja e propozuar për Shqipërinë, përfaqësonte një kompromis, që kënaqte kërkesat e nevojshme të të gjitha palëve të interesuara. Detajet e administrimit të Shqipërisë prej Jugosllavisë, Italisë dhe Greqisë do të përpunoheshin më tej. Qeveria franceze dhe ajo britanike deklaroronin gjithashtu se në procesin e këtij përpunimi, ndjenjat dhe interesat e ardhshëm të popullit shqiptar do të merreshin plotësisht parasysh dhe do të bëhej çdo përpjekje për një sistemim përfundimtar që të ishte në konsultim të plotë me ndjenjat e këtij populli.²² Përgjigjja franko-

²⁰ *Documents on British Foreign Policy, 1919-1939*, edited by E.L. Woodward and Rohan Butler, First Series, vol. II, 1919 (London: His Majesty's Stationery Office, 1948), 856-865. Notes of a Meeting of the Heads of Delegations of British, French and Italian Governments, held in M. Pichon's Office at the Quai d'Orsay on Tuesday, January 13, 1920, at 3 p.m. (no.70). Përmbajtja e plotë e dokumentit gjendet edhe në: Correspondence relating to the Adriatic Question, Presented to Parliament by Command of His majesty, London: 1920, *Miscellaneous*, no. 2 (1920), në: Library of LSE CHAT K5/175, f. 18: no.7. The Adriatic Question, Revised Proposals to M. Trumbitch and M. Pashitch by M. Clemenceau at Meeting held at the Quai d'Orsay on the afternoon of January 14, 1920.

²¹ *Documents on British Foreign Policy, 1919-1939*, First Series, vol. II, 968. Telegram from Mr. Lansing to Mr. Wallace, Paris, January 20, 1920. Footnote on Appendix A to no. 80, Draft Reply to Mr. Lansing's Memorandum.

²² *Po aty*, 969. Appendix A to no. 80. Draft Reply to Mr. Lansing's Memorandum. Teksti i plotë në Correspondence relating to the Adriatic Question, Presented to Parliament by Command of His majesty, London 1920, *Miscellaneous* no. 2 (1920), në: Library of LSE CHAT K5/175, 21-22, no. 10, Telegram in the Names of M.

britanike ndaj kundërshtimeve amerikane lidhur me kompromisin Nitti, nuk e kënaqi aspak Presidentin Woodrow Wilson (Udrou Uilson), i cili bëri një deklaratë të hapur mbi pikëpamjet e tij për zgjidhjen e propozuar të çështjes shqiptare. Ai e hodhi poshtë me forcë zgjidhjen e propozuar, të negociuar pa dijeninë dhe pa pëlqimin e qeverisë amerikane, në mungesë të përfaqësuesve të SHBA-së. Në mënyrë të veçantë, presidenti shprehte pakënaqësinë e tij mbi zhvendosjen e qëndrimeve, pasi, në qoftë se në Memorandumin e datës 9 dhjetor 1919, palët propozuese ruanin në një shkallë të madhe unitetin e shtetit shqiptar, propozimi i 14 janarit 1920 kërcënonte copëtimin e popullit shqiptar mes tri shteteve të huaja: Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë.²³

Kështu, kthesa e parë pozitive që ndryshoi rrjedhën, së paku të trajtimit të problemit shqiptar, erdhi nga nota amerikane e 6 marsit 1920, në bazë të së cilës kërkohet që çështja shqiptare të mos përfshihej në diskutimet e përbashkëta mes Italisë dhe Jugosllavisë. Gjithashtu, Presidenti Wilson nuk e aprovoi me këtë rast që tokat shqiptare në Veri dhe në Jug të përdreshin si kompensime territoriale për toka që Jugosllavia dhe Greqia ishin privuar diku tjetër. Ndërhyrja e qeverisë amerikane përbën goditjen e parë të fuqishme ndaj Traktatit të Fshehtë të Londrës, e njëkohësisht, një zhvlerësim të parë të marrëveshjes Titoni-Venizelos. Në thelb, këmbëngulja e Presidentit Wilson, në zbatimin e parimit të vetëvendosjes, çoi në kapitullimin e politikave të pasinqerta italiane në lidhje me Shqipërinë që në tre muajt e parë të vitit 1920. Kjo ndërhyrje bëri që plani i deriatëhershëm britaniko-franko-italian për ndarjen e Shqipërisë të arkivohej dhe Konferenca e Paqes të mbyllej pa arritur ndonjë marrëveshje për Shqipërinë. Në këtë mënyrë, praktikisht, Shqipëria i shpëtoi copëtimin, por problemet e saj mbetën në tavolinën e diskutimeve mes fuqive fituese.²⁴

Më 1 tetor 1920, Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) i kërkoi FO-së të bashkëpunonte në një përpjekje për të rregulluar një zgjidhje të arsyeshme dhe të drejtë të çështjes shqiptare. Qeveria amerikane kërkonte që një zgjidhje e shpejtë t'u jepej një vargu çështjesh që kishin lindur për

Clemenceau and Mr. Lloyd George handed to the United States Ambassador for Transmission to Washington, January 22, 1920.

²³ *Po aty*, 23-25, no.12. President Wilson's Note of February 10, 1920. I njëjti dokument edhe në *The Adriatic Question*, Presented by Mr. Hitchcock, 14, 24.

²⁴ Robert Lee Wolff, *The Balkan in our time* (Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press, 1956), 100.

sa i përket Shqipërisë. DASH ishte pro krijimit të një Komisioni ndërraleat për të hetuar shkaqet e vështirësive shqiptare, si edhe të bënte rekomandimet në Këshillin e Ambasadorëve për një përcaktim përfundimtar të kufijve të Shqipërisë. Gjatë përcjelljes së komunikimit të mësipërm, i Ngarkuari me Punë në ambasadën amerikane në Londër, mr. Williams, e informoi zyrtarin e lartë të FO-së, Nicolson, se Departamenti i Shtetit ishte jashtëzakonisht i interesuar në çështjen shqiptare dhe se nuk do të njihte ndonjë zgjidhje, së cilës kjo qeveri nuk do t'i jepte paraprakisht aprovimin e vet.²⁵

Më 4 tetor 1920 ambasadori britanik në Washington D.C., sër A. Geddes, zhvilloi një bisedë të gjatë me ndihmësin e Sekretarit amerikan të Shtetit, gjatë së cilës, ky i fundit, i bëri me dije se Presidenti Wilson dëshironte të dinte skemën që duhej të adoptohej për çështjen e Shqipërisë dhe se ai gjithashtu kërkonte që

shteti i pavarur shqiptar duhej të krijohet brenda kufijve të atillë që do të bënin të mundur ekzistencën politike dhe ekonomike të këtij vendi.²⁶

Në ndryshimin e qëndrimit amerikan, sipas mendimit tonë, kanë ndikuar katër faktorë të rëndësishëm: *së pari*, filozofia e cila e ka drejtuar politikën e jashtme amerikane në atë kohë, që është filozofia e lirisë dhe e vetëvendosjes së popujve; *së dyti*, skuadra e ekspertëve amerikanë në bisedimet e paqes, erdhi duke e zgjeruar nivelin e njohurive teknike të ekspertëve vlerësues për Shqipërinë, përmes ndryshimit të anëtarëve të skuadrës; *së treti*, një ndihmesë e spikatur duhet të konsiderohet ndërmjetësimi i Papës Benedikti XV (pas audiencës me imzot Luigj Bumçin), autoriteti moral i të cilit ka qenë natyrisht i padiskutueshëm;²⁷ *së katërti*, një kontribut të pamohueshëm ka dhënë komuniteti ortodoks i Shqipërisë që banonte në SHBA, për ndriçimin e realitetit etnik-kulturor

²⁵ *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, edited by Rohan Butler, J.P.T. Bury, M.E. Lambert, First Series, Volume XII (London: Her Majesty Stationery Office, 1962). Note communicated by the United States Charge d'Affaires, United States Embassy, London, October 1, 1920 (no. 407), 478; I njëjti dokument gjendet edhe në: *The National Archives*, London (më tej: TNA), Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO) 371. 4689, doc. no. 7696, f. 117.

²⁶ *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XII, 484-486, Earl Curzon to the United States Charge d'Affaires (London), Foreign Office, October 11, 1920 (no. 413); I njëjti dokument në PRO. FO. 371. 4689, doc. no. 7998.

²⁷ Luigj Bumçi, "Nji fletë e re në historin kombtare", *Hylli i Dritës*, nr. 5, 1934, 219-222.

dhe politik në Shqipërinë e Jugut, e në radhë të parë emigracioni shqiptar në SHBA,²⁸ në Rumani²⁹ dhe në mënyrë të spikatur vëllezërit, Faik e Mehmet Konica.³⁰ Përpjekjet e shumë shqiptarëve të emancipuar dhe largpamës ishin përqendruar sidomos te SHBA-ja. Presidentit Wilson që në fillim të vitit 1919 i janë dërguar memorandume, në të cilat i kërkohej të merrte në dorë fatin e popullit shqiptar dhe të ishte mandator i organizimit dhe i arsimimit të Shqipërisë. Memorandumet shprehnin besimin se vetëm Amerika mund ta shpëtonte Shqipërinë dhe të siguronte paqen në Adriatik: “*SHBA janë shpëtimtarët tanë*”.³¹ Gjithashtu, një numër i madh prej shqiptarëve të shquar shprehnin dëshirën që ky mandat mbi Shqipërinë e re duhej t’i jepej SHBA-së, një fuqie që shqiptarët e konsideronin të ishte pa ndonjë interes të vetin në këtë vend. Një memorandum me shpjegime për nevojën e përfshirjes së një Fuqie të Madhe dhe të painteresuar në Ballkan dhe dhënies së mandatit mbi Shqipërinë SHBA-së, e kishte paraqitur më 19 shkurt 1919 edhe misionari Telford Erickson (Telford Erikson).³² Mandati amerikan mbi Shqipërinë, sipas tij, do të mirëpritej prej popullsisë dhe do të ishte një shërbim i paçmuar në zhvillimin e vendit. Mandati amerikan duhej të përfshinte ish-vilajetet e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe të Janinës, duhej të shtrihej në dy vjet, pas të cilave kufijtë e Shqipërisë me Serbinë dhe Greqinë duhej të përcaktoheshin prej Komisionit të Lidhjes së

²⁸ TNA, PRO. FO. 371.3571, doc.no.146304. Statement of Christain Orthodox Albanians Native of districts of Koritza and Kolonia, in reply to the declaration of Pan-Epirotic Union of America of May 1919, f. 383. Në këtë dokument jepet një listë e gjatë e nënshkruesve me adresat e tyre të sakta në SHBA, nga e cila mund të krijohen ide të qarta mbi përbërjen e komunitetit shqiptar në Amerikë, në atë kohë.

²⁹ TNA, PRO. FO. 371.3571, doc.no.116644, Demetre Kolovani, La Question de Koritza, f. 237.

³⁰ Ilir Ikonimi, *Fan Noli*, vëll. I (Tiranë: Apostulli, 2023), 353, 356, 358-359, 361-365.

³¹ TNA, PRO. FO. 608.28, doc. no. 4775, f. 421-424. Memorandum drejtuar Presidentit Wilson nga doktor Adamidi, në cilësinë e ish-ministrit të Plotfuqishëm në Romë, presidentit të Komitetit Kombëtar Shqiptar dhe të Komitetit Shqiptar “Bashkimi” Egjipt, delegatit të Komitetit Panshqiptar “Vatra” Amerikë, dhe delegatit të Republikës Shqiptare të Korçës. Letra i është përcjellë Presidentit Woodrow Wilson me një memorandum shoqërues nga profesor George D. Herron, më 17 mars 1919. Profesor Herron, më datë 19 mars, i ka përcjellë edhe një memorandum të veçantë të dr. Adamidi-t, edhe Kryeministrit britanik Lloyd George, në të cilin apelohej për drejtësi dhe mbështetje të të drejtave të popullit shqiptar; *po aty*, PRO.FO. 608.28, doc. no. 5050.

³² *Po aty*, PRO.FO. 608.28, f. 402, doc. no. 2483, Future of Albania.

Kombeve. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë se, qeveria e SHBA-së nuk kishte qenë firmëtare e një marrëveshjeje të fshehtë mes fuqive të Antantës gjatë LPB-së dhe Komisioni Amerikan i Bisedimeve të Paqes në Konferencën e Paqes, ruajti lirinë e veprimit në Çështjen e Adriatikut dhe në çështjen shqiptare.

Mirëpo, në këtë lumë diskutimesh në nivelet diplomatike, lind edhe një dritë, hapet edhe një dritare e dytë pro Shqipërisë, e cila do të tërhiqte në kahun pozitiv njohjen e shtetit dhe të kufijve minimalë të tij, d.m.th. kufijve të vitit 1913. Bëhet fjalë për pranimin në Lidhjen e Kombeve, ngjarje politike kjo, që e vuri në ndërvarësi juridike detyrimin e fuqive aleate për zgjidhjen e problemit të statusit dhe të kufijve si dhe njohjen e Shqipërisë si shtet sovran e i pavarur.

Pranimi në Lidhjen e Kombeve

Mbrojtësi kryesor i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ka qenë lord Cecil-i. Apeli i tij për drejtësi në favor të këtij vendi fitoi në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve. Po pse Robert Cecil u bë mbrojtës i çështjes shqiptare në Lidhjen e Kombeve? Lordi Robert Cecil ka qenë ndër politikanët e parë të kontinentit të vjetër që përqafoi të paktën disa nga parimet e Diplomacisë së re, të diplomacisë së hapur, asaj të promovuar me 14 Pikat e Presidentit Wilson, në sistemin dhe në bazat e Diplomacisë së vjetër. Robert Cecil dhe Lloyd George njëllonj, kishin ide të ngjashme për Lidhjen, si një bashkësi e shteteve të vetëqeverisura dhe sovrane, të cilat duhej të drejtoheshin prej pesë Fuqive të Mëdha të Konferencës së Paqes të Parisit.³³ Brenda kësaj kornize duhet kuptuar edhe qëndrimi i lordit Robert Cecil ndaj Shqipërisë. Liria, vetëvendosja dhe integriteti i shtetit shqiptar ishin pjesë e koncepteve të tij mbi Diplomacinë e re, që gradualisht po hapte me vështirësi rrugën në periudhën pas LPB-së. Delegati i Perandorisë Britanike, Herbert Fisher, deklaroi se delegacioni britanik kishte ndërmarrë një studim të ri dhe tërësor të situatës shqiptare, ishte tani i përgatitur të pranonte mocionin e lordit Robert Cecil dhe të votonte për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Kështu, më 17 dhjetor 1920, Shqipëria u pranua në mënyrë të njëzëshme, me 35 vota pro, asnjë kundër dhe 6 abstenime dhe formalisht u bë anëtare e Lidhjes

³³ Ruth Henig, "New Diplomacy and Old: a Reassessment of British Conceptions of a League of Nations, 1918-1920", në *The Paris Peace Conference, 1919 – Peace without Victory?*, 161, 165.

së Kombeve. Shqipëria u njoh *de jure* si një shtet sovran dhe i pavarur, megjithëse kufijtë e saj me Jugosllavinë dhe Greqinë nuk ishin vendosur ende.³⁴

Pas këtij akti, Shqipërisë i hapej rruga e vendosjes së marrëdhënieve normale diplomatike me të gjitha Fuqitë, përfshirë Italinë, Greqinë dhe Jugosllavinë, të cilat deri në atë kohë kishin planifikuar copëtimin e saj. Si kusht për pranimin e saj, Shqipërisë iu kërkuar të nënshkruante një deklaratë, me anën e së cilës ajo do të angazhohej që të mbronte pakicat. Deklarata u nënshkrua nga delegati shqiptar, ipeshkvi ortodoks Fan Noli. Më 18 dhjetor 1920, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare në Gjenevë zuri vendin e tij në Lidhjen e Kombeve. Në fund të vitit 1920, qeveria shqiptare ishte në kontroll të pjesës më të madhe të territoreve të caktuara Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve e Londrës më 1913. Megjithatë, 26 fshatra në juglindje të Korçës mbeteshin ende nën pushtimin grek, ndërsa serbët mbanin të pushtuar një zonë të shtrirë nga liqeni i Ohrit deri në liqenin e Shkodrës, e cila ishte mjaft në brendësi të kufirit që ishte rënë dakord më 1913.³⁵ Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve përbënte një ngjarje shumë të rëndësishme në rrugën e gjatë dhe të vështirë të njohjes së shtetit shqiptar, pasi për herë të parë në historinë e saj, Shqipëria fitonte në këtë mënyrë të drejtën e pavarësisë dhe vetëqeverisjes tërësisht e pandikuar prej ndërhyrjes së fuqive të interesuara. Ky pranim hapi rrugën për njohjen e shpejtë të statusit, të kufijve dhe, si rrjedhim, edhe të qeverisjes së Shqipërisë. Mit'hat Frashëri, në cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, i drejtoi një letër Kryeministrit britanik Lloyd George, më 2 mars 1921, ku kërkonte rinovimin e marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.³⁶ Një letër e ngjashme iu drejtua edhe M. Aristide Briand-it, kontit Sforza dhe baron Hayashi-t, anëtarë të tjerë të Këshillit Suprem në Londër, në të cilën tërhiqej vëmendja mbi situatën jonormale të krijuar prej faktit se Shqipëria, megjithëse e pranuar

³⁴ TNA, PRO. FO. 371.5726, f. 33-35. Admission of Albania to the League. "Following is an extract from Report of 28th Plenary Meeting-Assembly of the League, 17th december 1920. Mr. H.L. Fisher (Great Britain).

³⁵ Owen Pearson, *Albania and King Zog-Independence, Republic and Monarchy 1908-1939* (London: The Center for Albanian Studies in association with I.B. Tauris Publishers, 2004), 155-158.

³⁶ TNA, PRO.FO. 371.5725, 5049/580/90. Independence of Albania and admmission to League of Nations, Paris, le 2 Mars 1921.

njësori si anëtare e Lidhjes së Kombeve, nuk lejohej të kishte marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera.³⁷ Gjithsesi, Shqipëria me një rrezik të jashtëm që sa vinte e dalëngadalë largohej, por me një situatë të brendshme jo të qëndrueshme politike, për shkaqe të mirënjohura të gjendjes së saj të përgjithshme të mangët formative, nuk u mbështet dhe nuk u monitorua në procesin e stabilizimit të saj institucional demokratik nga Lidhja e Kombeve. Në këto rrethana, rruga e përplasjeve të brendshme primitive u la e hapur edhe për shumë kohë, ndërsa presioni i jashtëm gjithnjë veprues.

Mirëpo, pavarësisht se Shqipëria ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve dhe ishte bërë anëtare e saj, Fuqitë e Mëdha nuk kishin marrë akoma një vendim përfundimtar mbi statusin e këtij shteti dhe kufijtë politikë të tij në Konferencën e Ambasadorëve që mbledhej për të plotësuar vendimet e paarritura prej Konferencës së Paqes. Për fat të keq, aleatët e Antantës gjendeshin ende të varur nga klauzolat e Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1913 dhe nga ndërhyrjet e paqëndrueshme të Italisë.³⁸

Gjatë vitit 1921 çështjet e lidhura me Shqipërinë, të mbetura të pazgjidhura në arenën ndërkombëtare, do të jenë edhe më tutje objekt diskutimesh edhe në Lidhjen e Kombeve, para së gjithash me nxitjen e qeverisë shqiptare dhe përfaqësuesit të saj Fan Stilian Noli. Problemi i krijuar nga njohja më 17 dhjetor 1920 e Lidhjes së Kombeve, përveçse një problem politik, kishte krijuar edhe një problem të ndërlikuar ligjor, që kërkonte një shpjegim nga ekspertë të së drejtës ndërkombëtare. Një prej çështjeve për të cilën komiteti dhe vetë asambleja ishte ndarë, ka qenë e lidhur me faktin nëse *pranimi në Lidhjen e Kombeve ishte i barabartë me njohjen e shtetit?* Ky problem u kaloi për shqyrtim anëtarëve të Seksionit ligjor të Sekretariatit të Lidhjes, por tre ekspertët të cilët merreshin me këtë çështje, nuk ishin në gjendje të arrinin në një mendim të përbashkët. Atëherë Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, sir Eric Drummond (Erik Drumond), i kërkoi këshilltarit

³⁷ Po aty, PRO.FO. 371.5726, C 6692/580/90. Diplomatic relations of Albania with other States, Paris, March 2nd 1921.

³⁸ Shih: Sali Kadria, “Çështja e statusit politik të shtetit shqiptar gjatë vitit 1921”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 49, Prishtinë: 2019; Sali Kadria “Çështja e kufijve jugorë të shtetit shqiptar në vitet 1921-1923” në *Gjurmime albanologjike*, nr. 50, Prishtinë: 2020; Romeo Gurakuqi, “Mbi caktimin e kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë”, në *Studime historike*, nr. 1-2 (2020).

ligjor të FO-së të Mbretërisë së Bashkuar, sër C. Hurst, nëse ishte i përgatitur për ta zgjidhur problemin. Ky i fundit, i komunikoi se nuk mund t'i përgjigjej për këtë çështje në këtë moment, pasi të katër anëtarët e tjerë të ekipit të tij ndodheshin në Këshillin Suprem dhe në Konferencën e Ambasadorëve, d.m.th. në Paris, Romë dhe në Londër. Në të njëjtën kohë, M. Huneus (ministër i Punëve të Jashtme të Kilit më 1912) dhe kryetar i Komitetit të Pestë për pranimin e shteteve, i kërkoi këshilltarit legal francez M. Fromageot (Fromazhó), këshilltarit legal italian M. Ricci-Busatti, këshilltarit të ambasadës japoneze në Paris, M. Nagaoka si dhe këshilltarit ligjor britanik sër C. Hurst, të këshillonin mbi këtë çështje. Këshilla që ata dhanë është formuluar në këtë mënyrë:

“Teorikisht, njohja *de jure* e një shteti është një akt individual prej anës së çdo shteti dhe shtrihet në një plan të ndryshëm nga ai i pranimin në Lidhjen e Kombeve. Por të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Lidhjes, ndërmjet anëtarëve të ndryshëm, e bën të pamundur për një anëtar të qëndrojë indiferent ndaj një anëtari tjetër të Lidhjes. Kjo gjë do ta bënte të pamundur në praktikë për një anëtar të Lidhjes të plotësojë detyrimet ndaj një anëtari tjetër të Lidhjes, në qoftë se në teori, ky anëtar i ri ishte për të jo ekzistent. Për pasojë, në qoftë se një shtet pranon aderimin e një shteti të ri në Lidhje, ai do të duhet ta trajtojë atë si një shtet ekzistues, që zotëron të gjitha atributet e një qenieje normale të një entiteti politik shtetëror. Nga përcaktimet e Konventës së Lidhjes së Kombeve, anëtarët e Lidhjes janë në një mendje të pranojnë vendimet e shumicës mbi këtë çështje për pranimin e një shteti të ri, ndaj ato me këtë akt pranojnë një detyrim që e bën të papraktikueshëm për ata, të mbajnë pezull njohjen *de jure* të një shteti, i cili është pranuar prej Lidhjes së Kombeve”.³⁹

Pavarësisht nga ky shpjegim juridik, zyrtarët britanikë kanë qenë krejt të ftohtë në marrjen e akteve të mëtejshme në njohjen e shtetit shqiptar. Kështu, vetë Crowe (nënsekretar i Përhershëm i Punëve të Jashtme) do të shprehej se lehtësia me të cilën Lidhja e Kombeve trajtonte problemet e rënda politike, si për shembull, njohjen e një shteti që nuk i kishte të

³⁹ *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, edited by W.N. Medlicott and Douglas Dakin, assisted by Gillian Bennett, First Series, vol. XXII, Central Europe and Balkans 1921, Albania 1921-22 (London: Her Majesty's Stationery Office, 1980), 652-654. Earl Curzon to Sir G. Buchanan (Rome) Foreign Office, January 14, 1921 (no. 601).

vendosur kufijtë dhe kishte një qeveri të panjohur ende, ishte një sëmundje e vajtueshme dhe domethënëse për të ardhmen. Ndërsa lord Curzon-i (Sekretari i Jashtëm) do të shtonte se

“edhe më tutje unë jam shumë larg nga dëshira për të pranuar qëndrimin se, pranimi me anë të një shumice të thjeshtë të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve, në mënyrë të nevojshme i detyron Fuqitë, përfaqësuesit e të cilëve mund të votojnë madje edhe kundër pranimi, se një gjë tillë nënkupton njohjen *de jure* të shtetit të pranuar. Fakti që çështja e njohjes *de jure* të shtetit është sjellë si një çështje e pavarur për t’u diskutuar në Konferencën e vendeve Aleate, më duket se tregon që Fuqitë e përfaqësuara atje nuk e konsiderojnë vehten e tyre të lidhur me atë çfarë ndodh në Gjenevë”.⁴⁰

Duhet të kemi parasysh se periudha e trajtimit të statusit të Shqipërisë, pas Luftës së Parë Botërore, ka qenë e tillë që sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi, vinte nga një periudhë decentralizimi dhe vetëm në këtë kohë u bënë përpjekje për të krijuar disa struktura bazë përqendrimi (pas Konferencës së Paqes të Parisit dhe krijimit të Lidhjes së Kombeve). Institucioni i njohjes kolektive nuk ishte i mirënjohur, prandaj dhe problemi i njohjes së Shqipërisë paraqitej shumë më i ndërlikuar. Sot, në praktikën e së drejtës ndërkombëtare, gjërat kanë ndryshuar. Përgjithësisht përdoret institucioni i njohjes kolektive, nëpërmjet pranimi në procedurat e anëtarësimit të Kombeve të Bashkuara. Në praktikë, entitetet të cilat janë shtete (por edhe ato që nuk janë), dhe të cilat dëshirojnë të konsiderohen si shtet prej shteteve të tjera, përgjithësisht, bëjnë kërkesë të menjëhershme për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Kjo nënkupton që të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara (gjë që nënkupton të gjitha shtetet e tjera anëtarë të kësaj organizate), u kërkohet të marrin qëndrim rreth statusit të një entiteti që kërkon anëtarësim në këtë organizatë.⁴¹

Pas qëndrimit të prerë amerikan në lidhje me Shqipërinë, pranimi të shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, edhe politika britanike ndaj Shqipërisë gjatë vitit 1921 ndryshoi. Pranimi i Shqipërisë nga Lidhja e

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ Colin Warbrik, “States and recognition in international law”, në *International Law*, edited by Malcolm D. Evans (Oxford University Press, second Edition: 2006), 259-260.

Kombeve si dhe presioni i opinionit publik britanik, që e shihte mbrojtjen e kombit shqiptar dhe shtetit të pavarur të Shqipërisë si një “rast moral”, ishin sinjale të fuqishme që politika britanike ndaj këtij vendi duhej të merrte tashmë një përmasë të re dhe një shtysë më të qartë. Një dokument shumë i rëndësishëm që shpjegon qëndrimin dhe politikën britanike ndaj Shqipërisë, ndaj çështjes së statusit të ardhshëm të saj, vështirësive juridike që paraqiteshin në situatën e fillimvitit 1921, është memorandum i përgatitur në FO prej mr. Nicolson, më 14 prill 1921, në të cilin, pasi bëhet një analizë e situatës, përcaktoheshin edhe linjat kryesore të politikës së ardhshme.⁴² Sekretari i Jashtëm britanik do t'i kushtonte një vëmendje të posaçme Shqipërisë, sidomos në muajt në vijim dhe falë kësaj vendosmërie dhe sensit pozitiv me të cilin ai e trajtoi këtë çështje, u arrit në zgjidhjen e problemit të statusit ndërkombëtar dhe përcaktimit teorik të kufijve, më 9 nëntor 1921.

Më 11 maj 1921, qeveria franceze dhe më 27 maj edhe ajo italiane, ranë edhe ato dakord që të pranonin propozimin e FO-së mbi zgjidhjen e çështjes së kufijve të Shqipërisë. Sipas këtij propozimi, kjo çështje duhej t'i nënshtrohej shqyrtimit të Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe forma e njohjes të caktohej nga aleatët kryesorë dhe fuqitë e asociuara.⁴³ Më 14 korrik, qeveria britanike i transmetoi përfaqësuesit të saj në Paris, lordit Hardinge, një memorandum me subjekt kufijtë e Shqipërisë, në të cilin jepeshin linjat kryesore mbi të cilat për këtë qeveri duhej të gjendej një zgjidhje.⁴⁴

Më 25 qershor 1921, Këshilli i Lidhjes së Kombeve kishte vendosur të diskutonte çështjen e Shqipërisë në një sesion publik me kërkesë të qeverisë shqiptare, e cila ishte ankuar kundër veprimeve ushtarake jugosllave dhe kishte bërë thirrje për mbrojtje nga Lidhja e Kombeve. Mirëpo, për shkak se me problemin e kufijve të Shqipërisë po merrej

⁴² TNA, PRO.FO. 371. 5726, C 7684/580/90. Earl Curzon to Signor de Martino, FO, April 20, 1921, Enclosure No.1; dhe në: *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XXII, 666-671. Albania (Memorandum Prepared in the Foreign Office by Mr. Nicolson regarding the present position and future policy), Foreign Office, April 14, 1921 (no. 609).

⁴³ *Po aty*, 691- 692. Earl Curzon to Lord Hardinge (Paris), Foreign Office, June 4, 1921 (no. 629); Sir E. Crowe to Mr. Spicer, Foreign Office, June 4, 1921 (no. 630).

⁴⁴ TNA, PRO.FO. 371.5727, C12276/580/90. Earl Curzon to Lord Hardinge (Paris), Foreign Office, June 14, 1921; po këtë dokument e gjeni edhe në *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XXII (no. 632), Enclosure in No. 632. Memorandum on Albanian Frontiers, Foreign Office, June 10, 1921.

paralelisht Konferenca e Ambasadorëve në Paris, ky diskutim u anulua ose u refuzua. Qeveria shqiptare menjëherë protestoi ndaj një refuzimi të tillë dhe kërkoi që kjo çështje, d.m.th. e provokimeve të vazhdueshme ushtarake jugosllave dhe greke, të referohej në një mbledhje të përgjithshme të Lidhjes së Kombeve në muajin shtator.⁴⁵ Komiteti i kufijve, i ngritur nga Konferenca e Ambasadorëve në fillim të muajit korrik 1921, filloi diskutimin e çështjes së kufirit të shtetit shqiptar, me referencë kryesore ishullin e Sazanit, i cili asokohe, ishte i pushtuar nga trupat italiane. I vetmi rajon tjetër në Shqipëri ku ndodheshin trupat ushtarake italiane ishte qyteti i Shkodrës. Përfaqësuesi italian në Komitetin e Kufijve, iu përmbajt qëndrimit se pushtimi italian i ishullit të Sazanit ndryshonte nga ai i Shkodrës, pasi ky i fundit kishte një karakter të pastër e të përkohshëm ndërkombëtar. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Shqipërisë deklaroi para komitetit se qeveria e tij kërkonte njohjen e kufijve të vitit 1913, pa ndonjë përjashtim, duke ia mohuar kështu Italisë çdo të drejtë politike mbi ishullin e Sazanit. Ky kundërshtim, siç duket, mbështetej edhe nga një marrëveshje e fshehtë e arritur më 2 gusht 1920 mes ministrit të Plotfuqishëm të Mbretërisë së Italisë, kontit Manzoni, dhe Kryeministrit shqiptar të asaj kohe Sulejman Delvina.⁴⁶ Ndërhyrjet dhe vështirësitë e herëpashershme të krijuara prej qëndrimit të pasinqertë të Italisë, siç është edhe rasti më i fundit, shtynë edhe më shumë marrjen e vendimit prej Konferencës së Ambasadorëve.

Akti final i njohjes

Para perspektivës së qartë të zgjidhjes përfundimtare të çështjes së statusit të Shqipërisë dhe kufijve të saj, qarqet më ekstremiste greke dhe serbe bënë lëvizjet e fundit të dëshpëruara në terrenin ushtarak. Një numër i konsiderueshëm komitësh të parregullt grekë filluan të

⁴⁵ TNA, PRO.FO. 371.5727, C13849/580/90. Mr. Eyres (Durazzo) to the Marquess Curzon of Kedleston, Durrazzo, July 4, 1921, Albanian Government protest against League of Nations refusal to discuss frontier question; po këtë dokument mund ta gjeni edhe në no. 640, në *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XXII, 703-704.

⁴⁶ TNA, PRO.FO. 371.5727, C14278/580/90. Sir M. Cheetham (Paris) to the Marquess Curzon of Kedleston, Paris, July 12, 1921, Enclosure in No.1, Preliminary Protocol of Tirana, August 2, 1920; po këtë dokument mund ta gjeni në no. 648 & Enclosur in no. 648, Preliminary Protocol of Tirana, August 2, 1920, në *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XXII, 710-712.

grumbulloheshin në kufirin shqiptar,⁴⁷ ndërsa qeveria serbe, duke injoruar të gjitha prezantimet e bëra nga Fuqitë e Mëdha ose nga Lidhja e Kombeve, filloi të zinte me anë të forcës territoret shqiptare në brendësi të vendit. Ata pushtuan Lurën dhe Oroshin dhe vazhduan përparimin në drejtim të perëndimit, duke u afruar pranë Lezhës, për të bërë kështu fakt të kryer zënien e territoreve. Lugina e lumit Mat u mbush me refugjatë, ndërsa qeveria shqiptare dhe forcat e saj të armatosura ndodheshin në përfundim të armatimeve të luftës dhe rezervave ushqimore. E gjithë administrata në veri të vendit, si rezultat i agresionit më të ri serb, u shpërnda.⁴⁸ Në këto rrethana, Londra zyrtare e konsideroi si të domosdoshme të mos humbiste kohë dhe i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve të fiksonte përfundimisht kufijtë e Shqipërisë në mbledhjen e radhës, më datë 5 nëntor 1921.⁴⁹ Në fakt, në mbledhjen e datës 5 nëntor u arrit të merrej vetëm aprovimi për përgatitjen e draftit, ndërsa vendimi u nënshkrua më datë 9 nëntor 1921.⁵⁰ Më 7 nëntor 1921, në orën 6 pasdreke, lord Curzon-i, me anë të përfaqësuesit të vet në Durrës mr. Eyres, njoftoi qeverinë shqiptare se, në kuadër të vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për sa u përkiste kufijve të Shqipërisë, qeveria britanike nga ai moment njihte qeverinë aktuale të Shqipërisë, si *de jure* dhe *de facto*, qeveri e të gjithë Shqipërisë. Një deklaratë e ngjashme u bë po atë ditë në Dhomën e Komuneve të Mbretërisë së Bashkuar dhe njëkohësisht u njoftuan menjëherë edhe qeveria franceze, italiane, serbo-kroate-slllovene dhe greke. Menjëherë pas këtij akti erdhi edhe njohja e qeverisë italiane dhe më 9 nëntor, edhe e qeverisë franceze. Komunikimet zyrtare të këtyre dy qeverive pranë qeverisë shqiptare janë kryer më 15 nëntor 1921. Kryeministri shqiptar, Pandeli Evangjeli, i

⁴⁷ *Po aty*, 801-802. Marquess Curzon of Kedleston to Lord Granville (Athens), Foreign Office, October 28, 1921 (no. 734) dhe Lord Granville to the Marquess Curzon of Kedleston, Athens, October 29, 1921 (no.735).

⁴⁸ *Po aty*, 804. Mr. Eyres (Durazzo) to the Marquess Curzon of Kedleston, Durazzo, November 4, 1921 (no. 739).

⁴⁹ *Po aty*, 803. The Marquess Curzon of Kedleston to Lord Hardinge (Paris), Foreign Office, November 2, 1921 (no. 737).

⁵⁰ TNA, PRO.FO.371.5733, C 21384/580/90. Decision of Ambassadors' Conference, Regarding Albania, Lord Hardinge to the Marques Curzon of Kedleston, Paris, November 8, 1921, Enclosure 1 in no. 1, Projet de Décision de la Conférence des Ambassadeurs, Paris, le 9 novembre 1921, Annex VII, Déclaration faite par Lord Hardinge a la Conférence des Ambassadeurs le 9 Novembre 1921. (C21371/580/90); (C21543/580/90); (C21633/580/90).

shprehu menjëherë mirënjohjen e qeverisë shqiptare Qeverisë së Madhërisë së Tij (His Majesty's Government - HMG) për këtë akt të parë të njohjes zyrtare (C 21566/580/90).⁵¹ Si parim i përgjithshëm u përcaktua vendosja e kufijve të vitit 1913 dhe iu la ekspertëve që të propozonin modifikime në Lindje dhe në Veri, në mënyrë që ta bënë më të logjikshme ndarjen e kufirit. Mirëpo, rekomandimet e ekspertëve nuk ishin shumë rezultative në lidhje me Shqipërinë, për sa kohë që ato u shoqëruan me cungime të mëtejshme territoriale në Lindje dhe nuk bënë asgjë në lidhje me përfshirjen e fiseve të rëndësishme të Malësisë, Hotit, Grudës, Triepshit dhe Kojës në Shqipëri. Rimbajtja jashtë Shqipërisë e këtyre fiseve me famë kombëtare, i hoqi Shkodrës dhe katolicizmit shqiptar dy krahë të rëndësishëm të energjisë dhe peshës së saj tradicionale politike në Shqipëri. Memorandumi i ekspertit britanik, J.S. Barnes i datës 28 tetor 1921, përcjellë në Paris, lordit Hardinge në lidhje me këto krahina, nuk u mbajt parasysh. (Për fat të keq, problemi i Triepshit dhe Kojës u la krejt në heshtje e konsiderohej i kapërcyer nga diplomacia britanike, për shkak të një aneksimi më të hershëm të këtyre dy fiseve të Malësisë prej Malit të Zi, d.m.th. pas krizës ballkanike 1875-1878). Ndërsa në Lindje, nevoja për të krijuar një basen praktik komunikimi e njëkohësisht marrëdhëniesh ekonomike për qytetet dhe rrethinat e Dibrës dhe të Prizrenit i hoqi Shqipërisë rreth 400 km katror, të banuar nga popullsia e pastër shqiptare.⁵²

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike

Një ngjarje e rëndësishme për vendin në vitin 1922 ishte njohja shtetërore, vendosja e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-në. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës, shumë herët e drejtoi vëmendjen përtej Atlantikut. Në prill të vitit 1920, qeveria shqiptare i kërkoi Sekretarit të Shtetit që të dërgonte në Shqipëri një komision të përbërë nga inxhinierë dhe ekspertë për hekurudhat, energjinë, minierat, financat, shëndetësinë dhe për të organizuar vendin. Pas njohjes së shtetit nga anëtarët e Lidhjes së Kombeve kishte një rritje të vëmendjes nga ana e ambasadës së

⁵¹ *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, First Series, vol. XXII, 807. The Marquess of Kedleston to Mr. Eyres (Durazzo), Foreign Office, November 7, 1921 (no. 742).

⁵² TNA, PRO.FO.371.5733, C 21003, Albania, Northern and Eastern Frontiers, 28.10.1921, f. 260-262.

SHBA-së në Romë në lidhje me Shqipërinë dhe posaçërisht gjendjen ekonomike dhe politike atje.⁵³

Lidhur me njohjen nga afër të situatës shqiptare në rrjedhën e vitit 1922, qeveria amerikane është bazuar në raportet e kolonelit Donnelly dhe përfaqësuesit të qeverisë shqiptare në SHBA gjatë vitit 1921, mr. C. Telford Erickson. Misionari Erickson ishte amerikan i informuar mbi gjendjen në Shqipëri, për shkak se ai kishte qenë i përfshirë në çështjet e Sinclair Oil Company, e angazhuar për koncesionet e naftës në vendin ballkanik. Kështu, interesave politikë, arsyes së shëndoshë, primeve të reja diplomatike u shtoheshin si faktorë pozitivë në dobi të Shqipërisë, interesat ekonomikë dhe tregtarë amerikanë.⁵⁴ Më 26 prill 1922, zëvendës-presidenti i Sinclair Oil Exploration Company, A. C. Veatch, iu adresua Sekretarit të Shtetit me një letër, në të cilën shpjegonte se opinioni publik në Shqipëri ishte pro dhënies së koncesionit të naftës një kompanie joeuropiane dhe se, pas kapërcimit të vështirësive të njohjes së qeverisë dhe shtetit shqiptar në muajin nëntor 1921, çështja e koncesioneve të naftës pritej të trajtohej në mbledhjen e parë të Parlamentit të ri, në muajin maj të vitit 1921. Ai i tërhoqi vëmendjen Departamentit Amerikan të Shtetit se interesat amerikanë, jo vetëm në lidhje me koncesionet e naftës, por edhe me aspekte të tjera, deri në vitin 1922 kishin qenë në disavantazh, pasi SHBA-ja nuk kishte ndjekur shembullin e shteteve të mëdha europiane për njohjen e Shqipërisë pas nëntorit të vitit 1921. Prandaj, ai rekomandonte me forcë që SHBA-ja duhej të dërgonte një përfaqësues të vetin në këtë vend, që nuk mund të lihej jashtë trajtimit sinkron me fuqitë e tjera.⁵⁵

Reagimi i Sekretarit të Shtetit Hughes ishte i menjëhershëm. Ai emëroi konsullin e Përgjithshëm në Tanger, Denning si të Dërguar të Posaçëm në Shqipëri me statusin e konsullit të Përgjithshëm mbi bazën e caktimit të përkohshëm. Në mesazhin e caktimit të misionit, të nisur më

⁵³ *National Archives and Records Administration*, Maryland (USA) (më tej: NARA), Microcopy 1211, Roll 1, Report on the Albanian Situation - October- november 1921, Prepared by John F. Carter, Jr. Lately attached to the American Embassy at Rome, December 14th, 1921.

⁵⁴ NARA, M1211/R1-D, C. Telford Erickson to Lt. Col. Edward T. Donnelly, Military Attache, American Embassy, Rome, Italy, Tirana, Albania, May 1, 1922.

⁵⁵ *Papers relating to the foreign relations of the United States*, 1922, vol. I (1922), Joseph V. Fuller (ed.) (United States Government Printing Office, Washington: 1938). Vice President of the Sinclair Exploration Company, A.C. Veatch, to the Secretary of State, New York, April 26, 1922.

datë 27 prill 1922, Sekretari i Shtetit i bëri me dije se DASH po e merrte në konsideratë njohjen e Shqipërisë, por, më përpara ky institucion kishte nevojë për një raportim të hollësishëm mbi gjendjen në vend, qëndrueshmërinë e qeverisë së atëhershme të Shqipërisë, interesat ekzistues dhe projektimet e ardhshme të SHBA-së në atë vend.⁵⁶

Është koha kur Fuqitë e Këshillit të Epërm të Antantës e kishin njohur Shqipërinë *de jure*. Nga ato vende, Anglia dhe Italia kishin dërguar ministrat e vet, të cilët ishin shumë aktivë; Franca përfaqësohej nga konsulli në Shkodër, Japonia nuk kishte ende një përfaqësues pavarësisht njohjes, ndërkohë që njohje kishin akorduar Finlanda, Zvicra, Belgjika dhe Jugosllavia, kjo e fundit e përfaqësuar nga një i ngarkuar me punë.⁵⁷

Më 18 maj 1922, Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendosi që vetë Lidhja të merrte protektoratin mbi Shqipërinë dhe se do të emëronte disa ekspertë financiarë ekonomikë dhe ligjorë për t'i asistuar vendit të ri. Këshilltarët ishin udhëzuar të mos punonin në mënyrë preferenciale, por të paanshme, me synimin për ta bërë pavarësinë e Shqipërisë sa më efektive. Italia protestoi në lidhje me këto tagra të marra nga Lidhja, me pretendimin se Shqipëria ishte një interes i veçantë i Italisë.

Duhet të kujtoj edhe një zhvillim tjetër të brendshëm ndërqeveritar amerikan që vulosi përfundimisht nisjen e misionit në Shqipëri. Më 26 prill 1922, Sekretari i Tregtisë (Hoover), në një letër drejtuar Sekretarit të Shtetit Hughes, tërhoqi vëmendjen mbi negociatat që po zhvilloheshin nga Sinclair Oil Corporation për koncesionin e vajgurit të Shqipërisë. Për këtë arsye, ai mendonte se, do të duhej të merrej në konsideratë serioze çështja e njohjes së Shqipërisë dhe dërgimi sa më shpejt i një

⁵⁶ *Po aty*. The Secretary of State, Hughes to the Diplomatic Agent and Consul General at Tangier (Denning), Washington, April 27, 1922.

⁵⁷ NARA, M1211/R1-D. American Commissioner, Maxwell Blake for Secretary of the State, Hughes, Tirana, Albania, August 2, 1922. (Lista e njohjeve të Shqipërisë prej qeverive të vendeve të ndryshme është si vijon: Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia e kanë njohur sipas radhës së mësipërme: më 9 nëntor 1921, Austria më 18 shkurt 1922, Finlanda më 27 shkurt 1922, Luksemburgu më 1 mars 1922, Zvicra më 8 mars 1922, Bullgaria më 24 mars 1922, Jugosllavia më 25 mars 1922, Danimarka më 12 prill 1922, Suedia më 13 prill 1922, Norvegjia më 6 maj 1922, Hungaria më 9 maj 1922, Gjermania më 19 maj 1922, Portugalia më 28 maj 1922, Holanda më 30 maj 1922, Greqia më 26 qershor 1922 dhe SHBA më 28 korrik 1922).

përfaqësuesi atje.⁵⁸ Gati një muaj më vonë, më 22 maj 1922, Sekretari i Shtetit iu përgjigj kolegut të tij duke e sqaruar, se konsulli i Përgjithshëm Maxwell Blake, ish-agjent diplomatik dhe konsull i Përgjithshëm në Tanger, ishte urdhëruar që të udhëtonte në Shqipëri për të bërë vlerësimet e përgjithshme mbi këtë vend, përfshirë çështjen e kompanisë amerikane të naftës.⁵⁹

Siç duket, meqenëse Joseph M. Denning mori detyrën e konsullit të Përgjithshëm në Tanger në vitin 1922, komisioner amerikan në Shqipëri në fund ishte caktuar Maxwell Blake, konsull i deriatëhershëm në Tanger. Më 28 qershor 1922, pas udhëtimit anekënd Shqipërisë, Blake dorëzoi raportin. Pasi përshkruan me profesionalizëm gjendjen reale të vendit në pikëpamje të autoritetit shtetëror, përfaqësisë politike, administratës, gjendjes ekonomike dhe financiare, *Blake njoftonte se qëndrimi i qeverisë shqiptare dhe i popullit karshi interesave amerikanë ishte veçanërisht favorizues. Atij i ishte bërë e qartë, se qeveria shqiptare mezi priste për të krijuar çdo lehtësi për tregtinë amerikane dhe ndërmarrjet; se qeveritarët e rinj shqiptarë ishin të gatshëm për të ftuar kapitalin amerikan të asistonte në zhvillimin e vendit dhe t'i jepnin SHBA-së garanci për sigurimin formal të trajtimit si kombi më i favorizuar etj.* Konsulli Blake, pas shqyrtimit të kujdesshëm të të gjitha aspekteve të situatës në shumë pjesë të vendit, **rekomandoi njohjen e menjëhershme të Shqipërisë nga ana e qeverisë amerikane.** Arsyetimi i M. Blake-ut: 1- si një akt të vetvetishëm moral ndaj popullit shqiptar në një fazë kritike të luftës së tij për pavarësi, ku pavarësisht vështirësive të mëdha, ky vend kishte dhënë prova të mjaftueshme të qëndrueshmërisë politike, duke ngjallur admirimin e Lidhjes së Kombeve si shtet sovran, i njohur prej 20 vendeve të Europës; 2- si arsye të dytë, Blake caktonte faktorët materialë, të cilët ishin në mënyrë të barabartë të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë. Vendi kishte mundësi të mëdha tregtare dhe zotëronte rezerva të pasura natyrore që prisnin të zhvilloheshin. Çdo zgjatje kohore e njohjes do të vononte mbështetjen e qeverisë amerikane për kompanitë tregtare të këtij vendi dhe ishte në dëm të prestigjit të lartë që kishte Amerika në Shqipëri. Në fund, Blake saktësonte se, në qoftë se

⁵⁸ *Papers relating to the foreign relations of the United States*, 1922, vol. I, Albania. The Secretary of Commerce (Hoover) to the Secretary of State, Hughes, Washington, April 26, 1922.

⁵⁹ *Po aty*. The Secretary of State (Hughes) to the Secretary of State Commerce (Hoover), Washington, May 22, 1922.

njohja do të aprovohej, legata duhej të vendosej dhe një ministër i Plotfuqishëm duhej të caktohej menjëherë, me seli ose në Tiranë, ose përkohësisht në Durrës ose në Shkodër. Interesat amerikanë kërkonin që përfaqësuesi i SHBA-së nuk duhej të ishte në ndonjë rang më të ulët se përfaqësuesit e fuqive të tjera në Shqipëri.⁶⁰

Pas këtij raporti të Blake-ut, Sekretari i Shtetit Hughes udhëzoi konsullin Blake, që, më datë 28 korrik 1922, të lajmëronte ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, me anën e një njoftimi të shkruar, se qeveria e SHBA-së njihte *de jure* Shqipërinë. Në dhënien e kësaj njohjeje, qeveria e SHBA-së ishte nisur nga fakti *se Shqipëria ia kishte dalë të ruante me sukses kohezionin e një qeverie kombëtare*. Derisa Kongresi të vendoste mbi çështjen e përfaqësisë së rregullt diplomatike në Shqipëri, *Blake do të vepronte si komisioner i SHBA-së në rangun e ministrit në Shqipëri*, detyrë të cilën e kreu deri më 4 dhjetor 1922 kur *Ulysses Grant-Smith u caktua i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër i Plotfuqishëm në Shqipëri*.⁶¹

Konkluzione

Qëndrimi i SHBA-së ndaj Shqipërisë pas LPB-së ishte vendimtar në shpëtimin e Shqipërisë, përkundërt përpjekjeve për përdorimin e saj si hapësirë për shkëmbim territori mes vendeve ballkanike dhe Italisë, të ndërmarra nga vendet fituese dhe vendimmarrëse në konferencë. Këmbëngulja parimore amerikane zhvleftësoi dy traktate të fshehta, ku Italia ishte pjesë ndërsa Serbia/Jugosllavia dhe Greqia përfituese: Traktatin e Fshehtë të Londrës dhe traktatin Tittoni-Venizellos. SHBA-ja jo vetëm zëvendësoi pak a shumë zbrazëtinë që la pas Austro-Hungaria në raport me mbikëqyrjen e Shqipërisë, por ia doli në fund të periudhës trevjeçare të diskutimit të statusit të Shqipërisë, të ruante shtetin shqiptar në kufijtë e vitit 1913, bazuar mbi parimet e së drejtës së kombeve, pa hyrë në tratativat e balancës së fuqisë, siç po tentohej deri atëherë. Pavarësisht se pozicioni fillestar nuk ka qenë i tillë dhe deri në këto përmasa, idetë e Presidentit Wilson në lidhje me çështjen shqiptare do të

⁶⁰ *Po aty*. The Commissioner in Albania (Blake) to the Secretary of State. Tirana, June 28, 1922.

⁶¹ *Po aty*. The Secretary of State (Hughes) to the Commissioner in Albania (Blake), Washington, July, 25, 1922.

vinin duke u plotësuar me kalimin e kohës, e për rrjedhojë, qëndrimi fillestar amerikan ndaj çështjes shqiptare do të pësonte ndryshime rrënjësore me kalimin e muajve dhe viteve, deri në zgjidhjen finale në Paris, që ishte produkt i linjave të kuqe të vendosura në Washington. Në saje të këtij qëndrimi të ri të qeverisë amerikane mund të themi se u arrit, më së shumti, shpëtimi i Shqipërisë së vitit 1913. Përkrahja e Presidentit Wilson ishte parimore dhe pozicioni i tij politik ndaj shqiptarëve rilindës, laikë e proeuropianistë, ishte i lidhur me formimin e tij filozofik dhe politik. Ai mbështeti parimin e përkatësisë etnike si përcaktues kryesor të kufijve kombëtarë, u dha shpresa shqiptarëve dhe të gjithë popujve e Europës Lindore për shtete të pavarura, të bazuara mbi identitetin e tyre etnik. Falë qëndrimit të prerë të Presidentit Wilson ndaj kërkesave territoriale të Italisë, u arrit që kursi politik i Romës ndaj Shqipërisë të ndryshojë dhe egoizmi i shfrenuar nacional i qeveritarëve italianë të ndalej. Në qëndrimin e Presidentit Wilson pasqyrohej gjithë filozofia racionale për mbështetjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, parimi se përkatësia etnike duhet të përcaktojë kufijtë kombëtarë. Ai shkoi në Versajë me shpresën për ta bërë botën më të sigurt për demokracinë. Kjo u shfaq në 14 Pikat e tij, të shpallura në janar të vitit 1918 për të cilat ai besonte se do të sillnin një paqe të qëndrueshme botërore. Presidenti amerikan shpresonte që diplomacia tani e tutje do të kryhej përmes besëlidhjes së hapur të paqes, jo traktateve sekrete; besonte se, nëse fuqitë fitimtare do të zbatonin parimin e drejtësisë për të gjithë popujt dhe kombësitë, qofshin ata të fortë apo të dobët, Europa do të hynte në një epokë stabiliteti të qëndrueshëm.⁶² Analiza e tij në këtë drejtim bazohej mbi arsyetimin e shkaqeve që çuan në Luftën e Parë Botërore dhe mbi atë se çfarë nuk shkonte me rendin e vjetër që i çoi qeveritë kombëtare në një luftë, e cila rezultoi në mjerim për miliona njerëz. Ai nxori mësim dhe u përpoq të gjente mënyrën që kjo gjë të parandalohet dhe të mos përsëritej. Në anën tjetër, ai strukturoi edhe bazën mbi të cilën mund të ndërtohej rendi i ri ndërkombëtar.⁶³ Përgjigjet e këtyre pyetjeve e bënë atë të mendonte se paqja do të vinte vetëm nëse ekuilibri klasik i forcës zëvendësohej me një sistem të sigurisë kolektive,

⁶² John Merriman, *A history of Modern Europe from the Renaissance to the Present* (New York - London: W.W. Norton & Company 1996), 1146.

⁶³ Shih për këtë edhe: Scot Burchill, Andrew Linklater, Richard Devetak, Jack Donnelly, Matthew Paterson, Christian Reus-Smit, Jacqui True, *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare* (Tiranë: AIIS, 2012), 9, 10.

përfshirë edhe konceptin e ndjekjes së drejtësisë për kombet e vogla, si Shqipëria. Wilson besonte se shpërthimi i Luftës së Madhe kishte treguar se koncepti diplomatik i një "ekuilibri të fuqisë", me të cilin forca mbizotëruese e një Fuqie balancohej nga aleancat midis disa fuqive të tjera, ishte i pabarabartë me detyrën e ruajtjes së paqes. Wilson u përkiste racionalistëve dhe realistëve që mendonin se një rend botëror më paqësor mund të krijohej duke i bërë elitat e politikës së jashtme përgjegjëse para opinionit publik dhe duke i demokratizuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Racionalizmi, dhënia e të drejtave përbënin premisat bazë të qëndrimit të tij. Për fat, kombi shqiptar pati një elitë mjaft të kualifikuar në SHBA që ndiqte me kujdes këtë ndryshim thelbësor të diplomacisë amerikane në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar si, Fan Noli, Faik Konica, Kostë Çekrezi, Mehmet Konica, Kolë Tromara etj., sikurse një elitë e brendshme që ia doli në Paris e prirë nga imzot Luigj Bumçi, Mihal Turtulli, atë Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mustafa Kruja, Mit'hat Frashëri etj. Kombinimi i faktorit të jashtëm me elitën e brendshme europianiste, që diti të mbisundojë dhe të fshijë trashëgiminë otomaniste dhe esadiste, mundësoi ruajtjen e Shqipërisë së Vogël, asaj të vitit 1912-1913 në kohën e rindërtimit shtetëror 1918-1921.

Bibliografi:

Arkiva:

National Archives and Records Administration (NARA), Maryland USA
Microcopy 1211 Roll 1 – D, years: 1919-1923

The National Archives, London (TNA)

PRO FO 371/5725, 5049/580/90; PRO FO 608/28.doc.no. 4775; PRO FO 608/28. doc.no. 5050; PRO FO 608/28, doc.no.2483; PRO FO 371/5726; PRO FO 371/4689 doc.no.7998; PRO. FO. 371. 4689, doc.no. 696; PRO FO 371/3571.doc.no.146304; PRO FO 371/3571.doc.no.116644; PRO FO 371/5726, C 7684/580/90; PRO FO 371/5727, C12276/580/90; PRO FO 371/5733, C 21384/580/90.

Botime dokumentare:

Albrecht-Carrié, René. *Italy at the Paris Peace Conference*, published for the Carnegie Endowment for International Peace in the Series The Paris

Peace Conference-History and Documents. Columbia University Press, New York: Morningside Heights, 1938.

British Documents on Foreign Affairs. Reports and papers from the Foreign Office Confidential Print, General Editors Kenneth Bourke and D. Cameron Watt, Part II Series I, The Paris Peace Conference of 1919, editor M. Dockrill Volume 10. University Publication of America: 1991.

Documents on British Foreign Policy 1919-1939, edited by Rohan Butler, J.P.T. Bury, M.E. Lambert. First Series, Volume XII. London: Her Majesty Stationery Office 1962.

Documents on British Foreign Policy 1919-1939, edited by W.N. Medlicott and Douglas Dakin, assisted by Gillian Bennett. First Series, Volume XXII. Central Europe and Balkans 1921, Albania 1921-22. London: Her Majesty's Stationery Office, 1980.

Papers relating to the foreign relations of the United States, 1922. Volume I 1922 United States Department of State Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office, 1922
<https://digital.library.wisc.edu/1711.dl/G5OAT7XT7HRHX84>.

The Adriatic Question, Presented by Mr. Hitchcock. Washington: Government Printing Office, 1920.

Literaturë historiografike:

Bumçi, Luigj. “Nji fletë e re në historin kombtare”, *Hylli i Dritës*, 1934/5.

Burchill, Scot & Andrew Linklater, Richard Devetak, Jack Donnelly, Matthew Paterson, Christian Reus-Smit, Jacqui True. *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare*, Tiranë: AIIS, 2012.

“Correspondence relating to the Adriatic Question, Presented to Parliament by Command of His majesty, London 1920”, *Miscellaneous* No. 2 (1920), në Library of LSE CHAT K5/175.

Gelfand, Lawrence E. *The Inquiry, American preparations for peace 1917-1919*. New Heaven: Yale University Press, 1963.

Henig, Ruth. “New Diplomacy and Old: a Reassessment of British Conceptions of a League of Nations, 1918-1920”, në *The Paris Peace Conference, 1919 - Peace without Victory?*. Edited by Michael Dockrill and John Fisher, Palgrave in association with the Public Record Office. New York: 2001.

Hupchick, Dennis P. *The Balkans, from Constantinople to Communism*. New York: Palgrave, 2002.

Ikonomi, Ilir. *Fan Noli*, vëll. I. Tiranë: Apostulli, 2023.

Kadria, Sali. “Çështja e kufijve jugorë të shtetit shqiptar në vitet 1921-1923”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 50, Prishtinë: 2020.

- Kadria, Sali. “Çështja e statusit politik të shtetit shqiptar gjatë vitit 1921”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 49, Prishtinë: 2019.
- MacMillan, Margaret. *Paris-Six Months that Changed the World, 1919*. New York: Random House, 2002.
- Merriman, John. *A history of Modern Europe from the Renaissance to the Present*. New York-London: W.W. Norton & Company, 1996.
- Miller, David Hunter. *My Diary at the Conference of Paris, with Documents*, (20 vol.), vol. IV. New York: Appeal Printing Co., 1928.
- Pastorelli, Pietro. *L’Albania nella politica estera italiana 1914-1920*. Napoli: Editore Jovene, 1970.
- Pearson, Owen. *Albania and King Zog-Independence, Republic and Monarchy 1908-1939*. London: The Center for Albanian Studies in association with I B Tauris Publishers, 2004.
- Warbrik, Colin. “States and recongnition in international law”, në *International Law*, edited by Malcolm D. Evans. Oxford University Press, second Edition 2006.
- Wolff, Robert Lee. *The Balkan in our time*. Cambridge, Massachusetts: Harward University Press, 1956.
- Woodall, Robert Larry. *The Albanian Problem During the Peacemaking, 1919-1920*. Memphis State University: University Microfilms International, 1978.

ROMEO GURAKUQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

romeo_gurakuqi@hotmail.com

romeo.gurakuqi@asa.edu.al

S u m m a r y

THE ROLE OF THE USA IN THE REESTABLISHMENT OF THE ALBANIAN STATE AFTER WORLD WAR I

The period from December 1918 to July 1922, marked by the redefinition of Albania's state status and borders (November 9, 1921) and the completion of international recognitions (July 28, 1922), is characterized as the era of independence and the Second State Formation of Albania in the Modern Era. This documentary review and analysis of events uncovered through archival research provide new insights into the Reestablishment of the State and its

second international recognition. The dynamics of the shift in the American government's official stance have not been thoroughly studied or documented before. The author traces the history of the evolving American stance on the rights of the Albanian people, influenced by several factors: the degree to which President Wilson's rationalist and realistic New Diplomacy principles were implemented, pro-Albanian lobbying efforts, the Albanian elite diaspora in the USA and Europe, interventions by the Holy See in support of Albanian rights in Northern Epirus/Southern Albania, and more. Although the Albanian issue was not resolved at the Paris Peace Conference, Albania was not divided during this conference. In this initial victory (1919-1920), the USA played a decisive role, effectively replacing the role previously held by the now-disintegrated Austro-Hungarian Empire. Despite the ambitions of Italian politicians, Italy's military occupation of Albania persisted until August 1920, when Albanians successfully resisted and expelled them. Following these events and the Preliminary Protocol of August 2, 1920, Italy, under Prime Minister Giolitti's different policies, withdrew militarily from Albania and began a gradual and successful policy of economic and political penetration. Meanwhile, Yugoslavia made significant military incursions and held a strip of land up to 15 km inside Albania until early 1922. Greek troops also occupied several villages in the former Kaza of Koritza. The end of 1920 and 1921 was a turning point for Albania. The USA, gradually joined by Great Britain, defended Albania's rights. Albania was admitted to the League of Nations on December 17, 1920, and on November 9, 1921, its state status and borders were internationally recognized, leading to gradual international recognitions. The departure from the Old Diplomatic course followed by France and Italy, with initial British indifference, resulted from the decisive and principled stances of American diplomacy. This intervention, documented through archival research, is the focus of the author's study. The final part of the article discusses the official recognition and establishment of diplomatic relations between Albania and the USA. The research draws on archival sources from two main archives in the United Kingdom and the USA, as well as published archival documents between the two countries, some of which are presented to the public for the first time.

KLEJD KËLLIÇI

Fakulteti i Shkencave Sociale / Universiteti i Tiranës
k.kellici@gmail.com

ERMIRA DANAJ

American Graduate School, Paris
edanaj@gmail.com
<https://doi.org/10.61773/x0ftkm30>

**EMANCIPIMI I GRUAS: LIGJËRIMI MBI ROLIN
E GRUAS NË VITET 1960-1970 NË FAQET E REVISTËS
“SHQIPTARJA E RE”**

Abstrakt:

Ky punim është një përpjekje për të identifikuar faza të ndryshme të ligjërimit të konceptit të emancipimit të gruas gjatë komunizmit në Shqipëri mes viteve 1950-1970. Emancipimi i gruas shihet si një prej politikave më të rëndësishme të aplikuara me themelimin e regjimit, e po kështu ndër ato më afatgjatë në ndërhyrje. Gratë u bënë subjekt ndërhyrjeje e transformimi të drejtuar nga Partia, e cila përcaktonte identitetin e mënyrën se si ky i fundit duhej të shfaqej në hapësirën e re të Shqipërisë socialiste. Shqetësimi apo ndërtimi i politikave publike mbi emancipimin e gruas ishte pjesë sa e arsenalit ideologjik, aq edhe e modeleve tashmë të manifestuara si ai i Bashkimit Sovjetik. Kështu regjimi jo vetëm që u mundua të vepronte e të transformonte gruan nisur nga parimet ideologjike të marksizmit por, mbi të gjitha, u mundua të aplikonte një model të provuar e të dëshirueshëm imitimi, atë sovjetik duke u përpjekur më pas, sidomos pas vitit 1961 të ofronte një version shqiptar të modelit të emancipimit të gruas.

Fjalë kyçe:

Grua, emancipim, socializëm, punë, sakrificë.

Hyrje

Roli dhe identiteti i gruas në komunizëm ishte i paracaktuar nga doktrina marksiste dhe modeli sovjetik. Megjithatë, kushtet specifike të Shqipërisë, detyruan autoritetet komuniste ta përshtatnin logjikën dhe praktikën e emancipimit të grave me rrethanat në të cilat ndodhej vendi. Teza kryesore e punimit ka të bëjë me faktin se: *së pari*, emancipimi i grave në Shqipëri, si politikë, ndiqte proceset modernizuese që kishin filluar në vend përpara vendosjes së regjimit komunist; *së dyti*, proceset emancipuese diktoheshin nga nevoja, më tepër e shtetit sesa e vetë grave. Përcaktimi identitar që u bënte shteti grave e burrave, parashikonte që këto identitete do të rikonfiguroheshin sa herë që të ishte e nevojshme, pa pasur parasysh aspiratat emancipuese të grave. Parashikimet ideologjike asnjëherë nuk u realizuan deri në fund, për shkak të rezistencës së pandërgjegjshme e formimit kulturor të elitave politike shqiptare, të mënyrës se si ushtrohej pushteti e të nevojës për të mos u përballur deri në fund me shoqërinë, duke i lënë kësaj të fundit edhe hapësira autonomie në raportimet gjinore.

Ky artikull synon të analizojë mënyrën se si artikullohet emancipimi i grave në revistën “Shqiptarja e re”, mes viteve 1950-1970. Në fillim të viteve '60, modeli i emancipimit do të synonte të paktën në imagjinimin e një shoqërie materiale,¹ në të cilën gruaja do të integrohej përmes punës, por ku do të ishte edhe konsumatore. Në mesin e viteve 1960 dhe sidomos nga viti 1967 e në vijim, theksi i ligjëritimit zhvendoset te puna si sakrificë, ku roli i gruas merr dimensione shumëplanëshe. Gruaja është i vetmi subjekt, i cili imagjinohej se mund të merrte një shumësi rolesh, njëkohësisht si grua, nënë, amvisë, punëtoare apo ushtare. Kjo vihet re sidomos me Bashkimin Sovjetik dhe vetëpërcakton modelin e socializmit shqiptar si të ndërtueshëm, jo në harmoni me vendet e Bllokut Socialist, por si një model të mëvetshëm, i cili ndërtohej në kushtet e një lufte e pamjaftueshmërie materiale. Emancipimi kthehet në një sakrificë të

¹ Klejd Këlliçi & Ermira Danaj, “Promoting Equality, Perpetuating Inequality: Gender Propaganda in Communist Albania”, në *History of Communism in Europe*, vol. 7-2016, Institute for Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile (Bucharest), Dalia Bathory (ed.) (Zeta Books: 2016), 39-61. <https://doi.org/10.5840/hce201673>.

vazhdueshme ku gruas i kërkohet, jo vetëm të performojë në vendin e punës por edhe të kujdeset për familjen, në emër të ndërtimit të një socializmi sakrificë. Ky punim mbështetet kryesisht në materiale arkivore dhe artikuj të revistës “Shqiptarja e re”. Ajo ishte e vetmja revistë dedikuar posaçërisht gruas, e njëkohësisht organi zyrtar i shtypit i Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Si e tillë, revista ishte një kanal i komunikimit të politikave zyrtare mbi gruan dhe, për pasojë, ndërtimit të një ligjërimi specifik mbi to. Kjo analizë do të shtrihet përgjatë viteve 1945-1979, vite kur ligjërimi emancipues ishte në pikun e tij.

Punimi do të ndahet në tri pjesë. Në të parën, do të bëhet një parashtrësë teorike e studimeve gjinore mbi komunizmin për të kuptuar orientimet e hipotezat kryesore kërkimore. Kjo parashtrësë do të kërkojë ta vendosë projektin emancipues në një plan krahasimor me studimet mbi emancipimin në hapësirën ish-sovjetike, duke mëtuar ofrimin edhe të një perspektive krahasimore. Njëkohësisht, në parashtrësën teorike do të analizohet edhe roli i gazetave të grave në hapësirën ish-sovjetike për të ardhur më pas në rastin specifik. Në pjesën e dytë, analiza e revistës do të përqendrohet në objektivat kryesorë të emancipimit në komunizëm duke pasur parasysh jo vetëm ndërtimin e identitetit, por edhe rolet që gruas i kërkohen të luhen në shoqërinë shqiptare dhe ndërtimin e socializmit. Në pjesën e tretë, do të trajtohet kohëzimi i ligjëritimit emancipues, i paraparë në dy logjika: atë të së ardhmes së ndritur dhe atë të sakrificës permanente.

Aparati teorik

Studimet gjinore për vendet ish-komuniste luhaten sa nga sintetizimi i elementeve teorike, aq edhe në studimet e rasteve specifike. Produktet e mësipërme shkojnë paralelisht e nuk i nënvendosen apo mbivendosen njëra-tjetrës. Fillimisht, ato nisen nga analiza e elementeve ideologjike dhe më pas riprodhimit të tyre në një rast specifik, nga lart poshtë (shih rastin e Bashkimit Sovjetik) dhe në rrezatime paralele (vendet e Europës Lindore). Për këtë arsye, në këtë punim aspektet teorike të trajtuara do të huazohen dhe do të diskutohen në lidhje me raste specifike si ato të Bashkimit Sovjetik, Hungarisë apo Rumanisë. Ndonëse vende të ndryshme, pas Luftës së Dytë Botërore aplikuan metodën sovjetike edhe në raport me emancipimin, e natyrisht kjo metodë, pavarësisht se pranohej se kishte vlera absolute, u përthye dhe u ripërthye, pasi iu përshtat kushteve specifike, ndjeshmërive të elitave por

edhe rezistencës që shoqëritë e këtyre vendeve i bënë metodës sovjetike. Në Bashkimin Sovjetik, emancipimi i gruas ishte pjesë integrale e revolucionit. Ai mbështetej në disa elemente klasike teorike të elaboruara nga Marksi dhe Engelsi. Ato nuk merreshin specifikisht me konceptin e barazisë sesa e nënkuptonin atë në raport me shkatërrimin e rendit pararendës, i cili mbështetej sa në strukturën patriarkale të njësisë bazë të shoqërisë – familjes, aq edhe në shfrytëzimin e grave dhe fëmijëve në raportet e punës.² Megjithatë modeli sovjetik ishte ai bazë, mbi të cilin u ngritën dhe u formuan modele të ngjashme emancipimi shoqëror të grave në hapësirën komuniste. Duhet pasur parasysh se, metoda apo mënyra sovjetike vinte e konsoliduar në atë që tashmë në historinë e komunizmit shihet si “stalinizëm i lartë”. Kështu, vendet e Europës Lindore huazuan jo vetëm modelin, por edhe frymën mbi të cilin ky model ngrihej. Ashëin³ bën një përmbledhje pak a shumë të të gjitha drejtimeve në të cilat kalonte emancipimi i gruas në komunizëm. Pikësëpari, vizioni mbi gruan në regjimet socialiste lidhet me atë të ndërtimit apo modelimit të një subjekti të ri, i cili shkon paralel me idenë e njeriut të ri. Gruaja kthehet më tepër në instrument sesa një subjekt i cili fiton liri e mundësi veprimi, apo për ta thënë më saktë, këta kufij e liri veprimi përcaktoheshin nga Partia e udhëheqësi, asnjëherë nga gratë. Fodor thekson disa linja kryesore, atë të ndërtimit të gruas si subjekt komunist, me rol të përcaktuar nga shteti e me identitet të variuar në funksion të problematikave me të cilat përballej shteti.⁴ Ajo shkon më tej duke ndërfutur konceptin e patriarkisë, atë që komunizmi kërkonte të luftonte brenda arsenalit të veprimit të vendeve komuniste. Fodor thotë se patriarkia ishte një koncept fleksibël, i cili rëndom u përdor në regjimet komuniste në Europën Lindore. Chatterjee sheh politikat emancipuese si justifikuese në raport me vetimplementimin e stalinizmit, përfshi këtu

² Për shqyrtimin e aspekteve teorike të Marksit dhe Engelsit, shih Joan B. Landes, “Marxism and the Women’s question”, 15-28, në *Promissory Notes: Women in the Transition to Socialism*, Sonia Kruks, Rayna Rapp, Marilyn Blatt Young (editors), (New York: Monthly Review Press, 1989), 22-23.

³ “Introduction: Gender, state and society in Soviet and post-Soviet Russia”, 1-29, në *Gender, State and Society in Soviet and Post-Soviet Russia*, Sarah Ashwin Sarah (ed.), (Routledge: 2000).

⁴ Éva Fodor, “Smiling Women and Fighting Men: The Gender of the Communist Subject in State Socialist Hungary”, *Gender & Society*, vol. 16, no. 2 (2002), 240-263.

rolin e grave dhe promovimin e tyre në procesin e kolektivizimit.⁵ Gal dhe Kligman ndërkohë e paraqesin procesin e emancipimit si një proces manipulativ, i cili ndikon dhe drejton riprodhimin e raportet mes burrit dhe gruas.⁶ Shteti postrevolucionar, në përpjekje për të ndërtuar socializmin ripërcaktoi jo vetëm pozitën e gruas, por u fut edhe në proceset e riprodhimit, duke e ngarkuar gruan me barrën e dyfishtë: atë të punës dhe riprodhimit. Në të njëjtën linjë, Tricia Starks, bën analizën e proceseve të higjienizimit të popullsisë në Bashkimin Sovjetik. Ajo i sheh gratë si një prej instrumenteve kryesore të futjes së shtetit në mjedisin familjar, qoftë duke i vendosur ato në pozitën e kujdestares së familjes, por edhe duke i fuqizuar ato që të vepronin si një zgjatim i shtetit brenda familjes.⁷ Katherine Verdery, në anën tjetër, sheh logjikën e emancipimit të ndërlidhur me një patriarki të detyruar, me vizionin e shtetit socialist si një familje e madhe, ku rolin e patriarkut tashmë e merrte në dorë shteti.⁸ Socializmi ishte një regjim paternalist, i cili, pa dyshim, fshiu shumë dallime mes burrave dhe grave, në një shkallë akoma më radikale se në vendet kapitaliste apo ato në proces e sipër modernizimi, por gjithsesi pozita e gruas u përshtat ose u ndërtua si e tillë që ajo brenda familjes të luante rolin që përcaktonte shteti. Verdery e shtyn më tej analizën e saj për patriarkinë socialiste, pasi ajo e lidh atë me dy elemente të tjera, regjimin e pamjaftueshmërisë materiale dhe emergjencën nacionaliste. Regjimet komuniste operonin në skarcitet të mirash materiale apo pamundësi për t'i prodhuar ato, si pjesë e premtimeve mesianike për mirëqenie. Në anën tjetër, këto regjime bartnin mbi vete pamundësinë për t'u shkëputur nga elemente të traditës politike, si p.sh. nacionalizmin, kjo edhe nga vetëpamundësia për të realizuar projektin e tyre politik.

Sipas Verdery-t, transformimi i sforcuar i ekonomive të vendeve lindore u bë në kushtet e pamjaftueshmërisë së kapitalit në njërën anë dhe

⁵ Choi Chatterjee, "Soviet Heroines and Public Identity, 1930-1939", in *The Carl Beck Papers in Russian & East European Studies*, no. 1402 (1999).

⁶ Susan Gal & Gail Kligman, *Reproducing Gender: Politics, Publics, and Everyday Life after Socialism* (Princeton, N.Y.: Princeton University Press, 2000) 8.

⁷ Tricia Starks, *Propaganda Hygiene and the Revolutionary State* (Wisconsin University Press: 2008), 10.

⁸ Katherine Verdery, "From parent-state to family patriarchy: Gender and nation in contemporary, Eastern Europe", *East European Politics and Societies*, 8 (1) (1994), 225-255.

të çlirimit me ligj të grave si forcë prodhuese, nga ana tjetër. Ky proces kërkonte angazhimin e krahut të lirë të punës, por pa i lëkundur fort pozitat e saj gjinore.⁹ Futja e grave në punë u shoqërua me konceptin e sakrificës dhe jo vetëm si detyrim e pjesë e agjendave emancipuese, por edhe të mirënjohjes për Partinë dhe udhëheqësin, të cilët bënë të mundur emancipimin. Megjithatë, këto nuk mjaftojnë.

Verdery, në studimet e saj mbi Rumaninë, flet për rëndësinë që regjimi i Çausheikut i dha traditës e nacionalizmit. Në pamje të parë, nacionalizmi e socializmi janë dy tradita e projekte politike antitetike që përjashtojnë njëra-tjetrën. Në shumë prej vendeve lindore, regjimet jo vetëm që nuk përmbysën dhe eliminuan elementet e nacionalizmit, por, përkundrazi, i zhvilluan dhe i përpunuan në funksion të agjendave të tyre politike. Në rastin e Rumanisë, Verdery interesohet kryesisht për dimensionin gjinor që i jepet nacionalizmit dhe trajtesën e tij në pikëpamje më shumë femërore, sesa mashkullore.¹⁰ Sipas saj, ndonëse nacionalizmi në socializëm ishte, si mashkullor edhe femëror, gratë konsideroheshin rëndom si bartëse të traditës, vazhduese të kombit por edhe prodhuese të heronjve të tij. Shoqëria komuniste konsiderohej kështu një familje e kolektiv i madh ekskluziv i cili, ishte gjithmonë në rrezik e për këtë lipsej kontributi i gjithkujt, edhe ai i grave. Regjimi i vazhdueshëm i pamjaftueshmërisë materiale, mungesa e kapitalit, nevoja për krahë pune e pozicionin gruan në komunizëm si heroinë, e cila duhej të luftonte në shumë fronte. Për të, shpërblimi që sillte emancipimi do të duhej të ishte sakrifica.

Studimet mbi emancipimin janë përqendruar në studimin e gruas kryesisht si instrument për përçimin e politikave publike.¹¹ Musaj, Rama dhe Pandejmoni kanë parë raportet gjinore, pas vitit 1967, vit ky, kur përpjekjet emancipuese u intensifikuan në Shqipëri, pas influencës së Revolucionit Kulturor kinez. Ato vërejnë se si emancipimi nuk arriti

⁹ Katherine Verdery, *What is Socialism and what comes next* (Princeton University Press: 1996), 64.

¹⁰ *Po aty*, f. 70.

¹¹ Klejd Këlliçi & Ermira Danaj, "Shoqja N ka lënë punën", në *Politikja* 2 (2017), 40-63, 44.

rezultate të njëjta me ato që propagandoheshin nga regjimi dhe se si gratë shpesh, iu nënshtruan një regjimi pune të dëmshëm për shëndetin e tyre.¹²

Këto studime e hulumtime, duke parë se si gratë futeshin në procesin e punës, mbeten një prej elementeve kryesore të dinamikave dhe raporteve të regjimit socialist me to.¹³ Studime të tjera kanë prekur elementin e propagandës, kryesisht në hulumtimin e elementeve dhe materialeve të shtypit të shkruar, sidomos të revistës “Shqiptarja e re”, ku mund të përmendet studimi i Irida Vorpsit.¹⁴ Ajo konsideron se, propaganda vizuale kërkonte të provonte emancipimin përmes përfigurimit të gruas si pjesëmarrëse aktive në shoqërinë socialiste, dhe se si puna që ajo bënte e vërtetonte këtë. Shannon Woodcock dhe Luljeta Ikononi e shohin pozitën e grave në socializëm nga lart poshtë. Punimi i tyre përqendrohet në analizën e letrave e denoncimeve të grave, që i drejtoheshin Enver Hoxhës mbi abuzimet seksuale që kryheshin ndaj tyre në familje.¹⁵ Autorët shohin se si këto denoncime përdoren si mekanizëm e instrument kontrolli nga Partia për të ndëshkuar në mënyrë selektive kundërshtarët politikë. Ky studim, mbështetet mjaft edhe në analizën e intervistave orale, gjë që përbën dhe mekanizmin metodologjik kryesor të Woodcock-ut në librin e saj “Life is War: Surviving Dictatorship in Communist Albania”.¹⁶ Autorja tregon se si subjektet e politikave të regjimit, përfshi edhe gratë, u vendosën nën një patriarkalizëm tashmë plural, atë të burrit brenda shtëpisë e punëdhënësit jashtë saj, ku shumë norma të shoqërisë tradicionale nuk ndryshuan. Kjo panoramë gjithsesi mbetet për t’u plotësuar. Një trajtesë që ky punim kërkon të bëjë, është rimarrja e konceptit të Fodor-it mbi natyrën elastike të patriarkalizmit dhe atë të urgjencës e pamundësisë së transformimeve shoqërore, pa marrë parasysh mungesën e kapitalit, regjimin e pamjaftueshmërisë

¹² Fatmira Musaj, Fatmira Rama & Enriketa Pandelejmoni, “Gender relations in Albania 1967-2009”, në *Gendering Post-Socialist Transition: Studies of Changing Gender Perspectives*, Krassimira Daskalova (ed.) (Vienna: Verlag, 2012).

¹³ Këlliçi & Danaj, “Shoqja N”, 46.

¹⁴ Irida Vorpsi, “Fotografia si mjet i përhapjes së propagandës së emancipimit të gruas në Shqipërinë komuniste”, në *Përpyekja*, Viti XX, nr. 32-33 (2014), 183-204.

¹⁵ Luljeta Ikononi & Shannon Woodcock, “Imoraliteti në familje: Nxitja e ankesave të grave për të përforcuar pushtetin e Partisë në revolucionin kulturor shqiptar”, *Përpyekja*, Viti XX, nr. 32-33 (2014), 155-182.

¹⁶ Shannon Woodcock, *Life is War: Surviving Dictatorship in Communist Albania* (Hammeron Press: 2016), 199.

materiale dhe kushtet politike specifike në të cilat u implementuan politikat emancipuese.

Ligjërimi dhe praktika e emancipimit në Shqipërinë komuniste nuk ishin të qëndrueshme. Sikurse do të shihet edhe në këtë punim, deri në fillim të viteve '60, politikat emancipuese synonin pranimin e modelit duke propaganduar zhvillimet dhe avancimet e Bashkimit Sovjetik. Në fillim të viteve '60, me proceset e industrializimit dhe kolektivizimit, gruas iu kërkua të ishte pjesë e proceseve prodhuese, dhe më pas ky ligjërimit u kthye në një sakrificë permanente, ku gruaja glorifikohet jo thjesht si një subjekt i emancipuar nga Partia, por, si një vijimësi tradicionale e gruas shqiptare, një model që vinte nga lashtësia apo tradita luftarake e popullit shqiptar, pjesë e së cilës gratë kishin qenë. Regjimi nuk bënte gjë tjetër veçse e rizbulonte këtë të vërtetë, andaj shumësia e roleve që gruaja duhej të kryente ishte më shumë pjesë e historisë sesa praktikë e regjimit.

Premtimi i bollëkut dhe parajsa socialiste

Modeli emancipues për gruan propagandohej, jo vetëm si pjesë esenciale e shoqërisë së re socialiste, por vinte paralel me vendosjen e vendit në Kampin Socialist. Krahas ndryshimeve, grave u premtohet që do të zhvilloheshin nën një model të caktuar shoqëror, të paktën nga pikëpamja materiale dhe intelektuale. Sikurse u tha edhe më sipër, ky ishte një proces sa imponues nga qendra aq edhe vetimponues. Sovjetizimi e përftimi i eksperiencave ndërkombëtare shënon një impuls të ri në zhvillimet emancipuese në aspektet praktike, pra si metodë dhe në ato propagandistike si perspektivë. Faqet e “Shqiptares së re”, sidomos midis viteve '40 e '50, paraqesin jo vetëm artikuj shqiptarë por edhe shumë syresh nga vendet lindore, e kështu politikat zyrtare emancipuese kanë jo vetëm formën por edhe orientim të përcaktuar, atë të vendeve socialiste. Këto politika synonin jo vetëm emancipimin, por edhe kërkonin ta bënin atë të prekshëm, kryesisht përmes modeleve të referencës, të ofruara nga Jugosllavia e Bashkimi Sovjetik (më pas vetëm nga ky i fundit). Sektori i propagandës në Bashkimin e Grave të Shqipërisë përkujdeset që çdo numër i revistës të mbushej me materiale mbi gratë marrë, huazuar apo transkriptuar nga revista të ngjashme

sovjetike apo jugosllave,¹⁷ pa anashkaluar apo duke u përshtatur me kontekstin vendor.

Politikat emancipuese, natyrisht që u përshtatën, në mos replikuan modelin sovjetik, e përshtatën atë aq sa të mos trondiste thelbësisht themelet e shoqërisë tradicionale. Fillimisht, politikat emancipuese u pasqyruan si pjesë e premtimeve të luftës, e më pas ato u plotësuan nga modeli sovjetik, përshtatur me nevojat jo vetëm shqiptare, por edhe me ato të sistemit ekonomik të kohës.

Ndërtimi i socializmit ishte një projekt i huazuar dhe i panjohur, e për këtë, mënyra më e mirë për ta implementuar ishte kopjimi më tepër sesa reflektimi mbi të. Sikurse pohon edhe Mëhilli, e ashtuquajtura metodë sovjetike ishte mënyra për ta nxjerrë vendin nga varfëria, dhe njëkohësisht një rrugë e shtruar dhe e sigurt drejt një të ardhmeje e cila për Bashkimin Sovjetik ishte e tashme.¹⁸ Kopjimi apo më mirë ideja e kopjimit të Bashkimit Sovjetik “nuk kërkonte të prodhonte një replikë të shoqërisë sovjetike. Por nëpërmjet rutinës metoda sovjetike krijonte, ftonte individët ta paraqitnin vehten si shqiptarë të përparuar”.¹⁹ Gratë shqiptare, në sytë e propagandës apo në dëshirat e propagandueseve të BGSH-së duhej, në mos të ishin, të reflektonin idenë e një përkatësie kategorike, e cila i tejkalonte kufijtë e Shqipërisë. Në mënyrë që modeli emancipues të bëhej në mos më i pranueshëm, më i justifikueshëm, ai duhej të paraqitej si një sipërmarrje sa lokale, aq edhe transnacionale. Çdo numër i revistës “Shqiptarja e re” duhej të përmbante, përveç të tjerave, artikuj për gratë e të gjitha vendeve të hapësirës socialiste, për të plotësuar jo vetëm një imagjinatë legjitimuese të emancipimit, por edhe për të mbështetur e për t’u dhënë kuptim përpjekjeve të atyre grave që pranonin emancipimin.²⁰ Këta artikuj nuk shërbenin vetëm si model, por duhej të kryenin edhe një funksion tjetër në një realitet të stimuluar për së larti, atë të gjetjes së një gjuhe të mesatarizuar, të përshtatur me realitetin social shqiptar.

¹⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 723, Viti (më tej: V.) 1947, Dosja (më tej: D.) 33, fl. 45. Plani tremujor i seksionit të Agjit-Propit (1947).

¹⁸ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World* (Cornell University Press: 2012), 114.

¹⁹ *Po aty*, f. 128.

²⁰ AQSH, F. 723, V. 1955, D. 55, fl.11. Analiza e revistës “Shqiptarja e re”, 3.

Në vitin 1955, në analizën e përmbajtjes e objektivave të revistës, u kërkuar të shtohet botimi i tregimeve sovjetike me temë familjare, pasi temat sociale të cilat ato trajtonin u përngjanin problemeve që gratë shqiptare kishin në shtëpi. Në njëfarë mënyre, kontakti që gratë kishin me propagandistët ofronte një mundësi për të trajtuar deri diku problemet familjare. Aty ku problemet shfaqeshin, ato shpjegoheshin më shumë përmes fabulave letrare sesa përmes shkrimeve propagandistike.²¹ Dukshëm, e deri në fillimet e Revolucionit Kulturor të vitit 1967, çështjet e emancipimit do të luheshin më tepër në raport me propagandën sesa me ndryshimet reale e substanciale. Në këtë logjikë, Meksi shprehet se, pozita kombëtare e “stalinistëve” shqiptarë ishte e veçantë, jo edhe aq në raport me situatën ndërkombëtare sesa me atë kombëtare.²² Regjimi synonte modernizimin dhe ndërtimin e socializmit, në kushtet e një prapambetjeje të thellë, jo aq të vendit, krahasuar me vende të tjera përreth, sesa të raportit të prapambetjeje me projektin socialist. Kjo prapambetjeje aq sa acaronte regjimin, po aq ruante të paprekur themelin tradicional të shoqërisë shqiptare. Qasja ndërkombëtare e revistës duhej të ruante të paktën një ekuilibër mes mobilizimit, asaj çka ofronte komunizmi dhe se si kjo legjitimohej në planin ndërkombëtar. Rugëtimi zhvillimor i Shqipërisë ishte i paracaktuar dhe për më tepër i dëshiruar, e kështu edhe ai i grave. Për këtë e në mundësi të një zhvillimi të fortë ekonomik e një varfërie dhe prapambetjeje akoma masive, theksi duhej të vihej më shumë te modeli sovjetik si paraqitje vizuale e një parajse të premtuar, sesa të mëtohej thjesht nëpërmjet mekanizmave që ofronte ideologjia.

Në revistë, përkthimet e materialeve apo referencat e modelit sovjetik vijnë edhe si nevojë për lëndë të parë, e cila dukej e pamjaftueshme për t’u siguruar nga burimet vendore dhe, për më tepër, ishte më cilësore.²³ Ato, sa shpjegojnë, aq edhe japin një ide apo çelës për mënyrën se si gruaja shqiptare do të duhej ta imagjinonte të ardhmen e saj, sikurse ajo në Bashkimin Sovjetik. Artikujt e revistës ndërtojnë kështu histori paralele, atë të eksperiencës sovjetike dhe atë të kopjes shqiptare. Sikurse u theksua edhe më sipër, eksperiencia e komunizmit

²¹ *Po aty*.

²² Sofokli Meksi, “Papërshtatshmëria e paradigmës totalitare në përpjekjen për të shpjeguar natyrën dhe dinamikën e regjimit stalinist shqiptar në vitet 1960-1962”, në *Politikja* 2 (2017), 7-40.

²³ *AQSH*, F. 723, V. 1959, D. 22, fl. 24. Protokoll nr. 10, fl. 23.

shqiptar nuk shkelte dhe as nuk pretendonte të shkelte në një rrugë të panjohur. Modeli sovjetik garantonte një alternativë e një standard të dëshirueshëm nga elitat e reja politike shqiptare. Për Shqipërinë, në vitet 1949-1960 dielli do të lindte nga Moska, dhe kështu reflektimet mbi ndërtimin e socializmit do të përqendroheshin më shumë në arritjen e standardeve sovjetike, sesa në një analizë të brendshme e lexim që mund t'i bëhej territorit në raport me mundësitë e zhvillimit. Utopia ishte utopi ndoshta për sovjetikët, por jo për shqiptarët. Këto modele më shumë kërkoheshin nga elitat sesa ofroheshin nga specialistët sovjetikë. Me pak fjalë, procesi i përafrimit në një hapësirë uniforme socialiste ishte më së shumti nga lart poshtë, pra, si kërkesë e elitave komuniste, sesa e imponuar nga sovjetikët. Sovjetizimi i Shqipërisë ishte një histori makinash e specialistësh, por jo vetëm.²⁴ Në këtë mënyrë, imazhi i gruas duhej përafruar me atë të gruas sovjetike. Për këtë, revista “Shqiptarja e re” heq vazhdimisht paralele e bën krahasime mes pozitës së grave shqiptare dhe atyre sovjetike.

“Shqiptarja e re” do të reflektonte në dy numra historinë e Duze Bajramit nga Kurveleshi, nënë dëshmorësh, e cila vizitoi Bashkimin Sovjetik. Kjo vizitë nuk është më pak e ngjashme nga ato që realizoheshin në Itali, përpara e pas pushtimit, si formë shpërblimi për subjektet vizituese dhe në formë simbolike, sidomos kur mbi to binte edhe barra e tregimit të eksperiencës së jetuar. Duze Bajrami²⁵ tregon për vizitat e shumta në vendin tashmë simbol të modernizmit komunist. Vizitat natyrisht kryheshin në vendet simbole të komunizmit, si ato historike edhe politike. Si fshatare, kategori që përfaqësonte pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare, ajo do të vizitonte kolkozet apo kooperativat sovjetike, të cilat kishin filluar të popullarizoheshin në Shqipëri. Ndërkohë që, po në Shqipëri, Reforma Agrare kishte bërë të mundur shpërndarjen e tokës fshatarëve, duke u mundësuar kështu atyre pronësinë mbi tokën. Kjo binte në kontradiktë me formën e zhvillimit ekonomik të vendit, që kërkonte, nën shembullin sovjetik të zhvillimit industrial, kolektivizimin e tokës. Megjithatë, vizita e Duzes kishte një shumësi qëllimesh. Pikësëpari, vendoste gruan në qendër të shkëmbimeve sovjeto-shqiptare. Duke qenë një grua në moshë, Duzja

²⁴ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist Word* (Cornell University Press: 2017), 54.

²⁵ “Intervistë me fshataren Duze Bajrami që vizitoi Bashkimin Sovjetik”, në *Shqiptarja e re*, nr. 1 (1949), 18.

shërbente si një dëshmitare ndoshta e besueshme në sytë e publikut femëror shqiptar, për të treguar jetën e lumtur e të vetëmjaftueshme të kolkozeve sovjetike, si dhe bollëkun material të siguruar sidomos nga gratë. Burrat sovjetikë nuk figuronin në rrëfimin e Duze Bajramit, si për të treguar se modeli sovjetik e kishte fuqizuar gruan nga ana ekonomike. Premtimi i bollëkut e parajsës socialiste nuk mund të realizohej kështu veçse përmes grave, mbi të cilat realizoheshin dhe materializoheshin premtimet. Gratë kishin një funksion social të caktuar, atë të krijimit të një kulture të shtëpisë, e cila vinte nga “kulturnost” – kombinimi i higjienës, përkujdesjes për shtëpinë dhe mësimave të marksizëm-leninizmit. Mirëpo, ky funksion nuk ishte thjesht ai i tregimit të shtëpisë. Në retorikën e “Shqiptares së re”, modeli sovjetik mësohet duke u mbivendosur ndaj atij shqiptar ose duke gjetur elemente të përbashkëta. Duze Bajrami e tregon këtë model, kur rrëfen për vizitën e saj në Gjeorgji²⁶. Ajo shprehet se kishte gjetur të njëjtat zakone, sikurse edhe në Shqipëri. Kjo duhet theksuar sidomos për lexuesin, për të cilin mendohej se tradita ishte akoma e rëndësishme. Por, vizita e Duzes në Gjeorgji dhe reportazhi i gjatë që e shoqëron atë nuk janë të rastësishëm. Mëhilli²⁷ vëren se sovjetikët kishin në mendje një model të caktuar zhvillimi, republikat kaukaziane, të cilat kishin pasur në të kaluarën të njëjtat karakteristika të prapambetjes dhe ishin zhvilluar përmes kolektivizimit. Duzja, në fund të vizitës së saj, u bënte thirrje grave shqiptare të arrinin të njëjtat suksese sikurse ato sovjetike, duke replikuar kështu modelin sovjetik, jo edhe aq si model i mbështetur në marksizëm-leninizëm sesa si një format, që, nëse replikohej, sillte bollëkun material. Modeli sillte transformimin, e transformimi bollëkun.

Për çdo formë angazhimi të gruas ekzistonte një model i gatshëm sovjetik, i cili nuk mësonte vetëm punën, por, mbi të gjitha, garantonte bollëkun ku “Partija dhe shoku Enver ne na mësojnë, shembulli i kolkozeve sovjetike ne na ndihmon”.²⁸ Sava Nushi tregon për përmirësimin material të jetës nën kujdesin e Partisë, përmes së cilës, gruaja në fjalë ka mësuar jo vetëm metodën e punës sovjetike por ka mësuar se si ta jetojë të përditshmen. Komunikimi me modelin sovjetik, përveçse përmes Partisë, vinte edhe nëpërmjet një komunikimi virtual që

²⁶ “Intervistë me fshataren Duze Bajrami”, 18.

²⁷ Mëhilli (2017), *From Stalin*, 60.

²⁸ “Partija dhe shoku Enver ne na mësojnë, shembulli i kolkozeve sovjetike ne na ndihmon”, *Shqiptarja e re*, nr. 9 (1950), 18.

revista ndërmjetësonte me ato që rëndom quheshin shoqet sovjetike. Rubrika mbante titullin “Gratë shqiptare u shkruajnë grave sovjetike”²⁹ ku shkruesja, një anëtare e BGSH-së, i shkruante një korrespondenteje të paidentifikuar sovjetike, dëshirën për t’u njohur dhe për të përfituar nga eksperiencia sovjetike dhe sa e vlefshme ishte ajo për shqiptarët. Si për ta përforcuar idenë e nevojës për ta riprodhuar në mënyrë të vazhdueshme rrëfimin e eksperiencës, në të njëjtën revistë, botohet artikulli i përkthyer në gjuhën ruse “Në një kolkoz të Kirgizisë”.³⁰ Thelbi i artikullit është transformimi e modernizimi në një republikë periferike të Bashkimit Sovjetik, ku modernizimi shihet si pashmangshmëri dhe fitore mbi natyrën e prapambetjen rajonale. Zëri përmes të cilit tregohet mrekullia socialiste është po ai i një gruaje kolkoziane. Përzgjedhja e artikullit nuk është e rastësishme, pasi ngërçi më i madh i stalinizmit shqiptar do të ishte kolektivizimi dhe të gjitha pasojat shtrënguese që ai do të sillte në vitet në vijim. Më shumë se çdo politikë tjetër, kolektivizimi apo edhe thjesht marrja me fshatin vë në objektiv kryesor gruan.

Modernizimi, transformimi i gruas nga një entitet i prapambetur ishte objekt kryesor i politikave emancipuese. Nëse në zonat urbane modernizimi dhe emancipimi mund të përçoheshin më lehtë, në fshat politikat do të ishin edhe më të vështira për t’u implementuar. Megjithatë, në fshat insistohej me politika publike, sikurse ishte vendosja e shërbimeve sanitare primare, ftesa ndaj grave për punë e njëkohësisht për ndërgjegjësimin e përfitimeve që ato kishin nga puna. Obsesioni i stalinizmit, sidomos atij shqiptar me fshatin, lidhej edhe me nevojën për të siguruar bazë ushqimore, gjë që e bënte të nevojshme kontrollin e fshatarësisë.³¹ Ky kontroll fillonte me procesin paralel të emancipimit të grave dhe atë vullnetar të kolektivizimit. Të dyja janë paralele, por i dyti nuk mund të kryhej pa të parin. Me emancipimin e grave, synohej shpërbërja e botës tradicionale rurale. Fillimisht, gruaja emancipohej me premtimin e bollëkut, që mund të krijohet jashtë familjes së madhe tradicionale, duke e shkëputur atë nga qerthulli i ekonomisë shtëpiake. Një ligjërim i tillë lidhet edhe me gruan në qytet. Këtu nuk është e nevojshme të vihet në pah e kaluara e errët, çarçafi apo prapambetja, më tepër sesa njohja dhe materializimi i të drejtave të grave e procesi i punës,

²⁹ Po aty, 20-21.

³⁰ Po aty, 23.

³¹ Sofokli Meksi, *Stalinizmi shqiptar: një vështrim nga poshtë*, disertacion doctoral (Universiteti i Tiranës: 2015), 9.

gjithmonë nën shembullin sovjetik. Jeta urbane e tejkalonte problemin e fshatit dhe daljen në punë, dhe ajo çka është e rëndësishme ishte produktiviteti.

Shumica e grave në qytet, ndonëse me një minimum formimi, i qaseshin punës me dëshirën për të përfituar si ekonomikisht, ashtu edhe në status shoqëror. Të dyja këto motivime janë të pranishme paralelisht. Në reportazhin “Mendoj për planin ashtu siç mendoj për fëmijët e mij” një punëtore, Kristina Kasapi, rrëfen jetën e saj në rafineritë e naftës në Qytetin Stalin.³² Jeta e saj është një ngjitje karriere thuajse e pandalshme, nga punëtore e thjeshtë në specialiste. Ghodsee dhe Liskova vërejnë se shteti socialist nuk ishte i gjithëpranishëm në jetën e grave, as në atë familjare dhe as në atë personale.³³ Kjo ndodh, sidomos, e të paktën për Shqipërinë, në fazën e parë të emancipimit kur, më shumë sesa penetrimi i shtetit në familje, shteti ofronte hapësira se si këto gra të dilnin nga ambientet tradicionale. Më shumë sesa emancipim, kjo edhe falë ndihmës ekonomike sovjetike, e mbi të gjitha modelit sovjetik, futja e grave në punë ofronte një mënyrë se si ato të plotësonin nevojat e familjes duke shtuar të ardhurat. Modeli i ofruar duket më i përngjashëm me atë të avancimit personal borgjez sesa shoqëror socialist. Ky pohim gjen konfirmim edhe në Bashkimin Sovjetik të viteve ’30,³⁴ standardi më i lartë i zhvillimit socialist, i cili u ofrua si model për Lindjen e pasluftës. Rehatia thuajse borgjeze del në pah në shkrimin “Në shtëpinë e Kaliopit ndriçon dielli i lumturisë dhe i begatisë”.³⁵ Gruaja në fjalë është subjekt atipik i vëmendjes së “Shqiptares së re”, pasi nuk përkon me modelet e grave të reja që punojnë. Kaliopi është nënë me shumë fëmijë, e dekoruar me “Urdhrin e Nënës”. Edhe pse në shkrim nuk përmendet, ajo drejton një familje të madhe, në të njëjtat linja sikurse familjet tradicionale patriarkale. Kur Kaliopi bën krahasimin mes së shkuarës, së tashmes dhe

³² “Mendoj për planin ashtu siç mendoj për fëmijët e mij”, *Shqiptarja e re*, nr. 7 (1952), 17.

³³ Kristen Ghodsee & Kateřina Lišková, “Bumbling Idiots or Evil Masterminds? Challenging Cold War Stereotypes about Women, Sexuality and State Socialism”, *Filozofija i Društvo XXVII* (3) (2016), 489-502.

³⁴ Gurova shkruan se ideja e rehatisë së shtëpisë dhe konsumi u rehabilituan gjatë viteve ’30, pavarësisht mungesave në treg. Olga Gurova, “Ideology of Consumption in Soviet Union: From Asceticism to Legitimizing of Consumer Goods”, *Anthropology of East Europe Review*, vol. 24, no. 2 (2006), 91-98.

³⁵ “Në shtëpinë e Kaliopit ndriçon dielli i lumturisë dhe i begatisë”, në *Shqiptarja e re*, nr. 10 (1953).

së ardhmes, ajo vë në dukje progresin personal të familjes, anëtarët më të rinj të së cilës kanë përfituar nga mundësitë që jepte sistemi. Pavarësisht se nusët e vajzat e Kaliopit ishin subjekte tashmë të emancipuara, ato i përgjigjeshin autoritetit të matriarkes tek e cila dorëzonin të gjitha të ardhurat materiale. Kështu regjimi punonte në dy drejtime, edhe emanciponte por njëkohësisht ruante të paprekur një pjesë të elementeve të familjeve tradicionale ose, në të kundërt, kërkonte të krijonte një model në miniaturë të familjes tradicionale. Të gjithë këtë e bënte duke shfrytëzuar bollëkun material të cilin e ofronte shoqëria socialiste, përmes punës që mundësohej nga shteti, e cila, shihej si patriarki shtetërore, ku shteti zëvendësonte familjen e ngushtë. Është kjo mënyra nëpërmjet së cilës, ligjërimi emancipues, në funksion të projektit socialist, fuste në krizë modelet tradicionale. Qëllimi nuk është drejtpërdrejt ky. Kurrsesi komunizmi shqiptar nuk e fuste në krizë familjen tradicionale, por vetëm e transformonte atë, duke e kthyer gruan në një entitet, progresi i së cilës varej kryekëput nga shteti. Që të forconte gruan, të paktën në fazën e parë të emancipimit, duheshin theksuar aspekte praktike, sikurse edhe puna e cila sillte përfitime të mëdha, e që barazoheshin me emancipimin. Në dallim nga Bashkimi Sovjetik, i pas revolucionit, Shqipëria ndërtonte socializmin duke parë nga Moska. Modernizimi shoqëror, hapja e fabrikave të reja në anën tjetër kërkonte krahë pune, dhe këtu emancipimi merrte formën e vet më specifike vendore dhe i përgjigjej pak edhe modeleve emancipuese në vendet e Lindjes. Në të njëjtën kohë, ky transformim kryhej nën mirazhin e bollëkut dhe atij të ndihmës ekonomike të huaj, asaj sovjetike, qoftë në aspektin material, por edhe atë moral. Shteti i atribuonte kështu një rol të rëndësishëm gruas, sidomos brenda familjes, pasi brenda saj gruaja organizonte e menaxhonte rezultatin final të punës, mirëqenien materiale. Narrativa emancipuese, sidomos para viteve '60, i mëshonte shumë mirëqenies dhe punës, e cila e bënte të mundur atë. Imagjinata e bollëkut material dhe e mundësive ekonomike që ofronte shteti socialist ishin në themel të ligjërimit emancipues, më shumë sesa të drejtat e grave. Këto të drejta ishin aksesore të forcimit të pozitës së gruas, si garanci për t'u përballur me daljen në punë dhe me familjen patriarkale. Kjo njësi sociale shihej si pjesë e së kaluarës, mbetje e së shkuarës në "kohën e Zogut", ku shoqëria shqiptare ishte pre e injorancës, dhe për pasojë, e shfrytëzimit.³⁶ Fitorja e

³⁶ "Më parë s'kisha shtëpi, sot kam tre dhoma për pula", *Shqiptarja e re*, nr. 5 (1954),

luftës i mundësoi gruas të emancipohet nën kujdesin e Partisë. Ky emancipim nuk ishte i detyrueshëm dhe nuk kërkonte të shkatërronte përmes politikave direkte themelet e shoqërisë patriarkale, por e rivalizonte atë në terma të modernitetit dhe mirëqenies materiale që ofronte qenia e Shqipërisë në Kampin Socialist. Reportazhi fotografik “Njihuni me makinisten”³⁷ ndjek aktivitetet javore të një punëtoreje, Serie Çeno. Punëtorja paraqitet në një klishe tashmë të kolauduar, të avancimit shoqëror, fshatare e varfër, e penguar nga familja të shkonte në shkollë, e megjithatë arrin të futet në punë në fabrikën e këpucëve. Me t’u futur në kursin e formimit, jeta e saj ndryshon.

Simboli i kësaj jete të re nuk është synimi politik më tepër sesa ai material. Seria është punëtore pararojë sipas metodës sovjetike, por jo në të kuptuarin e politikës sesa në atë që lidhet me përfitimin material nga puna. Familja e Series është një familje e re, me dy fëmijë, të cilët natyrisht rriten e shkollohen në çerdhen dhe shkollën e ofruar nga shteti. Brenda familjes roli i Series është kufizuar nga tradita, e cila në mënyrë të pandërgjegjshme jepet edhe në reportazh. Ajo shfaqet duke hekurosuar rroba në shtëpi, ndërsa burri lexon gazetën. Reportazhi nuk lë pa përmendur se familja jetonte me vjehrrën, së cilës i ishte besuar mbarëvajtja e shtëpisë. Kombinimi i elementeve tradicionale me ato moderne është i dukshëm. Në shtëpi Serial merrej me punët e shtëpisë por, në të njëjtën kohë, ajo kishte mundësi të shfrytëzonte kohën e lirë, e cila u dedikohet aktiviteteve moderne sikurse opera, plazhi, kinemaja etj. Mirëqenia materiale është elementi emancipues kryesor. Puna mundësonte mirëqenien, por jo detyrimisht pavarësinë e gruas shqiptare. Natyrisht që “Shqiptarja e re” tregon dhe përpiqet të ofrojë një imazh të idealizuar të shoqërisë shqiptare në fillimet e socializmit. Esenca e reportazhit është raporti i gruas me punën dhe përfitimin që ajo nxjerr prej saj, por objektivi i fotografisë futet e kap të gjithë të zakonshmen ideale. Ai futet në shtëpi, në një hapësirë private, e ndjek atë më pas në kohën e lirë, madje këtë të fundit e raporton si një shumësi zgjedhjesh, plazh, shëtitje apo edhe pushim. Privatja dhe publikja në socializëm kanë pak kuptim, por qëllimi i këtij operacioni propagandistik është ai i vendosjes në një plan të njëjtë pritshmërie apo ideali lexuesit. Gruaja, e cila lexon revistën dhe është subjekt i këtij operacioni propagandistik,

16.

³⁷ “Njihuni me makinisten”, *Shqiptarja e re*, nr. 7 (1957), 6-7.

është një kategori e përcaktuar si unitare nga regjimi, ndërkohë që gjendja e saj varion në raport me ekonominë apo ambientin shoqëror. Luhermann thotë se roli i propagandës socialiste nuk ishte thjesht paraqitja e ideologjisë, si një ndërgjegje false, por ndërtimi i ritualit socialist.³⁸ Revista e prodhonte këtë, sa për së brendshmi, aq edhe për së jashtmi. Për së brendshmi, përmes vendosjes e trajtimit unitar të temës kryesore, emancipimit nën udhëheqjen e Partisë. Emancipimi ishte vullnetar e jodetyrues. Temat gruaja – puna në fabrikë, gruaja – puna në fshat bashkohen nga ideja e progresit shoqëror, i cili nuk është vetëm shqiptar, por edhe ndërkombëtar. Në shtyp propagandoheshin modele specifike shqiptare, punëtore, fshatare por edhe intelektuale. Të gjitha kishin arritur një status profesional dhe material në kohën e Partisë.

Puna si detyrim, emancipimi si sakrificë: I gjithë populli ushtar

Emancipimi është gjithnjë sakrificë, në kuptimin e thyerjes e shkërmoqjes së shoqërisë tradicionale, vlerave dhe strukturës sociale e cila e mban në këmbë atë. Në vitet kur komunizmi shqiptar konsolidohet, dhe falë ndihmës sovjetike, emancipimi shihet si një politikë e dëshirueshme, e drejtë dhe e dobishme. Ndërtimi i socializmit ishte siguruar në sajë të ndihmës e modelit sovjetik, gjë që, të paktën në aspektin e gjuhës e shihte modernizimin dhe emancipimin si të pashmangshëm për shoqërinë e re shqiptare. Kjo situatë filloi të ndryshojë në momentet kur socializmi shqiptar ose e kishte të pamundur të ofronte parajsën materiale socialiste, ose e kishte të pamundur të evoluonte. Modeli sovjetik kishte kufizimet e veta ose më saktë prodhonte dinamika të tjera: emancipimi kërkonte zgjerimin e të mirave materiale, kërkonte çlirimin e marrëdhënieve ndërpersonale nga kufizimet e forca e traditës. Këtë regjimi stalinist shqiptar e kishte të vështirë ta bënte. Ndonëse “Shqiptarja e re” nuk prek kontradiktat në të cilat bie modeli zhvillimor shqiptar, regjistri i saj fillon e ndryshon në vitet ’60 e tutje. Atëbotë emancipimi shihej më shumë si sakrificë, sesa progres. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik, emancipimi i gruas ishte jo më si mundësi për progres personal e material, por si sakrificë e heroizëm personal. Tashmë, horizonti i parajsës komuniste ishte larguar shumë,

³⁸ Sonja Luehrmann, “The Modernity of Manual Reproduction: Soviet Propaganda and the Creative Life of Ideology”, *Cultural Anthropology*, vol. 26, Issue 3 (2011), 363-388.

dhe për këtë gjuha bëhej më e ashpër e ideologjike. Në këtë periudhë mungon raporti me mirëqenien materiale e suksesin personal. Ky i fundit nuk ishte rezultat, por armë ideologjike. Horizonti socialist në anën tjetër tkurret. Shqipëria filloi të zhvillonte marrëdhënie të ngushta me Kinën e vende të tjera aziatike, si Koreja e Veriut apo Vietnami. Modeli zhvillimor dhe ai emancipues nuk përmendte më metodën sovjetike, pasi kjo e fundit ishte zëvendësuar me modelin vendor shqiptar. Tismaneanu shkruan se si Bashkimi Sovjetik stalinist krijoi një regjim kështjellë, i cili u mundua të replikohej kudo, të paktën në praktikën politike, sikurse ishte distanca mes regjimit e shoqërisë dhe terrori politik. Si në planin politik, edhe atë ekonomik, këto regjime ishin të varura nga ndihma e modeli sovjetik. Me procesin e destalinizimit ato detyrohen të ndryshojnë.³⁹ Të vetmit që rezistuan ishin Shqipëria e Kina. Stalinizmi shqiptar nuk hoqi dorë nga industrializimi masiv, në funksion të idesë se socializmi duhej të kalonte pa dyshim nga zhvillimi i industrisë së rëndë, pa marrë parasysh investimet gjigante si dhe dimensionet e vendit. Kjo ëndërr hyri në krizë me përpjekjen dyfishe të Hrushovit, të racionalizimit të zhvillimit ekonomik në Kampin Lindor, kryesisht me shpërndarjen e specializimin në sektorë të caktuar të secilit prej vendeve dhe në përmirësimin e kushteve materiale të shoqërive specifike.⁴⁰ Përpos kësaj, procesi i destalinizimit në Shqipëri kishte ngecur në vend, gjë që çoi në kontradikta e më pas në ndarjen shqiptaro-sovjetike. Kështu, edhe procesi i modernizimit e zhvillimit ekonomik për pasojë ngeci në vend. E vetmja mënyrë për ta nisur e për ta përfunduar aspiratën zhvillimore ishte ndihma kineze.

Nëse Bashkimi Sovjetik ofronte një model të gatshëm, Kina ofronte mënyrën se si mund të arrihej zhvillimi përmes eksplorimit të elementeve të etosit heroik, njëfarë rikthimi të stalinizmi i hershëm. Humbja e mirazhit të parajsës sovjetike duhej të orientohej drejt diçkaje tjetër, pikërisht sakrificës për të ruajtur revolucionin. Gruaja, që është subjekt dhe pjesë e këtij revolucion, nuk sheh më të mirat materiale që vinin nga emancipimi, por bëhet pjesë e këtij etosi të treguar si heroik në zhvillimin

³⁹ Vladimir Tismaneanu, "Introduction", në *Stalinism Revisited: The Establishment of Stalinist regimes in Eastern and Central Europe*, Vladimir Tismaneanu (ed.) (Budapest-New York: CEU Press, 2009), 18.

⁴⁰ Për rastin e Shqipërisë, shih Mëhilli (2017), *From Stalin*, 189.

e vendit. Në vitin 1967,⁴¹ Hoxha do të fillonte procesin e revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës në vend, që kërkonte më shumë sakrifica e më pak përfitime materiale. Me ndarjen nga Bashkimi Sovjetik kristalizohet edhe një qëndrim dyshues ndaj atyre që quhen influenca të huaja. Vëmendja kthehet jo më nga bota socialiste, por për së brendshmi. Revolucioni Kulturor kinez e ai shqiptar zhvillohen thuajse në të njëjtën kohë. Ky konstatim nisët sa nga aleanca e re kino-shqiptare, aq edhe nga përkimi i kohëve, ku të dyja valët e brendshme revolucionare kanë vetëm një vit distancë: 1966 ai kinez e 1967 ai shqiptar. Në anën tjetër, Mëhilli e sheh si një proces të gjatë, i cili kishte filluar gradualisht nga mesi i viteve 1950, e që natyrshëm u maturua në pikun e industrializimit, pra midis viteve '60. Marku, në një tjetër artikull shpreh po të njëjtin qëndrim, që Revolucioni Kulturor në Shqipëri pati vetëm ngjashmëri në nivel ligjërimi e jo në praktikë.⁴² Vrulli revolucionar nuk nisej thjesht nga imitimi i aleatit të madh, por më shumë nga një koniunkturë historike. Industrializimi, frika e izolimi, projektimi i një shoqërie e vendi autarkik, bënin të nevojshëm ndryshimin dhe orientimin e etosit shoqëror kah sakrifica në emër të një rreziku sa ideologjik, aq edhe kombëtar, zhdukjen e revolucionit e për pasojë të vendit, të gjendur, gjeografikisht të izoluar mes Lindjes dhe Perëndimit. Në thelb, regjimi komunist shqiptar ishte i brishtë si ekonomikisht, ashtu edhe politikisht.

Orientimet e Revolucionit Kulturor shqiptar shihnin në disa drejtime, si: ndalimi i praktikimit të traditës,⁴³ ndalimi i besimit fetar, eliminimi i shfaqjeve të huaja apo të gjithë atyre influencave që perceptoheshin si joburimore, vullnetarizmi, cenimi i pozitës së burokratëve, iniciativa punëtore e kështu me radhë. Të paktën pjesa e parë e elementeve të prekur nga vrulli revolucionar preknin gratë dhe gjendjen e tyre shoqërore. Revolucioni shoqëror, e sidomos mbyllja e vendeve të kultit, konsiderohet si një prej “mëkateve” më të mëdha e më irracionale të komunizmit. Për këtë, e shpesh në paskomunizëm, kjo u pa si një masë ekstreme e cila kërkonte të zhbënte lidhjen shpirtërore dhe gjeografike me Perëndimin, po kështu edhe me Lindjen e zhvilluar, sa

⁴¹ *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, botimi i dytë (Tiranë: 8 Nëntori, 1981), 387-389.

⁴² Ylber Marku, “China and Albania: the Cultural Revolution and Cold War Relations”, *Cold War History*, 17 (4), (2017), 367-383.

⁴³ Albert Doja, *Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2018), 180.

kohë që lidhja kulturore shqiptaro-sovjetike ishte tejet më e fortë se ajo me Kinën. Por, ky revolucion u përgjigjej më mirë nevojave të brendshme, si rezultat i pamundësisë për të arritur një zhvillim ekonomik që siguronte mirëqenie, në favor të një industrializimi i cili potencialisht do ta bënte vendin të pavarur nga ndihma e huaj. Regjimi kështjellë, i përmendur më sipër, filloi të manifestohej me të gjithë formën e vet kryesisht në vitet 1960 e tutje, vite ndërtimi të industrisë por edhe të një bollëku material të munguar, që reflektohej edhe në frikën e manifestimeve të elementëve të cilët vinin në dyshim efikasitetin e sistemit. Nëse Revolucioni Kulturor ishte një sipërmarrje që kishte filluar më herët, atëherë përse u manifestua pikërisht në vitin 1967? Katherine Verdery i cilëson vendet socialiste si vende të dobëta, ku bartësit e pushtetit shpesh nuk arrijnë të bëjnë atë çka shteti do, ku shpesh rezultatet e politikave publike raportohen të tejfryra, dhe shteti rrallëherë komandon e kontrollon gjithçka.⁴⁴ Në ekonominë e skarcitetit socialist, shteti të paktën kontrollonte mjetet e prodhimit e për pasojë konsumet dhe, në njëfarë mase, detyrimin e bindjes nga popullata. Të qenit vetëprodhues dhe organizator i hapësirës së tregut, i jepte mundësi shtetit të operonte me kontroll të paktën në mundësimin e mbijetesës së popullsisë, përmes punës.

Mospjesëmarrja mund të linte vend për dyshim, sikurse edhe pjesëmarrja që duhej t'i nënshtrohej kontrollit politik të Partisë. Kapaciteti i kontrollit të shtetit, pra, varej në raport me mundësinë e “prodhimit” të pamjaftueshmërisë materiale. Shteti krijonte tregun dhe rregullat i kontrollonte vetëm ai. Po kështu, shteti vendoste kush do të konsumonte, çfarë do të konsumohej dhe sa do të konsumohej.⁴⁵

Në vitet '60 në Shqipëri filloi të zgjerohej industrializimi dhe rriten format e pronësisë publike, zgjerohet kolektivizimi dhe eliminohen të gjitha format e iniciativës ekonomike private. Zgjerimi i industrisë

⁴⁴ Katherine Verdery, *National Ideology under Socialism: Identity and Cultural politics in Ceausescu's Romania* (University of California Press: 1991), 85.

⁴⁵ Në vitin 1961, në Vlorë, organet lokale të FDSH-së akuzohen për formalizëm pasi kishin lëshuar karta anëtarësie në Front për një vajzë kulaku e cila, edhe pse nuk cilësohej si armike, jetonte akoma me prindërit. Të pasurit e kartës ishte shenjë formale përkatësie, mospasja e saj sillte damkën e dyshimit dhe të pamundësinë për t'u integruar në shoqërinë socialiste. AQSH, F. 14/Arkivi i Partisë (AP)-Strukturë (më tej: Str.), V. 1962, D. 118, fl. 22. Mbi funksionimin e kryesive të këshillave të FDSH-së të rretheve gjatë periudhës janar-shtator 1962, fl. 17.

kërkonte krahë pune, kolektivizimi po kështu, ndërsa eliminimi i formave të ekonomisë së tregut varësonte të gjithë qytetarët ndaj shtetit. 1967, ishte kështu një proces që filloi dhe u kristalizua në fillim të viteve '50 e konsolidohet brenda një dekade me shtetëzimin e mjeteve të punës e prodhimit dhe pamundësinë e iniciativës së lirë. Industrializimi ndikoi në punën e grave, pasi ato duhej të zëvendësonin burrat në sektorët joprodhues, kryesisht shërbime.⁴⁶ Nevoja për krahë pune në vitet '60 ndihej shumë, e kështu ajo duhej të mbulohej nga gratë, gjithsesi, ky mbulim nuk ishte edhe aq i nevojshëm në qytet sesa në fshat. Burrat e fshatit largoheshin për në fabrika ose miniera, ndërkohë që sektori bujqësor që duhej të mbante me bukë qytetin e punëtorët mbetej pa krahë pune. E pikërisht në sektorin bujqësor kjo bëhej jo vetëm më e dukshme, por puna në bujqësi kishte dhe mbante fytyrën e gruas. Kjo ndihet në fillim të viteve '60, kur organet shtetërore bënë presion për daljen e grave në punë, ndërkohë që mundësia për të ndërtuar një rrjet mbrojtjeje sociale rreth tyre që në fillim ishte e dështuar.⁴⁷

Për të përmbushur planin, shpeshherë gratë detyroheshin të punonin e të mos gëzonin të njëjtat të drejta si në qytet. Një raport i Ministrisë së Arsimit tregon se gratë detyroheshin të punonin deri në muajt e fundit të shtatzënisë, duke rrezikuar shpesh shëndetin e tyre dhe të fëmijës.⁴⁸ Një pjesë e mirë e raporteve për emancipimin në vitet 1960-1970 merreshin pak me qytetin e më shumë me fshatin. Fokusi i politikave emancipuese ishte gruaja në fshat. Për arsye të peshës së numrave, pjesa më e madhe e popullsisë jetonte në fshat dhe, me fillimin e industrializimit, një pjesë e mirë e burrave shkonte për të punuar në industri dhe grave u duhej të dilnin e të punonin në kooperativë. Puna ishte punë manuale dhe rrallëherë e mekanizuar. Paradoksi i një shoqërie që aspironte industrializimin ishte i dukshëm, pasi në fshat deri në fund të viteve '80 mbizotëronte puna manuale përkundrejt mekanizimit. Nëse në një shoqëri të zhvilluar, pesha e të punësuarve në industri e kalon atë të

⁴⁶ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1962, D. 115, fl. 4. Mbi zbatimin e vendimit të sekretariatit të KQ-së për edukimin e ngritjen e gruas në përgjegjësi (nr. 475), 9 mars 1962, f. 1.

⁴⁷ Hoxha në një prej sugjerimeve të tij hamendëson ngritjen e tendave të ushtrisë apo atyre me kashtë buzë arave, ku anëtarët më të pamundura të kooperativës të mbanin fëmijët ndërsa gratë më të reja të punonin; shih, Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 17 (Tiranë: 8 Nëntori, 1974), 263-264.

⁴⁸ *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1964, D. 160, fl. 5. Informacion i sekretares së Këshillit të Përgjithshëm të BGSH-së mbi punën e bërë në rrethin e Shkodrës.

bujqësisë, në Shqipëri kjo nuk ndodhi. Fakt për këtë ishte edhe transformimi i ngadaltë i shoqërisë nga fshatare në urbane, ku Shqipëria mbetej ende vendi me popullsinë më të lartë në zonat rurale. Megjithatë, është fshati që do të mbante peshën më të madhe të dobësisë së industrializimit shqiptar, sepse i duhej të rriste rendimentet e prodhimit, për shkak të mangësisë së mekanizimit, të mbante konsume minimale sidomos ushqimore, për të furnizuar me ushqime qytetin. Në këtë kuptim, orientimet e Revolucionit Kulturor e shihnin popullsinë fshatare si subjekt kryesor transformimi, i cili kishte filluar herët por bëhej më i nevojshëm me zgjerimin e kolektivizimit dhe nevojën për t'i përfshirë të gjithë në forcën e punës. Në fshat, po ashtu, ishte sa më e vështirë të ndërhyhej, për efekt të ngurtësisë sociale më të madhe, aq më e lehtë të detyroje popullsinë të dilte në punë. Puna e krahut, pa mekanizim kërkon pak ose aspak specializim dhe investim në formimin e punonjësve.

Ndërhyrja për të tronditur shoqërinë tradicionale fshatare, bëhej edhe për të sforcuar e eliminuar çdo lloj elementi që pengonte futjen në forcën e punës dhe kjo drejtohej sidomos ndaj grave. Justifikimi i luftës ndaj fesë e traditës bëhej në funksion të projektit socialist, por kryesisht në funksion të punës.⁴⁹ Kalendar i fetar, martesë e hershme, angazhimi i familjeve për këtë të fundit dhe deri te mënyra e veshjes, ishin të gjitha fenomene që ndiknin ose në mosfutjen në punë, ose në rendimentin e ulët të punës. Në vitet 1950 e tutje, besohej se transformimet zhvillimore do ta shpërbënin shoqërinë tradicionale dhe do ta bënin fenë irelevante, ndërkohë që në vitet '60 mirazhi i mirëqenies materiale ishte ende larg. Situata specifike gjeopolitike ishte gjithashtu më e komplikuar, falë izolimit në të cilin Shqipëria ndodhej. Në këto kushte, për regjimin ishte e nevojshme të sforconte tempo-ritmin e ndryshimeve shoqërore, të paktën, për të krijuar një uniformitet të dukshëm, mbështetur më shumë mbi etosin e sakrificës sesa mbi shpërblimin. Feja ishte e marginalizuar, ndërsa tradita relativisht e fortë. Me të parën ishte e thjeshtë të merreshe, ndërsa me të dytën duhej të negociohej. E para futej lehtësisht në kuadrin e influencës së huaj, dhe e kishte fituar këtë status me indigjenizimin e projektit komunist si projekt vendor, tradita ndërkohë, do të bëhej subjekt pastrimi nga influencat e huaja. Projekti socialist synonte ta zëvendësonte

⁴⁹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1962, D. 153, fl. 10. Material dërguar komiteteve të Partisë të rretheve, Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe organizatave të masave.

tempo-ritmin fetaro-tradicional me atë socialist, ritualin fetar me atë laik por jo ta zëvendësonte totalisht atë.⁵⁰

Për gratë, këto politika do të konsideroheshin si çlirimtare por ato nuk do të çliroheshin deri në fund nga obligimet e natyrës tradicionale, qoftë në formën e barrës së dyfishtë, qoftë në formën e kontrollit që familja akoma ushtronte mbi to. Nëse shteti luftonte kundër martesave në djep e atyre me shkuesi, të paktën kjo e fundit nuk përjashtojë deri në fund nëse partnerët nuk pranonin ta prishnin fejesën.⁵¹ Revolucioni seksual gjithsesi përjashtojë plotësisht, sikurse edhe mundësia e pavarësisë së grave apo edhe e burrave për të pasur marrëdhënie të lira nga detyrimet shoqërore. Ramiz Alia thoshte se “nuk jemi kundër dashurisë por kundër dashurisë së lirë, si mungesë impenjimi nga partnerët e për më tepër si shfaqje e huaj”. Garancia që mban e ruan prodhimin e riprodhimin është puna pasi, sipas Alisë, ishte vendi ku të rinjtë njiheshin me njëri-tjetrin. Në këtë kuptim, Partia dilte garante e marrëdhënieve që ndërtoheshin mes çifteve pa ndërmjetësinë e prindërve.⁵²

Politikat emancipuese nën komunizëm synonin modernizimin e grave, të cilat shërbenin si standard zhvillimor i progresit socialist shqiptar. Në Shqipëri, prapambetja u mvishej agjentëve të jashtëm, fesë apo influencave të huaja. Për pasojë ndërtimi i identitetit të gruas, u pretendua jo dhe aq i ri sesa si rizbulim i atyre që quheshin “tradita luftarake të popullit shqiptar”.⁵³ Arsyeja e emancipimit kishte të bënte me luftën dhe pjesëmarrjen e grave, e kështu referencat ishin me të vërtetë ideologjike, dhe ideologjia ofronte çelësa të ndryshëm interpretativë e vënie në praktikë. Në mesin e viteve '60, rizbulohet tradita dhe etosi i sakrificës, i inspiruar drejtpërdrejt nga elementi i luftës, por edhe ajo që

⁵⁰ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1967, D. 191, fl. 11. Shkresë e KQ-së, sektori i edukimit drejtuar të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve, kryesisë së organizatave të masave ku flitet për ‘Zëvendësimin e praktikave fetare me ceremonitë dhe festat socialiste’.

⁵¹ *Po aty*, fl. 7.

⁵² *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1967, D. 201, fl. 16. Letër e KQ të PPSH-së dërguar të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve ku flitet “Mbi problemet kryesore që do të trajtohen në Plenumin e KQ të Partisë për gruan”, f. 4-5.

⁵³ *Po aty*, F.14/AP-Str., V.1962, D. 152, fl. 10. Mbi probleme të punës kulturore me masat e shqyrtuara nga sekretariati i KQ-së: zbatimi i vendimit të Byrosë Politike të KQ-së, nr. 228, dt. 7.07.1959, për traditat patriotike revolucionare të popullit tonë; zbatimi i vendimeve të konferencës kombëtare për zhvillimin e kulturës në fshat; disa probleme të kinematografisë, fl. 5.

quhej tradita kombëtare. Sakrifica në luftë kthehet në sakrificë e heroizëm në punë. Në artikullin “Ku jehon kënga e hekurt”, kushtuar aksioneve të grave dhe vajzave në hekurudhë, etosi i luftës është i pranishëm.⁵⁴ Kjo vihet re që në fillim me paraqitjen e një ish-partizaneje, vullnetare, “shalleve të lidhura partizance e kazmave të hedhura si pushkë”.⁵⁵ Puna kthehet në front e përballje luftarake, mobilizimi është po ashtu i tillë. Në dallim nga vitet ’60, tashmë progresi material u zhduk nga ligjërimi ndërkohë që mirëqenia nuk paraqitet më si aspekt i rëndësishëm i jetës. Vullnetaret, vajza të reja i drejtohen një ish-partizaneje, e cila natyrisht tregon historitë e luftës, heroizmin e partizaneve gjatë saj, duke bërë në këtë mënyrë, lidhjen mes luftës dhe frontit të punës. Në vijim të shkrimeve të revistës, sakrifica paraqitet si element i përbashkët mes brezave, e që lidhet përsëri me luftën sikurse në artikullin “Vazhdimi i një tradite”. Gra të moshave të thyera tashmë, ofronin ndihmën e tyre si dikur në luftë ose si përfituese të politikave të regjimit që të merrnin pjesë në ndërtimin e hekurudhës.⁵⁶ Aty theksohet edhe letra e vajzës së Adem Rekës, Heroit të Punës Socialiste, e cila, edhe pse në moshë të vogël, zotohej se në të ardhmen do të punonte si aksioniste vullnetare për ta çuar përpara sakrificën heroike të të atit. Puna kështu kthehet në sakrificë e nuk kuptohet qartë se ku është kufiri mes aktivitetit dhe vullnetarizmit, përmirësimit të kushteve materiale, mobilizimit shoqëror dhe sakrificës për vendin. Në revistë, në dallim nga vitet ’50-’60, mungojnë shembujt për t’u ndjekur, por mund të bëhen vetëm paralelizma. Artikulli “Ndjenja luftarake”, përshkruan vizitën e grave të Vietnamit të Jugut,⁵⁷ asokohe në mes të luftës. Asociimi është i thjeshtë, i vetmi shembull që mund të paralelizohet me përpjekjet revolucionare në Shqipëri është ai i luftës dhe sakrificës për ndërtimin e socializmit.

Shoqëria shqiptare e pas viteve ’60 organizohet si shoqëri e militarizuar, e regjimentuar, ku puna kthehet në sakrificë pa mbarim në ndërtimin e një utopie tashmë të përkufizuar nga kufijtë territorialë. Ngushtimi territorial, ligjërimi ideologjik me tone luftarake, ofrohen jo vetëm në kuadrin e sakrificës kolektive, por edhe të ndërtimit të një horizonti e të kaluare historike që zbulohet si fat permanent. Revista

⁵⁴ “Ku jehon kënga e hekurt”, *Shqiptarja e re*, nr. 2 (1967), 18-19.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty.

ofron paralelisht figurën e gruas që sakrifikohet për punën, por edhe formohet ushtarakisht.⁵⁸ Në një reportazh të vitit 1969, tregohen vajzat e shkollës së mesme “Dhaskal Todhri” në Elbasan, të cilat merrnin pjesë në një kurs për tankiste. Vajzat nuk janë profesioniste të ushtrisë, e megjithatë stërviten në kuadrin e një horizonti të ngushtë dhe të kufizuar nga imagjinimi i rrezikut permanent, nga i cili vendi duhet të ruhet. Në aspektet emancipuese, afrimi i grave në ushtri shihet si pjesë e një logjike që flet për barazinë e plotë mes burrit dhe gruas, por nuk mbështetet nga politika të qarta publike emancipuese. Përfshirja e grave në përgatitjen ushtarake rimerr tema nga e kaluara jo vetëm e afërt, sikurse ishte Lufta Nacionalçlirimtare, por edhe më tej në histori. Provë e kësaj është pikërisht kjo luftë, e cila kishte ndërtuar imazhin e gruas së angazhuar në luftë për çlirimin e vendit por edhe për të drejtat e saj, sikurse shprehet edhe një artikull tjetër në revistën “Gratë trime”.⁵⁹ Fryma e emancipimit në vitet ’60 i referohet luftës, por në ndryshim nga vitet ’50-’60 ku lufta është tranzicion drejt të drejtave, pjesë e historisë e lënë pas në kuptimin e arritjes së një jete më të mirë, midis viteve ’60 e tutje, ajo kthehet në një standard që duhet simuluar në të përditshmen, si pjesë e një tradite tashmë historike. Kjo traditë e vendos shoqërinë shqiptare por specifikisht gruan në kuadrin e një sakrifice të përhershme, ku gruaja, tashmë e re, zbulohet më shumë si karakter në të shkuarën, për të arritur tek e tashmja. Mbajtësja e kësaj tradite është detyrimisht figura e nënës. Ligjërimi komunist shqiptar ka luajtur shumë me ambiguitetin e gruas së re dhe figurën historike të nënës. Në kinematografinë shqiptare, kundërshtarët e emancipimit në pjesën dërrmuese ishin burra, por ata përgjithësisht lidheshin me një traditë që konsiderohej e huaj në traditën historike shqiptare, si p.sh. figura e bajraktarit apo e priftit.⁶⁰ Kjo bëhet më e dukshme në momentin e ngushtimit të hapësirës socialiste ndërkombëtare dhe kufizimin e së vërtetës socialiste me Shqipërinë. Socializmi në këtë kuptim shndërrohet nga një ide universale në një ide lokale dhe barazohet me territorin e kombin. Në anën tjetër, kombi dhe vendi janë të veçantë. Përkundër socializmit që mbështetet te solidariteti i masave punëtore, kombi është i vetëmjaftueshëm, për pasojë kërkon një sakrificë permanente, e cila simbolizohet nga të menduarit e shoqërisë në

⁵⁸ “Vajzat Tankiste”, *Shqiptarja e re*, nr. 41(1969), 2.

⁵⁹ “Gratë trime”, *po aty*, 5.

⁶⁰ Bruce Williams, “Cherchez la femme: Gratë revolucionare në filmat e Kinostudios”, *Politikja 2* (2018), 129-143.

konflikt permanent me çfarëdolloj elementi të huaj që e cenon atë. Kështu, brenda emancipimit shqiptar bashkekzistonte edhe konservatorizmi në aspektin e marrëdhënieve shoqërore burrë-grua, pjesë e traditës por edhe e ligjërimit emancipues.

Përfundime

Parë në këndvështrimin praktik, modeli e manifestimi i emancipimit në Shqipëri, nuk përbënte ndonjë interes a veçanti, në kuptimin e përcaktimit të identitetit gjinor, politikave specifike gjinore apo rolit të grave në përcaktimin e tyre. Emancipimi ishte më shumë pjesë thujse e detyruar e politikave socialiste ndërtuese të regjimit, sesa nevojë e brendshme e manifestuar nga gratë. Pa dyshim që në situata thujse të ngjashme ndodheshin edhe vende të tjera të Europës Lindore, në të cilat imponoheshin apo vendoseshin regjimet komuniste. Këto regjime u mbështetën sa në një model – atë të kolauduar stalinist – aq edhe në eksperiencat emancipuese pararendëse. Edhe në Shqipëri, trajektorja e emancipimit filloi me manifestimin e nevojës për të ndërtuar një shtet modern, që simulonte apo tentonte të kopjonte modelin e ashtuquajtur perëndimor, natyrshëm të përshtatur apo përthyer sipas situatës politike në vend. Gjithsesi, modeli emancipues në kontekstin shqiptar, si ai socialist apo liberal i paraluftës, pak u përgjigjej nevojave të grave e më tepër shërbente si instrument e funksion i qëllimeve të regjimit.

Ajo që del nga analiza e revistës është gjithsesi ideja e një progresi material, i cili imagjinohet dhe propagandohet sidomos në fazën që shkon nga viti 1945 e deri në fundin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Ky i fundit ofronte një model zhvillimor, një mirazh bollëku që kërkohet të imitohej edhe në Shqipëri. “Shqiptarja e re” ishte zëri dhe imazhi i këtij realiteti të përzgjedhur me kujdes nga propagandistët e saj. Imazhet dhe fjalët e revistës janë ato që mundohen të ndërmjetësonin realitetin e ri shoqëror mes lexuesve, ndonëse ky realitet ishte episodik e funksiononte përmes përzgjedhjes së shembujve të veçantë të grave të suksesshme, jo si kategori por si individë, pjesëtarë të një kategorie të përcaktuar me kujdes. Nëse revista propagandonte, aspekti e prania e ideologjisë ruheshin në kufijtë e minimale apo edhe të pranueshmes.

Socializmi vendosej në këtë logjikë brenda kuadrit historik të kombit, më tepër sesa i mbivijes atij. Mbrojtja e atdheut, shqetësim

permanent historik, kthehej në mbrojtje edhe të regjimit, e kështu të dy barazoheshin. Vizioni i gruas së re socialiste lidhej me mbijetesën e regjimit, por edhe atë të kombit. Pjesëmarrja në mbrojtjen e vendit ishte kualifikim shtesë, i nevojshëm dhe i kuptueshëm. Në artikullin “Atdheu mbrohet nga të gjithë” analizohet pikërisht stërvitja ushtarake, pjesë tashmë e përditshmërisë socialiste, ku stërvitja shihej si terren suplementar emancipimi,⁶¹ por që nxjerr në pah pozitën specifike të gruas në socializëm. Sipas raportueses, instruktore e BGSH-së, stërvitja kishte si qëllim të dilte mbi paragjykimet “jemi nëna me fëmijë” apo “ushtria është për burra”, gjë që tregon se si në shoqërinë socialiste pak u arrit që gruaja të shkëputej nga barra e përkujdesjes për familjen. Lufta për socializmin ishte luftë për mbrojtjen e vendit, dhe gruaja e kushdo duhej e mund të sakrifikohej për të. Në një reportazh fotografik mbi stërvitjen ushtarake të punëtorëve të superfosfatit në Laç, theksohen si mbrojtja e atdheut, ashtu edhe zotimi për “dhënien më shumë pleh kimik vendit”.⁶² Të dyja nuk mund të ndahen, puna kthehet në luftë e lufta duhej përgatitur, e kjo natyrisht implikonte një formë sakrifice të vazhdueshme, sa kohë që vendi perceptohej përherë i rrezikuar. Ky rrezik shtrihej në të gjithë vijimësinë historike të Shqipërisë, ku justifikoheshin edhe figura e gruas, sakrifica e së cilës manifestohej si formë joemancipimi, por plotësim i burrave dhe, për më tepër, i një kuadri organik kombëtar – socialist. Përvjetori i 35-të i krijimit të BGSH-së, përkoi me qershorin e vitit 1978, vit i 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Imazhi i Lidhjes nuk mund të analizohet përveçse nëpërmjet perspektivës gjinore e etosit të regjimit, theksimit të dhunës e pjesëmarrjes historike të gruas në luftë, krah burrave.⁶³ Emancipimi kthehet nga arritje materiale në sakrificë, e kjo sidomos pas viteve '60, atëherë kur regjimi komunist kërkoi të ndërtonte industrinë e rëndë, pa ngritur mirëqenien materiale.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

⁶¹ “Atdheu mbrohet nga të gjithë”, *Shqiptarja e re*, nr. 5 (1975), 4-5.

⁶² “Me vullnetaret e vetëmbrojtjes”, *Shqiptarja e re*, nr.1 (1976), 5.

⁶³ “Me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit: Në istikam përkrah burrave duke qëlluar në shenjë mbi armiqtë”, *Shqiptarja e re*, nr. 6 (1978), 14-15.

Fondi 723 - vitet 1947, 1955, 1959
 Fondi F.14/AP-Str. - vitet 1962, 1964, 1967

Literaturë historiografike:

- Chatterjee, Choi. "Soviet Heroines and Public Identity, 1930-1939". In *The Carl Beck Papers in Russian & East European Studies*, no. 1402 (1999).
- Damoussi, Joy. "'The woman comrade': equal or different?". *Women's History Review*, 2:3 (1993): 387-394.
- Doja, Albert. *Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri*. Tiranë: Akademia e Shkencave, 2018.
- Fodor, Éva. "Smiling Women and Fighting Men: The Gender of the Communist Subject in State Socialist Hungary". *Gender & Society*, vol. 16, no. 2 (2002): 240-263.
- Gal, Susan & Gail Kligman. *Reproducing Gender: Politics, Publics, and Everyday Life after Socialism*. Princeton, N.Y.: Princeton University Press, 2000.
- Gender, State and Society in Soviet and Post-Soviet Russia*. Sarah Ashwin Sarah (ed.). Routledge: 2000.
- Ghodsee, Kristen & Kateřina Lišková. "Bumbling Idiots or Evil Masterminds? Challenging Cold War Stereotypes about Women, Sexuality and State Socialism". *Në Filozofija i Društvo XXVII* (3) (2016): 489-502.
- Gurova, Olga. "Ideology of Consumption in Soviet Union: From Asceticism to Legitimizing of Consumer Goods". *Anthropology of East Europe Review*, vol. 24, no. 2 (2006): 91-98.
- Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, Botimi i dytë. Tiranë: 8 Nëntori, 1981.
- Hoxha, Enver. *Vepra*, vëll. 17. Tiranë: 8 Nëntori, 1974.
- Ikonomi, Luljeta & Shannon Woodcock. "Imoraliteti në familje: Nxitja e ankesave të grave për të përforcuar pushtetin e Partisë në revolucionin kulturor shqiptar", *Përpyekja*, Viti XX, nr. 32-33 (2014), 155-182.
- Këlliçi, Klejd & Ermira Danaj. "Shoqja N ka lënë punën", në *Politikja* 2 (2017): 40-63.
- Këlliçi, Klejd. & Ermira Danaj. "Promoting Equality, Perpetuating Inequality: Gender Propaganda in Communist Albania". *History of Communism in Europe*, vol. 7-2016. Institute for Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile (Bucharest). Dalia Bathory (ed.) (Zeta Books: 2016): 39-61.
<https://doi.org/10.5840/hce201673>.

- Landes, Joan B. "Marxism and the Women's question". *Promissory Notes: Women in the Transition to Socialism*, Sonia Kruks, Rayna Rapp, Marilyn Blatt Young (editors). New York: Monthly Review Press, 1989: 15-28.
- Luehrmann, Sonja. "The Modernity of Manual Reproduction: Soviet Propaganda and the Creative Life of Ideology". *Cultural Anthropology*, vol. 26, Issue 3 (2011): 363-388.
- Marku, Ylber. "China and Albania: the Cultural Revolution and Cold War Relations". *Cold War History*, 17 (4), (2017): 367-383.
- Mëhilli, Elidor. *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*. Cornell University Press: 2012.
- Meksi, Sofokli. "Papërshtatshmëria e paradigmës totalitare në përpjekjen për të shpjeguar natyrën dhe dinamikën e regjimit stalinist shqiptar në vitet 1960-1962". Në *Politikja 2* (2017): 7-40.
- Meksi, Sofokli. *Stalinizmi shqiptar: një vështrim nga poshtë*, disertacion doctoral. Universiteti i Tiranës: 2015.
- Musaj, Fatmira & Fatmira Rama, & Enriketa Pandelejmoni, "Gender relations in Albania 1967-2009". Në *Gendering Post-Socialist Transition: Studies of Changing Gender Perspectives*, Krassimira Daskalova (ed.). Vienna: Verlag, 2012.
- Stalinism Rvisited: The Establishment of Stalinist regimes in Eastern and Central Europe*. Vladimir Tismaneanu (ed.). Budapest-New York: CEU Press, 2009.
- Starks, Tricia. *Propaganda Hygiene and the Revolutionary State*. Wisconsin University Press: 2008.
- Tolstikova, Natasha & Linda Scott. "The New Woman and the New Byt: Women and Consumer Politics in Soviet Russia". Në *Advances in Consumer Research*, vol. 28, Mary C. Gilly, & Meyers-Levy, Joan Valdosta (editors). GA: Association for Consumer Research, 2001: 106-113.
- Verdery, Katherine. *What is Socialism and what will come next?* Princeton University Press: 1996.
- Verdery, Katherine. "From parent-state to family patriarchs: Gender and nation in contemporary, Eastern Europe", *East European Politics and Societies*, 8 (1) (1994): 225-255.
- Verdery, Katherine. *National Ideology under Socialism: Identity and Cultural politics in Ceausescu's Romania*. University of California Press: 1991.
- Verdery, Katherine. *What is Socialism and what comes next*. Princeton University Press: 1996.

- Vorpsi, Irida. "Fotografia si mjet i përhapjes së propagandës së emancipimit të gruas në Shqipërinë komuniste". Në *Përpyekja*, Viti XX, nr. 32-33 (2014): 183-204.
- Williams, Bruce. "Cherchez la femme: Gratë revolucionare në filmat e Kinostudios". *Politikja 2* (2018): 129-143.
- Woodcock, Shannon. *Life is War: Surviving Dictatorship in Communist Albania*. Hammeron Press: 2016.

KLEJD KËLLIÇI

Faculty of Social Sciences / University of Tirana
k.kellici@gmail.com

ERMIRA DANAJ

American Graduate School, Paris
edanaj@gmail.com

S u m m a r y

WOMEN'S EMANCIPATION: DISCOURSE ON THE ROLE OF WOMEN IN THE 1960S-1970S ON THE PAGES OF THE MAGAZINE "NEW ALBANIAN WOMAN"

This paper is an attempt to identify different phases of the discourse on the concept of women's emancipation during communism in Albania between the 1950s and 1970s. Women's emancipation is seen as one of the most important policies implemented with the establishment of the regime, and also among the longest-lasting interventions. Women became subjects of intervention and transformation directed by the party, which determined the identity and the way it should be displayed in the new space of socialist Albania. The concern or the construction of public policies on women's emancipation was as much a part of the ideological arsenal as it was of the already manifested models, such as that of the Soviet Union. Thus, the regime not only tried to act and transform women based on the ideological principles of Marxism but, above all, it tried to apply a proven and desirable model of imitation, the Soviet one. Later, especially after 1961, efforts were made to offer an Albanian version of the model of women's emancipation.

SABIT SYLA

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë
sabitsyla1976@gmail.com

NURI BEXHETI

Fakulteti Filozofik / Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
nuribegu@yahoo.com
<https://doi.org/10.61773/ywqxzj78>

**FORMACIONET SHTETËRORE SERBE NË KOSOVË
MË 1998-1999****Abstrakt:**

Artikulli trajton forcat serbe të përfshira në luftën e Kosovës gjatë viteve 1998-1999. Qeveria e Serbisë gjatë viteve në fjalë angazhoi një numër të madh të forcave të armatosura serbo-jugosllave që paraqisnin një kombinim kompleks të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), përfshirë këtu forcat e rregullta dhe ato speciale të Ushtrisë Jugosllave (UJ) dhe njërive të saj, forcave apo njërive të ndryshme paramilitare, milicive lokale dhe grupe mercenarësh që u sollën nga jashtë, të gjitha këto nën ombrellën, kontrollin apo urdhrat e qeverisë në Beograd. Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë hierarkinë dhe veprimet e tyre të përbashkëta në luftën kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), krimet kundër popullsisë civile dhe spastrimin etnik të Kosovës. Në historiografinë shqiptare deri më tani nuk kemi shkrime për formacione të tilla që kanë vepruar në Kosovë, dhe kjo është përpjekja e parë me synim që të thellohet më tej aspekti studimor në këtë drejtim. Andaj, vlerësojmë që do të jetë pjesë kontribuuese në historiografinë shqiptare e më gjerë.

Fjalë kyçe:

Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i Sigurimit Shtetëror, Ushtria e Jugosllavisë, Komanda e Përbashkët.

Hyrje

Ish-drejtuesi i shtetit serb Slobodan Millosheviç kishte besim të madh te policia dhe shërbimet sekrete, kështu që ai u dha një prioritet këtyre organizatave. Si rezultat i një logjike të tillë, policia dhe shërbimi i Sigurimit Shtetëror u trajnuan dhe u pajisën më mirë sesa ushtria. Millosheviçit i duhej një forcë e armatosur që do t'ia siguronte pushtetin personal dhe zgjidhjen e gjeti në ndryshimin e rolit të policisë. Kjo e fundit gradualisht mori tipare ushtarake, madje edhe në pamje të jashtme, përfshirë uniformat e kamufluara dhe gradat ushtarake. Kështu, një strukturë tipike ushtarake u prezantua në njësitet policore, e kjo i dha fund policisë së rëndomtë në Serbi. Në kuadër të MPB-së u formuan njësi klasike ushtarake që nuk kishin të bënin fare me punën policore.¹ Në fakt, policia në Serbi ishte shndërruar në një xhandarmëri dhe ishte e pajisur madje edhe me mjete të blinduara e mortaja. Disa të dhëna theksonin se Serbia kishte forcën më të madhe të policisë në Europë në krahasim me numrin e banorëve, afërsisht rreth 40 000 deri 150 000 policë. Fuqia reale e pushtetit nuk bazohej në policinë e rregullt, por në shërbimet sekrete dhe në strukturat e tyre të fshehta. Shërbimi i Sigurimit Shtetëror kishte një rol të veçantë në ruajtjen e regjimit. Policia sekrete deri në vitin 2002 përbënte njërin nga dy sektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të udhëhequr nga ndihmësit e veçantë të ministrit. Këta vetëm formalisht figuronin në MPB, kurse për të raportuar i raportonin drejtpërdrejt Millosheviçit. Nga viti 1945 deri në vitin 2002 nuk kishte ndonjë ligj që i referohej ndonjë shërbimi të caktuar të inteligjencës. Në fakt, shefat e shërbimeve sekrete vetëvendosnin mbi formimin e shërbimit, detyrat e tij, kompetencat, organizimin, operimin dhe përgjegjësinë. Në këtë mënyrë u krijua tradita që shërbimi të punonte i pavarur nga ligji dhe sipas rregullave të vetëshpallura.²

Me transformimin e Armatës Popullore të Jugosllavisë në Ushtrinë e Jugosllavisë më 19 maj 1992, pas vendimit për formimin e Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), të përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, garnizonet ushtarake në Kosovë u futën në kuadër të Armatës III me seli në Nish, kurse korpusi 52 u emërua si Korpusi i Prishtinës. Përmes kësaj

¹ *Context Analysis of the Security Sector Reform in Serbian 1989-2009*, Belgrade Centre for Security Policy (Belgrade: 2011), 15-16.

² *Po aty*, 16.

urdhërese në kuadër të këtij korpusi (por edhe te korpuset e tjera) u sistemuan ish-njësitet e mbrojtjes territoriale të Serbisë, respektivisht të Kosovës. Të gjitha brigadat e Korpusit kishin njësitet e tyre të blinduara, të sistemuara pothuaj në të gjitha garnizonet në Kosovë. Batalionet kufitare u emëruan si batalione nr. 53, 55, 57³ etj.

Interesimi i Millosheviçit për ushtrinë u rrit më 1997, kur ai u zgjodh kryetar i Jugosllavisë dhe me këtë rast fitoi edhe kontrollin zyrtar mbi të. Në mesin e gjeneralëve ai gjeti kuadro që ishin të gatshëm të konfrontoheshin me botën, jo vetëm për shkak të ideologjisë së tyre nacionaliste, por edhe për shkak të motivimeve personale. Millosheviç kishte nevojë për gjeneralët në mënyrë që të zbatonte planin për sundimin e përfjetshëm, kurse në anën tjetër edhe gjeneralët kishin nevojë për Millosheviçin që të ngjithnin shkallët e hierarkisë ushtarake. Kështu, gjeneralët morën pjesë në fushatat politike, bënë prononcime në shtyp, madje edhe kërcënime publike duke theksuar se nuk do të lejonin ndryshimin e pushtetit.⁴ Ushtria Jugosllave e kishte Komandën e Përgjithshme gjatë sulmeve të NATO-s, së bashku me forcat policore e paramilitare nën urdhrat e saj sipas ligjit, edhe pse zyrtarët më të lartë të MPB-së qartazi ushtruan një lloj ndikimi gjatë fushatës. Ushtria kontrollonte rrugët kryesore dhe kufijtë, duke koordinuar dhe lehtësuar kështu spastrimin etnik. Policia dhe forcat paramilitare u angazhuan më drejtpërdrejt në dëbimin e shqiptarëve dhe shkatërrimin e fshatrave, përmes mbështetjes artilerike nga ushtria.⁵ Gjatë operacioneve të zhvilluara nga të dyja palët, si nga UJ-ja po ashtu edhe MPB-ja, u kryen krime kundër civilëve shqiptarë të grupmoshave të ndryshme e pronave të tyre dhe u shpërngulën me mijëra civilë në masë⁶ nga të gjitha fshatrat dhe qytetet e Kosovës.

³ Bojan B. Dimitrijević, "Jedinice Jugoslovenske Vojske na Kosovu i Metohiji 1945-1999", *Istorija 20. Veka*, Br. 2/2007, Institut za Savremenu Istoriju (Beograd: 2007), 116.

⁴ *Contex Analysis*, 15.

⁵ *Under Orders - War Crimes in Kosovo*, Human Rights Watch (2001), 9-10.

https://www1.essex.ac.uk/armedcon/story_id/Under_Orders_warcrimesinkosovo.pdf.

⁶ Kombet e Bashkuara, *Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991*. Lënda nr. IT-05-87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykim kundër Millan Millutinoviçit, Nikolla Shainoviçit, Dragolub Ojdaniçit, Nebojsa Pavkoviçit, Vladimir Llazareviçit, Sreten Llukiqit, 347.

Forcat e lartpërmendura në gjithë Kosovën zhvilluan një praktikë tipike: ushtria dhe forcat speciale policore e rrethonin fshatin dhe e granatonin nga distanca. Më pas, forcat e rregullta dhe ato speciale policore futeshin në fshat, e spastronin atë dhe i grumbullonin civilët në një vend të caktuar. Meshkujt ndaheshin nga gratë e fëmijët dhe merreshin në pyetje lidhur me UÇK-në. Policia e rregullt dhe paramilitarët më pas e plaçkitnin fshatin, vidhnin gjithçka që kishin banorët dhe shkatërronin dokumentet e tyre identifikuese. Fshati pastaj lihej nën mëshirën e policisë, paramilitarëve dhe milicisë lokale serbe, që plaçkitnin atë çfarë kishte mbetur dhe në fund e digjnin atë,⁷ vrisnin e masakronin gra, fëmijë e njerëz të moshave të ndryshme pavarësisht përkatësisë gjinore.

Ministria e Punëve të Brendshme

Komponentët kryesorë të kësaj ministrie ishin: Sektori për Siguri Publike dhe ai për Siguri Shtetërore. Kompetencat e komponentit të parë sipas ligjit serb të kohës konsistonin kryesisht në ruajtjen e rendit publik, kurse zbatimi i tyre kryhej nga Sekretariati për Punë të Brendshme (SPB). Në Serbi kishte 33 qendra të SPB-së. Nga ky numër shtatë qendra operonin në Kosovë gjatë viteve 1998-1999: SPB Prishtinë – përfshinte komunat: Drenas, Fushë-Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë dhe Prishtinë; SPB Mitrovicë – përfshinte komunat: Vushtrri, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Skënderaj dhe Mitrovicë; SPB Pejë – përfshinte komunat: Istog, Klinë dhe Pejë; SPB Gjakovë – përfshinte komunat: Gjakovë dhe Deçan; SPB Prizren – përfshinte komunat: Rahovec, Suharekë, Dragash dhe Prizren; SPB Ferizaj – përfshinte komunat: Kaçanik, Ferizaj, Shtime dhe Shterpcë; SPB Gjilan – përfshinte komunat: Viti, Kamenicë, Novobërdë dhe Gjilan.⁸ Shefi i SPB-së komandonte operacionet në zonën e tij të përgjegjësisë. Gjatë viteve 1998-1999, SPB-ja ishte nën komandën e Shtabit të MPB-së për Kosovën me seli në Prishtinë.⁹

Qeveria e Serbisë gjatë viteve 1998-1999 angazhoi në Kosovë një numër të madh të forcave policore serbe, të cilët vepruan nën ombrellën e Ministrisë së Punëve të Brendshme apo të SPB-së përkatëse në kuadër të Sektorit për Siguri Publike. Kështu struktura e forcave policore ndahej:

⁷ *Under Orders*, 63.

në policë të rregullt, rezervistë, Njësitë Speciale Policore (NJSP), Njësia Speciale Antiterroriste (NJSA) etj.

Njësitë Speciale Policore (NJSP) – Gjatë viteve 1998-1999 në kuadër të NJSP-së vepronin Brigadat 122 dhe 124 ndërhyrëse, si dhe ekipet: 23, 35, 36, 37, 73, 85 dhe 86 të NJSP-së. Secila SPB në Kosovë kishte së paku një njësi speciale, kurse SPB-ja e Prishtinës kishte dy.¹⁰ Gjatë periudhës korrik 1998 - 24 mars 1999, NJSP-ja në Kosovë përdorte zakonisht uniforma të kamufluara me ngjyrë të kaltër. Ata bartnin etiketën “Milicija”. Trajnimi i pjesëtarëve të NJSP-së për përdorimin e armëve bëhej nga UJ-ja. Armatimi i NJSP-së përbëhej nga: mina këmbësorie, granatahedhëse të kalibrit 60 dhe 80 (apo 82), mitralozë të kalibrit 12.7 mm, top kundërajror, raketahedhëse dore, raketahedhëse zolë etj.¹¹ Kjo njësi ia kalonte policisë së rregullt për nga specializimi dhe intensiteti i trajnimeve të tyre, si dhe për pajisjet e sofistikuara të armatosjes. Sipas Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë dhe të një analisti të famshëm policor në Beograd, NJSP-ja vlerësohej se kishte 7 000 trupa, edhe pse numri i tyre mund të rritej shpejt përmes rekrutimit të policëve të rregullt. Ministria e Mbrojtjes e Britanisë vlerësonte se NJSP-ja kishte 5 000 pjesëtarë dhe 8 000 rezervistë të ndarë në gjashtë sektorë në Serbi.¹²

Njësia Speciale Antiterroriste (NJSA) – E njohur në opinionin jugosllav si “Specialna Antiteroristička Jedinica”. Ishte forcë elitare e trajnuar në mënyrë speciale dhe e armatosur me armët më moderne të kohës. E formuar në korrik të vitit 1996 NJSA-ja përbëhej nga tri njësi me seli në Batanjićë afër Beogradit, ku ishte edhe qendra e tyre trajnuese, në Novi Sad dhe në Prishtinë. Struktura e NJSA-së në Beograd e Prishtinë ishte identike. Përbëheshin nga komanda dhe tri ekipe. Në dhjetor të vitit 1998 shpërbëhet ekipi i NJSA-së në Novi Sad. Sipas disa të dhënave, NJSA-ja kishte rreth dyqind pjesëtarë, nga 100 në secilin

⁸ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud za krivično gonjenje lica odgovornih za teška kršenja međunarodnog humanitarnog prava počinjena na teritoriji bivše Jugoslavije od 1991. Godine*, Predmet br. IT-05-87/1-T, Vlastimir Djordjevic, Datum: 23 februar 2011, 17.

https://www.icty.org/x/cases/djordjevic/tjug/bcs/110223_judgement_p1_bcs.pdf.

⁹ *Po aty*, 19.

¹⁰ *Po aty*, 24.

¹¹ *Po aty*, 24-25.

¹² *Under Orders*, 79.

ekip.¹³ Ndërsa, sipas Ministrisë britanike të Mbrojtjes NJSA-ja kishte rreth 400-500 trupa, kryesisht të rekrutuar nga forcat speciale të UJ-së.¹⁴ NJSA-ja ishte e trajnuar në mënyrë speciale, përdorte armatimet më moderne.¹⁵ NJSA-ja përdorte uniforma të kamufluara me ngjyrë të gjelbër/hiri dhe çizme të modelit “Gore-Tex”. Bartnin etiketën SAJ (NJSA) me shkronja cirilike, dhe poshtë saj mbishkrimin “Policija”. Po ashtu, bartnin emblemën me orlin dykrerësh me sfond të kuq dhe katër shkronja “S”. Nga fundi i vitit 1998 NJSA, përveç armatimit modern të llojit “Heckler-Koh”, filloi të përdorte edhe armatim të rëndë. Në automjetet e tyre u montuan mitralozët e rëndë të kalibrit 12.7 mm dhe granatahdhëse 60 deri 82 mm.¹⁶

Forcat rezervë – Përveç të tjerash, SPB-ja kishte për detyrë edhe organizimin e forcave policore rezervë. Në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999 ekzistuan dy lloj organizimesh të forcave policore rezervë: rezervistët e rregullt, të cilët pas mobilizimit kishin uniforma të policisë së rregullt dhe gëzonin po të njëjtat të drejta, si dhe njësia e policisë rezervë që në fakt ishin njësite lokale të përbëra ekskluzivisht nga serbët lokalë, të cilat, që nga fillimi i vitit 1998 u armatosën nga qeveria e Serbisë, një proces që u intensifikua në muajt qershor-korrik të po të njëjtit vit. Krahas armatimit, këta u trajnuan edhe nga MPB-ja dhe Ushtria Jugosllave në përdorimin e armëve të zjarrit dhe organizimin e mbrojtjes së vendbanimeve të tyre. Mobilizimi dhe armatosja e tyre kishte karakter masiv. Në një raport nga mbledhja e Shtabit të MPB-së, të mbajtur më datë 28 korrik 1998, thuhej se ishin formuar 243 njësi të policisë rezervë në të cilat bënë pjesë banorët e fshatrave/qyteteve përkatëse dhe ishin armatosur rreth 54 683 njerëz, 12 170 prej të cilëve u armatosën nga MPB-ja kurse 34 716 nga UJ-ja, ndërsa 7 797 ishin armatosur qysh më herët. Për më tepër, raporti theksonte se në Kosovë kishin arritur edhe 5 070 armë shpërndarja e të cilave ishte duke vazhduar. U vlerësua se në këtë proces duheshin armatosur rreth 60 000 persona.¹⁷ Një shifër e tillë të rekrutuarish lë të kuptohet se ishin mobilizuar pothuajse të gjithë meshkujt serbë lokalë të aftë për armë. Në

¹³ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 27.

¹⁴ *Under Orders*, 85.

¹⁵ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 27.

¹⁶ *Po aty*, 27-29.

¹⁷ *Po aty*, 34, 116-117.

mars të vitit 1999 shpallet mobilizimi i përgjithshëm dhe, si rrjedhojë, u mobilizuan të gjithë rezervistët lokalë.¹⁸

Spektori i Sigurimit Shtetëror ishte përgjegjës për ruajtjen e sigurisë shtetërore, kurse detyrat e tij përfshinin aktivitete informuese, kundërinformuese etj. Në Kosovë kishte tri qendra të Sigurimit Shtetëror: Gjilan – me degën në Ferizaj; Prishtinë – me degën në Mitrovicë dhe Prizren me degën në Gjakovë e Pejë. Në kuadër të Sigurimit Shtetëror kishte nivele të ndryshme të organizimit, prej të cilave Drejtoria e tretë ishte e ngarkuar me luftën kundër terrorizimit. Në kuadër të kësaj drejtorie vepronte Njësia për Operacione Speciale (N JOS), e njohur si “Jedinstvene Specialne Operacije”, e cila kishte për detyrë “kryerjen e detyrave të veçanta” që përfshinin sulme në caqe të ndryshme. E formuar në kuadër të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror, kjo njësi ishte e mirarmatosur në krahasim me njësitë speciale policore. N JOS-ja zotëronte armatimin më modern të kohës, përfshi edhe topa kundërajrorë dhe dispononte dy helikopterë, MIG-24, të cilat nuk i kishte as UJ-ja.¹⁹ Përveç armëve të prodhuara në Jugosllavi, që përdoreshin nga MPB-ja dhe UJ-ja, N JOS posedonte edhe armatime perëndimore sikurse Heckler Koh, pushkë MP5, mitralozë të rëndë M2 12. 5mm etj. Personeli i N JOS-së përbëhej kryesisht nga pjesëtarët e ish-“Beretave të Kuqe” të formuara më 1991, të cilët kishin marrë pjesë në luftërat në Kroaci e Bosnjë-Hercegovinë. Kjo njësi ishte një roje pretoriane për Millosheviçin, burimet financiare të së cilës ishin tepër sekret pasi ato vinin kryesisht nga krimi.²⁰ Pikërisht kjo njësi e lartpërmendur së bashku me Njësinë Speciale Antiterroriste dhe Njësinë Speciale Policore kishin zbatuar operacionin në Prekaz kundër familjes Jashari më 5-7 mars të vitit 1998, i përgatitur dhe i udhëhequr nga Spektori i Sigurimit Shtetëror dhe ai i Sigurisë Publike të MPB-së. John Crosland, atashë ushtarak britanik në Beograd, i cili ato ditë po vizitonte rajonin, kishte parë më 5 mars 1998 shumë pjesëtarë të MBP-së në rajonin në fjalë.²¹ Pas një lufte të ashpër

¹⁸ *Po aty*, 33.

¹⁹ *Bombardovanje 1999 - Put u rat*, RTS - Radio-televizija Srbije, Zoran Stijović - shef i sektorit të analizave i resorit të Sigurimit Shtetëror të MPB-së në Kosovë gjatë vitit 1998, Momir Stojanović - gjeneral në pension, ish-shef i resorit të sigurimit të Korpusit të Prishtinës të UJ-së gjatë vitit 1998, <https://www.youtube.com/watch?v=J1Cy1tBbDYY>.

²⁰ *Context Analysis*, 17.

²¹ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 102.

me këto njësite elitare të forcave serbe, Adem Jashari ra dëshmor së bashku me 58 anëtarët e tjerë të familjes së ngushtë dhe familjes së gjerë Jashari.

Në kuadër të NJOS-së u angazhuan edhe ekipe paramilitare që u vunë nën kontrollin e saj, sikurse “Skorpioni” (Akrepas), “Sivi vukovi” (Ujqit e përhimtë), “Arkanovi tigrovi” (Tigrat e Arkanit) etj. Në krye të njësisë ishte Frenki Simatoviq, kurse komandant operativ ishte Milorad Ulemek Lukoviq, i njohur si Legija.²²

Gjatë vitit 1998, baza e NJOS-së ishte në burgun e Dubravës në Istog dhe ajo vepronte krahas policisë së rregullt.²³ Ndërsa sipas disa burimeve të tjera, baza e kësaj njësie ndodhej në Deçan, diku në pjesën e pasme të manastirit të Deçanit.²⁴ Sidoqoftë, NJOS së bashku me forcat NJSP vepruan në këto rajone: Malishevë – mesi i korrikut 1998; Drenicë e Jabllanicë – 1998; Strellc i Epërm – korrik/gusht 1998; Bajgorë, Qyqavicë e Kosmaq – tetor 1998; Istog e Deçan – 1999; dhe Rogovë në janar të vitit 1999²⁵ etj. Sipas disa vlerësimeve në Kosovë gjatë tetorit të vitit 1998 kishte 14 000 pjesëtarë të MPB-së. Në fund të tetorit, në pajtim me marrëveshjen e Tetorit (Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviç), numri i pjesëtarëve të MPB-së (policëve) zbriti në 10 000. Ndërsa në mars 1999 numri i pjesëtarëve të MPB-së u rrit në 14 571, kurse në prill 1999 në Kosovë kishte 15 779 pjesëtarë të MPB-së.²⁶

Ndryshe nga Kroacia dhe Bosnja, në Kosovë grupet paramilitare u integruan kryesisht në UJ dhe MPB, saqë u lejuan të vepronin të pavarura.²⁷ Përkundrazi, ata operuan në bashkëpunim të ngushtë me policinë, ushtrinë, sidomos me Sektorin e Sigurimit Shtetëror. Kishte raste kur paramilitarët dilnin nga kontrolli, por në përgjithësi zbarkimi i tyre në Kosovë dhe koordinimi me sektorët e tjerë të aparatit të sigurisë ishte komponent i planifikuar në Kosovë.²⁸

²² *Po aty*, 269-270.

²³ *Bombardovanje 1999 - Put u rat.*

²⁴ *Po aty*, f. 30.

²⁵ *Po aty*, f. 31.

²⁶ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 101.

²⁷ *Under Orders*, 86-87.

²⁸ *Po aty*, f. 63.

Ushtria e Jugosllavisë

Sipas një raporti të OSBE-së, “Kosovo/Kosova: As seen as Told-Part I”, UJ-ja kishte një personel të përgjithshëm që shkonte nga 85 000 deri në 114 000 veta dhe të një force rezervë që shkonte deri në 200 000 persona. UJ-ja përbëhej nga tri komponentë: ushtria tokësore, ajrore-kundërajrore dhe marina. Organi më i lartë i saj ishte Shtabi i Përgjithshëm. Ushtria tokësore ishte komponenti më i madh dhe ndahej në tri pjesë të tjera: Armata I zona e përgjegjësish e së cilës përfshinte pjesën më të madhe të Serbisë; Armata II që përfshinte Malin e Zi; dhe Armata III zona e përgjegjësish e së cilës përfshinte Serbinë Jugore dhe Kosovën.²⁹

Armata III e Ushtrisë Jugosllave kishte këtë strukturë: Grupi Taktik i Timokut, Korpusi i Nishit, Korpusi i Leskovcit dhe Korpusi i Prishtinës (i njohur edhe si korpusi 52). Këto korpuse përbëheshin nga një numër i caktuar brigadash, batalionesh dhe ekipesh. Korpusi i Prishtinës që përfshinte territorin e Kosovës përbëhej nga:

- Brigada 15 e motorizuar (Prishtinë);
- Brigada 125 e motorizuar (Mitrovicë-Pejë);
- Brigada 549 e motorizuar (Prizren-Gjakovë);
- Brigada 243 e mekanizuar (Ferizaj-Gjilan);
- Brigada 52 e përzier e artilerisë (Gjilan);
- Njësia 52 e Policisë Ushtarake (Prishtinë);
- Regjimenti 83 i aviacionit;
- Regjimenti 82 i inxhinierisë (Krushevc);
- Regjimenti 311 i mbrojtjes kundërajrore (Gjakovë);
- Batalioni 53 kufitar (Gjakovë);
- Batalioni 55 kufitar (Prizren);
- Batalioni 57 kufitar (Ferizaj)³⁰ etj.

Gjatë vitit 1999 Korpusi i Prishtinës përbëhej nga 12 brigada, të cilat ishin të ngarkuara të vepronin brenda Kosovës. Secila brigadë kishte zonën e përgjegjësish. Kështu, gjatë vitit 1998, zona e përgjegjësish së

²⁹ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni Krivični Sud za bivšu Jugoslaviju*, Tužitelj protiv Milana Milutinovića, Nikole Šainovića, Dragoljuba Ojdanića, Nebojše Pavkovića, Vladimira Lazarevića i Sretena Lukića (I. dio), Predmet br. IT-05-87-T, Presuda 1 od 4, 26 februar 2009, 177.

³⁰ *Under Orders*, 67.

Brigadës 125 përfshinte komunat: Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Klinë, Istog, Pejë dhe Deçan.³¹ Brigada 37 e motorizuar³² me urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Jugosllavisë, më datë 29 korrik 1998, hyri në kuadër të Korpusit 52 (të Prishtinës) të Armatës III të UJ-së.³³ Korpusi i Prishtinës, i cili ishte përgjegjës për territorin e Kosovës,³⁴ nuk mund të vepronte pa miratimin e komandantit të Armatës III.

Gjatë vitit 1998 komandant i korpusit të Prishtinës të UJ-së ishte gjenerali Nebojsa Pavković, i cili në nëntor të vitit 1998 emërohet në pozitën e komandantit të Armatës III të UJ-së, në të njëjtën kohë kur gjenerali Dragoljub Ojdaniq u emërua si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Në vend të Pavkovićit, si komandant i Korpusit të Prishtinës emërohet gjenerali Vlladimir Lazareviq.³⁵ Ndërkohë, Radomir Marković u emërua shef i Sigurimit Shtetëror të Serbisë.

Në këtë periudhë UÇK-ja kontrollonte një pjesë të konsiderueshme të territorit në Kosovë. Në fillim të prillit 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës formoi skuadrat luftuese. Në kuadër të këtyre skuadrave luftuese u inkuadruan edhe Bateritë 20/3 mm M55A4M1 BOV-3 dhe 30/2 mm M-53/59/70 J171A PRAGA V3S me detyra përkatëse: kontrollimi i territorit dhe përcjellja e kolonave ushtarake; ofrimi i ndihmës për MPB-në gjatë realizimit të operacioneve antiterroriste etj.³⁶ Një ndër detyrat parësore të ARJ*– PVD në kuadër të skuadrave luftuese ishte ofrimi i ndihmës njësive të MPB-së të Serbisë, të cilat në terren po zhvillonin operacione luftarake kundër UÇK-së. Ndihma konsistonte në përcjelljen e njësive të MPB-së, kontrollin e territorit dhe sigurimin e rrugëve gjatë realizimit të aksioneve. Në rast të sulmeve të UÇK-së

³¹ *Dosije 125, motorizovana brigada Vojske Jugoslavije*, Fond za humanitarno pravo (Beograd: 2013), 9.

³² Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 59-60.

³³ *Dosije 125*, 2.

³⁴ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 59.

³⁵ *Po aty*, 67.

³⁶ Goran Radovanović, “Upotreba ARJ-PVD M/D na Kosovu i Metohiji 1998 i tokom agresije NATO 1999. Godine”, *Vojno Delo*, 7/2017, Univerzitet Odbrane, Vojna Akademija, Beograd, 2017.

http://www.odbrana.mod.gov.rs/odbrana-stari/vojni_casopisi/arhiva/VD_2017-7/69-2017-7-17-Radovanovic.pdf, f. 246.

* ARJ - Artiljerijsko-raketne jedinice za protivvazduhoplovna dejstva (Njësiti raketore-artilerike për veprime kundërajrore).

kundër njësive të MPB-së, ARJ përmes veprimeve i kundërvijet sulmit.³⁷ ARJ përdori kundër UÇK-së një sasi të konsiderueshme municionesh: fishekë 20 mm - 20 280 copë dhe fishekë 30 mm - 65 515 copë.³⁸

Qysh nga pranvera e vitit 1998, Ushtria Jugosllave po operonte përmes njësive të kombinuara të quajtura “skuadra luftuese”. Një skuadër e tillë përbëhej nga një kompani e këmbësorisë së motorizuar, një apo dy togje tankesh, gjysmë baterie artilerie dhe mortaja të rënda, disa inxhinierë e trupa logjistike dhe një tog kundërajror me armë përkatëse antiajrore³⁹ etj. Në qershor të vitit 1998, Ushtria e Jugosllavisë filloi një kundërofensivë në të cilën morën pjesë 40 000 trupa të shoqëruara me tanke, helikopterë, artileri të rëndë dhe granata.⁴⁰ Kështu nga fillimi i vitit 1998, Njësitë Speciale të MPB-së të Serbisë ishin baza e forcave të armatosura të RFJ-së në luftën kundër gueriljes shqiptare, kurse nga qershori i vitit 1998 edhe UJ-ja, kryesisht të Korpusit të Prishtinës. Në korrik të vitit 1998, në pajtim me urdhëresën e veçantë të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Komanda e Armatës III dha urdhër për operacionin Grom 98. Ky operacion u zhvillua në bashkërendim me MPB-në kundër UÇK-së. Madje u urdhërua për detyra ndihmëse edhe Armata I dhe II me njësitet e tyre⁴¹ etj. Edhe operacioni ushtarak i shtatorit 1998 ishte i koordinuar nga UJ-ja me organet e MPB-së,⁴² i cili në opinionin shqiptar të Kosovës njihet si “Ofensiva e Shtatorit”, që përfshiu pjesë të gjera të Kosovës. Komanda e Korpusit të Prishtinës përmes një shkrese, të emërtuar si sekret ushtarak tepër konfidencial, nr.

³⁷ Radovanović, “Upotreba ARJ-PVD M/D”, 248.

³⁸ Po aty.

³⁹ Bruce R. Nardulli, Walter L. Perry, Bruce Pirnie, John Gordon, *Disjointed War*, RAND Corporation (2002). <https://www.jstor.org/stable/10.7249/mr1406a.11>, f. 30.

⁴⁰ R. Craig Nation, *War in the Balkans, 1991-2002*, Strategic Studies Institute, US Army War College (2003), 227.

⁴¹ Fond za humanitarno pravo, *Zona neodgovornosti*, Operacioni GROM 98, Komanda e Armatës III, sekret shtetëror nr. 6034-7/1, 29 korrik 1998. Urdhër, për shkatërrimin e “forcave terroriste shqiptare” (FTSH) dhe shuarjen e kryengritjes së armatosur në Kosovë e Metohi. Komandanti gjeneral kolonel Dushan Samarxhiq, <http://zonaneodgovornosti.net/> f. 1-10.

⁴² Fond za humanitarno pravo, *Zona neodgovornosti* <http://zoneofnonresponsibility.net/>. Dokumenti 9/a, Komanda e Grupit Luftues BG-4, Tepër sekret, 25.09.1998. Analizë mbi operacionet e kryera. Për: Komandën e Brigadës 125 të motorizuar, Mitrovicë e Kosovës. Analizë mbi operacionet ushtarake të datës 22 shtator 1998. Nga: 22 shtator 1998, ora 07:00 deri më 23 shtator 1998, ora 02:00. Raportuar nga komandanti major Petko Jovčić.

880-243, njoftonte më 19 shtator 1998 njësitë vartëse të saj mbi “Urdhëresën për të mbështetur forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme në shkatërrimin e forcave terroriste në rajonin e gjerë të Qiqavicës”.⁴³ Urdhëresa në fjalë përmbante edhe planin e veprimit, forcat e angazhuara dhe objektivat e parashikuar. Në kuptim të gjerë duheshin arritur dy objektiva me rëndësi strategjike: (a) vënia nën kontrollin e forcave ushtarake e policore serbe të rrugëve të komunikacionit: Prishtinë – Vushtri – Mitrovicë – Klinë e Epërme dhe të asaj Drenas – Skënderaj, dhe (b) vënia nën kontroll e malit Qyqavicë si një pikë avantazhi ushtarak. Në kuadër të këtij projekti ushtarak, një objektiv tjetër ishte edhe vendosja e kontrollit mbi një pjesë të rajonit të Vushtrisë përgjatë malit Qyqavicë, respektivisht të fshatrave Ashlan dhe Dubovc, të cilat ndodhen disa kilometra në jug të Mitrovicës dhe në perëndim të Vushtrisë. Më 22 shtator, trupat serbe marshuan në drejtim të fshatit Ashlan nga drejtimi i Mitrovicës, ku ishin angazhuar togu 5 i NJSP-së dhe një tog i NJSP-së nga SPB i Mitrovicës, të mbështetura nga grupi luftues BG-125-4 i Brigadës 125 të UJ-së. Objektivi i këtij sulmi konsistonte në shkatërrimin e forcave të UÇK-së përgjatë linjës Akrahticë-Pantinë-Shtitaricë për t’i futur nën kontroll fshatrat Ashlan, Balincë, Jezercë dhe Taraxhë. Objektiv tjetër ishte edhe mbështetja për NJSO-në për shkatërrimin e forcave të UÇK-së përgjatë Qyqavicës, me detyrë specifike parandalimin e tërheqjes së UÇK-së përgjatë lumit Sitnicë.⁴⁴ Ky sulm rezultoi me pjesëtarë të vrarë të forcave të MPB-së dhe të plagosur nga NJSP-ja, e po ashtu edhe nga radhët e UÇK-së, si dhe me djegien e shtëpive shqiptare dhe me dhjetëra civilë të vrarë.⁴⁵ Gjithashtu, një tjetër objektiv i kësaj fushate ishte edhe detyra për ta vënë nën kontroll territorin në linjën Mikushnicë-Lubovec-Dubovc. Në zbatimin e kësaj detyre ishin ngarkuar togu 3 i NJSP-së, një tog i NJSP-së nga SPB-ja e Pejës dhe NJSO, të mbështetura nga grupi luftues BG-125-1 i Brigadës 125 të motorizuar të UJ-së. Këto forca arritën që, më datë 23 shtator 1998 të depërtonin në fshatin Dubovc. Menjëherë filluan me djegien e shtëpive. Banorët e fshatit ikën në pyjet e malit Qyqavicë. Po të

⁴³ Fond za humanitarno pravo, *Zona neodgovornosti*, “Order to support MUP/Interior Ministry/ in breaking up DTS forces in general Cicavica sector”, 1. <http://zoneofnonresponsibility.net> (shikuar më 27.06.2020).

⁴⁴ *Dosije 125*, 9.

⁴⁵ Fond za humanitarno pravo, *Zona neodgovornosti*, “Analysis of performed combat operations”, 1-3. <http://zoneofnonresponsibility.net> (shikuar më 27.06.2020).

njëjtën ditë, më 23 shtator 1998, forcat serbe filluan granatimin e pandërprerë të malit Qyqavicë. Nën zjarrin e artilerisë u gjendën edhe vendet ku strehoheshin mijëra civilë, dhe sipas burimeve të Fondit për të drejtën humanitare në periudhën 23-26 shtator 1998 u vranë rreth 130 civilë, midis tyre edhe 28 fëmijë.⁴⁶

Plane veprimi me një bashkërendim të tillë u hartuan brenda UJ-së edhe më 1999. Kështu, në janar dhe më pas në prill të vitit 1999 u përgatitën dy plane të mëdha (planet Grom 3 dhe Grom 4).⁴⁷

Në javën e parë të marsit 1999 Brigada 37 e motorizuar nga Rashka zbarkoi në Mitrovicë, në kuadër të Korpusit të Prishtinës, kurse grupi luftues 21 nga Korpusi i Nishit zbarkoi në Ferizaj dhe u vu nën ombrellën e Brigadës 243 të motorizuar. Forcat e UJ-së vazhduan ta përforconin kufirin me Shqipërinë e Maqedoninë. Më 18 mars u thirrën në shërbim rreth 36 449 pjesëtarë të shërbimit rezervë, prej të cilëve u përgjigjën 26 295 apo 72%. Këtij numri duhet t'i shtohet edhe grupi i ushtarëve të cilëve u kishte skaduar shërbimi në mars (që nuk u liruan), por vazhduan të shërbenin si rezervistë. Ishin rreth 7 831 rezervistë të tillë.⁴⁸

Fillimi i operacionit “Forca Aleate” kushtëzoi dërgimin për në Kosovë të përforcimeve të konsiderueshme të UJ-së, para së gjithash nga territori i Armatës III, por edhe nga rajonet e tjera. Mënyrat e organizimit të këtyre forcave shtriheshin në kuadër të grupeve luftuese të formuara në mënyrë të veçantë. Një pjesë e forcave që u dërguan në Kosovë u angazhua në veprime ushtarake kundër gueriljes shqiptare.⁴⁹ Nga fundi i marsit 1999, kur u ballafaquan me sulmet e NATO-s, ushtria, policia, paramilitarët dhe grupet e tjera koordinuan aktivitetet e tyre kundër UÇK-së dhe mbrojtjes ndaj sulmeve të NATO-s.⁵⁰ Deri më 24 mars 1999, kur filluan sulmet e NATO-s, Korpusi i Prishtinës kishte më pak se 18 000 ushtarë, kurse në fund të marsit kishte 17 971 ushtarë. Ky numër ndryshoi drastikisht pasi parashikohej sulmi tokësor i NATO-s. Sipas raportit të luftës, të datës 13 prill 1999, të cilën Korpusi i Prishtinës ia dërgonte

⁴⁶ *Po aty*, f. 10.

⁴⁷ *Tribunali Ndërkombëtar*, Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-05-87-T, 349.

⁴⁸ Bojan B. Dimitrijević, “Jugoslovenski vojni vrh i pripereme za rat sa NATO, oktobar 1998 - mart 1999”, *Istorija 20. Veka*, Br. 1/2009, Institut za Savremenu Istoriju (Beograd: 2009), 169.

⁴⁹ Bojan Dimitrijević, “Vazdušne operacije NATO u Jugoslaviji i posledice”, *Istorija 20. Veka*, Br. 1/2000, Institut za Savremenu Istoriju (Beograd: 2000), 114.

⁵⁰ *Under Orders*, 63.

Komandës së Armatës III dhe Shtabit Qendror, në Kosovë, nën komandën e Korpusit të Prishtinës kishte gjithsej 61 892 pjesëtarë të UJ-së, përfshi njësitet e tjera të bashkëngjitura dhe vullnetarët.⁵¹ Ndërkohë, sipas Lazareviqit, Korpusi i Prishtinës përmes përforcimeve nga të gjithë sektorët/pjesët e ushtrisë numëronte 75 000-80 000 pjesëtarë, apo edhe më shumë.⁵² Kurse nga fundi i prillit besohet që policia dhe ushtria jugosllave kishin në Kosovë edhe rreth 40 000 njerëz, nën mbështetjen e Armatës II të Jugosllavisë të stacionuar në Mal të Zi.⁵³

Tashmë kishte filluar grumbullimi masiv i trupave të UJ-së në të gjithë territorin e Kosovës, gjë që solli edhe armatosjen e civilëve dhe trajnimin e rezervistëve, sigurimin e armatimit kundërajror, gërmimin e llogoreve për tanke dhe përgatitjen e mjeteve eksplozuese përgjatë rrugëve kryesore, shtimin e aktiviteteve të aviacionit ushtarak⁵⁴ etj. Gjatë marsit 1999, policia serbe dhe Ushtria Jugosllave kishin dy detyra kryesore: ta mposhtnin UÇK-në dhe të përgatiteshin për sulmet e NATO-s. Për t'i arritur këto qëllime, fillimisht, ishte e nevojshme që të siguroheshin rajonet kufitare. Por kujdes më i madh iu kushtua pjesës perëndimore të Kosovës dhe kufirit me Shqipërinë. Këtu nuk ishte vetëm mundësia e hyrjes së NATO-s, por ishte një rajon ku UÇK-ja ishte vazhdimisht aktive, me prapavijë të sigurt dhe furnizime nga Shqipëria. Për më tepër këto furnizime arrinin në zona të tjera të UÇK-së, në Kosovë.⁵⁵

Në kuadër të forcave të UJ-së në Kosovë, përveç ushtarëve të rregullt, u angazhua edhe policia ushtarake nën ombrellën e së cilës vepronin njësi të ndryshme, duke filluar nga ato që trajtonin çështje të brendshme të ushtrisë, ato që kontrollonin komunikacionin e deri tek ato që merreshin me operacione speciale dhe antiterroriste.⁵⁶ Sipas revistës “Vojska”, në kuadër të njësive speciale ushtarake gjatë prillit 1998, përfshiheshin: brigadat kufitare, Brigada 63 parashutiste, Brigada 72

⁵¹ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 60.

⁵² Intervju: General Vladimir Lazarević - *Najveća čast je dati život za odbranu Srbije!* (Publikimi: 28.12.2018), BalkanInfo <https://www.youtube.com/watch?v=-DAKJhE6ksw>.

⁵³ *Kosovo - kako viđeno, tako rečeno*, Analiza OEBS Verifikacione misije Kosovo, stanje ljudskih prva oktobar 1998 - jun 1999, Fond za humanitarno pravo, OSCE (Beograd: 1999), 32.

⁵⁴ *Po aty*, 27.

⁵⁵ *Po aty*, 28.

⁵⁶ *Po aty*, 61.

speciale, njësitë antiterroriste të policisë ushtarake – Kobra dhe Fajkonjtë, si dhe brigadat e blinduara.⁵⁷ Më 14 maj 1999, Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së lëshoi urdhrin për futjen në veprime luftarake të policisë ushtarake.⁵⁸

Në kuadër të njësive speciale ushtarake, duke filluar nga korriku i vitit 1998, u inkuadruan edhe kriminelë e grupe vrasësish të cilët po vuanin dënimin në burgun e Sremit. Pasi u liruan nga pjesa e mbetur e dënimit, ata u pajisën me uniforma, armë të ndryshme dhe kartela të pjesëtarëve të sigurimit ushtarak dhe u dërguan në Kosovë me detyra të veçanta nën kujdesin e eprorëve ushtarakë. Kështu, nën komandën e Dikoviqit, nga maji i vitit 1998 në Brigadën 37 të motorizuar, oficerë të lartë të sigurimit ushtarak, në mesin e të cilëve ishin edhe nënkolonelët Sllobodan Stoshiq e Miograd Gjorgjeviq, i trajnuan dhe i ushtruan grupet e vrasësve, kriminelëve, madje edhe dhjetëra vrasës të tjerë që po vuanin dënimin në Mitrovicën e Sremit. Në korrik të vitit 1998 këto grupe u dërguan në Kosovë, në cilësinë e vullnetarëve të UJ-së. Shumicën e të dënuarve për vrasje, me kërkesë të shërbimeve të fshehta policore e ushtarake, gjykata i liroi nga pjesa e mbetur e dënimit dhe ata u liruan nga burgu. Nënkoloneli Stoshiq u dha atyre uniforma, armë moderne, mjete kimike dhe mjete të tjera për likuidime të heshtura, si dhe shenja e kartela identifikuese të pjesëtarëve të sigurimit ushtarak.⁵⁹ Edhe në fillim të marsit 1999 u dërgua nga kazerma e Rashkës në Kosovë skuadra luftuese (BG 37). Disa prej tyre ishin pjesëtarë të UJ-së të Brigadës 37 të motorizuar, e shumë të tjerë vullnetarë të trajnuar e të armatosur mirë, midis të cilëve edhe vrasës të dënuar nga gjykata e kriminelë lufte.⁶⁰

Të gjitha njësitë ushtarake që vepruan në Kosovë ishin nën komandën e Korpusit të Prishtinës. Nga data 8 prill 1999 edhe Qarku Ushtarak i Prishtinës ishte në varësi të Korpusit të Prishtinës, duke i vendosur kështu të gjitha detashmentet territoriale-ushtarake nën urdhrat e këtij korpusi, i cili bashkërendoi operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së.⁶¹ Këto të fundit gjatë mesit të muajit prill 1999, zhvilluan disa aksione të përbashkëta në rajonin e Drenicës, Çyqavicës, Jezercit,

⁵⁷ *Under Orders*, 70.

⁵⁸ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 62.

⁵⁹ *Dosije* 125, 2.

⁶⁰ *Po aty*, 2-3.

⁶¹ Kombet e Bashkuara, *Tribunali Ndërkombëtar*, Lënda nr. IT-05-87-T, 348.

Rugovës, Bajgorës, Zatriqit e vende të tjera.⁶² MPB-ja dhe UJ-ja i kishin koordinuar planet e tyre para këtyre operacioneve të përbashkëta.

Forcat rezervë të UJ-së – Përveç rezervistëve të rregullt që u rekrutuan në të gjithë territorin e RFJ-së, në kuadër të forcave ushtarake rezervë në Kosovë u inkuadruan edhe serbët lokalë. Detyrë e këtyre serbëve ishte mbrojtja e vendbanimeve të tyre, si dhe pjesëmarrja në operacionet ushtarake në rajonet e tyre.⁶³ Ishin serbët lokalë ata që udhëzuan forcat policore e ushtarake serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë, pasi ata flisnin gjuhën shqipe dhe njihnin fqinjët e tyre shqiptarë, dhe në këtë mënyrë u bënë pjesëmarrës në vrasjet dhe spastrimet etnike.

Mbrojtja territoriale dhe civile – Përveç forcave të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë vepruan edhe forca të tjera që ishin nën kontrollin e organeve shtetërore, të cilat mund të konsideroheshin si “forca të RFJ dhe të Serbisë”. Këtu përfshiheshin njësitet e mbrojtjes territoriale e civile në kuadër të Ministrisë Federale të Mbrojtjes. Në mbledhjen e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, në shkurt të vitit 1999, të pranishmit u informuan se UJ-ja kishte armatosur rreth 47 000 serbë dhe se ishin dërguar municione nëpër fshatra. Detyrë e këtyre serbëve ishte që së bashku me njësitet e UJ-së të merrnin pjesë në operacionet në rrethinën e tyre.⁶⁴

Raportet dhe bashkëpunimi

Në fillim të vitit 1998 në Kosovë ishin aktive vetëm policia e rregullt, ajo speciale dhe Sigurimi Shtetëror. Ushtria, edhe pse e pranishme, kufizohej vetëm në ruajtjen e sigurisë përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Por, një gjë e tillë ndryshoi në prill të vitit 1998 kur ushtria mori pjesë në operacionet policore në jugperëndim të Kosovës përgjatë kufirit me Shqipërinë. Më 23 prill 1998, rripi kufitar me Shqipërinë u zgjerua deri në 5 km. Ky rrip nënkuptonte zonën e përgjegjësisë së forcave të armatosura të RFJ-së përgjegjëse për sigurimin e kufirit. Zgjerimi i këtij rripi nënkuptonte mundësinë që forcat jugosllave të sigurisë të qëndronin aktive në një pjesë më të gjerë të rajonit. Më 21 korrik 1998, rripi kufitar me Shqipërinë e Maqedoninë u

⁶² Ujedinjene Nacije, *Međunarodni Krivični Sud*, Predmet br. IT-05-87-T, Presuda 1 od 4, 177.

⁶³ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 64-65.

⁶⁴ Po aty.

zgjerua edhe më tej, kurse një zgjerim edhe më i madh u bë me vendimin e 5 marsit 1999. Vendimet për zgjerimin e rripit kufitar u morën nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së pas kërkesës së Korpusit të Prishtinës.⁶⁵ Ky ishte momenti i fillimit të bashkëpunimit midis UJ-së e MPB-së (prill 1998), i cili do të merrte një formë më të organizuar dhe më të koordinuar nga qershori dhe korriku i vitit 1998 me miratimin nga udhëheqja më e lartë politike e ushtarake e RFJ-së të “Planit për shkatërrimin e terrorizmit në Kosovë”, prezantuar nga komandanti i Korpusit të Prishtinës, Pavković⁶⁶ dhe më pas të formimit të Komandës së Përbashkët.

Më 30 maj 1998 (apo në një datë të përafërt) në Beograd u zhvillua një mbledhje në kabinetin e kryetarit të RFJ-së. Në këtë mbledhje morën pjesë: kryetari Millosheviç, shefi i Sektorit të Sigurimit Shtetëror, ministri i MPB-së, shefi i Shtabit të MPB-së në Kosovë, shefi i Sektorit të Sigurisë Publike, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, komandanti i Korpusit të Prishtinës etj. Në këtë takim u diskutua situata në Kosovë dhe si rrjedhojë lindi iniciativa për kryerjen e përgatitjeve për ta vëzhguar situatën lidhur me aktivitetet e forcave shqiptare, në mënyrë që të mos ishte një “befasi” për UJ-në apo MPB-në.⁶⁷

Në fillim të qershorit 1998, ushtarakët e lartë të Korpusit të Prishtinës u ngarkuan me hartimin e një plani për shkatërrimin e UÇK-së. Për të hartuar një plan të tillë, ata mblodhën informacione nga të gjitha strukturat jugosllave që vepronin në Kosovë, përfshi MPB-në dhe sektorin e saj të Sigurimit Shtetëror. Më 9 qershor 1998, Këshilli Suprem i Mbrojtjes në mbledhjen e mbajtur lidhur me zhvillimet në Kosovë, në bazë të propozimeve të Millosheviçit vendosi që, UJ-ja të reagoje në “mënyrë adekuate”.⁶⁸ Kjo do të thotë se, UJ-ja mori detyrë, që krahas mbrojtjes së kufijve t’u ofronte ndihmë forcave të MPB-së në luftën kundër UÇK-së.⁶⁹ Kështu, më 9 qershor 1998, UJ-ja hartoi planin që nënkuptonte edhe veprimin e koordinuar midis UJ-së dhe MPB-së. Ky plan u miratua më 21 korrik 1998 në një mbledhje të nivelit të lartë

⁶⁵ *Po aty*, 103.

⁶⁶ Intervju: General Nebojša Pavković - *Bili smo spremni da damo život za odbranu Srbije!* (Publikimi: 6.10.2018), BalkanInfo, <https://www.youtube.com/watch?v=dTVFjLg2Zj4>.

⁶⁷ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 106.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ Intervju: General Vladimir Lazarević.

ushtarak dhe politik serb, përfshirë Millosheviçin dhe figurat kryesore në UJ dhe MPB. Komandanti i Korpunit të Prishtinës të UJ-së, gjenerali Pavković, e prezantoi planin në hartë duke specifikuar zonat e parashikuara për operacione të policisë dhe të ushtrisë. Plani u miratua pa asnjë ndryshim, si dhe u lëshua urdhri për zbatimin e tij.⁷⁰ Si rrjedhojë, intensiteti i veprimeve ushtarake u shtua nga korriku i vitit 1998⁷¹ e në vazhdim, me beteja të ashpra dhe të përgjakshme, ndërmjet forcave serbe dhe atyre të UÇK-së.

Në këtë periudhë komandant i Armatës III ishte gjeneralkoloneli Dushan Samarxhiq, i cili kishte unifikuar komandën mbi të gjitha njësitë e Armatës III.⁷² Ndërkohë, në një mbledhje tjetër që u mbajt në Prishtinë, Vlastimir Gjorgjeviq bëri të ditur formimin e një komande të nivelit të lartë që do të quhej Komanda e Përbashkët.⁷³ Ajo përbëhej nga funksionarë të lartë politikë, udhëheqës të lartë të MPB-së e të UJ-së. Në krye të saj ishte Nikolla Shainović, atëherë zëvendëskryeministër në qeverinë federale,⁷⁴ të cilit i ishte besuar bashkërendimi i ushtrisë dhe i policisë.⁷⁵ Vetë emërimi i Shainovićit tregon për rëndësinë dhe kompetencën vendimmarrëse të kësaj trupe, vendimet e së cilës do të manifestoheshin me vrasje, dëbime dhe shkatërrime të vendbanimeve shqiptare në Kosovë. Nga 22 korriku 1998 e deri në fund të tetorit 1998, Komanda e Përbashkët u mblodh së paku 2-3 herë gjatë një jave, varësisht nga rrethanat apo intensiteti i luftës. Takimi i parë u mbajt në ndërtesën e MPB-së në Prishtinë, kurse të tjerat kryesisht në ndërtesën e Këshillit Ekzekutiv në Prishtinë.⁷⁶ Megjithatë, dokumentacioni tregon se Komanda kishte vepruar së paku deri më 1 qershor 1999.

Në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 26 shtator 1998, Pavković dhe Lukiq raportuan se operacioni në rrethinën e Abrisë së Epërme kishte përfunduar. Në këtë operacion morën pjesë forcat serbe të sigurisë me ndihmën e forcave të Korpunit të Prishtinës. U ekzekutuan 23

⁷⁰ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 106-107.

⁷¹ *Kosovo Chronology: 1997 to the end of the conflict*, Reserch and Analytical Papers, Foreign & Commonwealth Office (London: June 1999), 28-29.

⁷² Ekskluzivno: “Nebojša Pavković iz zatvora u Finskoj za GMinfo”, <https://gminfo.rs/ekskluzivno-nebojsa-pavkovic-iz-zatvora-u-finskoj-za-gminfo/>, Pjesa I, 3 nëntor 2019 (shikuar më 10 mars 2020).

⁷³ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 86.

⁷⁴ *Po aty*, 89.

⁷⁵ Kombet e Bashkuara, *Tribunali Ndërkombëtar*, Lënda nr. IT-05-87-T, 127.

⁷⁶ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 87.

anëtarë të familjes Deliu, në mesin e të cilëve gra dhe fëmijë. Fshati Abri e Epërme ishte shkatërruar në masë. Më 28 shtator Komandanti i Korpusit të Prishtinës, përveç të tjerave, njoftonte komandën e Armatës III se: “BG-125-1, BG-125-2 dhe një pjesë e BG-243-2 të vazhdojnë t’i ofrojnë mbështetje MPB në shkatërrimin e plotë të FDT të rrethuara në sektorin e fshatit Obri e Epërme”.⁷⁷ Raportet në lidhje me këtë operacion dërguar Komandës së Përbashkët dëshmojnë, se ajo kishte urdhëruar operacionin në fjalë.⁷⁸ Edhe në procesverbalin e kolegjiut të UJ-së, të datës 21 janar 1999, vihet re se edhe operacioni në Reçak ishte urdhëruar nga Komanda e Përbashkët. Nga numri i madh i urdhëresave të lëshuara nga Komanda, lidhur me udhëheqjen e operacioneve luftarake në Kosovë, shihet se ajo ka pasur rol kryesor në planifikimin dhe komandimin e operacioneve të përbashkëta midis UJ-së dhe MPB-së.⁷⁹ Gjithashtu, edhe në komunikatën e lëshuar nga Komanda e Përbashkët, më 15 prill 1999, thuhet se Korpusi i Prishtinës i UJ-së ishte ngarkuar me detyrën që t’i mbështeste forcat e MPB-së në “shkatërrimin dhe asgjësimin” e forcave të UÇK-së.⁸⁰

Duhet theksuar se, që nga koha e përfshirjes së UJ-së në operacionet luftarake në Kosovë e deri te fillimi i zbatimit të planit në fjalë, në mesin e strukturave të larta ushtarake jugosllave kishte fërkime për sa i përket rolit të UJ-së. Duke qenë se shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Momçillo Perishiq, kërkonte në qershor të vitit 1998 të shpallej gjendja e jashtëzakonshme në mënyrë që përdorimi i forcave të UJ-së të ishte legjitim, duke argumentuar se UJ-ja ishte përgjegjëse vetëm për kufirin dhe agresionin e jashtëm, sepse në rast të kundërt mund të nxitej intervenimi ndërkombëtar, Nebojsa Pavković, atëherë komandant i Korpusit të Prishtinës, e akuzonte Perishiqin se për shkak të bllokadës në përdorimin e forcave të UJ-së “terroristët shqiptarë” kishin arritur të kontrollonin deri në 60% të territorit të Kosovës.⁸¹

⁷⁷ Komanda e Korpusit të Prishtinës, Top sekret nr. 873-1064/1, 28 shtator 1998, Tepër urgjente. Për: Komandën e Armatës III, Raport lufte, komandanti Nebojsa Pavković, 4.

⁷⁸ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 92.

⁷⁹ *Po aty*, 88. Kombet e Bashkuara, *Tribunali Ndërkombëtar*, Lënda nr. IT-05-87-T, 351.

⁸⁰ Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 440.

⁸¹ Ekskluzivno: “Nebojsa Pavković iz zatvora”.

Ndonëse Pavković ishte për një qëndrim më radikal ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi, nuk do të thotë se Perišiq ishte më i butë në këtë drejtim. Ndryshe nga i pari, i dyti kërkonte mbrojtjen ligjore në veprimet e tij. Një kërkesë e tillë mbështetej nga përvojat që ai i kishte fituar në ballafaqimin me Tribunalin e Hagës për krime lufte në Bosnjë-Hercegovinë.

Sidoqoftë, detyrë parësore e Komandës së Përbashkët ishte mbikëqyrja e realizimit të planit të shkatërrimit të UÇK-së dhe koordinimi i aktiviteteve politiko-ushtarake në këtë drejtim. Plani në fjalë ishte hartuar nga ushtarakët më të lartë të UJ-së dhe fillimisht parashihej që realizimi i tij të kryhej në tri faza. *Faza e parë* përfshinte angazhimin e njërive kufitare të UJ-së në zonën kufitare. Në këtë fazë policia nuk kishte autorizime, përveç kryerjes së detyrave të rëndomta policore dhe kontrollimit e verifikimit të lëvizjeve të njerëzve e automjeteve. UJ-ja e kishte si detyrë kryesore parandalimin e kalimit përmes kufirit të forcave shqiptare të UÇK-së. *Faza e dytë* përfshinte angazhimin e forcave të MPB-së me mbështetjen e UJ-së, për shkatërrimin e forcave të UÇK-së përgjatë rrugës kryesore Pejë-Gjakovë-Prizren, në rripin 10-15 km nga kufiri. *Faza e tretë* nënkuptonte mbështetjen e UJ-së për MPB-në në zhbllokimin e rrugës Mitrovicë-Runik-Pejë, rrugës Prishtinë-Klinë-Gjakovë dhe rrugës Shtimje-Suharekë-Prizren.

Në tetor dhe nëntor këtij plani iu shtuan edhe dy faza të tjera. *Faza e katërt* nënkuptonte shkatërrimin e forcave të UÇK-së në Drenicë, në Qyqavicë, Jabllanicë dhe rrethinën e gjerë përfshi edhe Glllogjanin, si dhe rrethinën e liqenit/malit të Jezercit dhe Duhlën. *Faza e pestë*, e cila u hartua pas marrëveshjes së Tetorit (marrëveshja Millosheviç-Holbrooke), nënkuptonte angazhimin e shtatë skuadrave luftuese për të siguruar rrugët në rripin kufitar si dhe të tri skuadrave të përziera në rrethinën e malit Volljak. Detyrë e MPB-së ishte që të formonte patrulla dhe pika kontrolli.⁸² Një nga detyrat e drejtpërdrejta që buronte nga ky plan ishte edhe angazhimi i përbashkët i forcave të MPB-së dhe të Korpusit të Prishtinës të UJ-së⁸³ kundër UÇK-së.

MPB-ja dhe UJ-ja zhvilluan operacione të koordinuara kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Bashkëpunimi i forcave serbe ishte kaq i ngushtë dhe i realizuar nën një zinxhir komandues, pra sipas urdhrave

⁸² Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud*, Predmet br. IT-05-87/1-T, 107-108.

⁸³ *Po aty*, 108.

nga Komanda e Përbashkët, saqë mund të dëshmohet edhe përmes këtyre fakteve: 1- një dokument i komandës ushtarake të Armatës III, datë 9 gusht 1998, urdhëronte njësitë vartëse që ta mbështesnin MPB-në në “shkatërrimin e forcave terroriste shqiptare” në rajonin e Gramaqelit, Prilepit dhe Gllogjanit për të siguruar rrugën Gjakovë-Deçan-Pejë; 2- një raport i Shtabit të Përgjithshëm, i datës 17 gusht 1998, urdhëronte komandën e Armatës III që “të vazhdohet koordinimi dhe bashkëveprimi me forcat e MPB për të shkatërruar forcat terroriste shqiptare”; 3- në masakrën e Reçakut, ushtria e granatoi fshatin dhe pastaj vazhdoi granatimin në pjesë të tjera të tij, e jo në drejtimin ku njëkohësisht po lëviznin forcat policore në drejtim të fshatit; 4- në masakrën e Rugovës, komuna e Gjakovës, 29 janar 1999, eprori ushtarak komandonte njëkohësisht edhe forcat policore⁸⁴ etj. Kështu zinxhiri komandues, udhëhequr nga Komanda e Përbashkët nuk ishte vetëm në drejtim të luftës së UÇK-së, por edhe në krimet e ndryshme dhe në dëbimin e dhunshëm të rreth 1 milion shqiptarëve. Duke pasur parasysh historikun e politikës serbe të shkatërrimit dhe dëbimit të shqiptarëve nga trojet e tyre dhe po ashtu motivin, karakterin dhe qëllimin e krimeve më 1998-1999 në Kosovë, arrijmë në përfundimin se ato paraqesin gjenocid ideor, teorik e praktik kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi.

Lufta në Kosovë përfundoi me Marrëveshjen tekniko-ushtarake të nënshkruar më 9 qershor 1999 në Kumanovë midis përfaqësuesve të NATO-s dhe të UJ-së. Kushtet e paqes parashihnin tërheqjen e plotë të forcave të sigurisë së RFJ-së nga Kosova në një afat prej 11 ditësh. Në dy ditët e para duhej zhvendosur gjithë sistemi i mbrojtjes kundërajrore, në mënyrë që NATO-ja pa pengesë ta kontrollonte hapësirën ajrore. Nuk u lejua që forcat e tërhequra jugosllave të sistemoheshin në Mal të Zi. Kosova u nda në tri zona evakuimi për forcat MPB-UJ që duheshin realizuar brenda 11 ditësh: a) zona 1: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Aeroport⁸⁵ – afati për tërheqjen e forcave serbe ishte 6 ditë; b) zona 2: pjesa qendrore e Kosovës – afati për tërheqje 9 ditë; c) zona 3: Mitrovicë dhe Leposaviq – afati i tërheqjes 11 ditë.⁸⁶ Forcat e Korpusit të Prishtinës u tërhoqën me këtë itinerar: komanda e korpusit u transferua në Leskovc, Brigada e motorizuar 549 kaloi në Vranjë, Brigada 15 e blinduar në

⁸⁴ *Po aty*, 96-97.

⁸⁵ B. B. Dimitrijević, “Jedinice Jugoslovenske Vojske”, 117.

⁸⁶ *Po aty*, 118.

Prokuplje, Brigada 125 e motorizuar kaloi në Krushevc, Brigada 243 e motorizuar në Vranjë etj.⁸⁷

Përfundime

Të gjitha forcat serbe të përfshira në luftën e Kosovës gjatë viteve 1998-1999 ishin nën urdhrat e qeverisë së Beogradit. Kjo e fundit, fillimisht, angazhoi në Kosovë një numër të madh të forcave policore, të cilët vepruan nën ombrellën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Por, në kuadër të saj u formuan njësi klasike ushtarake që nuk kishin të bënë fare me punën policore. Ministria e Punëve të Brendshme gradualisht mori tipare ushtarake. U integruan disa njësite të ndryshme, madje edhe serbët lokalë dhe ekipe të ndryshme paramilitare.

Ndërkohë, në kuadër të forcave të UJ-së në Kosovë, përveç forcave të rregullta ushtarake dhe atyre rezervë e njësiteve të tjera, u inkuadruan edhe kriminelë e grupe vrasësish të cilët po vuanin dënimin në burgje të ndryshme. Edhe armatosja e serbëve lokalë kishte pasur karakter masiv si nga MPB-ja, ashtu edhe nga UJ-ja. Detyrë e këtyre serbëve ishte që, së bashku me njësitet e UJ-së, të merrnin pjesë në operacione të ndryshme ushtarake. Të gjitha njësitë ushtarake që vepruan në Kosovë ishin nën komandën e Korpusit të Prishtinës.

Gjatë pjesës së parë të vitit 1998 në Kosovë ishin aktive vetëm policia e rregullt, ajo speciale dhe Sigurimi Shtetëror. Ushtria edhe pse e pranishme, kufizohet vetëm në ruajtjen e sigurisë përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Por, një gjë e tillë ndryshoi në prill të vitit 1998 me fillimin e bashkëpunimit midis UJ-së dhe MPB-së, i cili do të merrte një formë më të organizuar dhe më të koordinuar nga qershori dhe korriku i vitit 1998 me miratimin nga udhëheqja më e lartë politike e ushtarake e RFJ-së të “Planit për shkatërrimin e terrorizmit në Kosovë” dhe të formimit të Komandës së Përbashkët. Kjo Komandë nënkuptonte një trup politik-ushtarak, me seli në Prishtinë, i përbërë nga ushtarakë dhe zyrtarë të lartë policorë. Duke filluar nga pranvera e vitit 1998, MPB-ja dhe UJ-ja zhvilluan operacione të koordinuara në Kosovë. Kështu, bashkëpunimi i forcave serbe ishte i ngushtë dhe i realizuar nën një zinxhir të vetëm komandues, që nuk ishte vetëm në drejtim të luftës së UÇK-së, por edhe në fushatën e planifikuar dhe të institucionalizuar në rang shtetëror për zhdukjen e popullsisë shqiptare dhe spastrimin etnik

⁸⁷ Po aty.

përmes: eliminimit fizik apo vrasjeve në masë/masakrimeve të mbi 12 000 individëve shqiptarë, përfshi një numër të konsiderueshëm të grave e fëmijëve, plaçkitjeve, djegies dhe shkatërrimit të vendbanimeve, dhunimeve në baza etnike, dëbimit të dhunshëm të rreth 1 milion shqiptarëve etj.

Bibliografi:

Literaturë historiografike:

Contex Analysis of the Security Sector Reform in Serbian 1989-2009. Belgrade Centre for Security Policy. Belgrade: 2011.

Dimitrijević, Bojan B. "Jedinice Jugoslovenske Vojske na Kosovu i Metohiji 1945-1999". *Istorija 20. Veka*, Br. 2/2007. Institut za Savremenu Istoriju. Beograd: 2007.

Dimitrijević, Bojan B. "Jugoslovenski vojni vrh i pripereme za rat sa NATO, oktobar 1998 - mart 1999". *Istorija 20. Veka*, Br. 1/2009. Institut za Savremenu Istoriju. Beograd: 2009.

Dimitrijević, Bojan. "Vazdušne operacije NATO u Jugoslaviji i posledice". *Istorija 20. Veka*, Br. 1/2000. Institut za Savremenu Istoriju. Beograd: 2000.

Dosije 125, motorizovana brigada Vojske Jugoslavije, Fond za humanitarno pravo. Beograd: 2013.

Komanda e Korpusit të Prishtinës, Top sekret nr. 873-1064/1, 28 shtator 1998, Tepër urgjente. Për: Komandën e Armatës III, Raport lufte, Komandanti Nebojsa Pavković.

Kosovo – kako viđeno, tako rečeno, Analiza OEBS Verifikacione misije Kosovo, stanje ljudskih prva oktobar 1998 - jun 1999. Fond za humanitarno pravo, OSCE. Beograd: 1999.

Kosovo Chronology: 1997 to the end of the conflict. Reserch and Analytical Papers, Foreign & Commonwealth Office. London: June 1999.

Nation, R. Craig. *War in the Balkans, 1991-2002*. Strategic Studies Institute, US Army War College (2003).

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish - Jugosllavisë prej vitit 1991. Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-05-87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykim kundër Millan Millutinoviçit, Nikolla Shainoviçit, Dragolub Ojdaniçit, Nebojsa Pavkoviçit, Vladimir Llazareviçit, Sreten Llukiqit.

Website:

Bombardovanje 1999 - Put u rat, RTS - Radio-televizija Srbije, Zoran Stijović - shef i sektorit të analizave i resorit të sigurimit shtetëror të MPB Kosovë gjatë vitit 1998, Momir Stojanović - gjeneral në pension, ish-shef i resorit të sigurimit të Korpusit të Prishtinës të UJ-së gjatë vitit 1998. <https://www.youtube.com/watch?v=J1Cy1tBbDYY> (publikimi, më 21 qershor 2013).

Ekskluzivno: “Nebojša Pavković iz zatvora u Finskoj za GMinfo”. <https://gminfo.rs/ekskluzivno-nebojsa-pavkovic-iz-zatvora-u-finskoj-za-gminfo/>, Pjesa I, 3 nëntor 2019.

Intervju: General Nebojša Pavković - Bili smo spremni da damo život za odbranu Srbije! (Publikimi, më 6.10.2018), BalkanInfo. <https://www.youtube.com/watch?v=dTVFjLg2Zj4>

Intervju: General Vladimir Lazarević - Najveća čast je dati život za odbranu Srbije! (Publikimi, më 28.12.2018), BalkanInfo <https://www.youtube.com/watch?v=-DAKJhE6ksw>.

Nardulli, Bruce R. & Walter L. Perry, Bruce Pirnie, John Gordon, *Disjointed War*, RAND Corporation. (2002). <https://www.jstor.org/stable/10.7249/mr1406a.11> (shikuar më 30.06.2020).

Radovanović, Goran. “Upotreba ARJ-PVD M/D na Kosovu i Metohiji 1998. i tokom agresije NATO 1999. Godine”, *Vojno Delo*, 7/2017, Univerzitet Odbrane, Vojna Akademija. Beograd, 2017. http://www.odbrana.mod.gov.rs/odbrana-stari/vojni_casopisi/arhiva/VD_2017-7/69-2017-7-17-Radovanovic.pdf (shikuar më 30.06.2020).

Ujedinjene Nacije, *Međunarodni Krivični Sud za bivšu Jugoslaviju*, Tužitelj protiv Milana Milutinovića, Nikole Šainovića, Dragoljuba Ojdanića, Nebojše Pavkovića, Vladimira Lazarevića i Sretena Lukića (I. dio), Predmet br. IT-05-87-T, Presuda 1 od 4, 26 februar 2009.

Ujedinjene Nacije, *Međunarodni sud za krivično gonjenje lica odgovornih za teška kršenja međunarodnog humanitarnog prava počinjena na teritoriji bivše Jugoslavije od 1991. Godine*, Predmet br. IT-05-87/1-T, Vlastimir Djordjevic, Datum: 23 februar 2011. https://www.icty.org/x/cases/djordjevic/tjug/bcs/110223_judgement_p1_bcs.pdf (shikuar më 20.02.2020).

Under Orders - War Crimes in Kosovo. Human Rights Watch. 2001. https://www1.essex.ac.uk/armedcon/story_id/Under_Orders_warcrimesinkosovo.pdf (shikuar më 30.06.2020).

Zona neodgovernosti, “Analysis of performed combat operations”. Fond za humanitarno pravo. <http://zoneofnonresponsibility.net> (shikuar më 27.06.2020).

Zona neodgovernosti, “Order to support MUP/Interior Ministry/ in breaking up DTS forces in general Cicavica sector”, Fond za humanitarno pravo, <http://zoneofnonresponsibility.net> (shikuar më 27.06.2020).

Zona neodgovernosti, Fond za humanitarno pravo, Operacioni GROM 98, Komanda e Armatës III, sekret shtetëror nr. 6034-7/1, 29 korrik 1998, Urdhër, për shkatërrimin e “forcave terroriste shqiptare” (FTSH) dhe shuarjen e kryengritjes së armatosur në Kosovë e Metohi. Komandanti gjeneralkolonel Dushan Samarxhiq. <http://zonaneodgovernosti.net/> (shikuar më 27.06.2020).

Zona neodgovernosti, Fond za humanitarno pravo. <http://zoneofnonresponsibility.net/>. Dokumenti 9/a, Komanda e Grupit Luftues BG-4, Tepër Sekret, 25.09.1998. Analizë mbi operacionet e kryera. Për: Komandën e Brigadës 125 të motorizuar, Mitrovicë e Kosovës. Analizë mbi operacionet ushtarake të datës 22 shtator 1998. Nga: 22 shtator 1998 ora 07:00 deri 23 shtator 1998 ora 02:00. Raportuar nga komandanti major Petko Jovçiq (shikuar më 27.06.2020).

SABIT SYLA

Institut of History “Ali Hadri”, Prishtina
sabitsyla1976@gmail.com

NURI BEXHETI

Faculty of Philosophy / University of Prishtina “Hasan Prishtina”
nuribegu@yahoo.com

S u m m a r y

SERBIAN STATE FORMATIONS IN KOSOVO IN 1998-1999

All Serbian forces involved in the Kosovo war during 1998-99 were under the orders of the government in Belgrade. A large number of police forces under the responsibility of the Ministry of Internal Affairs (MIA) were employed in Kosovo. However, classic military units, that had nothing to do

with police work, were formed. Thus, the MIA took on military character. A number of different subjects were integrated into these units, including local Serbs and various paramilitary teams.

At the same time, the Yugoslav Army (YA) in Kosovo, along with its regular and reserve forces, recruited various criminals and murderers who were serving their sentences in different prisons. Even the arming of local Serbs, both by YU and MIA, had a massive character. These Serbs were tasked with participating in military operations. All military units situated in Kosovo were under the command of the Pristina Corps.

During the first part of 1998, only the regular police, the special police, and the state security units were active in Kosovo. The YA units maintained security along the border with Albania and Macedonia. But this configuration changed in April 1998 when a cooperation between MIA and YA commenced; this cooperation will take a more organized form in Jun and July 1999, when the highest political and military leadership of the Federal Republic of Yugoslavia approved the "Project to Combat Terrorism in Kosovo" and the formation of the Joint Command. The Joint Command was a military-political body with its seat in Pristina; it was composed of military and high-ranking police officers. Since spring 1998, the MIA and YU units have conducted coordinated operations in Kosovo. Thus, the Serbian forces cooperated closely and carried out their actions under a single chain of command, and thus it was not only directed against the Kosovo Liberation Army but even included their participation in a planned and institutionalized campaign, on the state level, to exterminate Albanian people or to carry out an ethnic cleansing through: physical elimination or mass killings of over 12,000 Albanian individuals, including a significant number of women and children; looting, burning, and destruction of settlements; carrying out rapes on ethnic grounds; violent expulsion of about 1 million Albanians etc.

DOKUMENTE E MATERIALE

YLL RUGOVA

<https://doi.org/10.61773/1ana2798>

DOKUMENTE TË PIKLOMINIT PËR FUSHATËN USHTARAKE HABSURGASE NË KOSOVË (1689)

Dokumenti 1:

21 tetor 1689, Prishtinë

*Pikolomini për Badenin*¹

Bericht des Feldmarschall-Lieutenants Fürsten Piccolomini an den Kaiser Leopold I. Pristina den 21ten October 1689.

Allernädigster Kaiser und Herr!

Euerer Majestät dürfte bereits bekannt seyn, daß der Markgraf Ludwig von Baden nich mit den Infanterie-Regimentern Strosser, Palfy, zwey Bataillons von Auersperg, einem Bataillon von Aspermont, und den Cavallerie-Regimentern Styrum, Piccolomini, Holstein, Hannover und Czacky, nebst 3000 Raißen theils zu Fuß theils zu Pferd, sämmtlich von dem Feldzuge ziemlich abgetmatteten Truppen, mit dem Auftrage bey Nissa zurückgelassen hat, die eroberte Grenze zu bewachen und zu vertheidigen, und wo möglich zu erweitern, um mehrere Rationen Euerer Majestät Scepter unterwürfig

Raport nga major lejtënant Princ Pikolomini, drejtuar Perandorit Leopold I. Prishtinë, 21 tetor 1689.

Perandor dhe Zot i hirshëm!

Madhëria Juaj do të jetë në dijeni tashmë se Margrav Ludvig von Baden ka lënë prapa në Nish regimentet e këmbësisë së Shtrazerit, Palfit, me dy batalione të Auerspergut, një batalion të Aspermontit dhe regimentet e kalorësisë së Stirisë, Pikolominit, Holshtajnit, Hanoverit dhe Çakit, së bashku me 3 000 ushtarë pjesërisht në këmbë, pjesërisht mbi kalë; të gjitha këto regjimente, mjaft të rraskapitura nga fushata, janë lënë me detyrë ruajtjen dhe mbrojtjen e kufirit të pushtuar dhe, po qe e mundur, zgjerimin më tutje për të futur më shumë subjekte dhe racione nën zotërimin e Skeptrit të Madhërisë

¹ Letra origjinale në dialektin italian, përkthyer në gjuhën gjermane është botuar në vitin 1808 tek *Oestreichisch-militärische Zeitschrift*, Vienna (2), (1808), 235-246.

zu machen. Das Schloß Pirot; welches zwey Märsche Herwärts von Sophia liegt, habe ich mit einigen hundert Mann Infanterie und Cavallerie nebst einigen Raißen beseßt. Dieses ist unser dußerster Posten gegen den Feind von dieser Seite. Bey meiner Ankunft fand ich den nach türkischer Art gut gebauten und reichen Ort in Flammen, einen Theil bereits in Asche; in dem alteri Schloße ist für die Truppen hinreichender Raum. Zwischen Pirot und Nissa nahe an einem Paß liegt Mustapha Pascha Palanka; der Ort ist mit Mauern umgeben, welche von Thürmen bestrichen werden, und wo sonst eine Besatzung von tausend Janitschären stand.

Ich habe zur Unterhaltung der Communication und Eintreibung der Contribution auch diesen Ort beseßt. Die Garnison von Nissa bestehet aus 5 Bataillons, der unberittenen Mannschaft, einigen Compagnien Raißen, hundert Hussaren; und dreyßig Kanonen.

Für die Verpflegung ist gesorgt; zur Förtseßung der Verschanzungen sind 400 Bauern aufgebracht worden. Durch die Commissärs lasse ich mehrere Magazine anlegen, um weiter in Feindesland eindringen zu können; mit dem Ueberrest der Truppen marschirte ich nach Procupia, einem weitschichtigen, mit einem Graben und Zaun umgebenen Orte. Die Dörfer in der Gegend sind entvölkert, aber nicht verbrannt; ich habe das Bataillon

Suaj. E kam pushtuar një kështjellë të quajtur Pirot, e cila ndodhet dy marshime nga Sofja, me disa qindra njerëz të këmbësisë dhe kalorësisë, si dhe disa trupa. Kjo është pika më e skajshme që zotërojmë kundruall armikut nga kjo anë. Kur mbërrita, gjeta një qytet të pasur dhe të ndërtuar mirë në stilin turk, i cili që në flakë, një pjesë e tij tashmë ishte bërë hi. Në kështjellën e vjetër ka hapësirë të mjaftueshme për trupat [tona]. Mes Pirotit dhe Nishit, afër një kalimi, ndodhet Mustafa Pasha Palanka. Vendi është i rrethuar me mure që përshkohen prej kullave, ku mbahej edhe një njësit me një mijë jeniçerë.

E futa nën komandë këtë vend edhe për qëllime komunikimi dhe kontributi. Garnizoni i Nishit përbëhet nga 5 batalione, me këmbësorë, disa kompani të rashianëve, njëqind husarë dhe tridhjetë topa.

Ushqimi është siguruar; 400 fermerë u sollën për të përforcuar fortifikimet. I kam ftuar komisarët të krijojnë disa magazina për të mbështetur depërtimin tonë më tej në territorin armik. Me pjesën e mbetur të trupave marshova në Prokuplë, një qytet i madh i rrethuar nga një hendek dhe një gardh. Fshatrat e zonës janë të varfra, por nuk janë të djegura. Këtu vendosa batalionin e Aspermontit me urdhër që të niset drejt Nishit në skenarin më të keq;

Aspermont hieher verlegt und den Befehl ertheilt, sich im äußersten Fall nach Nissa zu werfen; auch hier wird ein Magazin errichtet. Der Paß bey Lescoviß, welcher diesseits des Hamus liegt, und durch welchen sich die Türken nach der Niederlage bey Nissa flüchteten, ist in der Breite von 500 Schirt verhaueu und beseßt; ein gleiches geschah bey dem Passe, durch welthen die Straße nach Pristina in das Cassoverland führet.

Die Thäler, welche sich nach Bosnien ziehen, sind beseßt worden. Mit 200 Mann auserlesen braver und entschlossener Truppen, kam ich in das Cassoverland, welches flach und von hohen Gebirgen eingeschlossen ist. Das Land ist von Bosniern, Albanesern und Türken entvölkert; sie haben sich aus Furcht geflüchtet; die Dörfer sind nicht verbrannt.

In bem weitschichtigen offenen Hauptort Pristina ist für meine beyhabende Mannschaft hinreichende Unterkunft; ich lasse hier Berschanzungen antegen, und für die zurück-bleibende Truppe die nöthige Subsistenz zusammen bringen. Das Schloß Swezay bey Mitroviß, am Eingang von Servien in die Herzegowina, und Novibarbo am Hamus sind noch vom Feinde beseßt. Vom leßteren geht ein Reitsteig nach Sophia; beyde Orte habe ich, um die türkische Garnison im Zaume zu halten, blockiren lassen. Ich werde alles anwenden, um mich der Straße von Uranie, welche nach Scopia sührt,

këtu është duke u ngritur edhe një magazinë [tjetër]. Gryka e Leskovcit, e cila shtrihet në këtë anë të Hamusit, dhe përmes së cilës turqit ikën pas disfatës në Nish, është 500 hapa e gjerë dhe është nënshtruar e fortifikuar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në qafën nëpër të cilën rruga të çon për në Prishtinë, në tokën e Kosovës.

Luginat që shtrihen drejt Bosnjës janë pushtuar. Me 200 burra të zgjedhur, trima dhe të vendosur, erdha në tokën e Kosovës, e cila është e rrafshët dhe e rrethuar me male të larta. Vendi është i shpopulluar [i përbërë paraprakisht] nga boshnjakë, shqiptarë dhe turq, të cilët kanë ikur nga frika; fshatrat nuk janë djegur.

Ka strehim të mjaftueshëm për ekuipazhin tim në kryeqytetin Prishtinë, një vend i gjerë dhe i hapur. Këtu po ndërtoj fortifikime dhe po grumbulloj mjetet e nevojshme të jetesës për trupat e mbetura. Kështjella e Zveçanit pranë Mitrovicës, në hyrje mes Serbisë dhe Hercegovinës, dhe Novobërda në Himus, kanë mbetur ende të pushtuara nga armiku. Prej kësaj të fundit, një trok kalërimi mbërrin në Sofje. Kalimet drejt të dyja vendeve i kam bllokuar për të mbajtur nën kontroll garnizonin turk. Do të bëj çdo përpjekje për të siguruar rrugën nga Vranja që të çon në Shkup, dhe postin e Kaçanikut, që mbulon

und des Postens von Caſanick, der die erwähnte Stadt deckt, zu versichern; vor allen muß der Pascha Mamut Begonik, der den Posten von Caſanick beſeßt hält, vertrieben werden. Ich habe um Verstärkung gebethen, weil ich außer einen besondern Unglück, nicht nur die Truppen gut verpflegen zu können, sondern auch weitere Fortschritte zu machen hoffe. Sollte die erwartete Unterstützung hinreichend seyn, so werde ich zu der Unternehmung von Scopia schreiten, und bis Salonichi streifen lassen, auch werde ich trachten, wenn ich noch einige Regimenter Infanterie erhalte, mich in Albanien und in die Herzegowina einzuschleichen. Den Albanesern und Raißen, welche Enerer Majestät Schuß wünschen, gebe ich gute Hoffnung, bin aber dabey äußerst vorsichtig, weil man von Verräthern schwer eine standhafte Treu erwarten kann. Heute bin ich hier angekommen, morgen werde ich mit aller Vorsicht vorrücken, die Elementiner habe ich schriftlich eingeladen, in Conföderation zu treten; ich werde aber vermuthlich eher bey ihnen seyn, als mir ihre Antwort zukommen kann.

qytetin e përmendur. Mbi të gjitha, Mahmut Pashë Begolli, i cili kontrollon postin e Kaçanikut, duhet të dëbohet. Kërkova përf forcime sepse, nëse ndonjë fatkeqësi e mundshme s'na del ndërkohë, shpresoj që jo vetëm të jem në gjendje të furnizoj dhe të mbaj mirë trupat, por edhe të bëj përparim të mëtejshëm. Nëse arrij të siguroj edhe disa njësi këmbësorësh, unë do ta vazhdoj operacionin drejt Shkupit duke synuar që trupat tona të depërtojnë madje deri në Selanik. Do të përpiqem gjithashtu, nëse marr edhe disa regjimente këmbësorie të tjera, të futem fshehurazi në Shqipëri dhe në Hercegovinë. Kam pritje të mëdha për shqiptarët dhe rashianët që dëshirojnë të futen nën mbrojtjen e Madhërisë Suaj, por jam jashtëzakonisht i kujdesshëm në këtë drejtim, sepse është e vështirë të presësh besnikëri të patundur prej tradhtarëve. Sot mbërrita këtu, nesër do të përparoj me shumë kujdes; i kam ftuar me shkrim kelmendasit të hyjnë në konfederatë. Por me siguri do t'i takoj më shpejt, sesa të marr përgjigje prej tyre.

Dokumenti 2:

[22] tetor 1689 [Prishtinë]

*Pikolomini për Badenin*²

Se V.[oltra] A.[ltesa] S.[erinissima] mi mandasse ancora tutta l'Armata, io la farò sussistere. Gli Albanesi di Clementa mi hanno inviati Deputati, per venire tutti quanti alla divotione, e stò con essi in trattati: l'Albania Turca hà fatto lo stesso, e mi vogliono cedere li Castelli. Altre Comunità particolari, e simili li hò citati, massime li Christiani tutti: mando in tutte le bande le Armi di Sua Majesta Cesarea che dipinte portai l'anno passato da Vienna con protettionali, come pure Plenipotentarii, e Truppe à riconoscere quei Paesi, e intavolare i Trattati: m'ingegnarò, e spero di tirare tutti quei Paesi da Scutari sino à Novibassar alla divotione.

Sopra questi andamenti'l Bassà Mamuth si è fuggito, e io hò buscato la Coda di Cavallo, che gli diede il Gran Visiro, e essendo stata abbandonata la Città di Prisseren, io me ne serviro: 10000. Rasciani coll' Armi in mano, e senza Capo, e che vogliono vivere di rapina, e parer' essere divoti, mi danno non poco, che pensare; nè sò che fare di queste bestie indomite, e che mi

Nëse Madhëria Juaj e Shndritshme do ta zhvendoste këtu të gjithë ushtrinë (!), unë do ta mbaja të furnizuar mirë. Shqiptarët e Kelmendit më kanë dërguar përfaqësuesit e tyre, për të treguar devotshmëri ndaj Perandorit dhe unë jam marrë vesh me ta: Shqipëria turke ka bërë të njëjtën gjë, dhe duan të më japin kështjellat e tyre. Komunitete të tjera të veçanta e të ngjashme me ato që kam cekur, shumica të krishterë: dërgova në të gjitha anët flamujt e Madhërisë Suaj Cezariane, të cilat i solla të pikturuara, vitin e kaluar nga Vjena bashkë me oficerë, përfaqësues fuqiplotë (ambasadorë) dhe trupa për t'i njohur ato vende, dhe për të iniciuar me to traktate: do të përpiqem dhe shpresoj t'i nënshtroj të gjitha ato vise nga Shkodra deri në Novi Pazar.

Pas këtyre ngjarjeve, Mahmut Pasha iku, dhe unë ia mora bishtin e kalit (tujën), të cilin ia kishte dhuruar Veziri i Madh, dhe, meqë qyteti i Prizrenit ishte braktisur, unë do ta përvetësoj me: 10 000 rashianë të armatosur dhe pa dikë që komandon, e që duan të jetojnë duke vjedhur, dhe duke qenë se janë të devotshëm prandaj nuk jam shumë i sigurt. Nuk

² Botuar së pari në dialektin italian në vitin 1690 te Zenarolla (1690, 209-211). E njëjta është botuar në vitin 1700 nga Rycout në gjuhën angleze (1700, 351). Në përkthimin e këtij dokumenti ka ndihmuar edhe F. Serée dhe prof. dr. Majlinda Bregasi, për çka i falënderojmë.

saccheggiano il Paese, e mi mettono in apprensione, e timore; causando, che molti si trattenghino di venir' alla divotione: licentiandoli temo di peggio, e femandoli divorano il tutto: io vado al Passo di Cauinigh,³ e mi assicuro de tutte le Bande. Cosa sara di Uscopia non lo sò ancora. Li Nostri hanno travato il Castello Novibardo sull' Alpi ripieno nuovamente di Turchi; vi hò mandato soccorso, e si sono resi à discrezione. Hò gran carne al fuoco; mà poca gente, colla quale farò tutto quello, che mai potrò, come anco in farmi conoscere, che sono:

Di V.[ltra] A.[Altesa] S.[serenissima]
Il Conte Piccolomini

di ç'të bëj me këto bisha të pazbutura, që plaçkitin vendin dhe përhapin gjithkund ankth e frikë, duke bërë që shumë [njerëz] të hezitojnë të binden: druhem që po i hoqa qafe bëhet edhe më keq dhe po i ndala kam frikë se rrëmbejnë gjithçka: do të shkoj në Grykën e Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohem nga të gjitha anët. Nuk e di ende se çfarë do të bëhet me Shkupin. Të tanët e gjetën kalanë e Novobërdës në Alpe të marrë sërish nga turqit. Këtyre iu dërgova një thirrje dhe ata u dorëzuan në mënyrë diskrete. Kam shumë plane; por shumë pak njerëz, me të cilët do të bëj të pamundurën të njihem ashtu siç jam.

Kont Pikolomini
i Madhërisë Suaj të Shndritshme.

Dokumenti 3:

27 tetor 1689, Gryka e Kaçanikut

Raport anonim nga kampi i Pikolomini⁴

Auß dem Kayserlichen Feld-Lager
mitten im Paß gegen Scopia, genandt
Kazaneck, den 27. Octobrzs st.n.
Den 21. hujus kamen einige Räßen

Nga fushë-kampi i ushtrisë
perandorake në mes të grykës drejt
Shkupit, të quajtur Kaçanik, 27 tetor.
Në ditën e 21-të të këtij [muaji], disa

³ Është vështirë e besueshme që Pikolomini s'e shkruante mirë emrin e Kaçanikut në letrat e tij, ashtu siç bën edhe në letrën paraprake (Caßanick). Forma "Cauinigh" që shfaqet këtu duket më parë një gabim në transliterim nga Zenarolla. Duke qenë se të njëjtin "gabim" e gjejmë edhe te Rijkauti, është lehtësisht e kuptueshme se ky i fundit këtë letër e ka përkthyer prej Zenarollës.

⁴ Raport i botuar në gazetën e Hamburgut *Die Europäische Relation*, të datës 25 nëntor 1689. Sipas kopjes së mikrofilmuar nga Staats - und Universitätsbibliothek Bremen. Falënderojmë Andreas Reich-in për ndihmën në përkthimin e këtij raporti.

Hussaren und brachten nebstleinem Raß Schweif auch etliche Fahnen ins Lager, welche sie bey Pöza bem Machmut Bassa abgejagt, seine Trouppen zertrennet, und viel davon niedergebanen worden, unweiß von dar seynd unbeschreiblich hohe Gebürg, worauff 2. Gespan[s]chafften Climent und Resaiava, die dem Turcken niemahlen, sondern er ihnen; und zwar erst kürßlichen der Machmet 2000 Ducaten contribuiren müssen, wollen sich aniso an unsergeben, da man sie nur bey dem Ihrigen lassen walte. Zwischen gedachter Gegend und Scopia haben sich bereits auch viel Turcken umb die Römischise Käyserliche Protection angemeldet, darbed anhaitende, sie nicht von Hauß oder Hof zu treibet, mit welchen allen aber zur Zeit noch nichts gehandelt, sondern auff die Ankunsst des General Piccolomini, lmit Ihme selbstn diese falls zu tractiren verabscheidet, und dannenhero den 22. dito der Piccolominische Obrist Lieutenant mit einiger Mannschafft dieses Negoty halber an ermeldte Leuthe abgeschicket worden.

Darauff selben Morgends das Corpo von Pristina aussgebrachen und bey Robovze über Nacht zu stehen kommen, lieffe auch Nachricht ein, daß der in Alpius gelegene Sophier Paß Novo Porto sich an den dahin commaudierten Hollsteinischen Obrist Lieutenant auff Guad und Ungnad ergeben habe. Über daß wurde auch der gegen Mitrowiß stehende Boßnische

husarë rashianë erdhën dhe sollën në kamp jo vetëm bishta kuajsh (tuja), por edhe një numër flamujsh, të cilët ia morën Mahmut Pashës afër Pejës [Pöza], trupat e të cilit u shpartalluan, dhe shumë prej tyre e pësuan. Pranë ca bjeshkëve me lartësi të paparë, dy popujt e Kelmendit dhe të Rozhajës (?), u paraqitën [këta janë popuj] që nuk i paguajnë kurrë asgjë turkut, por ai [u paguan] atyre; kurse këta mbledhin vetëm 2 000 dukate kontribut për Mehmetin, dhe tani duan të na dorëzohen neve [me kushtin] që të lihen të qetë në punët e tyre. Midis zonës në fjalë dhe Shkupit, shumë turq janë regjistruar tashmë për mbrojtjen e Perandorit romak Cezarian, duke shpresuar që të mos dëbohen nga shtëpitë apo kasollet e tyre; me të gjithë këta [popuj] nuk është mbyllur ende asnjë marrëveshje për momentin, duke u pritur përfshirja e gjeneral Pikolominit, i cili ka dhënë aprovimin e tij për traktat, dhe më pas, më 22 të po këtij muaji, për hir të këtij negocimi është dërguar te këta persona një kolonel lejtënant Pikolominian (?) me disa të tjerë në shoqërim.

Po atë mëngjes, trupat ushtarake shkuan prej Prishtinës dhe u ndalën për të kaluar natën në Rabovc. Gjithashtu erdhi një lajm se në grykën drejt Sofjes, Novobërda afër Alpeve (?) i ishte dorëzuar togerit kolonel Holshtajnit, i cili ishte vendosur aty. Përveç kësaj, edhe Zveçani që qëndronte pranë Mitrovicës, në grykën drejt Bosnjës,

Paß Zwetzan mit etlichen recognoseirt und befunden, daß zu Eroberung und Behauptung dessen mehrer Leuth voundthen senu, weßwegen der Styrumhis. Obrist Lieutenant als der detmahliger Commandant zu Pristina Ordre hat; mit etwas des ihm hinterlassenen Fuß-Volcks dahin einen Versuch zu thun.

Den 23. maschirten wei biß an der Scopier Paß Kazaneck genand, worinnen ein vestes Schlos und Stadt ge legen, hier auff wurde in der Racht ein starckes Commando zu Roß und Fuß mit 4. Stück Geschüß ans geschickt, der Orth aber leer gefunden den der Feind aübereits verlassen, der Hanoveris. Doster Lieutenant Graf Rödern, hat den Fluchtigen war nach geseßt, selbe aber, weil en sie in das Gebürg geloffen, Nicht an getroffen, doch seynd Ihm 300. andere Türcken bevegnet, welche von Scopialkommen, so wohlidiesen, un der Veste mit allen andern unvergleichsichen Paß noch mehr zu verhanen, als auch gedachtes Schloß zu verstärcken, und biß teßten Mann zu behanbten, diese hat er nun lang nach Mitternacht in der Finstern beym Feuer nebst einer Steinernen Brücken gefunden, unvermerckt überfallen, verjagt, deren 11. gefangen, 19. nieder gemacht 4. Fähnlein und etliche Pferdt bekommen. Den 24. folgte das Corpo in diesem Paß bernach, der so eng, daß nur Man für Mann gehen kunte, schwer und mit härtester Muh die 10. Stucke nach gebracht, alle Bagage Wagen aber in Kazaneck zurück geblieben, wir

ishte pikasur me një numër banorësh, dhe u konstatua se duheshin më shumë njerëz për ta pushtuar atë, prandaj kolonel togeri i Stirisë si komandant në Prishtinë mori urdhra të bëjë një përpjekje atje me disa prej këmbësorisë së tij të mbetur.

Më datë 23 ne marshuam deri në Grykën e Shkupit, të quajtur Kaçanik, në të cilën ndodhej një kështjellë dhe qytet i fortifikuar. Këtu një trupë e fortë kalorësish dhe këmbësorësh me 4 copë artileri u dërguan përpara në kërkim, por qyteti u gjet bosh, i braktisur nga armiku, dhe kolonel lejtënanti Hanoverian, konti Rodern u ishte vënë pas të arratisurve, por të njëjtët ia kishin mbathur duke u fshehur në ato anë. Ndërkohë kishin ardhur edhe 300 turq të tjerë, të dërguar si përforcim nga Shkupi për të përforcuar kalimin e kështjellës së sipërthënë. I gjeti shumë kohë pas mesnate në errësirë pranë zjarrit duke u fshehur afër një ure guri, ku i sulmoi papritur, duke i përzënë, prej të cilëve 11 të kapur dhe 19 të vrarë, si dhe mori 4 flamuj e disa kuaj. Më datë 24, trupa ushtarake vazhdoi rrugën në këtë grykë, e cila ishte aq e ngushtë sa vetëm një njeri mund të kalonte, dhe me shumë vështirësi u sollën 10 copë topa, ndërsa të gjithë vagonët e bagazheve mbetën pas në Kaçanik, ku ne vendosëm kampin në mes të kalimit me ca tenda, ndërkohë që

campirten mitten im Paß mit gar wenig Zelten, dann der Trop bliebe meist dahinden. Die Gefangene sagen das in Scopia 30000. und mehr Seelen senen, die sich stadlich desendiren wolten, die gleich von dar her kommende Bauern aber versichern, daß die in der Nacht blessie Türcken mit blutigen Köpfen solchen Alarm in die Stadt gebracht, das sich alles Flucht fertig mache.

Nachdeme den 25. dieß unser Corpo endlich den so arg und schweren Paß Kazanick welcher 8. Stand lang und soentseßlich, das jederman bekennet, dergleichen in der Welt nie gesehen zu haben, glücklich über stiegen, ist selbes an ein schönes von Scopia 3. Stynd weites Felde angelangt, hat sich dar in guter Postur gestellt, und an sol cher Stadt einen starcken Mußqueten Schuß weit avansirt, im Hinrucke und daselbst zu Aniangung lieffen die Bauers-Leuthe aus denen Geburgen Hauffen-meiß zu, frohlockten und Teuts zelgten ob der Teutschen Ankunfft grosse Freuden, da erfuhre man nun daß die alda geweste Griechen den oest vor 5. Lagen ankomenen Bassa verlassen, Er mit seinen andern Leathen hinter etuem Thal sehr warckel mühtig stehen, und die Stadt selbst bereits leer seyn solle. Woruhe zu Freude die mit uns habende 10. Stuck geloset, und hierdurch der in einem Thal mit 4000 Mann zauhasst verborgen gestanhene Bassa gar davon gelaussen, demsiben aber, weil das Corpo nicht von übrigen Kräfte, nur mit einigen Hussaren und wenig Teutsch nuachgeseßat, doch vom

pjesa më e madhe e ushtarëve kishin mbetur prapa. Të burgosurit thonë se në Shkup jetojnë 30 000 njerëz apo më shumë dhe se të gjithë janë gati të ikin, por fshatarët që erdhën pak kohë më parë nga ky qytet na siguruan se turqit [e parë] me koka të përgjakura pas pësimeve të mbrëmshme sollën një alarm të tillë në qytet, sa të gjithë po bëhen gati të ikin dhe ta braktisin atë.

Pas datës 25, korpoja jonë më në fund e kaloi me sukses grykën aq të vështirë dhe të mundimshme të Kaçanikut, tetë Stande e gjatë dhe kaq e neveritshme sa të gjithë rrëfejnë se nuk kanë parë kurrë diçka të tillë në botë, për të arritur në një fushë të gjerë, tri orë larg nga qyteti i Shkupit, dhe morën një pozicion të mirë për të gjuajtur me top në drejtim të qytetit. Ndërkohë fshatarët nga majat e maleve vrapuan si një turmë e madhe, dhe të gëzuar brohoritnin për shkak të gjermanëve. Dhe më pas mësuam se grekët e atij vendi e kishin braktisur Pashanë, i cili po qëndronte 5 lega në Lindje, se ai dhe burrat e tjerë në përcjellje të tij po qëndronin (në vështirësi) pas një lugine, dhe se vetë qyteti tashmë ishte boshatisur. Për zbavitjen tonë, kërcitëm dhjetë topat që kishim me vete dhe si rezultat ia mbathi Pashai, i cili qe fshehur në një luginë me 4 000 burra, por për shkak se trupat nuk ishin të përforcuara mirë, vetëm me disa husarë dhe pak gjermanë, pjesa më e madhe e armikut u kap dhe u

Feind viel eingeholet, niederaemacht, über 200. Bauers Wagen, sambt denen darbey gefundenen mit Gewalt durch die Türcken sortgetriebened Christen Salvirt, auch nebst guter Beuthe über 100. gefangenen Türcken und Juden zuruck gebracht worden.

Die Stadt fanden wir an der Grosse wie Praag, an der Veste aber ein Dorff, ohne Mauer, ohne Graben, ohne Zaun, ohne Stück, ohne Volck und ohne Geld, aber voll mit Kauffmanns-Güthern, Früchten-Getrayd, Meel und allerhand erwünschten Lebens Mitteln, zwar auch mit einem Schloßbarmn aber kein Wasser, kein Defensions Plaß und vom Alter chon ruinirt, so also keinerley Wei ezu unserm Vorhaben dienstlich, dannenhero kurßijch resosvirt mare alles in Brand zu stcke, und ist also den 26. hierauff durch Commandirte bieser grosse Dit[c]h, nicht ohne Betaurung wesien der unter deenen Türcken me gesuchten vortresslichen Gebäuen sumptus, sen Moscheen, selßamen Garten und Delicien, auch andern Raritäten mehr, an vielen Orten zugleich amnezündet, völlig in die Aschen gelegt worden, darinn maren zuvor allezeit über 60000. possessionirt Einwohner, nebst 400. Jüdischen Familien und leßlich noch darzu aber 40000. dahin geflüchte Seele[y], welche alle, biß abgedachter massen auff den Bassa, 48. Sinnd vor unserer Aurückung entwichen. Nach diesen Tag auch den 27. dito wurde an alle Dorffschafften erinnert die Inwohner solten sich entweder über die Alpes retiriren, ader Contribution geben,

shkatërrua; mbi 200 vagonë fshatarësh u kapën së bashku me të krishterët e shpëtuar, të cilët ishin zhvendosur me dhunë prej turqve, dhe rreth 100 turq dhe hebrenj, që të gjithë u sollën me vete bashkë me plaçkat e mira që ishin kapur aty.

E gjetëm qytetin të një madhësie sa Praga, por që kalanë e kishte [veçse] një fshat, pa mur, pa hendek, pa gardh, pa bagëti, pa njerëz dhe pa pará, por plot me mallra tregtarësh, me fruta, pije, mish e lloj-lloj gjërash të dëshirueshme, mjete jetese, megjithëse me një bunar në kështjellë, por pa ujë, pa sistem mbrojtës dhe [me kështjellë] tashmë të shkatërruar nga koha, pra pa vlerë për qëllimin tonë. Kështu, më datë 26, u urdhëruam për t'i vënë flakën çdo gjëje; jo pa brengë, për shkak të cilësisë së mirë të godinave të preferuara nga turqit, xhamive, kopshteve dhe ushqimeve të veçanta, si dhe gjërave të tjera të rralla, të gjithave iu vu flaka në disa pika në të njëjtën kohë dhe qyteti krejtësisht u bë shkrumb e hi. Aty më parë kishte mbi 60 000 banorë, së bashku me 400 familje hebraike dhe 40 000 refugjatë të tjerë që ishin ngulitur atje paraprakisht, të gjithë kishin ikur nja 48 orë para përparimit tonë, përveç Pashait. Pas kësaj dite, më datë 27, të gjithë krerëve [të mbetur] nga fshatrat [përreth] iu kërkua që të zgjidhnin: ose të largoheshin përmes maleve, ose të jepnin kontribute, të gjithë

erwählten alle das erste, und ist solchem nach deren Concursus nicht zubeschreiben. Heut zage das Corpe von der Stadt wieder vor den Passe zurück.

zgjodhën të parën dhe pas kësaj fati i tyre më nuk dihet. Sot, trupat ushtarake prej qytetit po kthehen prapa për në Grykë [të Kaçanikut].

Dokumenti 4:

31 tetor 1689, Kaçanik

Pikolomini për Leopoldin I⁵

Allergnädigster Kaiser und Herr!

In Folge meines leßten Berichts trage ich in Unterthänigkeit nach, daß, nachdem das Schloß, Novibardo, dessen Garnison sich auf Discretion ergeben hat, beseßt, und die, Schlößer Swezan und Panza verproviantirt worden, ich weiter vorgerückt bin, um mich aller nach Bosnien führenden Engpässe zu versichern; indeffen sind katholische, albanische und andere Deputirte auf meine Vorladung erschienen; ich habe sie auf eine den Umständen angemessene Art empfangen, sie mit Gegendeputirten und Truppen begleiten lassen, um die Gegend kennen zu lernen, und mit Tractaten den Anfang zu machen, welche diese Völker Eurer Majestät mit standhafter Ergebenheit unterwersen sollen. Ich habe meine Forderungen zu erkennen gegeben; sie bestehen für jeßt in dem Eurer

Perandori dhe Zoti më i hirshëm!

Pas raportit tim të fundit, shtoj me përlësi se pas kalasë së Novobërdës, garnizoni i së cilës u dorëzua qetësisht, u bënë përpjekje edhe për kështjellat e Zveçanit dhe të Banjskës që të furnizoheshin; u sigurova më tej për t'i përforcuar edhe të gjitha grykat në drejtim të Bosnjës. Ndërkohë, pas thirrjes sime u shfaqën katolikët, shqiptarët dhe përfaqësues të tjerë. I pritë në një mënyrë të përshtatshme për rrethanat, i takova përmes përfaqësuesve tanë dhe ca trupave, e kësaj më mësojmë më shumë rreth rajonit dhe për të filluar me ta traktate përmes të cilave këta popuj i nënshtrohen Madhërisë Suaj me përkushtim të palëkundur. I kam bërë të qarta kërkesat e mia. Ato konsistojnë në dhënien e betimit të besnikërisë ndaj Madhërisë Suaj,

⁵ Botuar në gjuhën gjermane, që duhet të ketë qenë edhe gjuha origjinale e përpilimit, në vitin 1808 tek *Oestreichisch-militärische Zeitschrift*, Vjenë (2), f. 235-246. Disa fragmente të kësaj letre janë përkthyer në gjuhën serbe dhe janë botuar nga Kostić (1922, 123-126).

Majestät zu leistenden Eid der Treue, in dem Wollzug der höchsten Befehle, und jener der Generale ober sonstigen Bevollmächtigten, in einer Bürgschaft für die genaue Erfüllung des Bersprochenen.

Die Forderungen weiter auszudehnen hielt ich nicht an der Zeit, weil ich die Länder ausschlußweise von Scutari bis an die Save frey von dem Joche der Türken machen, und Euerer Majestät Staaten einzuverleiben wünsche, wozu die Adler, welche in verflossenem Jahre zu der Expedition nach Bosnien gefertigt worden, bienlich sehn können.

Meine Untergebenen bereiten die Mittel vor; sie raumen viele Hindernisse aus dem Wege; ich treffe Anstalten gegen die Greuelthaten der slavonischen Hayducken, und anderer Horden, welche diese arme Völker bedrücken, und sie zu flüchten zwingen. Mamut Pascha, welcher die Nachricht erhielt, daß die Albaneser und andere Völker mit mir unterhandelten, und ich ihm mit einem Corps zur Seite folgte, um seine Anhänger zu zerstreuen, warf sich in Pristina, eine zu Servien gehörige Stadt; als mein Vortrab erschien, verlies er den Ort, und flüchtete sich, ohne baß ich noch wissen kann wohin; er überließ diese gefegneten Gegenden der Zügellosigkeit der Hayducken, welche die Straßenräuber übertreffen. So standen die Sachen als ich im Begriff war das Schloß Gaßanick, welches in dem berahmten Paß zwischen den

në zbatimin e urdhrave më të lartë dhe nga ata që vijnë prej gjeneralëve tanë e eprorëve të tjerë [dhe] me një garanci në përmbushjen e saktë të asaj që është rënë dakord.

Nuk mendoja se ishte koha për të zgjeruar më shumë kërkesat, sepse dua të çliroj tërësisht vendet prej Shkodrës deri në Savë nga zgjedha e turqve dhe t'i përfshij ato në shtetet e Madhërisë Suaj; për çka njësitë i Shqiponjave, që është krijuar vitin e kaluar për ekspeditën në Bosnjë, do të ishte i dobishëm këtu.

Vartësit e mi janë duke bërë gati mjetet e duhura, duke larguar shumë pengesa. Po ndërmarr masa kundër mizorive të hajdukëve sllavë dhe hordhive të tjera që shtypin këta popuj të varfër dhe i detyrojnë të ikin. Mahmut Pasha kishte mësuar se shqiptarët dhe popujt e tjerë bënin marrëveshje me mua, dhe se unë isha vënë pas me një njësit për të parandaluar avancimin e tij. U gjuajt drejt qytetit të Prishtinës, që i takon Serbisë. Por, kur pararoja ime u nis në drejtimin e tij, ai u tremb dhe iku, nuk e di se ku; i la këto rajone të hapura e të gjera nën mëshirën e hajdukëve, të cilët janë më të zinj (të rrezikshëm) se cubat e malit. Kështu ishin gjërat kur po bëhesha gati të sulmoja kalanë e Kaçanikut, e cila shtrihet në grykën mes maleve që të çon për në Shkup. Për

Gebirgen auf dem Wege nach Uskopia liegt, anzugreifen. Zu meinem Erstaunen war der Pass unbeseßt; um denselben näher kennen zu lernen, rückte ich vor, und begegnete sechs türkischen Fahnen, denen ein Pascha folgte, der vor vier Tagen nach Scopia angekommen war, um Sophia zu unterstützen; die Türken wurden geworfen, vier Fahnen erobert, und einige Gefangene gemacht; nun war ich zu weit vor, um mich ohne Gefahr zurückziehen zu können; ich ließ die Bagage in dem Paß zurück, und unternahm es, das schreckliche acht Stunden lange steile Felsendefilee zu passiren; ich zweifle, daß die Alpen rauher und beschwerlicher waren, als Hanibal nach Italien vordrang; es gelang uns nach der äußersten Anstrengung; auch die Kanonen wurden mit vieler Mühe und angewandten Mitteln nachgebracht, und so kamen wir in die reißende Gegend von Scopia; wir sahen das weite Feld vor uns, in dessen Mitte die Stadt liegt. Der Pascha stand bereit sich zu vertheidigen. Die Lage war bedenklich; nur Entschlossenheit ließ einen glücklichen Ausgang hofen, hierzu stimmte uns das Vivatrufen der Bewohner, welches von den Gipfeln der Berge erschallte. Ich stellte die Truppe in Schlachtordnung zwischen den Fluß Lipenaz und einem großen Graben, der als Wasserleitung dient; der Fluß und der Graben laufen gegen die Stadt, sie gaben mir den erforderlichen Raum für meine Fronte, und beckten meine Flanken. Als ich wahrnahm, daß die Griechen

habinë time, kalimi ishte i panënshtuar dhe i lirë. Për ta njohur më mirë, përparova dhe takova gjashtë bajraktarë turq, të udhëhequr nga një pasha, i cili kishte mbërritur në Shkup katër ditë më parë si përforcim për Sofjen. Turqit u shpartalluan, katër bajraqe (flamuj) janë kapur bashkë me disa të burgosur; tani isha shumë larg për të qenë në gjendje të tërhiqesha, pa rrezik. I lashë furnizimet në kalim dhe mora përsipër të përshkoja për tetë orë një bjeshkë të tmerrshme me shkëmbinj të thepisur. Dyshoj që Alpet ishin aq të ashpra dhe aq të vështira kur Hanibali depërtoi në Itali. Ia dolëm pas përpjekjeve maksimale. Me shumë mund dhe mjete të përdorura u sollën disi edhe topat, dhe kështu arritëm në viset e “ngrysur” të Shkupit; para nesh pamë një fushë të gjerë, në mes të së cilës shtrihej qyteti. Pashai ishte gati të mbrohej. Situata ishte e rëndë. Vetëm vendosmëria na lejoi të shpresonim për një përfundim të suksesshëm; dhe për këtë na motivuan thirrjet mbështetëse të banorëve, që oshëtinin nga majat e maleve. I vendosa trupat në formacion beteje midis lumit Lepenc dhe një hendeku të madh që shërbente si kanal uji. Lumi dhe kanali derdeshin në drejtim të qytetit, duke më dhënë kështu hapësirën e nevojshme për frontin tim dhe për mbrojtjen e njësiteve që kisha në krahë. Kur mora vesh se edhe grekët

für uns geneigt waren, und den Pascha verließen, er selbst aber sich seitwärts von der Stadt aufstellte, rückte ich unter Anrufung des Nahmen Gottes und des Kaisers vorwärts; in drey Stunden waren wir unfern von der Stadt; der Pascha beobachtete unsere Stellung; ich ließ ihn mit den beyhabenben zehn Kanonen begrüßen, bald darauf ergrisfen die Turken die Flucht. Da ich einen Hinterhalt besorgte, ließ ich den Feind mit aller Behutsamkeit verfolgen; es wurden bey dieser Gelegenheit zweyhundert Wagen mit christlichen Familien gerettet, und mehrere Türken gefangen; bey einer größeren Anzahl Truppen wäre es möglich gewesen, dem Feinde alles Fuhrwerk und hunderttausend Stück Bieh abzunehmen. Viele dürften dieses Unternehmen als verwegen betrachten, weil Scopia jenseits des Hámus-Gebirges und außer aller Verbindung mit der Armee liegt; mich hat das Verlangen die Zahl Euerer Majestát Unterthanen zu vermehren, und ergiebige Contributionen einzutreiben, zu diesem Schritt gebracht; die Ausdehnung der Gränze schien mir für künftige Friedensunterhandlungen vortheilhaft. Die Stadt Scopia ist bey nahe so groß wie Prag, ohne Mauern und ohne Graben; ich fand sie unbewohnt, aller Schätze entblößt, mit Lebensmitteln reichlich versehen; die wenigen Menschen, welche sich noch hier aufhalten, sind voll Schrecken; bleich und entsetzt durchwandern sie die Straßen.

Die Citadelle ist nach alter Art gebout, dermahlen bey nahe ohne Bertheidigung

(ortodoksët) që kishin fituar simpati ndaj nesh e kishin braktisur Pashanë, dhe se ai vetë ishte zhvendosur përtej qytetit, eca ca përpara në drejtim të tij duke thirrur në emrin e Zotit dhe të Perandorit; mbërritëm pranë qytetit për jo më shumë se tri orë. Pashai e vëzhgonte pozicionimin tonë; unë e përshëndeta me dhjetë topat që kisha dhe pa vonuar shumë turqit filluan të ikin. Meqenëse po bëja plan për një pritë, armikun e ndoqëm nga prapa me shumë kujdes. Me këtë rast u shpëtuan dyqind vagonë me familje të krishtera dhe u kapën disa turq. Me një numër më të madh trupash, do të kishte qenë e mundur të merreshin të gjitha plaçkat e armikut dhe njëqind mijë kokë kafshë. Shumë do ta konsideronin këtë sipërmarrje si të nxituar, sepse Shkupi shtrihet përtej maleve Hámus dhe larg çdo lidhjeje me pjesën tjetër të ushtrisë [sonë]. Dëshira për të shtuar numrin e nënshtetasve sundimit të Madhërisë Suaj, si dhe për të mbledhur kontribute të pasura më ka sjellë në këtë hap. Zgjerimi i kufirit më dukej i favorshëm për negociatat e ardhshme të paqes. Qyteti i Shkupit është pothuajse po aq i madh sa Praga, pa mure dhe pa hendeqe. E gjeta të pabanuar, të zhveshur nga gjithçka dhe të furnizuar në mallra me bollëk; ata pak njerëz që ndodheshin aty dukeshin të tmerruar, të zbehtë dhe të shpërfytyruar, duke u endur rrugëve.

Kalaja është e ndërtuar në stilin e vjetër, tashmë pothuajse e

und ohne Wasser; sie hat keinen Raum, um Cavallerie, welche zu Eintreibung der Contributionen so nöthig ist, unterzubringen. Wir blieben die Nacht hindurch unter dem Gewehre.

Ich machte dem Obersten Strasser den Vorschlag, hier das Commando zu übernehmen; dieser erfahrene Kriegsmann verlangte fünfzehn Tage, um mit Verwendung aller Truppen, und der aufzubringenden Landleute die Citadelle in Vertheidigungsstand zu setzen, und gehörig zu approvisioniren; ich sah die Billigkeit dieser Bedingniß ein, konnte mich aber nicht entschließen, so lang mit dem ganzen Corps bey dieser Stadt zu bleiben; eine feindliche Armee konnte in vier oder fünf Tagen vor Scopia erscheinen; wir hatten einen Paß im Rücken, welcher bey häufigem Regen, der in dieser Jahreszeit von einem Tag zum andern zu erivarten war, nur sehr langsam und mit größter Mühe hinterlegt werden konnte; das Cassover-Land war unbesetzt, Nissa von uns entfernt, Bosnien blieb uns im Rücken. Diese Umstände verlangten eine reife Ueberlegung, und während ich noch unschlüssig der Sache nachdachte, erhielt ich eine Staffette, welche die Nachricht brachte, daß der Markgraf Ludwig von Baden im Zurluckzug begriffen sey. Nun beschloß ich nicht ohne Unmuth, die Stadt unter der Asche zu begraben. Es that mir weh, Gebäude dergleichen wie ich in diesem Krieg noch nicht gesehen; Moscheen von feinstem Marmor und Porphir, mit tausenden von Lampen und vergoldeten

pambrojtur dhe pa ujë. Nuk kishte vend për të akomoduar kalorësinë, e cila është aq e nevojshme për të mbledhur kontributet. Qëndruam gjithë natën nën pushkë.

I sugjerova kolonel Shtrazerit që të merrte komandën këtu. Ky luftëtar me përvojë kërkoi pesëmbëdhjetë ditë për të vënë në rend të gjitha trupat dhe fshatarët, për të mbrojtur kështjellën dhe për ta pajisur siç duhet me furnizime; e kuptova arsyen e kësaj kërkese, por nuk qe e mundur të merrja vendim të qëndroja kaq gjatë me të gjitha trupat e ushtrisë në këtë qytet; një ushtri armike mund të shfaqej përpara Shkupit për katër ose pesë ditë. Pas vetes kishim një kalim, i cili mund të kalohej veçse tepër ngadalë dhe me shumë vështirësi, mbi të gjitha duke pasur parasysh reshjet e shpeshta në këtë periudhë të vitit që pritej të binin nga dita në ditë. Toka e Kosovës ishte e vështirë për t'u mbrojtur, Nishi ishte larg nesh, kurse Bosnja mbetej [shumë] prapa nesh. Këto rrethana kërkonin një plan të menduar mirë dhe, ndërsa unë ende po e shqyrtoja çështjen në mënyrë të pavendosur, mora një letër porosie që njoftonte se Margravi Ludvig i Badenit ishte duke u tërhequr. Kështu, jo pa pendesë, vendosa ta varros qytetin nën hi. Më dhimbsej për faktin se këso lloj ndërtesash nuk ishin parë ende në këtë luftë. Xhamitë e bëra nga mermeri dhe porfiri më i mirë, të

Alkoreanen verziert, denen man auch in Rom einige Aufmerksamkeit fchenken würbe, schöne Alterthümer, Carten und Lustorte, ebschon im barbarischen Geschmad, einen sehr großen Vorrath an Lebensmitteln, den Flammen preis geben zu müssen. Um aber dem Feinde nichts zu überlassen, was nicht behauptet werden konnte, um Furcht und Schrecken unter den barbarischem Völkern zu verbreiten, und die Waffen meines Herrn auch in den entferntesten Gegenden furchtbar zu machen, schritt ich zur Ausführung. In allen Ecken der Stadt waren Leute mit Fackeln bestellt. Auf das Signal von drey Kanonenschüssen brach das Feuer aus, der Rauch verdunkelte den Sonnenschein des 26ten Octobers, und jenen noch des folgenden Tages; wir standen wie Domitian auf einem nahen Berg, und unter dem Wiederhall kriegerischer Instrumente, sahen wir den Brand dieses schönen Ortes wahrlich nicht ohne Qual und Bedauern, während sich der Gedanke vordrangte, daß die schönen Borstädte Wiens einem eben so harten Schicksal unterliegen mußten.

Was sollte ich thun? hätte ich hinreichende Truppen gehabt mich hier zu behaupten, ich würde noch weiter vorgedrungen seyn.

Nachdem ich den Paß hinterlegt hatte, wurde derselbe seht stark an mehreren Orten verhaue; die Infanterie schickte ich nach Pristina; einen Theil der Cavallerie stellte ich gegen Sophia als Vorposten aus, mit dem Ueberrest trat

zbukuruara me mijëra llamba dhe alkorane të praruara, të cilat do të tërhiqnin vëmendje madje edhe në Romë, antikitetë të bukura, karroca dhe vende kënaqësie, anipse në shije të barbarëve, një depo shumë e madhe furnizimi ushqimesh. Por, për të mos i lënë asgjë armikut që nuk mund të merrej [me vete], për të përhapur frikë e tmerr midis popujve barbarë të atyre anëve dhe për t'i bërë armët e zotërisë tim të ngjallnin frikë edhe në zonat më të largëta, shkova përpara në ekzekutimin e këtij plani. U dha urdhri që në çdo cep të qytetit të vendoseshin njerëz me pishtarë. Me sinjalin e tri të shtënave të topave u ndez flaka, tymi errësoi diellin e 26 tetorit dhe atë të ditës pasardhëse. Ashtu si Domitiani, ne qëndruam në një kodër aty pranë dhe me jehonat e instrumenteve luftarake, pamë djegien e këtij vendi të bukur, jo pa dhimbje dhe keqardhje, ndërsa filloi të na kaplojë mendimi se edhe kalaja e bukur e Vjenës [dikur] i qe nënshtruar një fati po aq të ashpër.

Çfarë duhej të bëja? Po të kisha pasur trupa të mjaftueshme për të mbajtur pozicionin tim këtu, do të kisha përparuar edhe më tej.

Pasi e kalova grykën, ajo ishte shkatërruar rëndë në disa vende. E dërgova këmbësorinë në Prishtinë. Një pjesë të kalorësisë e vendosa si pikë përforcuese kundër Sofjes dhe me pjesën tjetër marshova drejt

ich ben Marsch nach Albanien an, um die dortigen Verhandlungen zu beendigen. Ich lasse die Eingänge in Bosnien und in die Herzegowina recognosciren, und erwarte die zugesagte Unterstußung des Markgrafen von Baden. Ich ruhe nicht um Euerer Majestät gut zu dienen; an Willen gebricht es mir sicher nicht, um mich auszuzeichnen als

Euerer Majestät
unterthänigst treu gchorsamster

Piccolomini.

P. S. In Scopia waren 60,000 Einwohner, nebst 40,000 dahin Geflüchteten, und 400 jüdische Familien, welche acht und vierzig Stunden vor meiner Ankunft die Stadt verließen. Zwey Priester, welche in Loretto studirt haben, sagen aus, daß sie vor wenig Tagen in Sophia waren, wo sich ein Franzose, welcher ben dem Sultan in Ansehen steht, dermahlen aufhält; ich führe diese Geistlichen und zwanzig christliche Familien mit; seiner Zeit werde ich sie mit Almosen von Euerer Majestät Geld entlassen, denn ich bin außer Stand von dem Meinigen Almosen zu vertheilen.

Shqipërisë për të përfunduar negociatat atje. I kam nën kontroll hyrjet në Bosnjë dhe në Hercegovinë dhe pres përforcimin e premtuar nga Margravi von Baden. Nuk do të pushoj së shërbyeri më së miri Madhërisë Suaj. Sigurisht që nuk më mungon vullneti për t'u dalluar pranë

Madhërisë Suaj,
si më besniku dhe më i zellshmi

Pikolomini.

P. S. Shkupi kishte 60 000 banorë, së bashku me 40 000 refugjatë që janë vendosur atje dhe 400 familje hebraike, të cilët u larguan nga qyteti dyzet e tetë orë para mbërritjes sime aty. Dy priftërinj që kanë studiuar në Loretto (Romë) thonë se disa ditë më parë ishin në Sofje, ku aktualisht po qëndronte një francez i respektuar nga Sulltani. I mora me vete këta klerikë dhe njëzet familje të krishtera. Në kohën e duhur do t'i liroj me lëmoshë nga paratë e Madhërisë Suaj, sepse nuk jam në gjendje të shpërndaj gjë prej lëmoshës sime.

Dokumenti 5:

[9] nëntor 1689, Prizren

*Raport anonim nga kampi i Pikolominit*⁶

Von dem corpo unter Commando des Feld Marschal Leut.[enant] Graffen Piccolomint das man folgend Particnlaria erhalten, nehmlich, es a[trib]urt[e] gedachter General am 28 Octob.[er] vom Scopia an den en[d]en Paß von Kazianeck zurück, mit sich führende viele Land [L]eute auß der Gegend von Scopia, wolche man dann voraus Marchieren Lassen.

Am 29 verbliebe daß Corpo in der mitten selbigen Paßes, und Marchierte am 30 die Cavallerie voraus, die Infanterie aber verbliebe noch selbigen Tag umb selbigen Paß zu verßauen, und kahme man am 31 ausser der Cage bey der Bagagio wleder an, welche bey der March nacher Scopia daselbsten zurück geblieben, selbiaen Tages separierte sich selbiges Corsso(?), und Marchierte am 1 Novemb.[er] (nachdehme daß Castell von Kazianeck wal beseßer gelassen worden) der Herzog von Hollstein mit seinem Regiment, und denen Curassierern von Hannover nacher Patiani gegen dem Berge Hamus, der General Piccolomini aber marchierte selbigen Tages mit den übrigen Reste der Militie nacher Lippian, woselbsten der Herr Obriste Strasser Commandieret wurde mit der Infanterie und 6.

Nga njësiti ushtarak nën komandën e feldmareshal lejtënant kontit Pikolomini, është pranuar një *partikularia* si në vijim, me të dhëna se si ky gjeneral më 28 tetor është kthyer nga Shkupi në Grykën e Kaçanikut, i shoqëruar nga shumë fshatarë vendës prej zonës së Shkupit, të cilët i ka lënë të ecnin të lirë.

Më [datë] 29, njësiti ushtarak u ndal të qëndronte në po atë grykë, dhe më [datë] 30 kalorësia marshoi më tej, kurse këmbësoria mbeti edhe më tutje për ta mbrojtur atë, ndërkaq më 31 do të mbërrinin jashtë fortifikimit, për të marrë bagazhet, të cilat pas marshimit drejt Shkupit qenë lënë aty. Të njëjtën ditë e njëjta trupë ushtarake u nda dhe më 1 nëntor (pasi kalaja e Kaçanikut i ishte lënë në mbrojtje) duka i Holshtajnit marshoi me regjimentin e tij të kalorësisë së madhe të Hanoverit për në Patiani (?), në drejtim të malit Hamus. Në anën tjetër, po atë ditë, gjeneral Pikolomini marshoi me pjesën e mbetur të ushtrisë për në Lipjan, ku kolonel Shtrazer u urdhërua me këmbësorinë dhe gjashtë topa për të shkuar në kështjellën e vogël të Zveçanit dhe në atë të Banjskës, që ndodhen në drejtim të grykës për në

⁶ Raport i botuar në gazetën e Hamburgut *Die Europäische Relation*, të datës 10 dhjetor 1689, sipas kopjes së mikrofilmuar nga Staats - und Universitätsbibliothek Bremen. Në përkthimin e këtij dokumenti ka ndihmuar Andreas Reich, prof. dr. Blerta Ismajli.

Canonen nach den kleinen Castel von Zwetzen, und Panza zu gehen, so auff den Paß von Boßnien Situiert, ümb die Türcken so noch darinnen befindlich von dannen zu vertreiben, welchen zu folge, gedachter Obriste am 2 sich von den General Piccolomini Separierte, welcher (ob Er gleich von einen hefftigen Fieber befallen, und überderdehme von einem geschwüre unter den rechteren Armen Incommodiert) sich mit seinem Regiment, und den Dragonnern von Styrum, nebenst 2 Stücken Geschuß nacher Albanien gewand, ümb allda hinem zu Marchieren, und zu seßen wie weit man mit denen Jutavolierten Tractaten Avancieret, weiln aber Sr.[erenite?] Exell.[entie] selbigen Tages sich mehr den des vorigen Incomindierer befunden, alß bliebe Er mit der Militie am 3 zu Capuschnik beligen und erhielte man Rachricht, daß der Obrist Leutenant Mauersberg von Stirumischen Regiment, daß kleine hintere Castel gegen Boßnien Panza genandt, Grobert, das vordere aber welches ein Situation gleich Mongats hat, könnte ohne mehreren Anzahl Volks; und Feuerwerckereyen nicht bestickten worden, weiln nuß obgedachter Obrister Strasser mit der Infanterie dorthin Marchieret, so wurde der erste beordert nacher Pristina zu seinen Commando sich wieder zu erheßen.

Bosnjë [me urdhër] për të përzënë turqit që ishin ende duke qëndruar atje. Ky kolonel, sipas urdhrit të dhënë, u shkëput nga gjeneral Pikolomini më datë 2, i cili (ndonëse ishte kapluar nga një temperaturë e fortë dhe ndiente një gungë nën krahun e djathtë që i shkaktonte shqetësim) me regjimentin e tij dhe dragonjtë e Stirisë, së bashku me dy copa artilerie, u nis në drejtim të Shqipërisë për të marshuar atje dhe për të parë se deri ku kishte avancuar marrëveshja e bërë pak më parë. Sidoqoftë Shkëlqesia e Tij, për shkak të shqetësimit që kishte [sëmundje], nuk e pa të mundur të vazhdonte më tutje, si një ditë më parë, prandaj u detyrua të ndalej me ushtarët [e tij] në Llapushnik edhe në datën 3, ku do të pranonte një raport se kolonel togeri Mauersberg i regjimentit të Stirisë kishte marrë nën kontroll një kështjellë të vogël në skaj që shihte drejt Bosnjës, të quajtur Banjska (Panza), e ashpër, ndërkohë që kështjella e përparme, e cila ngjasonte me atë të Mukaqevës,* nuk qe e mundur të merrej pa një numër [shitesë] njerëzish dhe pushkësh. Për këtë arsye, i sipërpërmenduri kolonel Shtrazer është detyruar të marshonte atje me këmbësorinë e tij; ndërsa i pari është urdhëruar të kthehej në komandën e tij në Prishtinë.

Ob nun auch gleich keine besserung

Edhe pse nuk pati asnjë përmirësim

* Kështjella Mungats, apo kështjella e Mukaqevës, sot në Ukrainë. Është e vërtetë se në një gravurë të shek. XVI Zveçani ngjan shumë me kështjellën e Mukaqevës.

bey der Herrn Generalen sich dewühren lieffe, so wolte deunoch derselbe nicht länger stille liegen, umb bey so weit avancierten Jahrs Zeit keine zeit zu verliehren, sondern ließ den March wegen besorgenden schlimmen Wetters beschleunigen; weißwegen Er dann ame von gedachten Capuschiert mit der zweyen Regiementeren auffgebrochen, und bey Pannige lagert, woselbsten Nachricht erhielte, daß der Commandant von Pyrot, eine Parthey mit weniger Teutschen Militie, und mehr alß 800 Raßen und Ungarn gemacht, so ibine auch anfänglich wol geglückt, siatemahlen Er mehr alß 1500 Turcken auß ihren Lager getrieben, so sie bey Dragomon gehabt, nachdehine aber von berden Seiten eine Reserve von 5000 Turcken, und 4000 Tartarn über von Gebirge ankommen, so seind die Unserigen ganß ümbgeben worden, also daß sie nach einen langen Gefechte, und verlust etlicher 100 von beeden Seiten, die Flucht ergreifen müssen.

Auss diese Rachricht wurde der Obriste Strasser beordert, sich schleunig uacher Nissa zu begeben, daselbsten daß Commande zu führen. Die Herrn General aber Avancierte in seinen March, und arrivierte am 5 zu Mamulcha 3. Stunden von Prisseren, denen alwo mit Albanesere [Trac]tieret wurde.

Am 6. brach man von Mamuscha auff, und marchierte biß zu gedachten Ohrt von Preiseren, woselbsteu der Her.[rn] General von dem Erz Bichoffe selbigen Landes und den Patriarchen von

në shëndetin e gjeneralit, ai nuk donte të rrinte pa lëvizur më tutje, në mënyrë që të mos humbiste kohë në një sezon kaq të vonshëm të vitit, prandaj për shkak të motit të keq e shqetësues u detyrua të përshpejtonte marshimin e tij. Për këtë arsye u nis nga Llapushniku në fjalë me dy regjimentet dhe vendosi kampin pranë Banjës, ku mori lajmin se Komanda në Piroto kishte bashkuar njësitet e ushtarëve gjermanë me më se 800 ushtarë rashianë dhe hungarezë, të cilët fillimisht ishin treguar të suksesshëm, duke dëbuar më shumë se 1 500 turq nga kampi i tyre që ishte vendosur në Dragomon, por më pas njësitet rezervë prej 5 000 turqish sulmuan prej njëres anë dhe 4 000 tartarë prej anës tjetër të maleve, kështu njerëzit tanë ishin detyruar të braktisnin postin e tyre pas një beteje të gjatë dhe pas humbjes së disa qindra ushtarëve nga të dyja anët.

Si rezultat i kësaj disfate, kolonel Shtrazer u urdhërua të shkonte shpejt në Nish për të marrë komandën atje. Ndërkohë që vetë gjenerali, më datë 5, përparoi në marshimin e tij dhe mbërriti në Mamushë, një 3 orë nga Prizreni, ku nisi diskutimet me shqiptarët.

Më datë 6 u nisën nga Mamusha dhe marshuan në qytetin e përmendur të Prizrenit, ku zoti gjeneral u prit nga kryepeshkopi i të njëjtit vend dhe nga krerët e Kelmendit, të cilët

Climent empfangen wurde, so eine Fahne mit den Zeichen des Creußes vorher tragen liessen, und stunden bey 5000 Arnauten, Albaneser Christen und Turcken, und andere National Volck, in zweyen Linien vor der Stabt ins Gewehr, welche sämbtlich bey Durchpaßierung der Teutschen Militie eine Dreysache Salve gaben, und nachgehends so woll selbige als diekinsrige nahe bey einander Campireten.

Am 7. erfolate zwischen Se. Exell.[entie] den Her.[rn] General Piccolomini (welcher wegen seiner anwachsenden Kranckheit un Bette sich besande), und abgedachten Erz Birchoffe nebenst anvern Officianten, so sich unter Ihre Käyser.[lische] Maytt. Devotion ergaben, eine Unterrebung wegen den angefangenera Tractatenm selbigen Tages erhielt man and Rachricht, das Ihr Durchl.[aus] von Baden zu verstärckung dieses Corpo 3 Regimenter abgesandt, nehmlich das Craische und Serausche zu Fuß und das Hannoverische Draoguner Regiment, und daß selbige bereits Zeit den ersten dieses von Fetislau außers aufgebrochen, wesswegen dann zu veren Reneoutrirung schlernige Ordre ortheilet ward, nehaiblich dass das Serausche und Croische nocher Nissa und Precopia, das Hannovrische ober nacher Pristina sich begeben solte, allda zu überwintern, Un dem Herzogen von Hollstein ward auch selbigen Tages gesch teben, das Sr. Durchl.[aus] webrender Rranckheit des Hn. Generals das völlige Commando

[paraprakisht] mbanin një flamur me simbolin e kryqit, dhe ishin të shoqëruar prej 5 000 arnautësh, shqiptarësh të krishterë e turq, si dhe popuj të kombeve të tjera, të ndarë në dy rreshta përpara shtabit, të cilët me pushkë krisën tri breshëri të shtënash kur ushtria gjermane po parakalonte pranë tyre; dhe më pas të gjithë së bashku vendosën kampet afër njëri-tjetrit.

Më datë 7 pati një takim midis gjeneral Pikolominit (i cili ishte në shtrat për shkak të sëmundjes së tij në rritje) dhe kryepeshkopit të sipërthënë, së bashku me oficerët e tjerë që ishin të përkushtuar të qëndronin nën mbrojtjen Cezariane sipas marrëveshjes së lidhur. Të njëjtën ditë erdhi një njoftim me lajmin se Hirësia e Tij e Shkëlqyer von Baden, kishte urdhëruar nisjen e 3 regjimenteve si përforcim për njësitet që ndodheshin aty; përkatësisht ata të këmbësorisë së Krojit (Croy) dhe Seranit (Seauraut) si dhe regjimentit të dragonjve të Hanoverit, dhe se të njëjtit [regjimente] ishin nisur tashmë më datë 1 të këtij muaji nga Fetislami, për të cilët u lëshua një urdhër i veçantë që të shkonin në vende të caktuara, përkatësisht që Serani dhe Kroji të shkonin në Nish dhe në Prokupje, ndërsa ai i Hanoverit të shkonte lart në Prishtinë për të kaluar dimrin atje. Duka i Holshtajnit u informua gjithashtu po atë ditë, se Shkëlqesisë së Tij, për shkak të gjendjes së përkeqësuar të gjeneralit, do t'i jepej komanda e plotë e ushtrisë me vendim

sühren, und nacher Pristina marchieren möchte.

Am 8 wurde zu gedachten Presseren ein Ansang gemadet, mit selbigen National Troupen ein und andere Disposition zu smachin welche außi gemissen Conditionen acceptiret wurden, nehmlich dass von allen denen, so Belichuna tougen, vorSoldaten zu ienen, ordinirte und regulierte Regimenter solten formieret werden die jenigen aber so verlangen trugen in den Städien nod Döiffern zu wohnen, das Gewehr niederlegen solten, und waro indeßen mit den anwesenden das Regulament gemachet, biß die ander en des gaussen Landes auch anlangeten welche wegen verzdgterter Ankunßt der Deutschen wieder nadier Hause gegangen.

Aus 9 zu Morgens harte die Kranckheit des Herrn Generalen der [o]lgestalt zu genow[ar]en, daß der Erh Bischoff selbstn ihme die Sacramente der Kirchen reichete, und gabe mehrge meldier General zu höchsten Leydwesen der gayßen Armee um 7 Uhr sor Morgens seinen Geist auff.

Nach geheuds hat man Nachricht erhalten, das Ihm der I.[hre] Durchl.[aus] Herzg von Hollstein die Stadt Stippa erobert, 2000 Turcken ne dergemachst unb eine größere Anzahl von dannen perpaget.

që të marshonte drejt Prishtinës.

Më [datë] 8, në të njëjtin qytet Prizrenin, u bënë përpjekje për disa sqarime shitesë me trupat e përmendura kombëtare [shqiptarët], përmes të cilave u pranuan deri diku edhe disa kushte, përkatësisht të gjithë ata që dëshironin të qëndronin si ushtarë do të regjistroheshin në regjimente të organizuara dhe të rregullta, por të tjerët që zgjidhnin të jetonin në tokën e tyre në qytet apo në fshat dhe të mos luftonin, do të duhej t'i dorëzonin armët. Dhe derisa u bënë përgatitjet me ata që mbetën, ndërkohë mbërritën edhe popuj të tjerë nga viset e largëta, të cilët nuk kishin qenë prezent deri atëherë për shkak të mbërritjes me vonesë të gjermanëve.

Më datë 9, në mëngjes sëmundja e gjeneralit ishte përkeqësuar aq shumë, sa vetë kryepeshkopi ia administroi atij sakramentet e kishës, kështu që në orën 7 të mëngjesit, për pikëllimin e madh të të gjithë trupave të ushtrisë, shpirti i tij e lëshoi trupin.

Ndërkohë sipas raportimeve, u mor lajmi se duka i Holshtajnit kishte pushtuar qytetin e Shtipit [ku] ishin dëbuar prej andej 2 000 turq dhe një numër më të madh i kishte marrë peng.

Dokumenti 6:

1 janar 1690 [Prishtinë]

Fragment nga relacioni i Xhovani Françesko Pompeati⁷

Relatione di quanto nel Paese di Cossova e passato sotto il comando del Sig. Colonello Barone Strasser, con alcuni Squadroni di Cavalleria, e 200 Fanti, contro incirca 40000 Turchi, Tartari, & Arnauti dell'Albania, seguito à di 1 Genaro, 1690. [...]

Morse frà tanto l'Arcivescovo di Albania, che con ardore Christiano somentava tutti quei Popoli alla divozione verso Sua Maestà Cesarea; ese ben questo colpo parue gl'intepidisse alquanto, non lasciò Sua Altezza pertanto d'impiegare altri mezzi, per sollecitarli à perseverare nella fede data, come in fatti à mezzo Dicembre scorso comparuero pur li Clementini in Pristina, à ratificare col loro Religioso il giuramento già tempo fà prestato in Pecchia. Li Gassi à ricevere l'ordine per l'immissione in Diacovizza; e finalmente doppio molti allettamenti, e carrezze fattegli da lontano, mette si tratteva Spettatore dell'esito delle facende, il Patriarca di Pecchia in Erzegovina comparue pur egli in Pristina, e ricevuto dall' Altezza Sua con ogni dimostrazione di affetto, fù dalla medesima ordinato al Segretario

Raporti i asaj që ndodhi në Kosovë nën komandën e z. kolonel baron Shtrazer, me disa skuadrilje kalorësie dhe 200 këmbësorë, kundër afërsisht 40 000 turqve, tartarëve dhe arnautëve të Shqipërisë, dhënë më datë 1 janar 1690. [...]

Vdiq edhe kryepeshkopi i Arbërisë, i cili me zjarr të krishterë i nxiti të gjithë këta popuj në përkushtim ndaj Madhërisë së Tij Cezariane. Ndonëse kjo goditje dukej se e kishte molisur paksa, Lartësia e Tij* nuk e ndaloi veten të përdorte mjete të tjera për t'i nxitur [këta popuj] të mbanin fjalën e dhënë, pasi në fakt në mes të dhjetorit të kaluar kelmendasit u shfaqën në Prishtinë për ta ratifikuar betimin për besnikërinë e tyre, tashmë të dhënë në Pejë disa kohë më parë. Gashët për të marrë urdhrin për hyrje në Gjakovë; dhe më në fund, pas shumë joshjeve dhe thirrjeve që iu dhanë nga larg, meqë sillej si spektator i rezultateve të ngjarjeve, në Prishtinë u shfaq edhe patriarku i Pejës në Hercegovinë, i cili u prit nga Lartësia e Tij me shumë nderime e dashuri; me urdhër nga i njëjti [Holshtajn] për sekretarin e të

⁷ Relacion i botuar si fletushkë më vete, sipas kopjes së skanuar nga Biblioteka shtetërore e Bavarisë. Një version në gjuhën holandeze i letrës është botuar në periodikun *Hollandse Mercurius* për vitin 1690, botuar në vitin 1691 në Harlem (f. 290-294). Falënderojmë prof. dr. Majlinda Bregasin për ndihmën në përkthimin e këtij fragmenti.

* Këtu e ka fjalën për gjeneral Holshtajnin.

del Sig. Gen. Conte Piccolomini Defonto, di ricondur'il Patriarca in Pecchia, ad assieme con esso lui procurare di attirare quelli dell'Erzegovina, & altri Confinanti à quella Provincia, alla divozione di Sua Maestà Cesarea. Intanto S. A. sebene dalla metà di Dicembre in quà aggravata da travagliosa indisposizione, che la riducesse sin'à gli estremi, non lasciava mai cosa intentata, per ben'incamminar, e diriggere le cose del comando, anzi richiedendo frequente li sentimenti de' Primarii Sig. Ufficiali, mostrava con ciò il zelo, la premura, e la confidenza assieme, diffidando anzi di se stesso per via dell'infermità,&c. [...]

Il Si[gniore] Gio[vanni] Francesco Pompeati già Secretario del Si[gniore] Conte Piccolomini, Soggetto di molta pratica in quella parti, che fu adoprato nelle commissioni della Generalita con tutte quelle Nazioni confinanti all'Albania, Macedonia, e Ezregovina, ne'Trattati della Soggezione da quei Popoli giurata a S[ua] M[ajesta] C[esarea] stato qui di passaggio alla Corte Cesarea per le Poste, porto qua il sudetto Racconto.

ndjerit Pikolomini, që ta kthejë patriarkun në Pejë dhe së bashku me të të përpiqet të tërheqë ata popuj të Hercegovinës dhe fqinjë të tjerë të asaj province, në përkushtimin e Madhërisë së Tij Cezariane. Ndërkohë, Madhëria e Tij, ndonëse nga mesi i dhjetorit e tutje i rënduar nga një sëmundje e komplikuar, e cila e preku deri në gjymtyrë, nuk la asgjë pa bërë, që të mund të ecte dhe të drejtonte vetë punët e komandës, në vend që të kërkonte mendimet e zyrtarëve të lartë; në këtë mënyrë ai tregoi zell, shkathtësi dhe besim së bashku, madje duke mos i besuar as vetes për shkak të dobësisë së tij etj. [...].

Zoti Xhovani Françesko Pompeati, ish-sekretar i zotit kont Pikolomini, subjekt i shumë praktikave në ato anë, i cili punoi me komisionet e gjeneralit me të gjitha ato kombe që kufizojnë Shqipërinë, Maqedoninë dhe Hercegovinën, për nënshkrimin e traktateve nga ata popuj për Shkëlqesinë Tuaj Cezariane, duke u ndalur në rrugë e sipër pranë zyrës perandorake për postë, po e sjell rrëfimin e sipërshkruar.

